

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XLII nr. 105 / 2014

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore

Viti XLII nr. 105 / 2014

Botues:

Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës

Prishtinë, rr. Vellusha nr. 84

Tel & fax: 038 / 224-024

e-mail: **edukataislame@hotmail.com**

Kryeredaktor:

Mr. Qemajl Morina

qemajlmorina@hotmail.com

Redaksia:

Akad. Pajazit Nushi, Dr. Fejaz Drançolli, Dr. Ejup Sahiti,
Nexhat Ibrahim, Hajrullah Hoxha dhe Dr. Xhabir Hamiti

Sekretar i redaksisë:

Hajrullah Hoxha

Lektor:

Bislim Berisha

Realizimi: **Shtëpia Botuese**



Redaktor teknik &

Operator kompjuterik:

Nuhi Simnica

Shtypi: “Grafika REZNIQI” - Prishtinë

Tirazhi: 600

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XLII nr. 105 / 2014

Prishtinë
2014

EDITORIALI

Qemajl Morina

LUFTA NË SIRI DHE PJESËMARRJA E SHQIPTARËVE NË TË

Edhe pesimistët më të mëdhenj nuk do të besonin se lufta në Siri, e cila që nga muaji mars ka hyrë në vitin e katërt të saj, do të zgjasë aq shumë dhe se me vete do të marrë një numër aq të madh viktimash. Sipas të dhënave të Observatorit sirian për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, me seli në Londër, thuhet se deri më tani në Siri ka mbi 150.000 të vdekur dhe mbi 350.000 të plagosur, shumica prej tyre, pleq, gra dhe fëmijë. Në ndërkohë që mbi dy milionë e gjysmë janë shpërngulur jashtë Sirisë, kurse numri i të shpërngulure në vende fqinje siç janë: Turqia, Jordani dhe Libani, tejkalon mbi gjashtë milionë e gjysmë.

Ndërkohë që shkatërrimet në aspektin material kishin tejkaluar çdo parashikim. Kështu që në këtë luftë vëllavrasëse deri më tani qytete të tëra janë bërë rrafsh me tokë. Sa për ilustrim po përmendim qytetin e Halepët në veri të Sirisë, i cili edhe pse është nën mbrojtjen e UNESCO-s, ai është shkatërruar tërësisht nga ushtria e presidentit, Bashar el-Asad. Thuhet se janë granatuar dhe shkatërruar mbi 800 xhami nga forcat besnike të qeverisë në pushtet.

Kryengritja në Siri nisi si protestë paqësore kundër Asadit dhe u transformua gjatë dy vjetëve në një betejë të përgjakshme. Por, vrasjet më nuk kanë të bëjnë vetëm me mbështetjen apo kundërshtimin e qeverisë, madje as me Sirinë. Disa shiitë janë duke shkuar në Siri, për shkak se këtë e ndjejnë si obligim fetar. Në Irak, sulmet mbi xhamitë dhe lagjet sunite, të cilat patën shënuar rënie, sërish kanë vazhduar.

Lufta mes sunitëve dhe shiitëve

Derisa Arabia Saudite, Katari dhe Turqia, shtete këto të udhëhequra nga sunitët, janë duke e mbështetur kryengritjen kundër Asadit, që mbështet prej Iranit shiit dhe Hizbullahut, ndasitë sektare në rajon janë duke u shtrirë.

Lufta siriane nxit dhe është e nxitur prej armiqësive më të mëdha në rajon, rrënjët e së cilës ndodhen jo në ndasitë sektare, por në përplasjen e interesave gjeopolitike dhe strategjike: beteja për ndikim në rajon midis Arabisë Saudite dhe Iranit: konfrontimi i Iranit me Perëndimin rreth programit bërthamor dhe aleanca midis Hizbullahut dhe qeverisë laike siriane. Megjithatë, tani kanë filluar të shpërfaqen edhe ndasitë sektare. Iraku është prekur më së shumti në këtë aspekt. Derisa shumica sunite në Siri, janë duke luftuar për ta rrëzuar qeverinë e dominuar nga sektu alevit i Asadit, degë kjo i Islamit shiit, pakica sunite e Irakut luftën në Siri e ka filluar që ta shfrytëzojë për ta rrëzuar qeverinë shiite.

Sot, shumica e irakianëve kanë përshtypjen se janë kthyer në vitet e errëta të viteve 2006 dhe 2007, në kulmin e masakrave me motive sektare.

Në Liban, përplasjet midis militantëve alevitë dhe sunitë në Tripoli, kanë arritur nivelin më të lartë për shumë vite, derisa palët po fajësojnë njëra-tjetrën për masakra në Siri.

Në Siri, si qeveria ashtu edhe kundërshtarët e saj insistojnë nëse lufta civile nuk paraqet përplasje midis sekteve fetare. Liderët rebelë thonë se qëllimi i tyre i vetëm është rrëzimi i diktatorit. Asad thotë se

ai është duke luftuar terroristët ekstremistë, derisa tregohet i kujdes-shëm që luftën të mos e cilësojë si luftë kundër shumicës sunite.

Luftë sektare apo gjeopolitike

Këtu mund të mësojmë se në Siri kemi të bëjmë me një konflikt par excellence sektar mes pakicës alevite dhe shumicës sunite. Për këtë kishte paralajmëruar ish-Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Kofi Anan, “Nëse gjërat nuk ndryshojnë, e ardhmja ka të ngjarë të jetë një represion brutal, masakër, dhunë sektare e madje edhe luftë civile. Të gjithë sirianët do të humbasin”, pati thënë i dërguari ndërkombëtar për krizën në Siri, Kofi Anan, më 7 qershor 2011.

Që nga shtatori i vitit 2011, në Homs ne kemi parë luftë sektare. Pra, kemi ushtrinë siriane që lufton kundër opozitës, por opozitën e përbën vetëm popullata sunite. Ka fare pak njerëz josunitë në Ushtrinë e Lirë, aty nuk ka sa alevitë e as të krishterë.

Alevitët, të cilët janë ndarë nga dega shiite e Islamit në shekullin e IX përbëjnë rreth 10 për qind të popullatës siriane, por janë me ndikim për shkak të dominimit të tyre në qeveri dhe ushtri.

Kështu, Fabris Baloush, drejtor në Institutin francez për kërkime “Gremmo”, i cili ka studiuar rritjen e alevitëve në pushtet, thotë se tensionet shoqërore janë më të mëdha përgjatë vijave kufitare. Kështu në skenë kemi milicinë “Shabiha” (që do të thotë “Fantazmë”) si pjesë e sektit alevit, të cilit i përket edhe familja në pushtet.

Shabiha daton nga koha e babait të presidentit të tanishëm sirian, Hafidh al-Asad, i cili ka marrë pushtetin me grushtshtetin e vitit 1970, duke vendosur sundimin alevit në Siri.

Njëra nga arsyt përse regjimi sirian e konsideron Shabihan të vlefshme, është pasiguria e tij lidhur me besnikërinë e të gjitha njësive të ushtrisë. Baloush thotë se këto shqetësime bëjnë që Damasku të përdorë vetëm një njësi ushtarake, atë të Divizionit të Katërt, që udhëhiqet nga vëllai i presidentit Beshar al-Asad, për të luftuar në provincat e trazuara të Sirisë.

“Divizioni i Katërt, i udhëhequr nga Mahir Asad, është ekskluzivisht alevit - nuk ka as sunitë, as të krishterë, as друзë. Ky divizion përdoret nga regjimi përkundër rezistencës shumë rigorozë. Batalionet sunite janë në zonat tjera, ku ka më pak rrezik, sepse regjimi nuk është i sigurt në besnikërinë e ushtarëve sunitë”, thekson Baloush.

Shkaqet e përfshirjes së shqiptarëve në luftën e Sirisë

Ka kohë që përfshirja e shqiptarëve në luftën e Sirisë është bërë objekt diskutimi dhe shqyrtimi i shumë niveleve të ndryshme, qofshin ato mediatike apo institucionale të ndryshme. Me këtë rast po sjell një analizë të Elton Hatibit, të botuar në të përditshmen “Panorama” të Tiranës.

Në rastin e shqiptarëve të përfshirë në konfliktin sirian, ende nuk ka evidenca që individë të tillë të jenë radikalizuar me synim minimin e bashkëjetesës në vend, por autoritetet duhet ta evidencojnë ose jo këtë dimension të fenomenit në fjalë

Ngjarja kryesore e ditëve të fundit është arrestimi i tetë shtetasve shqiptarë nën akuza që lidhen me organizimin, rekrutimin, stërvitjen dhe financimin e personave të tjerë, për t'i dërguar më pas ata në konfliktin sirian. E veçanta që e fokusoi këtë ngjarje në qendër të vëmendjes së opinionit publik është implikimi i njerëzve religjiozë, që akuzohen se në ambientet e xhamive përkatëse predikojnë pjesëmarrjen në atë konflikt nisur nga motivime fetare. Vërtetësia e plotë ose e pjesshme apo rrëzimi i këtyre akuzave, pritet që të ndodhë në të ardhmen, sidoqoftë prania e disa dhjetëra të shtetasve shqiptarë atje, si dhe rastet e të vrarëve mes tyre, shtrojnë pyetjen e arsyeve të pranisë në këtë konflikt. Shkaqet e mundshme që ndikojnë në vendimin e shumë shqiptarëve që nisen për në Siri janë disa, por për të shkuar deri tek ato, kryefjala mediatike, ku ia vlen të ndalemi sigurisht është ajo e “xhihadit”.

Nuk është këtu mundësia për të analizuar termin “xhihad”, më të përfolurin si nxitësi i fenomenit të pjesëmarrjes së të huajve, mes tyre dhe shqiptarëve në konfliktin sirian, por shumëkush pohon se prania e

tyre atje është produkt i idealizimit të këtij koncepti, i cili pak është trajtuar profesionalisht te ne, kjo edhe për shkak të konotacionit pezhorativ që ka përfutur termi dekadat e fundit. Duhet thënë se pas zërave të parë që informonin prezencën e shqiptarëve atje, shumica e teologëve dhe aktivistëve myslimanë janë pozicionuar kundër kësaj pjesëmarrjeje, duke e argumentuar kryesisht me analogjitë e trajtesave juridike klasike mbi luftën. Shfaqja e një fenomeni të tillë, risi për shoqërinë tonë, siç duket i ka gjetur të papërgatitur maksimalisht aktorët që mund të zbutin efektet e saj. Zëri i profesionistëve duhet të jetë më i fortë dhe më bindës për të analizuar teorikisht fenomene shoqërore që implikojnë religjionin, politikën, ekonominë dhe ligjin, të cilat në të ardhmen mund të paraqiten në trajta më komplekse dhe më kërcënuese sesa rasti në fjalë. Interpretimi *ad litteram* i konteksteve religjioze nga e kaluara historike e bashkësive të para të myslimanëve, dhe mbivendosja e tyre në realitetin sirian, duket se ka motivuar mjaftueshëm për t'u përfshirë fizikisht në atë që së fundi ka degeneruar në një konflikt të përgjakshëm civil.

Sociologët e fesë theksojnë se bota sot është në shumicën e rajoneve të saj më religjioze se kurrë më parë. Thënë këtë, duhet të njohim të gjitha trajtat e këtij rigjallërimi shpirtëror që në disa raste manifestohet në forma të ngurta. Dekadën e fundit, në disa vende myslimane konfliktet e ndryshme me karakter politik kanë marrë gjithashtu edhe ngjyresa sektare, ku ithtarë të bashkësive të ndryshme janë futur në spirale dhune të pandalshme. Këtu jemi dëshmitarë të dështimit të autoriteteve fetare, të cilëve situata u ka dalë nga kontrolli në favor të grupeve marginale që interpretojnë fenë ngushtësisht për të maksimizuar përfitimet politike. Pasojat e këtyre konflikteve ndërkohë kanë një impakt të gjerë në opinionin publik ndërkombëtar, saqë shpesh përtej një solidariteti me karakter humanitar që zbutin pasojat e konflikteve, implikojnë dhe përfshirjen emocionale të simpatizantëve në rreshtime militante.

Në rastin e Shqipërisë, mund të theksojmë fort se nuk ka premisa për përplasje sektare, dhe se mes besimtarëve të feve të ndryshme, grupe potenciale që mund të minojnë bashkëjetesën mes feve janë të

papërfillshme. Gjithsesi, në rastin e bashkësisë së myslimanëve, autoriteti fetar është ende i brishtë pas goditjes që pësuan komunitetet fetare gjatë diktaturës komuniste. Duke qenë se Islami nuk ka një autoritet ekstrakombëtar, përpjekjet vendore për ta ripërtërirë këtë autoritet kanë rezultuar të pamjaftueshme aq sa të shkërmoqin çdo interpretim sektar në dëm të bashkësisë së gjerë. Energjitë e titullarëve institucionale më së tepërmi janë kanalizuar në shëndoshjen ekonomike të administratës dhe konsolidimit të saj burokratik, sesa ngjizjes së një fizionomie spirituale me karakter origjinal. Gjithashtu, bota akademike ende ka një alergji ndaj dijeve teologjike, të cilat do të ishin kontributore në pasurimin e jetës intelektuale në shoqërinë shqiptare, pasurim i cili do të amortizonte rrëshqitjet mediokre me pasoja konfliktuale.

Sakaq për ekspertët ndërkombëtarë, jo cilido luftëtar i përfshirë në konfliktin sirian është një radikal potencial, i cili me kthimin e tij në vendin e origjinës do të përbëjë një kërcënim për sigurinë kombëtare. Etiketimi i tyre *en bloc* si radikalë dhe ekstremistë nuk do ta ndihmonte zbutjen e problemit, përkundrazi, do ta thellonte atë, duke e futur në një prizëm që më tepër përfshin panikun sesa arsyen e shëndoshë. Por, nuk duhet përjashtuar assesit që individë të tillë mund të kthehen me agjenda ekstremiste apo që të jenë përfshirë në rrjetin e terrorizmit ndërkombëtar, i pranishëm mjaftueshëm në Siri. Në rastin e shqiptarëve të përfshirë në konfliktin sirian, ende nuk ka evidenca që individë të tillë të jenë radikalizuar me synim minimin e bashkëjetesës në vend, por autoritetet duhet ta evidencojnë ose jo këtë dimension të fenomenit në fjalë. Autoritetet, pas masës paraprake të parandalimit të përfshirjes në konfliktin sirian të të rinjve shqiptarë, duhet të ndjekin rast pas rasti cilindo prej tyre që kthehet në vend, dhe për ata që nuk janë përfshirë në aktivitete kriminale, me ndihmën e ekspertëve, duhet t'i përfshijnë në programe rehabilitimi. Trajtimi me gjakftohtësi i një realiteti sakaq kompleks do të ishte zgjidhja më e mirë dhe çarmatosja më efikase ndaj radikalizmit potencial të elementëve që popullojnë margjinat e shoqërisë shqiptare.

Sa mund të jetë numri i luftëtarëve shqiptarë në Siri?

Në Siri, luftojnë mbi 400 shqiptarë kundër al-Asad. Gjithsej 28 janë vrarë.

Mes viktimave janë edhe 28 shqiptarë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe Presheva. Numri i viktimave është i njëjtë me ata të vrarë në luftën e fundit mes forcave serbe dhe forcave shqiptare (UÇPMB-së) në Luginën e Preshevës, bën me dije agjencia e lajmeve "Presheva jonë".

Raportuesi i OKB-së: Mbi 100.000 vullnetarë, luftëtarë të huaj në Siri.

Ne këto fronte nuk shkojnë shëhidë vetëm shqiptarët, por në këtë luftë kundër diktatorit al-Asadit shkojnë edhe qindra persona tjerë nga Ballkani, mijëra persona nga vendet e BE-së dhe nga mbarë bota. Zyrtarisht thuhet se në Siri, sot luftojnë mbi 11.000 mijë vullnetarë, d.m.th., të huaj në krah të rebelëve kundër regjimit al-Asadit.

Shifrat e para për numrin e vullnetare të huaj që luftonin në Siri, janë bërë publike nga Lakhdar Brahimi, i dërguar special i OKB-së dhe Ligës Arabe. Sipas tij, ka rreth 65.000 luftëtarë të huaj në Siri, ndërsa presidenti sirian, Bashar Al Assad, paraprakisht flet për një shifër prej mbi 100.000 luftëtarëve të huaj.

Megjithatë, regjimi al-Asadit nuk është i vetëm, sepse në krahun e tyre luftojnë mijëra vullnetarë, që mediet perëndimore i konsiderojnë si "mercenarë". Në krah të diktatorit Bashar al-Asadit janë edhe qindra rusë e serbë, si dhe sllavë të tjerë, numri i të cilëve arrin mbi një mijë. Por, këta mercenarë paguhën dhe mbrohen mirë, prandaj edhe rrallë dëgjojmë se ka pasur viktime. Edhe kur ka viktime, mbahen sekrete për të ruajtur moralin e ushtarëve të al-Asadit. Në frontet siriane në krah të regjimit diktatorial të al-Asadit luftojnë mbi 6 mijë mercenarë, në mesin e tyre edhe mbi 500 serbë, shkruajnë mediet e huaja.

Luftëtarët nga Ballkani në Siri, serbët në krah të al-Asadit, shqiptarët kundër!

Sipas burimeve të njëjta, kundër kësaj diktature të al-Asad-it janë duke luftuar me rebelët rreth 600 rekrutë nga Ballkani, ku një numër i konsiderueshëm, mbi 400 janë shqiptarë nga viset e ndryshme të Ballkanit. Vetëm nga Kosova janë mbi 150, nga Shqipëria 120 dhe të tjerët nga Maqedonia dhe Lugina e Preshevës. Numrin 400 luftëtarë vullnetarë shqiptarë e arrijnë, nëse i llogarisim edhe shqiptarët në Perëndim.

Kur është fjala për Perëndimin, sipas qeverive evropiane, numri i luftëtarëve nga këto vende në Siri, arrin mbi 6000. Luftëtarë nga vendet e BE-së nuk janë vetëm myslimanë, por edhe të krishterë, katolikë e ortodoksë. Qëllimi i tyre është vetëm për ta mposhtur regjimin diktatorial të Bashar al-Asadit, ku dikush shkon atje për të luftuar në emër të Allahut, e dikush për para. Gjithë rusët nuk janë duke luftuar në krah të al-Asadit. Kreu i Shërbimit të Sigurisë në Rusi, ka thënë se rreth 200 shtetas rusë janë duke luftuar përkrah militantëve të Al Kaidës në Siri. Në një konferencë në Kazan, Aleksandër Bortnikov ka thënë se shumica e tyre vijnë nga republikat e Kaukazit Verior, të domnuara me shumicë myslimane.

Ja kush janë të rinjtë shqiptarë të vrarë në frontet e luftës në Siri këto tre vjetët e fundit:

SHQIPËRIA (6)

Halit Maliqaj (31) nga Tirana, Ermal Xhelo nga Vlora, Omer Albani nga Shqipëria, Edu Samed (40) nga Pogradeci, Bledar Hamza (27) nga Pogradeci, Diamant Rasha nga Tirana.

KOSOVA (13)

Muhamet Koprova (22) nga Mitrovica, Atdhe Deva nga Peja, Pajtim Ulluri (22) nga Lipjani, Naman Demolli nga Prishtina, F. S. nga ish-Avallja e Vjetër (Prishtinë), Valon Musliu nga fshati Tushillë (Skënderaj) H. Dema nga Kaçaniku, Musë Ahmeti, Hetem Sinan Dema dhe Qani Mujaku nga Kaçaniku. Po ashtu, në muajin prill të këtij viti është raportuar se janë vrarë dy shqiptarë nga Ferizaj në Siri, viktime e fundit në Siri ishte dje ajo e kosovarit (nga Luksemburgu).

MAQEDONIA (8)

Shqiptari i parë që u vra nga Maqedonia, ishte i riu nga Gostivari, Rasim Zeqiri, Alim Osmani (22) nga Shkupi, Egzon Avdyli, Nimetullah Imeri (38), Hoxhë Sami Abdullahu nga Shkupi, Rasim Zeqiri nga Gostivari, Nimetulla Imerin, 38 vjeç nga fshati Gërçec (Shkup) Rasim.S nga Bellovishta (Gostivar).

PRESHEVA (1)

Muaz Ahmeti (23) nga Tërnoci, (Bujanoc).

Deri tani me shifra zyrtare dihet vetëm për të vdekurit, por jo edhe për numrin e vullnetarëve të gjallë, që gjenden sot në frontet e Sirisë. Dihet se deri më tani janë vrarë 28 shqiptarë nga Ballkani, ku vetëm vitin e kaluar në luftën e Sirisë, u vranë 18 shqiptarë, kurse sivjet 10, kryesisht të rinj të moshës 20-40 vjeçare. Për këtë hov të të rinjve nga Ballkani, sidomos të shqiptarëve, nuk duhet lënë faji vetëm atyre, por edhe vendeve ku jetojnë, sepse papunësia e madhe, varfëria në Kosovë dhe Shqipëri, nuk është çudi se fut kokën e të rinjve në gërrshëri. Unë shkoj në Siri të luftoj pak për Zot, pak për lekë... thonë vullnetarët që u drejtohen fronteve të Sirisë, për mediet perëndimore, shkruan "Presheva Jonë".

FBI, e shqetësuar me vajtjen masive të vullnetarëve në Siri. Më 8 maj në Bruksel, mbahet një konferencë ndërkombëtare për luftëtarët e huaj në Siri.

Lidhur me vajtjen masive të vullnetarëve në drejtim të Sirisë, për të luftuar në krah të rebelëve kundër regjimit të Bashar al-Asadit, edhe FBI ka shprehur dje shqetësimet e saj. Kështu, drejtori i Policisë Federale (FBI), thotë se numri i luftëtarëve të huaj që shkojnë në Siri, rritet dhe paraqet një kërcënim për sigurinë e Shteteve të Bashkuara. James Comey u tha gazetarëve dje se për çdo ditë po rritet numri i njerëzve që po lënë vendet amerikane dhe evropiane për të shkuar në Siri, për t'u bashkuar me radhët e luftëtarëve, të cilët janë duke u përpjekur për të përmbysur regjimin e presidentit Bashar al-Asad. Autoritetet kanë frikë se këta njerëz janë radikalizuar në Siri.

Për këtë arsye, më 8 maj në Bruksel, do mbahet Konferenca Ndërkombëtare për xhihadistët e huaj në Siri, sepse ky numër i vullne-

tarëve vetëm nga Franca ka arritur shifrën 700. Këto shifra i ka konfirmuar edhe vetë Qeveria franceze. Kështu kryeministri Manuel Valls, duke përmendur këtu luftëtarin e fundit dhe më të ri nga Toulouse i Francës, i cili me vetëm 15 vjet që ka, ka marrë rrugën e xhihadit, në drejtim të Sirisë, tha se rritja e vullnetarëve në luftimet e Sirisë nga Franca dhe vendet e BE-së është shqetësuese.

Deri tani numri i luftëtarëve nga vendet e BE-së, kuptohet edhe nga Zvicra në drejtim të Sirisë, ka arritur rreth 2.000. Për sa i përket numrit të viktimave në këto luftime, deri më tani ka pasur më se shumti nga radhët e rebelëve të ardhur nga vendet arabe, ku numri i tyre shkon mbi 800, duke mos llogaritur këtu ata nga vendet e Ballkanit (267 nga Arabia Saudite, nga Libia -201, nga Tunizia-182, nga Jordania-95) kurse nga Franca 15 viktima.

Sipas një raporti të Britanisë së Madhe, thuhet se mbi 100 britanikë sot luftojnë në Siri në krah të rebelëve. Kurse sipas gazetës Le Figaro, rreth 80 francezë sot janë të angazhuar në luftimet e Sirisë. Kurse sipas gazetës gjermane "Der Spiegel", qindra tjerë janë nga Gjermania, ndërkaq sipas gazetës daneze "Jyllands-Posten", janë rreth 50 të rinj nga Danimarka, që gjenden në Siri. Zvicra me rreth 50, ku së fundit është kthyer një vullnetar zviceran. Ai ka shpjeguar publikisht në mediet zvicerane se kishte shkuar të luftojë regjimin e al-Asadit për të ndihmuar rebelët sirianë.

Qemajl Morina

THE WAR IN SYRIA AND THE INVOLVEMENT OF ALBANIANS IN IT

(Summary)

Even the greatest pessimists could have not imagined that the war in Syria, which has been going on for four years now, would last this long and would result in so many casualties. According to the Syrian Observatory for Human Rights, which is based in London, some 150.000 people have been killed and some 350.000 have been wounded in Syria so far, most of whom, women, children and elderly. More than 2.5 million refugees from Syria have fled to neighboring countries (Turkey, Jordan and Lebanon), whereas the number of internally displaced persons within Syria itself exceeds 6.5 million.

كمال مورينا

الحرب في سوريا و مشاركة الالبانيين فيها (خلاصة البحث)

حتى أكثر المتشائمين عن الاوضاع في سوريا لم يكونوا يتوقعوا بأن الحرب التي دخلت عامها الرابع سوف تطول هذه المدة و تأخذ معها هذا العدد الهائل من الضحايا فوفقا للاحصائيات للمرصد السوري للجنة حقوق الانسان و مقره لندن يفيد بأن حتى الان عدد الضحايا وصل الى اكثر من مائة و خمسين ألف انسان بينما تجاوز عدد الجرحى أكثر من ثلاثمائة و خمسون ألف. و فيما يتعلق بالدين اضطروا الى مغادرة البلاد غصبا عنهم فانه طبقا لنفس المصدر تقول بان عدد المواطنين الذين غادروا سوريا تجاوز اكثر من مليونين و نصف مليون مواطن سوري بينما تجاوز عدد الذين طلبوا اللجوء السياسى لدى الدول المجاورة مثل تركيا و الاردن و لبنان أكثر من ستة ملايين مواطن سوري.

JURISPRUDENCË ISLAME

Mr. Ejup Haziri

RËNDËSIA E MARRËVESHJEVE NË ISLAM

Hyrje

Në këtë punim do të flasim për marrëveshjet në Islam dhe konsideratën e madhe që Islami ka për to, kur dihet se Islami është fe e paqes që thërret në paqe dhe kërkon nga njerëzimi të jetojë në mënyrë të dinjitetshme dhe në bashkëjetesë me të tjerët, pa i cenuar të drejtat e të tjerëve.

Brenda punimit, tërthorazi do të jepen indikacione për marrëveshjet sublimë që bënë myslimanët që nga koha e të Dërguarit të Allahut, kurse për ilustrim më të gjerë do të prezantohen dy marrëveshje, mes myslimanëve dhe jomyslimanëve.

Lufta, akt i urreyer

Njeriu si krijesa më e përsosur e gjithësisë, ka një prirje të jashtëzakonshme për të krijuar konflikte, lakminë e tij e ngop vetëm dheu, ajo lakmi e shpie atë në armiqësi ndaj të tjerëve, nga një lakmi e krijuar kalon në një konflikt të hapur, e nga konflikti i hapur vjen deri te lufta. Kështu është bërë lufta një traditë natyrore në mjedisin njerëzor,

e cila përsëritet në çdo kohë dhe vend. Prandaj, ndodhin problemet dhe luftërat mes njerëzve në mbarë botën, pa përjashtim.¹

Luftërat janë të vjetra, që nga njerëzit e parë, nga tronditja vrastare e bijve të Ademit, kur njeri deshi të mbizotërojë ndaj tjetrit, prandaj, vrasja dhe mbytja në këtë jetë u bë një gjë mjaft e njohur dhe e ndërlydhur (ngushtë) me njeriun.²

Lufta e ka shoqëruar njerëzimin që prej krijimit të tij, ajo është rritur dhe zhvilluar me njerëzimin që nga faza e krijimit, rritjes dhe zhvillimit. Ajo është një dukuri njerëzore e vazhdueshme, saqë as mendja e as urtësia nuk ishin në gjendje ta eliminojnë atë, ngase shkaqet dhe motivet ndryshojnë, rigjenerohen me evoluimin e jetës, dhe kanë një vazhdë të ripërtëritjes.

Lufta, nuk ka dyshim se është një gjë e urreyer, ngase për shkak të saj ndodhin gjëra që nga vrasja, shkatërrimi, gjakderdhja, prishja e rendit, shkatërrimi dhe shumë tjera, që janë tendenca për efekte negative.

Shkaqet dhe motivet e luftërave janë të shumta, ato ndryshojnë me ndryshimin e betejave njerëzore. Mund të jetë motiv i luftës lakmia për të mbizotëruar tjetrin, mbizotërimi ndaj pasurisë së tjetrit, mund të jetë motiv tjetër ideja politike apo religjioze, çështje ekonomie, sikurse edhe regjimi diktatorial për ta shtypur masën e gjerë.

Luftërat fetare janë bërë legjitime për t'i stopuar luftërat që bëhen për motivet e lartcekura. Në Kur'an flitet për beteja e luftëra të gjeneratave të hershme. Në Kaptinën 'el-Bekare', flitet për luftën mes Talutit dhe Xhalutit:

فَهَرَمُوهُمْ بِإِذْنِ اللَّهِ وَقَتَلَ دَاوُودُ جَالُوتَ وَآتَاهُ اللَّهُ الْمُلْكَ وَالْحِكْمَةَ وَعَلَّمَهُ مِمَّا يَشَاءُ وَلَوْلَا دَفْعُ اللَّهِ النَّاسَ بَعْضَهُمْ بِبَعْضٍ لَفَسَدَتِ الْأَرْضُ وَلَكِنَّ اللَّهَ ذُو فَضْلٍ عَلَى الْعَالَمِينَ

¹ Hadixhe Ebueteleh, *El-Islamu vel-ilakatud-devlijeh fis-silmi vel-harbi: dirasetun mukarenetun*, Dar el-Mearif, pa vit botimi, Kairo-Egjipt, fq. 176.

² Dhafir El-Kasimij, *El-Xhihadi vel-hukuk ed-devlijeh el-ameh fil-islam*, bot. i I-rë, Dar el-Ilm lil Melajine, 1982, Bejrut-Liban, fq. 116.

“Me ndihmën e Allahut i thyen ata, e Davudi e mbyti Xhalutin dhe Allahu i dha atij (Davudit) sundimin, pejgamberllëkun dhe e mësoi atë për çdo gjë që deshi. Dhe sikur Allahu të mos i mbronte njerëzit me disa prej disa të tjerëve, do të shkatërrohej toka, po Allahu është bamirës i madh ndaj njerëzimit.”³

Në kaptinën ‘el-Maide’ flitet për betejën e Musait dhe arrogantët tiranikë, e në kaptinën ‘en-Neml’ për frikësimin e mbretëreshës së Sebeit nga ana e Sulejmanit a.s.⁴:

قَالَتْ يَا أَيُّهَا الْمَلَأُ إِنِّي أُلْقِيَ إِلَيَّ كِتَابٌ كَرِيمٌ إِنَّهُ مِنْ سُلَيْمَانَ وَإِنَّهُ بِسْمِ اللَّهِ
الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ أَلَا تَعْلَمُونَ عَلَيَّ وَأُتُونِي مُسْلِمِينَ قَالَتْ يَا أَيُّهَا الْمَلَأُ أَفْتُونِي فِي
أَمْرِي مَا كُنْتُ قَاطِعَةً أَمْرًا حَتَّى تَشْهَدُونِ قَالُوا نَحْنُ أَوْلُو قُوَّةٍ وَأُولُو بَأْسٍ شَدِيدٍ
وَالْأَمْرُ إِلَيْكِ فَانْظُرِي مَاذَا تَأْمُرِينَ قَالَتْ إِنَّ الْمُلُوكَ إِذَا دَخَلُوا قَرْيَةً أَفْسَدُوهَا
وَجَعَلُوا أَعْرَافَهُمْ أَذَلَّةً وَكَذَلِكَ يَفْعَلُونَ

“Ajo (gruaja - Belkisa) tha: “O ju pari, mua më ka arritur një letër madhështore!” (e lexova). Kjo është prej Sulejmanit (mandej e hapi, kur qe, në të) “Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!” (Bismil-lahir-Rrahmanir-Rrahim!)

(në vazhdim shkruan): **“Të mos u mbani në të madh kundër meje, po të më vini të dorëzuar (dhe besimtarë)!”**

Ajo tha: “O ju pari, më sugjeroni në këtë çështje timen se unë nuk do të vendos asgjë derisa edhe ju të jepni pëlqimin!”

Ata (paria) i thanë: “Ne jemi të fuqishëm dhe jemi luftëtarë të rreptë, por puna qëndron te ti, e ti mendo se çka do të na urdhërosh!”

Ajo tha: “Kur sunduesit e pushtojnë ndonjë vend, ata e rrënojnë atë e parinë më të zgjedhur të atij vendi e nënshtrojnë. Kështu ata veprojnë!”⁵

³ Kur’ani, El-Bekare, 251.

⁴ Mahmud Ibrahim ed-dik, *el-Muahadat fish-Sheriatil islamijeh vel kanun ed-devlij el-am*, bot. i II-të, el-Mektebetul Vetanijetu, 1418h-1997m, fq. 1-2.

⁵ Kur’ani, En-Neml, 29-34.

Ka edhe raste tjera të luftërave dhe betejave të popujve të kaluar që janë cekur në Kur’anin Famelërtë, e që nënkupton se padyshim lufta ka qenë shoqëruese e njerëzimit që nga gjeneratat e hershme.

Ibni Halduni në ‘Mukaddimen’ e tij, thotë: “Dije se lufta dhe llojet e betejave, nuk i janë shmangur pothuajse krijesave që kur Allahu denoncoi atë (luftën), e burimi i saj është hakmarrja e disa njerëzve ndaj të tjerëve, e ndaj të dy grupeve rivale pozicionohen fanatikë të ashpër, e nëse kjo ndodh atëherë të dyja grupet pajtohen (për luftë), njeri grup kërkon hakmarrje, e tjetri kërkon mbrojtje, e më pas ngjan lufta, e ajo është çështje natyrore mes njerëzimit, e që nuk ka popull e as gjeneratë që nuk është shoqëruar me luftën, e që shkaku zakonisht i kësaj hakmarreje mund të jetë: zilia, armiqësia, konkurrenca, hidhërimi për Allahun, për fenë e Tij, apo hidhërimi ndaj mbretit...”⁶

Ibni Halduni kur flet për luftën, ai e ndan atë në katër lloje:

I pari: Më së shumti që ndodh mes fiseve fqinje dhe klaneve asimetrike.

I dyti: Armiqësia/agresioni, e që më së shumti ndodh te popujt primitivë...ata furnizimin e tyre e bëjnë në mjetet (shtizat) e luftës, jete-sa e tyre është ajo që është në duart e të tjerëve...e tërë brenga e këtij lloji është uzurpimi i asaj që nodhet në duart e të tjerëve.

I treti: Ajo që njihet në jurisprudencën islame si Xhihad-Luftë në rrugën e Allahut.

I katerti: Luftërat e shteteve me grupe të caktuara që dalin nga ato shtete, dhe me ata që refuzojnë t’i binden udhëheqësve të shteteve.

Këto ishin katër llojet e luftës, dy të parat konsiderohen si lufta agresive dhe grindjeje/përçarjeje, ndërsa dy versionet e fundit konsiderohen lufta të xhihadit-luftës në rrugën e Allahut dhe luftë e drejtë.⁷

Islami ka anuluar të gjitha llojet e luftërave me përjashtim të luftës në rrugën e Allahut. Lufta e cila ka si synim fetar, aplikimin i ligjit të Zotit apo parandalimin e sulmit ndaj tij (ligjit), është e vetmja luftë

⁶ Abdurrahman ibn Haldun, *Mukaddimetu ibni Haldun*, Dar el-Fikr, Bejrut-Liban, pa vit botimi, fq. 270-271.

⁷ Ibid, fq. 226.

legjitime, dhe pavarësisht llojeve tjera, ato mbështin jo legjitime brenda vëllazërisë islame dhe jashta saj.⁸

Luftërat në përgjithësi kanë shumë arsye; që ajo të jetë për shkak të një ideje apo doktrine fetare, politike apo ekonomike, apo për të dominuar ndaj të tjerëve, ose për shkak të një mosmarrëveshjeje për qëllime ndërkombëtare.

Feja Islame nuk është fe e luftës

Luftimet në Islam janë katër lloje⁹: Lufta ndaj jo-muslimanëve, lufta ndaj renegatëve, lufta ndaj shtypësve dhe shkatërrimtarëve, dhe lufta ndaj atyre që ngrihen pa arsyeshëm në luftë apo ndaj banditëve. Këto tri llojet e fundit quhen ndryshe edhe si lufta të interesit të mirë¹⁰...¹¹

Duhet pasur parasysh se Islami nuk nxit luftë, edhe pse një pjesë e njerëzve e akuzojnë islamin si fe të luftës, mirëpo e vërteta është se islami është fe e paqes, dhe nuk e lejon luftën vetëm atëherë kur është më së e nevojshme ajo, kur s'ka ndonjë rrugë tjetër përpos saj, si dhe nuk e justifikon muslimanin që të shpresojë në luftë, apo të thërrasë në të qoftë edhe ndaj agresorëve, ndaj abuzuesve, ngase duhet provuar mjetet tjera paqësore nëse kanë efekt,¹² në mënyrë që të mos derdhet gjaku përmes armëve, por të përdoren metodat tjera për eliminimin dhe shmangien e luftës. Në këtë kontekst i Dërguari i Allahut thoshte: **“O ju njerëz, mos shpresoni në takim me armikun, luteni Allahun për shëndet të mirë, e nëse i takoni armiq të (në betejë) dijeni se Parajsa**

⁸ Mexhid Hidveri, *el-Harbu ves-Selem fi Shir'atil Islam*, bot. i I-rë, dar el-mutehideh linesshr, Bejrut-Liban, 1973m, fq. 99.

⁹ Këtu është fjala për luftërat në islam, ndërsa në ndarjen e parë ishte për qëllim luftërat në përgjithësi, e kjo ndarja e fundit në katër lloje rrjedh nga lloji i tretë i ndarjes së parë.

¹⁰ Kur shihet interesi i muslimanëve sulmohen këto tri grupe, zakonisht urdhri bëhet nga udhëheqësi i muslimanëve, në momentin kur ai e sheh se tanimë është në interes të muslimanëve, sulmohen, e nëse ka ndonjë efekt negativ atëherë duhet heshtur derisa të vjen momenti i duhur.

¹¹ Vehbeh Zuhejli, *Atharul Harbi fil Fikhil Islami; Dirasetun Mukarenetun*, bot. i IV-të, dar el-Fikr, Damask-Siri, 1412h-1992m, fq. 59-60.

¹² Shih: Hadixhe Ebuetleh, *El-Islamu vel-ilakatud-devlijeh fis-silmi vel-harbi*, fq. 180.

është nën hijen e shpatave, e pastaj ai thoshte: O Zot, zbritës i librave, shtytës i reve, dhe mposhtës i aleancave, mposhti ata dhe mundësona të ngadhnjemë ndaj tyre.”¹³

Islami, jo vetëm që nuk e nxit luftën, por edhe është kategorik kundër luftës, mbytyjen e një njeriut të pafajshëm e sheh si mbytyje të tërë njerëzimit:

مِنْ أَجْلِ ذَلِكَ كَتَبْنَا عَلَىٰ بَنِي إِسْرَائِيلَ أَنَّهُ مَن قَتَلَ نَفْسًا بِغَيْرِ نَفْسٍ أَوْ فَسَادٍ فِي الْأَرْضِ فَكَأَنَّمَا قَتَلَ النَّاسَ جَمِيعًا وَمَنْ أَحْيَاهَا فَكَأَنَّمَا أَحْيَا النَّاسَ جَمِيعًا وَلَقَدْ جَاءَتْهُمْ رُسُلُنَا بِالْبَيِّنَاتِ ثُمَّ إِنَّ كَثِيرًا مِنْهُمْ بَعْدَ ذَلِكَ فِي الْأَرْضِ لَمُسْرِفُونَ

“...kush mbyty një njeri (pa të drejtë), pa pasë mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa pasë bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si ta kishte mbytur gjithë njerëzimin. E kush e ngjall (bëhet shkak që të jetë ai gjallë) është si ta kishte ngjallur (shpëtuar) gjithë njerëzimin.”¹⁴ E padyshim që lufta është një veprim i urrejtur, për shkak të saj mbyten njerëz të pafajshëm, e besimtari nuk e justifikon vetveten që ta shkatërrojë atë që e ka ndërtuar Allahu. Kur'ani ka përmendur se lufta është një veprim i urrejtur për besimtarët, ata nuk e duan atë dhe nuk pajtohen me të, mirëpo në raste të caktuara ata e pranojnë atë ngase është caktim i Zotit dhe nuk ka rrugëdalje përveç saj,¹⁵ kur shteren gjitha mundësitë tjera, atëherë lufta mbetet opsioni i pashmangshëm, gjithsesi i fundit.

Legjislacioni islam e ka miratuar luftën si nevojë njerëzore, e cila mund të adresohet te renegantët, tiranët-zullumqarët, plaçkitësit e rrugëve,¹⁶ apo edhe ndonjë grupi tjetër, e cila në disa raste nji-

¹³ Transmeton Buhariu, libri i Xhihadit, nr. i hadithit 2821. Muslimi, nr. i hadithit 3276.

¹⁴ Kur'ani, El-Maideh, 32.

¹⁵ Hadixhe Ebuetleh, *El-Islamu vel-ilakatud-devlijeh fis-silmi vel-harbi*, fq. 180-181.

¹⁶ Ky fenomen ka qenë mjaftë i përhapur në të kaluarën, ku grupe të caktuara dilnin zakonisht natën dhe plaçkitnin njerëzit kalimtarë apo tregtarë, e shumë herë edhe i mbytnin pasi i plaçkitnin ata.

het me emrin luftë në rrugën e Allahut (xhihad), e në disa tjera si luftë për qëllime të mira e dobi (mesalih).¹⁷

Kur themi se islami e ka miratuar dhe pohuar luftën, kem për qëllim atë se ajo është miratuar si një domosdoshmëri që është në interes të përgjithshëm, për ta larguar armikun e jashtëm (huaj), për t'i dhënë të drejtën atij që është gjunjëzuar nga e drejta e tij, e nuk është miratuar për motive agresive, apo për lakmi ekspansioni, mirëpo është legjitimuar për motive bujare e qëllime fisnike. Është bërë legjitime për ndihmë ndaj atij që i është bërë padrejtësi, për të sjellë drejtësi, për largimin e okupatorit, për mbrojtje të atdheut, për frymim të lirisë fetare, dhe për eliminimin e padrejtësisë dhe armikut. Burimi në lidhjet mes shteteve dhe grupacioneve në islam është paqja, e jo lufta, ngase lufta siç thamë më lart është mjeti i fundit, atëherë kur të gjitha mjetet paqësore përfundojnë pa sukses, mbetet e pashmangshme dhe e detyrueshme lufta për qëllime që i cekëm më lart.¹⁸ Në këtë kontekst në Kur'an thuhet:

وَقَاتِلُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ الَّذِينَ يُقَاتِلُونَكُمْ وَلَا تَعْتَدُوا إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ الْمُعْتَدِينَ

“Dhe luftoni në rrugën e Allahut kundër atyre që ju sulmojnë e mos e teproni se Allahu nuk i do ata që e teprojnë (e fillojnë luftën).”¹⁹

Nga kjo kuptojmë se në Islam lufta zhvillohet vetëm ndaj atyre që nxisin dhe zhvillojnë luftën, dhe nga kjo përjashtohen të vjetërit, gratë, fëmijët, ata që janë përkushtuar adhurimit, bujqit, tregtarët e zejtarët, ngase gjithë këta u takojnë kategorisë së civilëve. Është vërtetuar në hadithe autentike se i Dërguari i Allahut kishte ndaluar mbytjen e grave, fëmijëve, pleqve, adhuruesve që ndodhen në sinagoga e kulte adhurimi. Në një hadith thuhet: **“Nisuni me emrin e Zotit...Mos mbytini të moshuarin, fëmijën, as gruan, mos kini urrejtje...”**²⁰

¹⁷ Maverdiu, *El-Ahkam Es-Sultaniyeh*, bot. i I-rë, Matbeah Mustafa el-Halebij, Kairo-Egjipt, 1380h-1960m, fq. 51.

¹⁸ Mahmud Ibrahim ed-dik, *el-Muahadat fish-Sheriatil islamijeh vel kanun ed-devlij el-am*, fq. 2-3.

¹⁹ Kur'ani, El-Bekare, 190.

²⁰ Transmetohet në koleksionin e Bejhekiut, vol.IX, fq. 90.

Gjithashtu nuk duhet harruar faktin se në fillim të Islamit, lufta nuk kishte marrë lejen ende, e nga ana tjetër, myslimanët iu nënshtroheshin torturave dhe agresionit të kurejshëve, e ata duronin ngase lufta nuk iu lejohej, derisa shpallja proklamoi:

أَذِنَ لِلَّذِينَ يُقَاتِلُونَ بَأْنَهُمْ ظَلَمُوا وَإِنَّ اللَّهَ عَلَىٰ نَصْرِهِمْ لَقَدِيرٌ

“Atyre që po sulmohen me luftë, u është dhënë leje të luftojnë, për shkak se u është bërë e padrejtë, e Allahu ka fuqi për t'u ndihmuar atyre (myslimanëve).”²¹

Andaj, deklarojmë se islami nuk është ashtu siç paraqitet e siç portretizohet si agresiv e si fe e dhunës dhe e luftës, por është fe e paqes, e që luftën e njeh vetëm atëherë kur është më së e nevojshme ajo, për largimin e armikut, mbrojtjen e kolektivit, dëbimin e padrejtësisë, mbrojtjen e të drejtave të njerëzve, lartësimin e fjalës hyjnore, zbatimin e drejtësisë, ngase Islami në realitet është dërgesë përmirësuese për përmirësimin e popujve.²²

Islami nuk thërret në luftë, as në derdhjen e gjakut, as që nxit për luftë, apo derdhje të gjakut e as për vrasje, përkundrazi thërret në paqe (selam), Islami dhe Selami (paqja) janë po nga e njëjta rrënjë, prej emrave të bukur të Allahut është edhe ‘Selam’, përshtendja e myslimanëve po ashtu është ‘Selam’, si dhe parajsa thirret ‘Selam’, dhe e tëra kjo nuk është një koïncidencë e as rastësi.

Në përgjithësi, fetë qiellore kanë ardhur për të vendosur paqen dhe sigurinë, për përfundimin e ngatërresave dhe mosmarrëveshjeve mes njerëzve, si dhe për të zvogëluar konfliktet dhe rivalitetet midis njerëzve, dhe kjo është fryma e vërtetë e legjislacionit Islam.²³

Islami nuk përdor dhunën dhe forcën, përpos në rastin e tiranisë dhe ndaj atyre që nuk i nënshtrohen të vërtetës, ai nuk shpalos shpatën ndaj askujt për urrejtje ndaj fesë së tij, e as për gllabëritje sipërfaqe, mirëpo islami e vendos fuqinë aty ku nuk bën dobi urtësia, e shkaqet e

²¹ Kur'ani, El-Haxh, 39.

²² Vehbeh Zuhejli, *Atharul Harbi fil Fikhl Islamij; Dirasetun Mukarenetun*, fq. 37.

²³ Ibid, fq. 132.

kësaj fuqie të vendosur llogariten si mbrojtje e së vërtetës, dhe ruajtje e paqes. Shpatën e shtrin atëherë kur popullata rrezikohet nga despotët, apo për ta larguar shtypjen dhe agresionin ndaj atyre që iu është bërë padrejtësi.

Njerëzimi është i rrethuar me frikën e agresionit, shfarosjen dhe acarimin e konfliktit. Udhëzimi njerëzor ua përkujton atyre aleancat dhe marrëveshjet, të cilat sadopak do ta ndalonin një grup nga tjetri nga gjakderdhja e shkaktuar që shkak i saj është lufta dhe nga tendencat konfliktuoze, në këtë mënyrë njerëzimi njohu traktatet, marrëveshjet, aleancat dhe armëpushimet.²⁴

Islami u kushton rëndësi të posaçme marrëveshjeve

Islami u jep rëndësi të madhe marrëveshjeve të ndryshme, ngase ato bazohen kryesisht në vullnetin e mirë të të gjitha palët, kurse zbatimin e tyre e ka bërë obligim fetar (vaxhib dinij), dhe zbatimi i tyre si obligim fetar i bën marrëveshjet të pacenueshme-të paprekshme.²⁵ Kur'ani i ka kushtuar shumë ajete kësaj shenjtërie të marrëveshjeve, e prej tyre veçojme disa:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَوْفُوا بِالْعُقُودِ

“O ju që besuat! Zbatoni premtimet (obligimet).”²⁶

Pastaj fjala e të Madhërishmit:

وَأَوْفُوا بِالْعَهْدِ إِنَّ الْعَهْدَ كَانَ مَسْئُولًا

“...Premtimin zbatoni, pse për premtimin ka përgjegjësi.”²⁷

Gjithashtu edhe kjo:

²⁴ Alij Muhamed Husejn Musa, *El-Hudnetu fil Hurubi ve mevkifush Sheriatil Islamijetu minha*, pa vend botimi, 1398h-1978m, fq. 3.

²⁵ Hadixhe Ebuetele, *El-Islamu vel-ilakatud-devlijeh fis-silmi vel-harbi*, fq. 154.

²⁶ Kur'ani, El-Maideh: 1.

²⁷ Kur'ani, El-Isra: 34.

وَأَوْفُوا بِعَهْدِ اللَّهِ إِذَا عَاهَدْتُمْ وَلَا تَنْقُضُوا الْأَيْمَانَ بَعْدَ تَوْكِيدِهَا وَقَدْ جَعَلْتُمُ اللَّهَ عَلَيْكُمْ كَفِيلًا إِنَّ اللَّهَ يَعْلَمُ مَا تَفْعَلُونَ

“Meqë keni premtuar, pra zbatoheni premtimin e dhënë ndaj Allahut, e mos i prishni betimet pasi i keni vërtetuar ato, duke qenë se Allahu e bëtë garant tuajin. Vërtet, Allahu e di se çka punoni.”²⁸

Kurse në disa vende tjera përmban një vëmendje të veçantë për të forcuar përmbushjen e premtimit, gjegjësisht marrëveshjes, madje edhe me jomyslimanët, për shembull:

إِلَّا الَّذِينَ عَاهَدْتُمْ مِنَ الْمُشْرِكِينَ ثُمَّ لَمْ يَنْقُصُوكُمْ شَيْئًا وَلَمْ يُظَاهِرُوا عَلَيْكُمْ أَحَدًا فَأَتِمُوا إِلَيْهِمْ عَهْدَهُمْ إِلَى مُدَّتِهِمْ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُتَّقِينَ

“Pos atyre idhujtarëve me të cilët keni lidhur marrëveshje, të cilët nuk ju kanë shmangur asgjë dhe nuk e kanë ndihmuar askënd kundër jush, pra, edhe ju përmbushni marrëveshjen e tyre deri në afatin e caktuar. S'ka dyshim se Allahu i do të devotshmit.”²⁹

Në po të njëjtën kaptinë, Ai thotë:

كَيْفَ يَكُونُ لِلْمُشْرِكِينَ عَهْدٌ عِنْدَ اللَّهِ وَعِنْدَ رَسُولِهِ إِلَّا الَّذِينَ عَاهَدْتُمْ عِنْدَ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ فَمَا اسْتَقَامُوا لَكُمْ فَاسْتَقِيمُوا لَهُمْ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُتَّقِينَ

“Si mund të kenë idhujtarët besë (marrëveshje) tek Allahu dhe tek i dërguari i Tij, përveç atyre me të cilët keni lidhur marrëveshje pranë xhamisë së shenjtë (Qabes), e derisa ata i përmbahen (marrëveshjes) përmbahuni edhe ju. Allahu i do ata që ruajnë besën.”³⁰

Ky është një tekst i çiltër në ngritjen e një themeli të fuqishëm bazë të marrëveshjeve për zbatimin reciprok të marrëveshjes nga të dyja palët kontraktuese.

²⁸ Kur'ani, En-Nahl: 91.

²⁹ Kur'ani, Et-Tevbeh: 4.

³⁰ Kur'ani, Et-Tevbeh: 7.

إِلَّا الَّذِينَ يَصِلُونَ إِلَى قَوْمٍ بَيْنَكُمْ وَبَيْنَهُمْ مِيثَاقٌ أَوْ جَاءُوكُمْ حَصِرَتْ صُدُورُهُمْ
أَنْ يُقَاتِلُوكُمْ أَوْ يُقَاتِلُوا قَوْمَهُمْ وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَسَلَّطَهُمْ عَلَيْكُمْ فَلَقَاتِلُوكُمْ فَإِنْ
اعْتَزَلُوكُمْ فَلَمْ يُقَاتِلُوكُمْ وَأَلْقَوْا إِلَيْكُمُ السَّلَامَ فَمَا جَعَلَ اللَّهُ لَكُمْ عَلَيْهِمْ سَبِيلًا

“Përpos atyre që strehohen te një popull, me të cilin keni marrveshje, dhe përpos atyre që vijnë te ju, e u vjen rëndë të luftojnë kundër jush ose kundër popullit të vet. Sikur Allahu të donte do t’ju jepte atyre fuqi e pushtet mbi ju dhe do t’ju luftonin. Në qoftë se ata tërhiqen prej jush, nuk ju luftojnë dhe ju ofrojnë paqe, atëherë Allahu nuk ju lejon rrugë (luftë) kundër tyre.”³¹

Islami me rolin e tij i ka kushtuar rëndësi të lartë marrëveshjeve, çdoherë që gjendet mënyra për realizimin e qëllimeve publike, atëherë prijësi i myslimanëve mund të lidhë marrëveshje me jo-myslimanët nëse marrëveshja është në të mirën e Islamit, dhe që prej saj shpresohet në zbutjen e zemrave e tyre ndaj islamit.³²

Islami legjitimon marrëveshjet

Islami nuk promovon luftën dhe urrejtjen, e as që nxit në konflikte –çfarëdo qofshin ato, përkundrazi nxit në marrëveshje dhe paqe mes njerëzve, në mënyrë që njerëzit të jetojnë të lirë, të sigurt dhe në paqe.

Në Kur’an, gjejmë se në shumë vende flitet për marrëveshje, dhe se miratohet një gjë e tillë edhe me armiqtë. Allahu i Madhërishtëm thotë:

إِلَّا الَّذِينَ يَصِلُونَ إِلَى قَوْمٍ بَيْنَكُمْ وَبَيْنَهُمْ مِيثَاقٌ أَوْ جَاءُوكُمْ حَصِرَتْ صُدُورُهُمْ
أَنْ يُقَاتِلُوكُمْ أَوْ يُقَاتِلُوا قَوْمَهُمْ وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَسَلَّطَهُمْ عَلَيْكُمْ فَلَقَاتِلُوكُمْ فَإِنْ
اعْتَزَلُوكُمْ فَلَمْ يُقَاتِلُوكُمْ وَأَلْقَوْا إِلَيْكُمُ السَّلَامَ فَمَا جَعَلَ اللَّهُ لَكُمْ عَلَيْهِمْ سَبِيلًا

“Përpos atyre që strehohen te një popull, me të cilin keni marrveshje, dhe përpos atyre që vijnë te ju, e u vjen rëndë të luftojnë kundër jush

³¹ Kur’ani, En-Nisa: 90.

³² Jakub ibn Ibrahim Ebu Jusuf, *El-Haraxh*, el-Matbeatus-Selefijeh, 1352h, fq. 207.

ose kundër popullit të vet. Sikur Allahu të donte do t’iu jepte atyre fuqi e pushtet mbi ju dhe do t’ju luftonin. Në qoftë se ata tërhiqen prej jush, nuk ju luftojnë dhe ju ofrojnë paqe, atëherë Allahu nuk ju lejon rrugë (luftë) kundër tyre.”³³

Pastaj i Madhërishtëm thotë:

وَأَوْفُوا بِعَهْدِ اللَّهِ إِذَا عَاهَدْتُمْ وَلَا تَنْقُضُوا الْأَيْمَانَ بَعْدَ تَوْكِيدِهَا وَقَدْ جَعَلْتُمُ اللَّهَ
عَلَيْكُمْ كَفِيلًا إِنَّ اللَّهَ يَعْلَمُ مَا تَفْعَلُونَ

“Meqë keni premtuar, pra zbatoheni premtimin e dhënë ndaj Allahut, e mos i prishni betimet pasi i keni vërtetuar ato, duke qenë se Allahun e bëtë garant tuajin. Vërtet, Allahu e di se çka punoni.”³⁴

Kolosi i madh i komentimit të Kur’anit, Ibni Kethiri, lidhur me ajetin e fundit thotë: “Kjo është ajo që ka urdhëruar Allahu i Madhëruar, që të zbatohen marrëveshjet dhe besëlidhjet, si dhe të ruhen me kujdes besatimet e dhëna.”³⁵

Islami e ka bërë përmbushjen dhe zbatimin e marrëveshjeve prej nevojave të besimit të vërtetë, dhe se zbatimi i marrëveshjes është besnikëri prej besnikërisë së arsyes dhe ndërgjegjes, e nuk është përgatitje politike për mashttrim dhe tradhti, e nuk gjejmë si Islami ndonjë kushtetutë që i ka lartësuar marrëveshjet dhe i ka vrojtuar me kujdes konventat.³⁶

Në biografinë profetike, gjejmë shembuj të gjallë dhe fjalë që e konfirmojnë fuqishëm legjitimitetin e marrëveshjeve në Islam. Ishte vetë i Dërguari i Allahut, ai i cili kishte lidhur disa marrëveshje mes tij dhe armiqve të tij, përveç kësaj, ai kishte stimuluar në përmbushjen dhe realizimin e marrëveshjeve në shumë prej fjalëve dhe fjalimeve të tij. Pas emigrimit të tij nga Mekka në Medine, ai bëri traktatin e parë

³³ Kur’ani, En-Nisa: 90.

³⁴ Kur’ani, En-Nahl: 91.

³⁵ Ibni Kethir, *Tefsir ibni Kethir*, dar el-Ma’rifeh, Bejrut-Liban, 1400h-1980m, vell. IV, fq. 220.

³⁶ Muhamed Selam Medkur, *El-Medhal Lil Fikih Islami*, darun-Nehdah el-arabijetu, 1960m, fq. 58.

ndërkombëtar³⁷ mes myslimanëve, çifutëve dhe idhujtarëve, dhe ai traktat konsiderohet si njeri prej traktateve më të çmuara ndërkombëtare, me të drejta dhe më të vlerësuara nga njerëzit në përgjithësi, ajo duhet të jetë udhë-përshkrim ndriçues për mbarë myslimanët në raportet ndërkombëtare mes tyre dhe pasuesve të feve tjera. Kështu, shteti islam filloi marrëveshjen që në fillim të gjallërimit të tij, dhe kështu rezultoi edhe me njohjen e myslimanëve si shtet të pavarur.³⁸

Ky është pra traktati i parë ndërkombëtar mes myslimanëve, çifutëve dhe jobesimtarëve idhujtarë, aty Profeti (paqja e Zotit qoftë mbi të) dizajnoi bazat e shtetit të ri Islam dhe marrëdhëniet e myslimanëve me të tjerët.³⁹ Myslimanët u bënë ruajtës të këtij shteti me gjithë ndryshimin e racave dhe fanatizmit që mbretëronte, u bënë një komb me tri besime të ndryshme, mirëpo me të drejta të garantuara të barabarta nga Karta e Medinës, e cila u formulua nga Profeti (paqja e Zotit qoftë mbi të), dhe që njihet ndryshe si Kushtetuta e parë e zbatuar në botë.

Përveç kësaj ai lidhi marrëveshjen e Hudejbijes, e njohur më shumë si Paqja e Hudejbijes, dhe kishte lidhur edhe disa marrëveshje tjera më të vogla, e që u japin legjitimitet të plotë marrëveshjeve në Islam.

Përveç rasteve kur i Dërguari i Allahut kishte lidhur marrëveshje të ndryshme, ai në shumë raste kishte dhënë deklarata të prera për gjithë ata që shkelin legjitimitetin e traktateve duke prishur besëlidhjen.

I Dërguari i Allahut kishte potencuar qartë: **"Ai i cili mbyl një njeri (pa të drejtë) që është në traktat, s'do ta shijojë erën e Xhennetit, e era e xhennetit ndodhet larg tij në distancë prej dyzet vjetëve."**⁴⁰

³⁷ Do ta cekim më vonë traktatin në mes muslimanëve, idhujtarëve dhe çifutëve (Karta e Medines).

³⁸ Abdurrahman Izam, *Err-Rrisaletu el-Halidetu*, bot. i I-rë, Vizaretut-Terbijeh vet-Ta'lim el-Urdunijetu, aman-Jordani, 1395h-1975m, fq. 92.

³⁹ Shih: Mahmud Ibrahim ed-dik, *el-Muahadat fish-Sheriatil islamijeh vel kanun ed-devlij el-am*, fq. 120.

⁴⁰ Transmeton Buhariu. Ngjashëm transmetohet edhe ne koleksionin e Ebu Davudit, Ne-saiut dhe Tirmidhiut.

Dinjiteti i marrëveshjeve

S'ka dyshim se Islami e ka bërë përmbushjen dhe zbatimin e marrëveshjeve prej nevojave të besimit të vërtetë, dhe se zbatimi i marrëveshjeve është besnikëri prej besnikërisë së arsyes dhe ndërgjegjes, e nga ana tjetër, mashtrimin ndaj marrëveshjes e ka bërë prej hipokrizisë të cilën e ka krahasuar me pabesimin.

Marrëveshjen e bëri pjesë të fesë, e prishjen apo mashtrimin ndaj tij e konsideroi si mashtrim edhe ndaj besimit, e në këtë kontekst Profeti kishte thënë: **"...S'ka fe për atë që s'ka besë."**⁴¹

Nuk është prej parimeve të myslimanit prishja e marrëveshjes apo mashtrimi ndaj tij, ngase i Plotfuqishmi i ka cilësuar robërit e Tij besimtarë me keto fjalë:

لَّذِينَ يُوفُونَ بِعَهْدِ اللَّهِ وَلَا يَنْقُضُونَ الْمِيثَاقَ

"Ata janë, të cilët e zbatojnë besën e dhënë Allahut dhe nuk e thyejnë zotimin."⁴²

Gjithashtu në lidhje me ta thotë:

وَالْمُوفُونَ بِعَهْدِهِمْ إِذَا عَاهَدُوا

"...dhe ata që kur premtojnë e zbatojnë..."⁴³

I Madhërishmi duke i urdhëruar besimtarët me zbatim të premtimit, thotë:

وَأَوْفُوا بِعَهْدِ اللَّهِ إِذَا عَاهَدْتُمْ وَلَا تَنْقُضُوا الْأَيْمَانَ بَعْدَ تَوْكِيدِهَا

"Meqë keni premtuar, pra zbatoheni premtimin e dhënë ndaj Allahut..."⁴⁴ ndërsa kur përmend cilësitë e tyre, thotë:

⁴¹ Transmeton Bejhekiu ne Sunenin e tij, vol IX, fq. 231.

⁴² Kur'ani, Err-Rra'd: 20.

⁴³ Kur'ani, El-Bekare: 177.

⁴⁴ Kur'ani, En-Nahl: 91.

وَالَّذِينَ هُمْ لِأَمَانَاتِهِمْ وَعَهْدِهِمْ رَاعُونَ

“dhe ata të cilët me kujdes i ruajnë ato që u janë besuar (sende ose fjalë), e ruajnë edhe premtimin e dhënë.”⁴⁵

Ruajtja dhe zbatimi i premtimit është prej moralit njerëzor të një shkalle të lartë në Islam, ngase Allahu i lavdëroi besimtarët, të cilët vërtetuan besën e dhënë dhe realizuan premtimin e tyre dhënë Allahut:

مِنَ الْمُؤْمِنِينَ رِجَالٌ صَدَقُوا مَا عَاهَدُوا اللَّهَ عَلَيْهِ فَمِنْهُمْ مَنْ قَضَىٰ نَحْبَهُ وَمِنْهُمْ مَنْ يَنْتَظِرُ وَمَا بَدَّلُوا بَدِيلًا

“Prej besimtarëve kishte burra që vërtetuan besën e dhënë Allahut, e disa prej tyre e realizuan premtimin duke dhënë jetën, dhe ka prej tyre që janë duke pritur (ta zbatojnë) dhe ashtu nuk bënë kurrfarë ndryshimi.”⁴⁶

Islami fillimin e prishjes së marrëveshjes e konsideron tradhti, qoftë me myslimanë apo me të tjerët.⁴⁷ Është përherë kundër tradhtisë dhe mashtrimit të marrëveshjes, e kjo më së miri u vërejt në ajetet që i cituam sipër, ku në mënyrë kategorike përjashtohet mashtrimi dhe tradhtia, kurse nga ana tjetër ngrihen dhe lartësohen ata të cilët nuk e thyejnë premtimin, vërtetojnë besën e dhënë, dhe realizojnë atë që kanë premtuar.

Myслиmanëve iu lejohet prishja e marrëveshjeve atëherë kur jomyслиmanët prishin së pari atë, në këtë rast lejohet edhe tërheqja e tyre prej marrëveshjes në fjalë, mirëpo përderisa ata i përmbahen dhe zbatojnë marrëveshjen e lidhur, atëherë myslimanët duhet respektuar dhe zbatuar në përpikëri deri në kohën e caktuar kur i asaj i skadon afati.

Ky është islami që premtimet e dhëna i bën të pacenueshme, marrëveshjet i ka bërë premtime me plot dinjitet, me respektin më të

madh ndaj tyre duke çuar deri në fund zbatimin për premtimet e dhëna. Dhe ky civilizim mijëra vitesh, ka proklamuar siguri dhe besatim ndaj marrëveshjeve të lidhura, gjithnjë nën prizmin e së vërtetës dhe drejtësisë, i Plotfuqishmi thotë:

وَإِذَا قُلْتُمْ فَاعْدُوا وَلَوْ كَانَ ذَا قُرْبَىٰ وَبِعَهْدِ اللَّهِ أَوْفُوا ذَلِكُمْ وَصَّاكُم بِهِ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ

“...Kur të flisni (të dëshmoni), duhet të jeni të drejtë edhe nëse është çështja për (kundër) të afërmit, dhe zotimin e dhënë Allahut plotësonie. Këto janë me çka Ai ju porositi kështu që të përkujtoni.”⁴⁸

Marrëveshjet në Islam janë të obliguara në respektimin dhe aplikueshmërinë e tyre, pa marrë parasysh se në çfarë gjendje është kontraktuesi, madje edhe atëherë kur myslimanët janë të fuqishëm apo të dobët, në të gjitha gjendjet e tyre, zbatueshmëria e marrëveshjeve mbetet e njëjtë, deri në kohën e caktuar ku palët kontraktuese janë pajtuar.

Islami ka shtrirë dorën ndaj lidhjeve të marrëveshjeve të ndryshme me popujt tjerë, me qëllim që të mbizotërojë paqja mes njerëzve, dhe kudo që ekziston një iniciativë e mirë për paqe me nënshkrimin e ndonjë marrëveshjeje, atëherë islami është i gatshëm me lidhjen e akteve që ndihmojnë jetën e njerëzve. Mirëpo, nëse ka ndonjë thirrje për ndonjë marrëveshje reciproke për padrejtësi dhe sulm ndaj të pambrojturve, këtu Islami marrëveshjet e tilla i quan ‘ndihmë ndaj mëkatit dhe armiqësisë, dhe largim ndaj devotshmërisë dhe mirësisë’⁴⁹:

وَتَعَاوَنُوا عَلَى الْبِرِّ وَالتَّقْوَىٰ وَلَا تَعَاوَنُوا عَلَى الْإِثْمِ وَالْعُدْوَانِ

“...Ndihmohuni mes vete me të mira dhe në të mbara, e mosni në mëkate e armiqësi...”⁵⁰

Islami e ndalon mashtrimin ndaj marrëveshjeve, në të gjitha format e mundshme mashtruese, dhe mashtrimin e marrëveshjeve e kon-

⁴⁵ Kur’ani, El-Mu’minune: 8.

⁴⁶ Kur’ani, El-Ahzab: 23.

⁴⁷ El-Mejdani, *El-Ahlak el-Islamijetu ve Usesuha*, dar el-Kalem, Bejrut, pa vit botimi, vol. I, fq. 508.

⁴⁸ Kur’ani, El-En’am: 152.

⁴⁹ Abdurrahman Izam, *Err-Rrisaletu el-Halidetu*, fq. 112-113.

⁵⁰ Kur’ani, El-Maide: 2.

sideron prej mashtrimeve më të shëmtuara⁵¹, andaj, në këtë kontekst, Islami i ka dhënë dinjitet të plotë marrëveshjeve, duke i bërë ato të pacenueshme deri në skadimin e afatit të tyre.

Lidhur me respektimin e marrëveshjeve dhe largimit nga mashtrimi, ekziston një shembull i mrekullueshëm nga koha e të Dërguarit të Allahut, që është mjaft i ndjeshëm për lexuesit, por që tregon për dinjitetin e lartë të myslimanëve karshi respektimit dhe trajtimit human të marrëveshjeve. E ky rast është ai i Hudejbijes, kur teksa përfunduan negociatat mes Suhejl ibn Amr-it dhe të Dërguarit të Allahut, djali i Suhejlit, Ebu Xhendeli kishte pranuar më herët Islamin, por që ishte në mesin e kurejshitëve në Mekke, atë e kishte lidhur e burgosur babai i tij, e më pas e kishte dënuar me dënime të ndryshme me të vetmin qëllim që ai të kthehej në fenë e tij të mëparshme, por pa ndonjë efekt. Ebu Xhendeli iku disi nga burgu i babait të tij, dhe ashtu i prangosur erdhi deri te myslimanët, ku e hodhi veten në tokë para myslimanëve, duke kërkuar ndihmën dhe mbrojtjen e tyre. Myslimanët i dëshiruan mirëseardhje dhe u gëzuan që u ka shpëtuar torturave të pabesimtarëve, mirëpo babai i tij kur e pa atë e goditi dhe u drejtua karshi Profetit duke i thënë: *“O Muhammed, çështja u krye mes meje e teje para se ky të arrijë këtu..”*, dhe e mori atë duke e tërhequr zvarrë për ta dërguar te kurejshët, e Ebu Xhendeli bërtiste me zë të lartë: *“O myslimanë, po më lini të shkoj te politeistët që të më sprovojnë në fenë time, a nuk po shihni çfarë kam përjetuar?”* Të ndodhur para një situatë të vështirë, disa myslimanë thoshin se ai nuk duhet dorëzuar te kurejshitët, e babai i tij e kërkonte atë në bazë të neneve të marrëveshjes⁵², ndërsa vendimi pritej nga i Dërguari i Allahut. Profeti pasi kërkoi nga Suhejli që ta linte djalin e tij, e që kjo lutje u refuzua po aq herë sa kërkoi ai⁵³,

⁵¹ Mahmud Ibrahim ed-dik, *el-Muahadat fish-Sheriatil islamijeh vel kanun ed-devlij el-am*, fq. 125.

⁵² Neni i tetë i traktatit të paqes së Hudejbijes nënvizonte se në qoftë se ndokush nga kurejshitët vjen tek pala e myslimanëve pa lejen e familjes së tij, ai duhet kthyer mbrapa. Pikërisht ky nen e kthente mbrapa edhe Ebu Xhendelin.

⁵³ I Dërguari i Allahut kërkoi nga Suhejli disa herë që ta linte djalin e tij pranë të të Dërguarit, mirëpo Suhejli në mënyrë kategorike refuzoi kërkesën e të Dërguarit të Allahut.

iu drejtua Ebu Xhendelit me këto fjalë: ***“Duro dhe llogarit në shpërblim, ngase Allahu do të bëjë për ty dhe për ata që janë të dobët një rrugëdalje, e ne kemi lidhur traktatin e paqes me ata, u kemi dhënë besë atyre ashtu siç edhe ata na kanë dhënë besë neve, e ne nuk i mashtrojmë ata.”***⁵⁴

Kjo ngjarje simbolizon dinjitetin e lartë të myslimanëve karshi respektimit të marrëveshjeve dhe ky shembull, ndonëse prekës, ka hyrë në analet e historisë, si shembull që i Dërguari i Allahut dhe myslimanët respektuan deri në skajin më të lartë marrëveshjet e lidhura.

Shembuj të respektimit të marrëveshjeve

Ekzistojnë shembuj të shumtë të marrëveshjeve të ndryshme mes të Dërguarit të Allahut dhe jobesimtarëve, që nga Karta e Medinës, më pas marrëveshja e Hudejbijes e deri te marrëveshjet e fundit. Sigurisht se Karta e Medinës dhe Marrëveshja e Hudejbijes janë raste madhështore dhe unike, ndonëse nuk do t'i marrim ato për ilustrim, mirëpo do të flasim për dy marrëveshje tjera, të cilat po ashtu janë të rëndësishme. E para prej tyre është marrëveshja me banorët e Iljes, kurse e dyta me të krishterët e Nexhranit.

Paqja me banorët e Iljes⁵⁵

Pas çlirimit të Mekes, e cila përfundimisht bëri dallimin mes të vërtetës dhe të pavërtetës, rrjedhat e historisë ndryshuan tërësisht. Njerëzit grupe-grupe e përqaфонin Islamin. Mirëpo, ekzistonte një fuqi botërore, e cila e kundërshtonte Islamin pa kurrfarë arsye. Ky ishte

⁵⁴ Ibn Xherir Et-Taberi, *Te'rihu-t-Taberij*, vol.II, fq. 120; *Siretu Ibni Hisham*, voll.III, fq. 274-275; *Ihtisat es-Sultatu et-Tenfidhijetu fid-Devletil Islamijeh ven-Nudhum ed-Dusturijetu el-Muasiretu*, fq. 200; *Sulhul Hudejbijeh*, fq. 253 e tutje.

⁵⁵ Qyteti i Kudsit është quajtur ndryshe si Ilija apo Ejle, që është një emër i vjetër latin Aelia Capitolina, që daton nga perandori romak Aelius Hadrianus, i cili e rindërtoi qytetin e vjetër në formën e vjetër pas një revolucioni të çifutëve në mes viteve 132-135 miladi, e që revolucionin e tyre e shoi Aelius Hadrianus. Sipas Telmudit, Aelius Hadrianus i kishte persekutuar çifutët dhe kishte mbytur një numër të konsiderueshëm prej tyre.

Bizanti-fuqia më e madhe ushtarake në rruzullin tokësor të asaj kohe.⁵⁶

Pas një konflikti të vrasjes së një emisari mysliman, gjërat u përkeqësuan dhe lufta që e pashmangshme. Ushtria Bizantine së bashku me disa fise arabe u përgatit për luftë. Situata ishte shumë e vështirë dhe mjaft e rrezikshme, ngase kjo betejë ndodhi pikërisht në ditët përcëlluese të verës dhe gjatë thatësirave të mëdha me të gjitha hallet që ofron shkretëtira dhe shtigjet e saj.⁵⁷ Megjithatë, myslimanët përgatitën një ushtri të madhe⁵⁸ dhe armikun e kaploi frika, andaj nuk guxuan të përballen, kështu që bizantinët së bashku me aleatët e tyre u shpërtalluan.

Në vitin e nëntë hixhrij i Dërguari i Allahut kur mbaroi Tebukun, erdhi tek ai Juhannetu ibn Ru'be udhëheqës i Ilijes, dhe kërkoi paqe me të Dërguarin e Allahut, gjithnjë në gatishmëri për ta paguar taksën (xhizjen), atëherë i Dërguari i Allahut lidhi paqe me banorët e Ilijes si vijon:

“Në emer të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirbërësit.

Kjo është një siguri dhe garanci nga Allahu dhe Muhamedi –i Dërguari i Allahut- për Juhanetu ibn Ru'be dhe banorëve të Ilijes. Janë të lira anijet lundruese dhe karvanët që mund të jenë në tokë e det, janë mbrojtje/garanci nga Allahu dhe nga Profeti Muhamed Profeti (paqja e Zotit qoftë mbi të), gjithashtu mbrojtje/garanci janë edhe ata që janë në mesin e tyre (Ilijes), qofshin banorët e Shamit, Jemenit, apo edhe ata që janë duke lundruar në det.⁵⁹ Uji i burimeve, ku po qëndrojnë këta njerëz, nuk duhet t'i mohohet ndokujt dhe ata nuk kanë të drejtë të bllokojnë ndonjë vend apo udhë detare.”⁶⁰

⁵⁶ Safijjurr Rahman El-Mubarekfuri, *Nektari i vulosur i Xhennetit*, fq. 499; Ibn Xherir Et-Taberi, *Te'rihu-t-Taberij*, vol.II, fq. 181-182.

⁵⁷ Safijjurr Rahman El-Mubarekfuri, *Nektari i vulosur i Xhennetit*, fq. 502.

⁵⁸ Numri i ushtrisë muslimane numëronte tridhjetë mijë ushtarë. Dhe kurrë më parë nuk ishte zhvilluar ndonjë betejë me një ushtri të muslimanëve numerikisht kaq të madhe.

⁵⁹ Ibni Kethiri, *El-Bidaje ven-Nihaje*, dar edh-Dhehebijetu, pa vit botimi, vol. 5, fq. 18.

⁶⁰ Tabekat Ibn Sa'd, vol. III, fq. 37; Suhejli, *Rrevdul Enf*, vol.IV, fq. 300; Ibni Hisham, *Siretu Ibni Hisham*, vol.II, fq. 525.

Pakti me banorët e Nexhranit⁶¹

Përveç marrëveshjeve me çifutët, paganët, bizantinët, i Dërguari i Allahut kishte lidhur marrëveshje edhe me të krishterët arabë që jetonin në disa vende arabe, një marrëveshje i njohur mes myslimanëve dhe arabëve të krishterë është edhe ai mes të Dërguarit të Allahut dhe krishterëve arabë të Jemenit⁶², që ndodhi në vitin e nëntë të hixhretit, kur një delegacion⁶³ nga Nexhrani i Jemenit erdhi në Medine, ku u takua me të Dërguarin e Allahut, ku lidhën një pakt, siç vijon:

“Në emer të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirbërësit.

Ky pakt i Muhammedit (s.a.v.s.), Pejgamberit të Allahut, është për popullin e Nexhranit⁶⁴

1.Megjithëse Pejgamberi Muhammed (s.a.v.s.) kishte mundësi të merrte pjesë prej prodhimit tuaj, flori, argjend, armë dhe skllevër, ai i trajtoi njerëzit me shpirtmadhësi, duke i lënë mënjatë të gjitha këto gjëra, caktoi për ta dy mije *hul-las*⁶⁵, për çdo vit, secila me një vlerë prej një *evkia*⁶⁶ - një mijë (të furnizohen) në muajin Rexheb dhe një mijë në muajin Sefer.

⁶¹ Nexhrani, që ishte një qendër tepër e rëndësishme e Krishterimit në Arabi, është një rajon në veri të Jemenit. Në të ka ekzistuar një Katedrale madhështore, të cilën të krishterët e konsideronin si Kabe të tyre. Pronat e mëdha që i përkisnin Katedrales ishin burim i të ardhurave të mëdha. Kur populli i Nexhranit e mori letren e Pejgamberit (s.a.v.s.), ata dërguan një delegacion tek Pejgamberi (s.a.v.s.), të cilët shqyrtuan kushtet dhe bënë diskutime. Pejgamberi (s.a.v.s.) i ftoi ata të Muhabila (Lutje për Mallkimin e Allahut mbi grupin që është në rrugë të gabuar dhe kërkoi prej tyre që të mblidheshin së bashku me miq dhe fafëfë dhe t'i luteshin Allahut, që të dërgojë Mallkimin e Tij mbi gënjeshtarët. Delegacioni nuk e pranoi këtë kërkesë, nga frika se mallkimi do të binte mbi ta dhe u morën vesh që të vendosin një pakt. Sulltan Ajmed Kureshi, *Letrat e Muhamedit a.s.*, fq. 88.

⁶² Gjegjësisht këta krishterë ishin nga qyteti i madh i Jemenit, Nexhrani, i cili ishte vilajet që përfshinte shtatëdhjetë e tre fshatra.

⁶³ Delegacioni i tyre ishte i përberë prej njëzet e katër qytetarësh të dalluar.

⁶⁴ Traktatin në fjalë e kishte shkruar Ali ibn ebi Talib.

⁶⁵ Hulla është një lloj veshjeje arabe që përbëhet prej dy çarçafëve, të cilat mund ta mbulojnë krejt trupin e njeriut.

⁶⁶ Evkije kishte vlerën e 40 dërhemëve.

2. Secila *Hul-la* duhet të jetë në vlerën e një Aukia dhe çdo gjë që është më shumë ose më pak se kjo vlerë, duhet të vlerësohet në pajtim me këtë.
3. Nese në vend të Hullas jepet diçka tjetër, si armë, kuaj apo deve udhëtimi, atëherë ato duhet të llogariten në përputhje me vlerën e tyre.
4. Duhet të jetë obligim i popullit të Nexhranit, të parapërgatitet për qëndrimin e punëtorëve të mi. Ndërkaq, ata do të duhet të paguajnë në taksat brenda një muaji. Ata nuk do të qëndrojnë më tepër se një muaj.
5. Nëse ne do të duhet të bëjmë luftë për shkak të ndonjë rebelimi në Jemen, populli i Nexhranit do të duhet të na huazojë 30 armë (parzmore-Dir'un), 20 kuaj dhe 30 deve. Nëse ndonjë prej kafshëve humbet, populli i Nexhranit do të kompensohet.
6. Jeta e popullit të Nexhranit dhe hapësira rrethuese e tij, feja e tyre, vendi i tyre, pasuria, kafshët dhe gjithçka e tyre, ku është e ku s'është, lajmëtarët dhe vendet e tyre të adhurimit janë nën mbrojtjen e Allahut dhe mbikqyrjen e Pejgamberit të Tij. Gjendja e tyre e tanishme nuk do të trazohet, rregullat e tyre nuk do të ndryshohen dhe as idhujt e tyre nuk do të shformohen. Uskuf⁶⁷ (Peshkopi) Rahib apo Weka nuk duhet të hiqen nga funksionet e tyre. Qëllimi është që të ruhet gjendja e gjithsecilit, ashtu siç është (të ruhet status quo).
7. Asnjë njeri nuk do të ndëshkohet për ndonjë krim apo vrasje të kryer në të kaluarën, dhe ata nuk do të detyrohen të kryejnë shërbimin ushtarak. Askush nuk duhet t'u imponojë atyre *Ushr*⁶⁸ dhe nuk duhet që në zonën e tyre të depërtojë ndonjë ushtri.
8. Nëse ndonjëri nga populli i Nexhranit kërkon të drejtën e tij, drejtësia duhet të ndërhyjë midis paditësit dhe të paditurit. Nuk do të

⁶⁷ Këto ishin rangje fetare të popullit të Nexhranit. Këto janë të njëvlershme me Peshkopin (peshkopi i Saksonisë së vjetër, peshkopi i Gjermanisë së Vjetër të Madhe apo Oshënari).

⁶⁸ Një e dhjeta.

- lejohej të kryhet asnjë lloj shtypjeje mbi ta, e as ata nuk do të lejohen të shtypin ndokënd.
9. Kushdo prej banorëve të Nexhranit, që do të marrë kamatë pas përfundimit të paktit, do të jetë i përjashtuar prej garancisë sime.
 10. Asnjë prej popullit të Nexhranit nuk duhet të ngatërrohet në krimin e dikujt tjetër.
 11. Për çdo gjë që është shkruar në këtë pakt, Allahu dhe Pejgamberi i Tij, Muhammedi (s.a.v.s.), janë garantues për to, derisa të ekzistojë urdhri i Allahut në lidhje me këtë dhe për aq kohë sa populli i Nexhranit qëndron i devotshëm dhe u përmbahet me vendosmëri kushteve të cilat u janë vendosur atyre, me përjashtim të rastit kur dikush i detyron ata të veprojnë ndryshe.⁶⁹
- Përveç këtyre marrëveshjeve, i Dërguari i Allahut kishte lidhur traktat me sunduesin e Devmetul Xhendel, Ekejderin, si dhe kishte lidhur traktate dhe marrëveshje tjera, ku në secilin traktat apo marrëveshje pasqyrohej dhe garantohej jeta e tyre, liria fetare dhe ekonomike..., duke nënvizuar se ata janë të lirë dhe të sigurt, askush nuk mund ta cenojë integritetin e tyre, vendet e kultit të tyre do të jenë të siguruar, nuk i lejohej askujt që të dëmtojë pronat e tyre, shtëpitë dhe vendet e adhurimit të tyre.
- Karshi kësaj sigurie në të gjitha sferat, ai kërkonte një taksë simbolike, duke u bazuar në urdhrin kur'anor⁷⁰ dhe atë profetik. Kjo taksë, ndryshe nga tatimet feudale në Evropë dhe gjetiu, nuk përbënte një vështirësi ekonomike për jomyslimanët që jetojnë nën sundimin mysliman. Tatimi konsiderohet si e drejtë legjitime e shtetit islam, kur kihet parasysh se të gjithë popujt - myslimanë dhe jomyslimanë përfitojnë nga mbrojtja ushtarake e shtetit, sigurohej jeta e tyre fetare, poli-

⁶⁹ Ahmed ibn Jahja ibn Xhabir Beladhuri, *Futuh al-Buldan*, bot.I-re, Kairo-Egjipt, 1319h/1901m, fq.70-71.

⁷⁰ Sipas urdhrin kur'anor shih në Kur'an 9:29. Kurse në traditën profetike, ka shumë hadithe që flasin për këtë taksë simbolike, të njohur me emrin Xhizje, e cila vjen nga folja xheza-jexhzi-që nënkupton shpërblim, e kjo në kontekstin tatimor kuptohet një shpërblim për sigurinë e jetës së tyre, besimit të tyre, vendeve të adhurimit, shtëpitë e tyre, të lashtat dhe gjithçka tjetër. Andaj, ata që e paguajnë atë taksë, do të kenë në këmbim të asaj pagese një shpërblim sigurie në të gjitha aspektet.

tike dhe ekonomike. Jomyslimanët paguanin taksën e njohur si xhizje, kurse myslimanët paguanin gjithashtu një taksë të nevojshme dhe obliguese të njohur me termin zekat. Myslimanët duhet t'i mbronin me çdo kusht jomyslimanët që kanë paguar atë taksë, e nëse nuk mund t'i mbronin, atëherë ajo nuk merrej. Gjithashtu, atë nuk e paguanin edhe njerëzit e varfër dhe të sëmurët.⁷¹ Pra, kur jomyslimanët paguanin atë taksë, ata ishin të mbrojtur, e jo si tatimet feudale që edhe nëse paguheshin, ata nuk ishin të mbrojtur domosdoshmërisht.

I Dërguari i Allahut u premtonte se nën patronazhin e tij do të jenë të sigurt nga armiqët e tyre. Kur dëgjoi për vdekjen e Pejgamberit, njëri prej kryetarëve klithi: "I mjeri unë, derisa ai ishte gjallë, kam mundur të jetoj në paqe nga armiqët e mi!"⁷²

Marrëveshjet që i miratoi Profeti, ndryshonin sipas kohës, vendit dhe popullit, ato dallonin shpeshherë njëra prej tjetrës, por në secilën prej tyre tregoheshin kushtet, detyrat dhe obligimet që dalin nga traktatet. Ato që kishin të bëjnë me anën ushtarake, përmbanin nene ushtarake; ato të ekonomisë flitnin për ekonomi; ato të bujqësisë për bujqësi, e kështu me radhë. Andaj, i Dërguari i Allahut nuk shpërfillte asnjë gjë të vogël e të mos përmendej në marrëveshje, kjo e bënte atë të jetë vigjilent i madh dhe mësues i madh për shokët e tij se si të veprojnë.

Përfundim

Në këtë punim, u munduam ta paraqesim tematikën e dinjitetit të marrëveshjeve në Islam dhe respektin maksimal që ka Islami ndaj marrëveshjeve në përgjithësi, sepse ato u japin fund luftërave dhe sjellin paqe mes konfesionëve dhe shoqërive. Së këndejmi, ato janë të mirëseardhura dhe duhet të aplikohen nga myslimanët dhe të tjerët, në mënyrë që njerëzit të jetojnë në bashkëjetesë mes të tjerëve, pa marrë parasysh besimin, kombësinë dhe statusin e tyre.

⁷¹ Shih per me tepër: Ed-dik, *el-Muahadat fish-Sheriatil islamijeh vel kanun ed-devlij el-am*, fq. 316-317.

⁷² Thomas W. Arnold, *Historia e Përhapjes se Islamit*, fq. 49.

Mr. Ejup Haziri

TREATIES IN ISLAM

(Summary)

Introduction

In this paper we will discuss treaties in Islam, which are held in great consideration by it. This is due to the fact that Islam is a religion of peace, which calls for peace, respect for human dignity, calls for coexistence and respect for the rights of others.

In this paper we will present treaties that date back to the time of the messenger as well as two treaties between Muslims and non-Muslims (to better illustrate the issue).

ايوب حازيري

أهمية الاتفاقيات في الاسلام

مدخل

سوف نتناول في هذا المقال الاهمية القصوى التي يوليها الاسلام للاتفاقيات و ذلك باعتبار الاسلام دين سلام و يدعو الى سلام و يدعو الى أن يعيش الناس باستمرار في كرامة بحيث لا يمكن ان تمس كرامتهم من أحد مهما كان منصبه و مكانته و أن يعيشوا متساوين على الرغم من المفارقات الموجودة بينهم.

في هذا المقال سوف نشير بطريق غير مباشر عن الاتفاقيات الكبرى التي قام المسلمون بتوقيعها منذ عهد الرسول عليه السلام و بصورة أوسع سوف نتحدث عن اتفاقيتين تم ابرامها بين المسلمين و غير المسلمين.

JURISPRUDENCË ISLAME

Dr. Fikret Karçiq

USULI-FIKHU - METODOLOGJIA E TË DREJTËS ISLAME

Metodologjia e së drejtës¹ është disiplinë e cila studion metodat e të drejtës dhe këtë metodat e njohjes së të drejtës (shkencore dhe filozofike) dhe metodat e teknikës juridike (krijimit dhe zbatimit të së drejtës). Me disa çështje të cilat bëjnë pjesë në domenin e metodologjisë së të drejtës, shkenca juridike është marrë qysh prej fillimit. Ky preokupim ka qenë josistematik dhe kalimthi. Pasi që prej epokën antike metoda kryesore e shkencës së të drejtës ka qenë metoda dogmatike, për këtë teoria e shpjegimit është zhvilluar deri në shkallë të lakmueshme. Mirëpo, në botën të ndërtuar mbi themelet të cilët e përbëjnë kulturën e Perëndimit (filozofia greke, e drejta romake, kristianizmi) metodologjia e të drejtës si disiplinë e veçantë zhvillohet vetëm në kohët e fundit. Interesimi i përgjithshëm për metodologjinë e shkencave shoqërore është prekur pas Luftës së Dytë Botërore, dhe në këtë suazë është rritur edhe interesi për metodologjinë e të drejtës. Vëmendje e posaçme i kushtohet metodave reale (ai sociologjik dhe të ngjashme me të) kurse në fushën e interesimit të shkencës juridike hy-

jnë edhe problemet logjiko-semantike).² Nga fundi i shekullit 2 dhe fillimi shekullit 3 të Islamit (shekulli 8-9 sipas Isait a.s.).

Nga fundi i shekullit 2 dhe nga fillimi i shekullit 3 hixhri (shekulli 8-9 sipas Isait) në mesin e shkencave islame ekziston disiplina e mëvetësishme e *usuli-fikhut* (bazat e shkencës juridike). Në raport me lëndën e studimit kjo shkencë i përgjigjet metodologjisë bashkëkohore të së drejtës. Profesor Muhammed Hamidullahu shprehimisht thekson se te asnjë popull para Islamit, duke kyçur edhe grekët, romakët, kinezët, induat, egjiptianët, babilonasit, fenikasit, persianët e të tjerë, nuk mund të gjendet disiplina juridike e cila do të merret me filozofinë e së drejtës, burimet, metodat e ligjvënies, shpjegimet e të ngjashme, që muslimanët e quajtën *usuli-fikh* kurse shkenca moderne juridike metodologji të së drejtës.³

Në këtë tekst, do të përpiqemi ta arsyetojmë konstatimin e profesor Hamidullahut duke ofruar njoftimet themelore për krijimin e metodologjisë të të drejtës islame, lëndën e saj dhe me drejtimit e zhvillimit, dhe të tregojë në rëndësinë e arsimimit të disiplinës së mëvetësishme e cila i studion metodat e të drejtës në tërësi të shkencave islame.

I

Rrethanë e rëndësishme për të kuptuarit e krijimit të disiplinës së *usuli-fikhut* është mënyra e ndërtimit të sistemit juridik islam. *Fikhu* - sistemi juridik islam - është ndërtuar me angazhimet intelektuale të juristëve të orientuar në shpjegimin dhe përkthimin në realitet të urdhrave të Ligjit islam (*shariatit*). Sheriati e ka burimin në shpalljen e Zotit të shprehur me fjalë dhe kuptim (Kur'ani), apo vetëm me kuptim

¹ Radomir D. Lukić, Metodologija prava, Beograd 1979, fq. 30-33.

² Muhammed Hamidullah, në librin *Hel lil-kanun er-rumi te'thir ala el-fikh el-islami* (A ka ndikuar e drejta romake në fikhun islam), Bejrut 1973, fq. 77, shënimi 1. (Shih këtë tekst në gjuhën shqipe: Muhammed Hamidullah, Ndikimi i të drejtës romake mbi fikhun, botuar në revistën *Edukata Islame*, Prishtinë, nr. 102/2013, fq. 43-60 ose versioni elektronik: <http://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=2566> (qasja më 15.01.2014).

¹ Fikret Karçiq, Studije o serijatskom pravu i institucijama, Botimi II i plotësuar, Sarajevë, 2011, fq. 25-35.

(Sunet) dhe përbën pjesën e amshueshme të sistemit juridik islam. Orvatja njerëzore e shpjegimit të Ligjit islam dhe përpjekjet që nga dispozitat dhe parimet e tij të përgjithshme të nxirren dispozitat individuale dhe të hollësishme përgjithësisht quhet *ixhtihad* apo *fikh* i disa juristëve. Pasi që në kushtet e caktuara historike heshtazi është ndërprerë shpjegimi i mëvetësishëm i Ligjit islam, kjo është tërësia e përpjekjeve personale të të kuptuarit e sheriatit janë objektivizuar dhe shndërruar në sistem. Ky sistem, sipas natyrës së tij, paraqet të a.q. të drejtën juridike dhe quhet shkenca juridike apo jurisprudencë, përkatësisht *fikh*. Fakti që këto tërësi të dispozitave janë aplikuar nëpër histori dhe kështu kanë paraqitur të drejtë pozitive mundëson që t'i shënojmë edhe si sistem të së drejtës.

Pas vdekjes së Pejgamberit të Zotit juristët muslimanë janë gjetur në gjendje delikate: para tyre ka qenë Libri i Zotit dhe Suneti i Pejgamberit të Zotit kurse detyra e tyre ka qenë përfshirja juridike e një numri të madh rastesh, të cilët janë paraqitur me përhapjen e papritur të Islamit dhe me pranimin e fesë së Zotit nga ana e popullatës së territoreve të pushtuara. Rruga ishte në shpjegimin e burimeve, arritjes së caqeve të ligjvënies, shtrirjes së dispozitave ekzistuese në rastet e porsalindura. Gjatë kësaj gjithnjë e kanë pasur në mendje: Ligjvënës në Islam është Allahu xhel-le shanuhu, Krijuesi i Përkryer i tërë ekzistueses, ndërsa ata janë vetëm njerëz të papërkryer, të cilët me dijen e tyre modeste përpiqen ta arrijnë Vullnetin e Tij.⁴ Vetëdija për madhësinë e punës dhe droja që mos të thuhet për Ligjin e Zotit diçka arbitrare apo të gabueshme kanë pasur për pasojë që juristët muslimanë të tregojnë vëmendjen e pashembullt gjatë shpjegimit të teksteve, klasifikimin e

⁴ Edhe në metodologjinë e të drejtës të cilat nuk bazohen në Shpalljen e Zotit (të a.q. të drejtat njerëzore) gjatë shpjegimit përdoret "supozimi për përsosurinë e krijuesit të së drejtës". Supozohet se krijuesi i normës është qenie ideale e cila e njeh në mënyrë të përkryer shoqërinë njerëzore, të drejtën dhe mundësitë e tij, gjuhën, logjikën dhe teknikën juridike. Shpjeguesi është i vetëdijshëm se ky supozim është jo i saktë, por e përdorë që ta nxisë t'i lëviz të gjitha forcat e veta dhe të imagjinojë zgjidhje konkrete të krijuesit të "përkryer" dhe vetë t'i sendërtojë. (Shih: R. Llukiq, po aty, fq. 125). Juristët muslimanë nuk është dashur të ndërtojnë supozime: ata kanë qenë të bindur se sheriat është i bazuar në Shpalljen e Zotit dhe se detyra e tyre është të përpiqen t'i njohin caqet e normave të cilat burojnë nga Krijuesi i Përsosur.

dispozitave, nxjerrjes së nocioneve të përgjithshme juridike, të kuptuarit të raporteve të teksteve që kanë të bëjnë me materien e njëjtë e të ngjashme.

Kur njëherë është vërejtur rëndësia e këtyre çështjeve dhe kur ishte e qartë që metodat korrekte në masën më të madhe i garantojnë përfundime korrekte, ka qenë tashmë rruga e hapur edhe për disiplinën e veçantë e cila me këtë edhe do të merret.

Shpjegimi (gjuhësor dhe logjik) do të jetë njëra prej temave më të rëndësishme të kësaj discipline dhe tradicionalisht do të ekspozohet në veprat e mëvonshme me titull *vuxhuh dilale el-edil-le* (domethëniet e burimeve). Përpjekjet e juristëve muslimanë në fushën e shpjegimeve do të gjejë shprehjen e vet në ndarjet e shprehjeve në mënyrë konsekuente të nxjerra të përdorura në burimet sheriatike duke e marrë parasysht qartësinë e domethënies, pastaj në vërtetimin e karakterit logjikojuridik të dispozitave të nxjerra nga tekstet të shkallës së ndryshme të qartësisë, në përpunimin teorik të çështjes së specializimit të domethënies të shprehjeve të përgjithshme të përdorura në burimet sheriatike, çështjen e abrogimit e të ngjashme.

Tema e dytë e usuli-fikhut janë burimet e të drejtës islame (*el-edil-le esh-sher'ijje*). Juristët muslimanë kanë zgjidhur problemin e hierarkisë së burimeve, teoretikisht e kanë arsyetuar bazueshmërinë juridike të secilit burim një për një, natyrën juridike të dispozitave të cilët rrjedhin nga burimet e ndryshme e të tjera.

Tema e tretë e usuli-fikhut është çështja e dispozitave juridike (*el-ahkam*). Janë të njohura ndarjet e dispozitave juridike sipas përmbajtjes së tyre në dispozitat lidhur me detyrimet njerëzore dhe gjendjet njerëzore. Duke e pasur parasysht natyrën logjike dhe morale, juristët muslimanë dispozitat i kanë ndarë në urdhra rigoroz, ndalesa rigoroz, rekomandime, pengimeve dhe lënie përzgjedhjes së lirë. Kjo ndarje tregon në specificitetin përmbajtësor të të drejtës islame e cila përfshin dhe një pjesë të madhe të lëndës jojuridike. Është e njohur, me fjalë të tjera, që e drejta, në domethënie e zakonshme të fjalës, përfshin vetëm urdhëresat. E drejta islame përfshin edhe kategoritë morale.

Krahas lëndës së dispozitave juridike, juristët islamë zakonisht e shqyrtojnë edhe çështjen e Ligjvënësit, mundësitë dhe mënyrat e njohjes së vullnetit të Tij. Në kapitullin e njëjtë diskutohet për subjektet juridike, aftësinë juridike dhe afariste. Fakti që shkenca juridike islame relativisht herët erdhi deri te nocionet e përgjithshme juridike sikurse janë subjektet e të drejtës e të ngjashme flet për veten për nivelin e zhvillimit të saj.

Tema e katërt në veprat tradicionale të *usuli-fikhut* është *ixhtihadi* dhe *taklidi*. Fjala është për nocionet specifike për të drejtën islame, dhe për mundësinë dhe autorizimin për shpjegimin e mëvetshëm të Ligjit islam dhe detyrimit të pasimit të mendimeve të juristëve të njohur dhe shkollave juridike. Këtu zakonisht shqyrtohen kushtet për muxhtehidët, llojet e muxhtehidëve, çështjen e dhënies së mendimeve juridike e të tjera.

Është interesant të përmendet edhe një ndarje e lëndës të *usuli-fikhut* të pranishme tek autorët shi'it, e cila me të vërtetë është e afërt me sistematizimin bashkëkohor të metodologjisë së të drejtës islame.⁵ Fjala është për ndarjen në rregulla të nxjerrjes së dispozitave (*el-usul el-istinbatijje*) dhe rregulla të aplikimit të dispozitave (*el-usul el-amelijje*), ku fusha e parë do të përfshinte metoda të caktuara të njohjes së të drejtës dhe metoda juridiko-teknike të krijimit të së drejtës, ndërsa e dyta metoda juridiko-teknike të aplikimit të së drejtës.

Tërë kjo vërteton ndërtimin dhe ekzistimin e metodologjisë së të drejtës si disiplinë të mëvetshme në tërësinë e shkencave islame. Duke e marrë parasysh lëndën e studimit, metodologjia e të drejtës islame është klasifikuar në “shkenca tradicionale” (*naklî*), të vërtetat e të cilës rrjedhin nga Ligjvënësi (Ibn Halduni); sipas natyrës së saj bënë pjesë në shkencat të lidhura për Shpalljen e Zotit (*el-ulûm esh-sher'ijje*), ndërsa shoqëria në tërësi është e detyrueshme që të merret me të

⁵ Murteza Motahhari, *Jurisprudence and its Principles* (Jurisprudenca dhe parimet e saj), fq. 28.

(*fard el-kifâje*), si e thekson këtë Gazaliu.⁶ Për karakterin e kësaj discipline thuhet:

“Ky është studimi i rregullave të cilat përdoren gjatë nxjerrjes së rregullave islame dhe të cilat na mësojnë me metodën korrekte të nxjerrjes së përfundimeve nga burimet thelbësore të shkencës juridike. Bazat (usul) janë, sikur edhe logjika, studimi i urdhrit, në kuptim që lënda e shkencës juridike është grumbull i gjerave të cilat duhet të jenë e jo grumbull të gjerave të cilat janë.”⁷

Me fjalë të tjera, përmbajtjen e metodologjisë së të drejtës islame sikur edhe përgjithësisht të metodologjisë së të drejtës, e përbëjnë thëniet indikative.

II

Në veprat klasike të *usuli-fikhut* nuk ka pasqyrë të historisë së kësaj discipline. Autorët bashkëkohorë të cilët flasin për fillimet e metodologjisë së të drejtës islame zakonisht thirren te Ibn Halduni i cili në *Mukaddime* ka cekur se imam Shafi'u ka qenë i pari i cili ka shkruar vepër për *usuli-fikhun*. Ibn Halduni thotë se në Risalen e tij, ka shkruar për urdhëresat dhe ndalesat, shpjegimin, abrogimin, përfundimet, përfundimit me analogji kurse pas tij imamët hanefitë e kanë zgjeruar dujen për këto çështje.⁸ Përveç Imam Shafiut (vd. 204 h.) si autorë të veprave të para nga *usuli-fikhu* përmenden juristët hanefitë Ebu Jusufi (vd. 183 h.) dhe Hisham ibn Hakemi (vd. 189 h.). Dosido, veprat e paravara nga fusha e *usuli-fikhut* paraqiten nga fundi i shekullit 2 dhe në fillim të shekullit 3 hixhri, përkatësisht nga fundi i shekullit 8 dhe fillimi i shekullit 9 sipas Isait. Nga ana tjetër, është e qartë se shfaqja e veprave të tërësishme në një disiplinë nënkupton një shkallë të caktuar të zhvillimit, dhe se fillimet e metodologjisë së të drejtës islame duhet

⁶ G. Anawati, *Science (Shkenca) në: The Cambridge History of Islam, II*, Cambridge University Press, 1970, fq. 744-745.

⁷ Murteza Motahhari, po aty, fq. 13.

⁸ Mevsu'a el-fikh el-islami (Enciklopedia e të drejtës islame), El-Kahire, 1386-1400 h., XII, fq. 386.

të lëvizin përpara. Prandaj, është i pranueshëm mendimi se fillimi i shkencës së sulit daton nga fillimi i shekullit 2 hixhri, përkatësisht 8 sipas Isait.⁹

Shumica e dijetarëve islamë ka pranuar rolin e madh të Imam Shafiut në ndërtimin e shkencës së *usuli-fikhut*. Si njohës i dy drejtimeve të atëhershme të fikut, shkollës medinase dhe irakiane, si trashëgues i dijes së Abdullah ibn Abbasit në fushën e shpjegimit të Kur'anit, njohës i hadithit dhe ekspert gjuhësor, Shafi'u ka arritur të kundrojë tërësinë e lëvizjeve në fushën e mendimit juridik të Islamit, të zgjedhë më të mirat dhe të shtrojë një dimension të ri. Në fushën e metodave juridiko-teknike i ka përparuar rezultatet e juristit hanefit Muhammed Shejbaniut (vd. 189 h.). Duke synuar unifikimin e të drejtës islame, i ka kushtuar vëmendje çështjes së burimeve dhe rendit të tyre. Teoria për “katër burime” konsiderohet një prej kontributeve më të mëdha të Imam Shafiut. Nga ky shkak edhe është quajtur “baba i të drejtës juridike islame” kurse roli i tij në këtë fushë është krahasuar me rolin e Aristotelit në fushën e filozofisë.¹⁰

Pas mëvetësimit, zhvillimi i shkencës së *usuli-fikhut* ka ecur në dy drejtime.¹¹ Dijetarët e kelamit (apologjetikës dogmatike) në suaza të interesit të tyre shkencor filluan të merren me problemet të cilët hyjnë në fushën e *usuli-fikhut* (mundësitë e njohjes së Ligjit të Zotit, çështja e shpjegimit të teksteve sheriatike, çështja e përgjegjësisë njerëzore e të ngjashme). Qasja e tyre problemeve ka qenë teorike. Janë orientuar në vërtetimin rregullave metodologjike dhe parimeve të përgjithshme në bazë të hulumtimit vetjak të burimeve pa marrë parasysh në atë se a pajtohen rezultatet e tyre në zgjidhjet pozitive të disa shkollave juridike. Në veprat e frymëzimit të këtyre gjejmë qasje të gjerë për disa probleme (kyçjen e filozofisë dhe logjikës në shqyrtimin e çështjeve juridike). Ky drejtim tradicionalisht quhet “drejtim i mutekel-limëve” apo “drejtimi shafiit”, pasi konsiderohet se Imam Shafi'u është theme-

lues i qasjes së këtyre. Mund të thuhet se ky drejtim, sipas karakteristikave të tij, i përgjigjet metodologjisë direktive (normative). Përfaqësuesit më të njohur janë: Abdul Melik El-Xhujeni, Imamu-l-Haremejn (vd 478 h.), autor i veprës *El-Burhan*; Ebu Husejn El-Basri (vd. 463 h.), autor i veprës *El-Mu'temed*; Muhammed El-Gazali (vd. 505 h.), autor i veprës *El-Mustasfa*.

Drejtimi i dytë në *usuli-fikh* është quajtur “drejtimi i hanefitëve”. E karakterizon qasja pragmatike ndaj lëndës. Rregullat metodologjike konstruktohen duke i marrë parasysh zgjidhjet ekzistuese në disa degë të medhhebit të caktuar. Kjo do të thotë që juristët i formulojnë rregullat për të cilat konsiderojnë se u janë përmbajtur muxhtehidët gjatë normimit të disa rasteve. Metodologjia është në shërbim të fuqizimit të zgjidhjeve praktike të një shkolle juridike. Pasi i gjen dhe i përshkruan metodat të cilat janë përdorur gjatë mësimit dhe formulimit të rregullave juridike, ky drejtim mund të shënohet si drejtim i metodologjisë deskriptive. I lindur në suaza të medhhebit hanefit, më vonë është pranuar edhe nga pjesëtarët e shkollave të tjera juridike. Përfaqësuesit e dalluar të këtij orientimi janë: Ebu Hasan El-Kerhi (vd. 340 h.), autor i veprës *Risale*; Ebu Zejd Ed-Debusi (vd. 340 h.), autor i veprës *El-Esrar*; Ali Muhammed, Sejfu-l-Islam El-Pezdevi (vd. 482 h.), autor i veprës *Kenz el-vusul fi usul el-fikh*, të njohur edhe në viset tona me titullin *Usul el-Pezdevi*.

Në zhvillimin e mëtejshëm, metodologjia e të drejtës islame do ta ndajë fatin e shkencës juridike islame. Dominimi i tezës për “mbylljen e deryve të ixhtihadit” në fillim të shekullit 5/11 do të ketë pasojat thelbësore në gjendjen e *usuli-fikhut*. Në këtë periudhë do të shfaqen autorët të cilët do ta shënojnë epokën e pjekur të metodologjisë së të drejtës islame: Ibn Hazm El-Endelusi (vd. 456 h.), autor i veprës *usu-liste El-Ihkam fi usul el-ahkam* dhe bashkokëhisi i tij El-Baxhi, autor i veprës për artin e polemikave juridike me titull *El-Minhaxh fi tertib el-hixhaxh*.

Në periudhën vijuese veprat e këtyre juristëve kanë përjetuar shkurtime dhe shpjegime të shumta. Shkenca e *usuli-fikhut* e ka humbur rëndësinë e vet zanafillore praktike: më nuk kishte muxhtehidë të

⁹ Daire me'arif el-islamijje (Enciklopedia e Islamit), El-Kahire, II, fq. 280.

¹⁰ N. J. Coulson, A History of Islamic Law (Historia e të drejtës islame), Edinburgh University Press, 1978, fq. 61.

¹¹ Shih: Imam Muhammed Ebu Zehre, Usul el-fikh, El-Kahire, (-), fq. 13-20.

cilët do të mund t'i aplikonin rezultatet e kësaj disipline gjatë përdorimit të mëvetshëm të burimeve juridike. *Usuli-fikhu* është bërë disiplinë e cila studiohet si pjesë e arsimimit tradicional islam ndërsa veprat nga kjo fushë, për shkak të shkurtimeve dhe përpunimeve të shumta, qenë bërë gjithnjë e më pak të kuptueshme.

Zhvillimi i *usuli-fikhut* te shi'itët ka pasur një rrjedhë diç ndryshe.¹² Edhe disa autorë shi'ite e pranojnë tezën që imam Shafi'u është autori i parë i veprës së tërësishme nga *usuli-fikhu*, duke kthyer vëmendjen njëkohësisht (sikur këtë e ka bërë rahmetli Sejid Hasan Sadr) se autorët shi'itë para Shafiut kanë shkruar punime për çështje të caktuara të metodologjisë së të drejtës islame. Edhe pse është e vërtetë që shi'itët dhe harixhitët e kanë pranuar *fikhun* çfarë që zhvilluar në bashkësinë suite krahas ndërrimeve të domosdoshme të cilat i kërkonin shkaqet e veçanta politike dhe dogmatike¹³, në përpunimin përmbajtësor të disa problemeve metodologjike ekzistojnë dallime të ndjeshme. Rasti i kështillë është me çështjen e burimeve të *fikhut*.

Edhe në *fikhun* shi'it (xhaferit) ekzistojnë katër burime *el-edil-le el-erbe'a*. I pari është Kur'ani, i dyti është Sunneti (i cili përveç fjalëve, veprave dhe miratimeve të heshtje të Pejgamberëve përfshin edhe fjalët, veprat dhe miratimet në heshtje të imamëve shi'itë), i treti është ixhmai - pajtimi i juristëve (dhe ky pajtimi i arritur në kohën e Pejgamberit dhe imamëve (shi'itë); detyrueshmëria juridike e kësaj pajtueshmërie bazohet në bindjen që ajo shërben si mjet për themelimin e Sunetit), burimi i katërt është '*akli* – arsyeja njerëzore (gjatë kësaj mendohet në angazhimet mendore të muxhtehidëve që, duke vepruar në emër të imamatit të munguar dhe nën ndikimin e tij, përpiqen ta arrijnë përmbajtjen e dispozitave në rastin e zbrazëtive juridike; '*akli* assesi nuk mund të identifikohet me *kijasin* (i cili tek shi'itët është rigorozisht i ndaluar).

Përveç conceptualizimit të ndryshëm të disa nocioneve veçoria e dytë e rëndësishme të usulit shi'it është mungesa e pasojave negative

të taklidit. Te shi'itët, si është e njohur, "dyert e ixhtihadit" nuk janë të mbyllura, dhe gjatë historisë metodologjia nuk është gurëzuar as që e ka humbur rëndësinë praktike.

Autori i parë shi'it i veprës së parë të tërësishme për *usuli-fikhun* ka qenë Murteza Alemul-Huda nga fundi i shekullit 4 dhe fillimi i shekullit 5 sipas hixhretit, autori i veprës *Ez-Zehire*. Një nga nxënësit e këtij alimi ka qenë shejh Tusi (vd. 460 h.), autor i shumë studimeve nga *usuli-fikhu* dhe themelues i mësonjëtores së njohur në Nexhef (Irak). Vijues në vargun e dijetarëve të *usulit* është vahid Bahbehani (vd. 1208 h.), i njohur me nxënës të shumtë të cilët i ka nxjerr në nivel të ixhtihadit. Në shekullin e fundit dijetari më i rëndësishëm i *usuli-fikhut* konsiderohet Murteza Ensari (vd. 1281 h.), shkollën e mendimit të të cilit e pason thaujse tërë ulemaja e mëvonshme shi'ite. Është autor i veprave të famshme *Fera'id el-usul* dhe *Mekasid*, të cilat edhe sot përdoren si libra të usulit.

III

Në kohën më të re në tërë botën muslimane vërehet interes i shtuar ëpër metodologjinë e të drejtës islame. Shkaqet janë të dukshme: çdo kërkesë për reformë të *fikhut* hap çështjen e metodës së aplikimit, çdo kërkesë për aplikim të së drejtës islame hap çështjen e mënyrës së zbatimit në realitet të normave të Ligjit të Zotit.

Në fushën e reformës së *fikhut* janë vërtetuar metoda të caktuara të cilët paraqesin risi në raport me trashëgiminë tradicionale të *usuli-fikhut*. Përveç sijase sher'ijje, e cila shënon kompetencat e prijësit të shtetit ta zbatojë parimet e përgjithshme të të drejtës islame kur nuk ka normë konkrete (të hollësishme) dhe e cila praktikisht i lë pa sanksione dispozitat të cilët nuk i përgjigjen interesave të themeluara të bashkësisë islame, janë formuluar edhe metoda të reja - *tehajjur* dhe *telfik*. I pari domethënë mundësinë e zgjedhjes të mendimit më të përshtatshëm nga mësimi i shkollave të pranuar apo juristëve në rastin individual, kontestues. Në këtë mënyrë anulohet lidhshmëria për zgjedhjet e medhhebit të caktuar ndërsa trashëgiminë e pasur të *fikhut* e

¹² Vidi, Murteza Motahhari, po aty, fq. 23-26.

¹³ Joseph Schacht, Law and justice (E drejta islame dhe jurisprudenca) në: The Cambridge History of Islam, II, fq. 543.

bënë trashëgimi të të gjithë muslimanëve. Metoda e dytë shënon bashkimin e mendimeve të shkollave të ndryshme apo të juristëve në ndërtimin e një dispozite juridike. Kështu zgjidhjet e reja vendosen në kontekst të ri dhe në tërësi paraqesin risi në raport me qëndrimin fillestar. Kjo procedurë konsiderohet hap kryesor drejt *ixhtihadit* të ri. Me shfrytëzimin e metodave të bazuara në zgjidhjet klasike të *usuli-fikhut* reforma është veshur në format e autoriteteve tradicionale apo, si tha një njohës bashkëkohor i të drejtës islame, është përdorë metodologjia e cila thekson përkatësinë formale autoriteteve të kaluara ndërsa faktikisht futen ndryshimet materiale në të drejtën.¹⁴ Gjatë reformës së *fikhut* shkenca e usulit ka rolin e ruajtësit të lidhshmërisë së brendshme të shkencës juridike islame dhe vazhdimësisë së tij historike. Këtu duhet kujtuar reformatorët muslimanë induaë të shekullit 19 - Sejjid Ahmed Hanin dhe Mumtaza Aliun, të cilët reformën e dikhut e kanë nxjerr në formën e precedentëve detyrues. Nën ndikimin e dukshëm të traditës juridike angleze, vendimit gjyqësor në rastin konkret i është dhënë fuqi detyruese për të gjitha rastet e njëjta apo të ngjashme. Ishte kjo abstenim i dukshëm nga koncepti i të drejtës

Në fushën e aplikimit të së drejtës, metodologjia ka për detyrë të gjejë mjetet më të përshtatshme për realizmin e të drejtës. Nga mënyra e aplikimit varen edhe efektet e një sistemi juridik - përmbushja e caqeve të ligjvënies apo komprometimi i tyre. Metodologjia e të drejtës islame do të duhet t'i kushtojë kësaj fushe vëmendje të veçantë. Dallohen mendimet që veprat nga usuli duhet të kyçin edhe shqyrtimin e aplikimit të bazave dhe parimeve, sepse “sheriati është pjesë e fesë islame dhe jo ushtrim akademik”. Pa analizë se si në rrethanat reale historike janë aplikuar rregullat shariatike, ligjërimi për “bazat e tyre” bëhet akademizëm formal.”¹⁵

¹⁴ John L. Esposito, *Women in Muslim Family Law* (Gruaja në të drejtën familjare muslimane), Syracuse University Press, 1982.

¹⁵ Z. J. Qureshi, në paraqitjen e librit *Basis of Shari'ah (Islamic Law)* dr. Abdul-Rahman I. Doi, të publikuar në *The Muslim World Book Review*, 2/1983, fq. 5.

IV

Rëndësia e rritjes së disiplinës së mëvetshme e cila merret me metodat e së drejtës në suaza të sistemit të shkencave islame më së miri vërehet nëse paraqitet zhvillimi përkatës i shkencës juridike në kulturat e tjera.

Më shumë shkencëtarë kanë tërhequr vërejtjen në ngjashmëritë e tipareve të përgjithshme të së drejtës herreje dhe islame. Ka pasur mendime të skajshme që fikhu është Talmudi i receptur (Hughes në *Dictionary of Islam*). G. H. Bousquet, i cili është marrë me këtë problem thekson që, nga aspekti metodologjik, të dy sistemet kanë ngjashmëri në aspekt të: bazës (Shpallja e Zotit), mënyrës së ndërtimit (veprimtaria e juristëve të cilët e përdorin metodën e rasteve individuale të supozuara) dhe strukturës (nuk ka pushtet latin ligjvënës, nuk ka institucione të larta gjyqësore vendimet e të cilit janë detyruese, nuk ka murgj). Mirëpo, edhe pse në ndërtimin e të dy sistemeve rol të madh kanë pasur juristët, e drejta hebrenje nuk ka diçka që i përgjigjet *usuli-fikhut*, as hadithit, i cili ka luajtur rol aq të madh në formësimin e të drejtës islame. Në aspekt të burimeve, e drejta hebrenje e njeh vetëm shpalljen (Tevratin) dhe mendimet e juristëve.¹⁶ Edhe përkundër zhvillimit të rëndësishëm të mendimit juridik në hebraizëm (Mishna, Gemara), metodologjia e së drejtës si disiplinë e mëvetësishme nuk është formuar. Sa i përket të drejtës romake, në themelet e së cilës është ndërtuar e drejta kanunore e kristianizmit, mungesa e tij më e rëndësishme është mungesa e një qasjeje të përgjithshme të së drejtës dhe mungesa e nocioneve dhe përkufizimeve të përgjithshme juridike.¹⁷ Detyra kryesore e shkencës juridike romake ka qenë që për rastin kon-

¹⁶ G. H. Bossquet, *Le Mystere de la formation et des origines du Fiqh* (Sekreti i krijimit dhe burimeve të shkencës juridike islame). Citati sipas përkthimit në gjuhën arabe në veprën A ka ndikuar e drejta romake në të drejtën juridike islame, fq. 77.

¹⁷ Obrad Stanojević, *Gaius noster - prilog historiji rimske pravne nauke*, Beograd 1976, fq. 50-55.

kret të jep zgjidhje konkrete juridike. Juristët romake flisnin: “*Da mihi facta, dobo tibi ius*” (Mi jep faktet, do ta jap të drejtën).

Në baza të rasteve individuale më vonë me rrugë të natyrshme, nëpërmjet klasifikimeve dhe përgjithësimeve, është rritur në sistem. Konsiderohet se filozofia greke dhe hapja e shkollave juridike e kanë futur të drejtën romake në fushën e abstraksioneve. Edhe pse romakët kanë dhënë kontribut të lartë në zhvillimin e metodës dogmatike dhe, në masë të caktuar, edhe normative dhe shkencën juridike e kanë ngritur në nivel të artit si “si dije për gjerat hyjnore dhe njerëzore” (*Rerum divinarum atque humanorum notitia*) deri te metodologjia e të drejtës si disiplinë e mëvetësishme në suaza të shkencave juridike nuk kanë arritur.

Përktheu:
N. Ibrahim

Dr. Fikret Karcic

Usul al-Fiqh: Methodology of Islamic law (Summary)

Usul al-fiqh is a discipline that studies the methods (scientific and philosophic) that aid us in understanding the law and the methods to create and implement it. Juridical science has dealt with certain issues, which are part of the domain of usul al-fiqh, since the beginning. Yet, this approach was not systematic.

فكرت كارتشيتش

أصول الفقه منهجية التشريع الاسلامي (خلاصة البحث)

منهجية التشريع الاسلامي تعتبر مادة تبحث عن طرق التشريع و هذا عن طرق معرفة التشريع = العلمية و الفلسفية = و طرق الاساليب القانونية = ايجاد و تطبيق القانون = . و فيما يتعلق بمجال منهجية التشريع علم القانون انشغل به منذ البداية و لمن يمكن القول بأنه كان تلقائيا و غير منتظم. و كما هو معروف فان منذ العهد اليوناني المنهجية الرئيسية في علم التشريع كانت الطريقة العقائدية و يمكن القول بهذا الصدد بأن نظرية شرحها وصلت الى مستوى مرض.

ISLAMMI DHE RACIONALIZMI

Prof. dr. Jahja Jesribi

KRITIKA DHE RACIONALIZMI, SIPAS ISLAMIT

Abstrakt

Me këtë shkrim do të mundohem të shqyrtoj statusin e kritikës dhe racionalizmit sipas fesë islame. Autori beson se feja islame dallon esencialisht me fenë krishtere, ngase Islami për dallim nga Krishterimi, njeriun e fton në racionalizëm, ndërkaq mesazhi i tij për kohën aktuale nuk është tjetër pos racionalizmit. Për të dëshmuar këto prete-ndime kemi argumente të shumta në Kur'an. Autori gjithashtu mbron qëndrimin se një mesazh tjetër i Kur'anit për njeriun e sotëm është edhe kultura e kritikës, ndonëse vetëm ai besim është vlefshëm, i cili mund t'u bëjë ballë dyshimeve dhe hamendjeve të ndryshme, andaj secili prej nesh për të arritur në besim të plotë duhet të ketë një qasje kritike ndaj kulturës sonë.

Fjalët Çelës: Racionalizmi, besimi, kritika, skepticizmi, Islami, Krishterimi.

Hyrje

Së fundi, për arsye të ndryshme, gjithandej diskutohet për domosdoshmërinë dhe rëndësinë e kritikës dhe risive kulturore. Autori i këtyre rreshtave, para shumë vitesh ka vënë theksin mbi rëndësinë e kësaj çështjeje dhe mungesën e diskurseve të tilla, sidomos në fushën e shkencave humane.

Duke pasur parasysh besimin tonë, se feja islame është feja e vetme e vërtetë e njerëzimit e cila posedon të gjitha forcat për udhëzimin e njeriut në çdo kohë dhe vend, duhet ta dimë se Kur'ani që nga shpallja e tij na ka treguar rrugën të cilën duhet ta ndjekim, por ne vetë kemi qenë neglizhentë dhe nuk iu kemi përmbajtur predikimeve dhe mësimave të tij. Si pasojë e kësaj neglizhence sot jemi dëshmitarë të përpjekjeve të shumta, me të cilat mundohen që fesë islame t'i japin ngjyrimet e fesë krishtere. Njëri nga diskursat e tillë pretendon në mosmarrjen parasysh sa duhet të racionalizmit të Islamit. Por, s' duhet harruar se dimensionin më fuqishëm i Islamit është mbështetja e tij në mendim, logjikë dhe racionalizëm.

Prandaj, qëllimi i këtij shkrimi është trajtimi i argumenteve kur'anore në fushën epistemologjike, duke vënë theksin në qasjen e Islamit ndaj 'mendjes' dhe 'mendimit'. Në këtë përpjekje simbolike do të mjaftohem vetëm me shpalosjen e qëndrimeve kur'anore mbi temën në fjalë.

Sipas Kur'anit të Shenjtë, njeriu në këtë botë vjen me mendje të zbrazët (bosh): *"All-llahu ju nxori nga barqet e nënave tuaja (si foshnje) që nuk dinit asgjë. Ju pajisi me (shqisa për) të dëgjuar, me të parë dhe me zemër,..."* (Nahl, 78)¹

Njohje dhe dituri, njeriu përfiton me forcat e tij perceptuese, por për shkaqe të kufizimeve të ndryshme, ai dhe mund të gabojë dhe të ndjekë rrugë të devijuara.

¹ Ajetet e Kur'anit janë huazuar nga:
<http://iium.edu.my/deed/quran/albanian/alindex.html> (A.R.)

E vërteta dhe hamendja (conjecture)

Arsyeja më e rëndësishme e të gabuarit dhe të devijuarit të mendjes së njeriut është se ai, hamendjet dhe iluzionet e trilluara nga mendja e tij i pranon si të vërteta absolute, dhe në këtë mënyrë bindjet dhe besimet e tij i përforcon mbi këto hamendje dhe imagjinata: **“Në qoftë se u bindesh shumicës (mohuese që janë) në tokë, ata do të largojnë ty nga rruga e All-llahut. Ata nuk ndjekin tjetër vetëm supozime dhe nuk janë tjetër vetëm se rrenacakë”**. (En’am, 116)

Kjo ikje nga e vërteta (rruga e All-llahut) drejt hamendjes është po ai ‘kthim’, ‘largim’, ‘ikje’ e gjuhës së Shpalljes që do të thotë kthim nga ajetet dhe traditat hyjnore, largim nga e vërteta dhe mospasje raportesh të shëndosha me dijen (shkencën) dhe mbështetje në hamendje dhe iluzion: **“...por shumica e tyre nuk e dinë të vërtetën, andaj edhe nuk vështrojnë”** (Enbija, 24) **“Nuk ka argument që u vjen atyre nga argumentet e Zotit të tyre, e që ata nuk i shmangen”** (En’am, 4).

Rezultati i këtij i kthimi nga e vërteta drejt hamendjes është po ai rezultat të cilin filozofët e mëdhenj e kishin vërejtur shumë herët. Aristoteli, duke e çmuar lart Okiposin dhe Atemianin për dallim nga Platoni, shkruan: “Dallimi qëndron këtu se studimi dhe njohja e vazhdueshme e natyrës, studiuesin e çon drejt prezantimit të tezave të fuqishme, të cilat i lidhin mes vete një pjesë të madhe të realiteteve, por në të shumtën e rasteve kur jemi të zënë më tepër se ç’duhet vetëm me botëkuptime dhe koncepte të të tjerëve, atëherë e dobëson fuqinë e tezave tona dhe na pengon arritjen e së vërtetës”. (Gomperz: 1375, 337)

Kur’ani Kerim, këtë paralajmërim e shtron duke refuzuar legjitimitimin e ‘emrave’ dhe në lidhje me zotat e krijuar nga mendja e njerëzve, thotë: **“Ata (që i adhuron) nuk janë tjetër, vetëm se emra që ju dhe prindërit tuaj i emërtuat; All-llahu nuk zbriti për ta ndonjë fakt. Por, ata (idhujtarët) nuk ndjekin tjetër vetëm se paragjykime dhe çka duan vetë,...”** (Naxhm, 23)

Kur’ani i paraqet dy elemente bazë përmes të cilëve njerëzit sajojnë besimet dhe bindjet e tyre të padrejta dhe të devijuara. Elementi i parë është hamendja apo iluzioni, nëpërmjet të cilit individ i krijon dhe strukturon besimin e tij; dhe elementi i dytë është egoja apo dëshira e epshit të tij, përmes të cilit ruan këtë besim. Rreth elementit të parë nuk nevojitet shpjegim i detajuar, por mbi egon dhe epshin e njeriut me të cilin ruan besimin dhe bindjen e tij të gabuar, duhet dhënë sqarime më të hollësishme.

Kur një mendim dhe kulturë e transferuar nga një gjeneratë në gjeneratën tjetër përhapet në ambientin jetësor dhe edukativo-arsimor tonin, atëherë njerëzit atë mendim dhe kulturë e perceptojnë si pjesë të personalitetit të tyre dhe lidhen për të me të gjitha forcat shpirtërore. Kurse kjo lidhje shpirtërore me atë mendim dhe kulturë tregon fuqinë e pranimi të saj dhe çdo kundërshtim ndaj tyre perceptohet si sulm ndaj personalitetit dhe intimitetit të ndjekësve të tyre.

Historia e njerëzimit më shumë ka kaluar dhe vazhdon të kalojë me një gjendje të këtillë. Nëse studiojmë me kujdes të kaluarën dhe të tashmen e njerëzve gjithnjë do të përballemi me një fatkeqësi dhe realitet të hidhur, të cilën Kur’ani e përshkruan me një shprehje brilante, (shih: Rum, 32. Mu’minun, 53), pra kjo kënaqësi dhe krenari në ndarje është më tepër se pranim i një mendimi dhe feje tjetër.

Pra, kjo kënaqësia dhe krenaria të cilat burojnë nga epshi dhe egoja e individit janë elementi kryesor i sigurimit dhe mbrojtjes së mendimit dhe kulturës, sepse:

E para: Kjo krenari njeriun e ka zhytur në një neglizhencë të thellë dhe mendimin dhe kulturën e vet atij ia paraqet pa të meta dhe pa gabime. Në atë mënyrë që ai, për mendimin dhe kulturën e tij nuk ka as dyshimin më të vogël.

E dyta: Individ i urren dhe refuzon çdo kritikë dhe kundërshtim ndaj mendimit dhe kulturës së tij.

E treta: Nuk e merr serioze asnjë mendim dhe kulturë tjetër dhe nuk e hulumton atë në mënyrë të pavarur; ashtu siç vepron sot bota e civilizuar, e cila me gjithë ato pretendime për racionalizëm, mendim të lirë dhe studim të pavarur është kapur fort për diskursat jora-

cionale, madje anti-rationale të Krishterimit, dhe jo vetëm që nuk përfill Islamin me gjithë atë bagazh të dijes, por dhe e lufton atë me të gjitha mjetet!

Metoda të cilën e propozon Kur'ani për t'i ikur kësaj varësie që kemi ndaj kënaqësive dhe krenarive të tilla të palogjikshme, është qasja kritike ndaj mendimit dhe kulturës sonë dhe të tjerëve. (Zumer, 17,18) ***“Ndërkaq, ata që u larguan prej adhurimit të idhujve dhe iu drejtuan All-llahut, ata kanë gëzim të madh, që t'i përgëzojë robërit e Mi!*** Gjithashtu s'duhet harruar se qasja kritike vetëm atëherë mund të ketë rezultate të dobishme vetëm nëse mendimet dhe bindjet tona i krahasojmë me të vërtetën. Ky është udhëzim i Kur'anit. Rasti i hz. Ibrahimit në Kur'an është i tillë. Kur'ani atë e përshkruan si një të djallë të ri, i cili kërkon të vërtetën.

Ibrahimi a.s. dhe bashkëmendimtarët e tij, bindjet dhe mendimet që dominonin në familjen dhe shoqërinë e tyre i shihnin me sy kritik dhe i konsideronin të palogjikshme. Ai, duke kundërshtuar xhaxhanë dhe njerëzit tjerë të asaj shoqërie, deklaronte se gjërat që i adhuronin ata ishin të paperceptueshme dhe nuk meritonin adhurimin e njeriut. (Mumtehene, 4, En'am, 74).

Kjo ishte dhe pikë fillimi i një lëvizjeje intelektuale në shoqërinë e njerëzimit. Të gjitha thirrjet për dyshim dhe kritikë ndaj traditës bëhen me qëllim të shpëtimit nga prangat e besimit të trashëguar, moskënaqësisë me atë që posedon dhe të moskërkimit të së vërtetës. Mutezilitët të cilët dyshimin e kishin cilësuar si detyrën kryesore dhe parësore të njeriut, e kishin bërë me qëllim që njeriu derisa të mos dyshojë, nuk do të mendojë. (Xhujeni: 1360, 15, Hasanzade Amoli: 1361, 292)

Tani shtrohet pyetja se athua pse rruga e vetme e lëvizjes mendore (intelektuale) është vënia në pikëpyetje e besimit apo mendimit të plotë dhe arritja në dyshim? Në përgjigje duhet thënë se mendja e njeriut nuk ka më tepër se këto dy statuse: ose nuk është në gjendje të gjykojë dhe të miratojë asgjë, ose të kundërtën të gjykojë dhe miratojë çdo gjë për shkak se ka jetuar në shoqërinë njerëzore dhe është ndikuar prej saj.

Personi i cili në kushte normale arrin në shkallën e zhvillimit mendor dhe gjen mundësinë për zgjerimin e diapazonit të tij intelektual, padyshim se nuk ka pasur mendje të zbrazët (bosh), pra truri i tij ka statusin e dytë të lartpërmendur, që do të thotë ka jetuar në shoqëri dhe mendimin e tij e ka krijuar si pasojë e ndikimeve të ndryshme familjare dhe shoqërore. Gjithashtu duhet theksuar se nuk ekzistojnë persona që mendjet i kanë plotësisht të zbrazëta nga mendimet dhe imagjinatat, ata mund të supozohen vetëm si mite. Për shembull, në qoftë se një fëmijë lind në një ishull dhe i vdesin prindërit, e ai rritet me shtazët dhe ambientin rreth tij, atëherë mund të ketë mendje të zbrazët (të pandikuar nga askush) dhe të jetë 'vetja'. Por, të gjithë njerëzit lindin në familje të caktuar dhe jetojnë në shoqëri dhe në këtë mënyrë mendjet e tyre mbushen me gjykimet dhe mendimet që ua servojnë të tjerët nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm, siç janë edukimi familjar, ndikimi shoqëror, shkollat, televizionet, interneti, etj.. Për atë dhe njeriu i sotëm si prioritet të tij parësor duhet ta ketë çlirimin nga çdo pranga e gjykimeve dhe paragjykimeve që iu kanë imponuar nga të tjerët.

Nuk do mend se midis ndjekësve të shkollave dhe feve të ndryshme ekzistojnë individë, besimi i të cilëve është i drejtë, apo ka raste kur gjykimet dhe mendimet e njerëzve janë të drejta dhe të ekuilibruara. Andaj, dhe shtrohet pyetja pse njerëzit lëvizjen e tyre mendore (intelektuale) duhet ta fillojnë duke dyshuar?

Nëse supozojmë se bindjet, besimet, mendimet, veprimet, e madje vetëm një shkolle apo feje në botë janë të vërteta dhe të tjerët janë të devijuar, atëherë çfarë dallimi ekziston mes ndjekësve të shkollave dhe feve të vërteta dhe të devijuara? Ndjekësit e të dyjave janë të njëjtë, sepse bindjet dhe mendimet i kanë trashëguar nga të tjerët, ndërkaq asnjëri prej tyre nuk ka gjeturuar për të arritur deri te e vërteta. Që të dy grupet janë formuar nëpërmjet imitimit (taklidit) apo përmes mekanizmave të cilët i përmendëm më lart. Gjithashtu, duhet theksuar se ndjekësit e këtyre dy rrugëve aksidentalisht i takojnë asaj shkolle apo feje, qoftë ajo e drejtë apo e gabuar, dhe derisa ata nuk dyshojnë në bindjet dhe mendimet e tyre dhe nuk përpiqen të gjejnë të vërtetën,

mbeten të njëjtë pa asnjë dallim nga njëri-tjetri. Padyshim se këtu përjashtojmë rastet kur individët gjejnë të “vërtetën” e tyre, duke hulumtuar ditë e natë.

Me një shprehje tjetër, nëse një shkollë apo fe është e vërtetë dhe nëse ndjekësit aksidentalisht janë pjesëtarë të saj dhe nuk e kanë zgjedhur atë duke studiuar, atëherë gjithashtu aksidentalisht do t'i shfrytëzojnë dobitë dhe të mirat e kësaj shkolle dhe feje, ashtu si të tjerët që aksidentalisht janë në rrugën e gabuar. P.sh., njëri është lindur në një familje hebraike dhe është bërë hebre dhe tjetri në një familje myslimane dhe është bërë mysliman, në qoftë se njëra nga këto dy fe është e vërtetë, njëri prej tyre fatmirësisht është në rrugën e drejtë, ndërkaq tjetri aksidentalisht në të gabuarën. Ndonëse asnjëri prej tyre nuk ka kërkuar argumente për besimin dhe mendimin e tij dhe s'ka hulumtuar fare në këtë drejtim.

Mund të shtrohet edhe kjo pyetje, se a ekziston mundësia që disa nga mendimet dhe bindjet e një individi mund të jenë të drejta, atëherë pse ai duhet të braktisë gjithë sistemin e tij mendor apo fetar? Mund të themi se individi çdo mendim dhe bindje duhet ta vendosë në peshoren e dyshimit dhe të studiojë derisa të gjejë bindjen e plotë lidhur me atë. René Descartes ka një alegori të bukur, ku thotë se nëse vendosim rindërtimin e shtëpive të një qyteti, nuk duhet që t'i rrënojmë të gjitha shtëpitë së bashku dhe pastaj t'i ndërtojmë, po duhet vepruar në mënyrë individuale, duke u marrë me secilën shtëpi në vete. Por, vetë ai e pa të udhës që njëherë të rrënojë çdo gjë, ku thotë: “... dhe nuk pashë rrugë tjetër pos flakjes së të gjitha mendimeve që i kisha deponuar në mendje deri në atë kohë”. (Descartes: 1361, 46.)

Është tepër vështirë derisa të vihet në funksionim dyshimi dhe më i vështirë bëhet kur fillon të kontrollohet dhe menaxhohet nga dyshuesi. Nuk është lehtë të dyshosh ndaj gjithë atyre dijeve, bindjeve, mendimeve dhe informacioneve që i ke përfituar vetë apo t'i kanë imponuar të tjerët përmes sistemeve edukativo-arsimore, por është kënaqësi kur të gjitha këto i vë në pikëpyetje dhe me një përpjekje të palodhshme studiuese arrin të dallosh të vërtetën nga pseudo e vërteta dhe në këtë mënyrë shijon ëmbëlsinë e besimit dhe mendimit të drejtë.

Rreth këtij diskursi, për mendimin tim, fetvaja më madhështore nga një dijetar i fesë është ajo e Ibn Xhabai (v. 326 hixhri kameri), i cili kur flet në lidhje me ‘detyrimin (vaxhibin) e parë’ për njeriun në këtë jetë thotë, se ai është ‘dyshimi’, derisa një grup dijetarësh thotë se detyrimi i parë është ‘njohja e Zotit’, ndërsa disa të tjerë thonë ‘mendimi/arsyeja’. Ibn Xhabai potencon faktin se pa ‘dyshim’ nuk mund të kemi ‘mendim’ dhe pa mendim nuk mund ta ‘njohim Zotin’. (Xhurvejni: 1360, 15)

Dyshimi është fillimi i rrugës së studimit dhe gjurmimit shkencor dhe intelektual. Më duhet të theksoj, se me dyshimin nuk synoj gjë tjetër pos gjykimit dhe vënies në peshoren e kritikës së bindjeve dhe mendimeve tona të deritanishme, të cilat i kemi deponuar përmes studimeve tona individuale apo nga të tjerët. Edhe pse thonë se i pari që ndoqi një metodë të tillë ishte Descartes, por ne që njohim mirë traditën intelektuale islame e dimë, se Ibn Xhabai, Ebu Hishami, Imam Gazaliu shumë më herët se Descartes kishin arritur në një rezultat të tillë dhe e kishin trasuar seriozisht këtë diskurs mjaft të rëndësishëm në shkencë.

A është dyshimi - si armik i injorancës dhe mosdijes - qëllimi final i njeriut?

Një grup njerëzish, dyshimin e konsideron si një fenomen shkatërrues të sistemeve shkencore dhe të vlerave dhe predikojnë distancimin prej tij. Këtyre personave duhet t'i japim pakëz të drejtë, sepse dyshimi si fenomen në vete është ‘injurancë/mosdije’ kurse njeriu i etur për dije dhe informim. Por, s'duhet neglizhuar fakti se dyshimi nuk është qëllimi final i njeriut në këtë jetë, por ai është vetëm mjet për të arritur deri te dija dhe shkenca. Këtu nuk flitet për atë nëse dyshimi është më i mirë se bindja/besimi, por bëhet fjalë rreth asaj se në qoftë se njeriu kërkon të arrijë të vërtetën dhe dijen njëherë duhet të tejkalojë nga rruga e dyshimit dhe të ndjekë qëllimin përfundimtar të tij. Kritikët dhe dyshuesit (skeptikët) e mëdhenj gjithmonë kanë hapur horizonte dhe diskurse të reja në fusha të ndryshme intelektuale. Në qoftë se ne mjaftohemi me gjykimet dhe dijet tona që kemi dhe nuk i vendosim ato në peshoren e kritikës, do të vazhdojmë me vetëkëna-

qjet shterpe dhe të padobishme madje edhe për veten. Prandaj, dhe dyshimin s'duhet ta perceptojmë si qëllim tonin, por vetëm si mekanizëm për të arritur deri te e vërteta shkencore.

A është dyshimi dhe propagandimi i tij në dëm të së vërtetës?

Ata të cilët janë të mendimit se dyshimi është i barabartë me injorancën dhe shkatërrimin, propagandimin e tij e cilësojnë si kundërshtim ndaj arsyes dhe logjikës. Gabimisht mendojnë se detyrë e çdo individi është të mbrojë besimin/bindjen aktuale që ka dhe jo të përkrahë dyshimin dhe dyshuesit. Individi të tillë nuk i shqetëson fare injoranca dhe mosdija e njerëzve, për arsye se ata:

- a) Janë të bindur se posedojnë të vërtetën dhe vetëm besimet/bindjet dhe mendimet e tyre janë të drejta. Ata nuk e kanë kuptuar se një besim i tillë absolut është i trashëguar apo i kumtuar nga të tjerët dhe s'është përfituar nga studimi dhe gjurmimi. Të tillët, kritikën dhe dyshimin ndaj sistemit besimor dhe mendor të tyre e shpallin veprim blasfemik dhe të devijuar.
- b) Dhe përveç vetes, fesë dhe sektit të vet nuk shohin edhe miliarda njerëz të tjerë me fe dhe sekte të ndryshme, madje as që duan të informohen rreth realiteteve dhe fenomeneve tjerë në rruzullin tokësor. Në kohën kur mendja dhe arsyeja e shëndoshë na shtyjnë që të jemi më të hapur ndaj të tjerëve të cilët nuk janë sikur ne. Padyshim se më e dobishmja për të gjithë njerëzit edhe për vetë ne, do të ishte që sistemin aktual të mendimit dhe besimit ta shohim me një sy kritik dhe të mos këmbëngulim me fanatizëm në mendimet dhe bindjet që i kemi trashëguar nga të tjerët.

Kurse vështrimi kritik ndaj kulturës dhe bindjeve tona fetare do të ishte në interes të diturisë dhe shkencës dhe do t'u dilte në ndihmë përpjekjeve kundër padijes dhe injorancës. E vërteta nuk dëmtohet fare nga kërkimi i dijes dhe gjurmimi në horizonte të reja shkencore dhe intelektuale, por dëmtohet nga mosdija dhe mbyllja ndaj ideve dhe mendimeve të reja. Intelektualët perëndimorë, me të drejtë e kishin kuptuar se armiku më i madh i shkencës nuk është dyshimi, por gjykimet dogmatike dhe kategorike. Edhe një gjë nuk duhet ta harrojmë se diturinë nuk e dëmton mosdija dhe një person i paditur, por dija dhe i

padituri që zbukurohen me kozmetikën e shkencës dhe diturisë dhe që pretendojnë të zënë vendin e dijes së vërtetë. Këtu s'kemi të bëjmë me një gabim intelektual apo shkencor, por kemi të bëjmë me një mashtrim shumë të rrezikshëm që kërcënon çdo dimension shoqëror. Fjalë të tilla mund të thuhet edhe për besimin, jo vetëm për diturinë, sepse rreziku për besimin e vërtetë nuk vjen nga mosbesimi, por nga besimet e gabuara dhe të devijuara. Besimet e gabuara janë armik i përbashkët i diturisë dhe fesë dhe këto të fundit luftojnë me të gjitha mjetet këto të fundit. (Casirer: 1372, 218). Kurse lufta kundër besimeve të shtrembëruara nuk mund të zhvillohet ndryshe pos me kritikë dhe racionalizëm, duke i vënë në shënjestër të kritikës të gjitha të dhënat shkencore pa marrë parasysh prejardhjen e tyre dhe duke bërë analogji midis këtyre të dhënave. Askush nuk duhet të frikësohet nga një veprim i tillë, sepse kjo ndihmon në ndarjen e shapit prej sheqerit dhe kështu njerëzit mund të arrijnë deri te një besim dhe mendim i drejtë.

Duhet potencuar fakti gjithashtu se thirrjet e Perëndimit në pluralizëm fetar - thirrje e cila për fat të keq në disa raste po përsëritet edhe nga disa intelektualë myslimanë - bëhet me prapavijë politike dhe buron nga qasja epistemologjike perëndimore. Përndryshe, absolutisht është në dëm të së vërtetës dhe mbyll çdo rrugë të studimit dhe hulumtimit. Në vend që të mbyllim rrugët e hulumtimit dhe studimit për ta kërkuar të vërtetën, ashtu siç bën thirrje Perëndimi përmes pluralizmit, duke u dhënë të drejtë të gjitha grupeve, feve dhe sekteve, ne duhet të bëjmë thirrje për përhapjen e gjurmimeve dhe studimeve shkencore dhe diturore me qëllim të gjetjes së të vërtetës burimore.

Përfundim

Studimi dhe hulumtimi është një detyrë themelore për çdo njeri. Studimi dhe hulumtimi në fusha të ndryshme të dijes dhe shkencës është ideal e jo mekanizëm për të arritur përfitime materiale apo për të bërë karrierë në sy të njerëzve. Sepse individi që ka studiuar dhe është informuar ashtu si duhet, nuk mund të shndërrohet në mjet i të tjerëve që nuk ia duan të mirën shoqërisë dhe vendit, e as që sakrifikon

të vërtetën për përfitime tjera të kësaj bote. Ashtu siç kishte vepruar hz. Muhammedi s.a.v.s., kur të afërmit e tij i kishin thënë të hiqte dorë nga thirrja e tij në rrugën e Zotit, ai në përgjigje iu kishte thënë: “Bethem në Zotin se sikur diellin të ma japin në dorën e djathtë dhe hënën në dorën e majtë, nuk do të dorëzohem përballë kërcënimeve dhe propozimeve lakmuese të tyre”. Ashtu si Sokrati që pranoi të pijë helmën e athinasve dhe të mos heq dorë nga dituria dhe bindja e tij. Ndërsa ata të cilët janë shkolluar dhe informuar për përfitime materiale, nuk mund të jenë aq të besueshëm për shoqërinë dhe atdheun, sepse për fat të keq nuk kanë kuptuar bërthamën e dijes dhe shkencës dhe qëllimin human të saj.

Në fund, duhet thënë se asnjë person nuk duhet të kënaqet dhe të mjaftohet me atë gjendje të dijes dhe besimit që e ka, por vazhdimisht duke e kritikuar dhe duke e vënë në dyshim, duhet të kërkojë horizonte të reja të diturisë dhe përvojës fetare dhe kështu të lëvizë drejt përsosmërisë intelektuale dhe fetare.

Literatura:

1. Kur’ani
2. Casirer, Ernest. (1372) Felsefeyi revesh endishi. Përktheu: Nexhef Deryabendi. Teheran
3. Descartes, René. (1361) Shkrime filozofike (versioni persisht). Teheran.
4. Hasanzade Amoli, Hasan. (1361) Marifeti Nefs, vëll. 2. Teheran.
5. Xhuvajni. (1360) Esh Shamil fi Usul ed Din. Teheran.

Përktheu:
Abdullah Rexhepi

Prof. dr. Yahya Yasribi

CRITICISM AND RATIONALISM ACCORDING TO ISLAM

(Summary)

Through this paper we will try to analyze the position of criticism and rationalism according to Islam. The author believes that Islam differs essentially from Christianity, since it calls on people to embrace rationalism. There are many arguments in the Qur’an to prove this. Only the faith which can withstand doubt is authentic. Thus, we must all have a critical approach towards our culture.

يحيى يسري

النقد و العقلانية في الاسلام

(خلاصة البحث)

سوف أحاول خلال هذا المقال مناقشة حالة النقد والعقلانية في اطار الاسلام . و يعتقد صاحب المقال بأن الدين الاسلامي يختلف أساسيا مع الدين المسيحي بو من أوجه الاختلاف بينهما فان الاسلام يدعو الى العقلانية و ان رسالته لهذا الزمن الذي نعيش فيه تثبت بأنه ليس هناك مفر الا العقلانية . و بقول صاحب المقال بأن لديه عدد كثير من الادلة من القرآن الكريم تشهد على ذلك .

TRASHËGIMI ISLAME

Agim Aliu

STUDIM HISTORIK DHE ARKITEKTONIK I NAMAZGJAHUT TË OPOJËS

1. Hyrje

Namazgjahu është ndërtim arkitektonik i dallueshëm nga të gjitha objektet tjera të ndërtimeve islame, i cili shërben për të kryer obligimet fetare islame.

Namazgjahu i Opojës shtrihet në qendër të krahinës së Opojës, gjegjësisht në krahun e majtë të rrugës që lidh Prizrenin me fshatin Zaplluxhe, afër fshatit Buzes. Namazgjahu është i ndërtuar në një kodër artificiale, e cila e mban të njëjtin emër, pra kodra e Namazgjahut. Studiuesit mendojnë se kjo kodër ka qenë vend kulti pagan, apo edhe varrezë në formë tume, dhe se lokacioni i Namazgjahut të Opojës është vazhdimësi i një vendi apo objekti të mëhershëm të besimit fetar. Sot lokacioni përreth dhe vetë objekti janë në territorin kadastral të fshatit Buzes, por Namazgjahu i Opojës ka qenë i të gjithë fshatrave të Opojës, andaj nuk mund të lidhet me asnjë pronë të asnjë fshati.

Edhe pse rreth kohës së ndërtimit dhe donatorit të Namazgjahut të Opojës, ekzistojnë mëdyshje, megjithatë sipas asaj që unë kam gjetur dhe konsultuar gjatë këtij hulumtimi mund të supozohet se Namazgjahu i Opojës është ndërtuar mes dekadës së dytë ose tretë të shekullit e

XVI, nga feudali dhe vasali shqiptar i kësaj ane, Kukli beu. Namazgjahu i Opojës, në funksionin e tij burimor, është shfrytëzuar deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, atëherë kur nën ndikimin e ideologjisë komuniste, objekti u la pas dore dhe në mëshirë të fatit. Sot struktura fizike e objektit paraqet një gjysmë gërmadhe, ku procesi i shkatërrimit është duke ecur me ritme të shpejta, dhe në rast mosndërrhyrjeje, rreziku i shkatërrimit të tërësishëm të këtij monumenti të rrallë historik dhe arkitektonik të kulturës materiale shqiptare, është shumë i madh.

2. Namazgjahu, tip i veçantë i objekteve arkitektonike

Namazgjahu është ndërtim arkitektonik, i cili shërben për të kryer obligime fetare islame. Në këtë kuptim namazgjahu është xhami, në të cilën kryhen faljet dhe ceremonitë tjera gjatë ditëve të xhumasë dhe të festave islame. Në aspektin arkitektonik namazgjahu është një ndërtim i hapur me skemë funksionale dhe formësim hapësinor unik, të dallueshëm nga të gjitha objektet tjera të ndërtimeve islame.

Namazgjahët ashtu si edhe xhamitë në përgjithësi, në kohë dhe vende të ndryshme, formësoheshin në aspektin arkitektonik me koncepte të ndryshme, por duke u përmbajtur të gjitha elementeve të cilat në aspektin fetar islam dhe atë social të shoqërisë islame, ishin të nevojshme për të kryer denjësisht faljen dhe ceremonitë tjera fetare islame. Fjala namazgjah rrjedh nga persishtja dhe ka këtë kuptim: namaz - falje; gjah - vend, mejdan, hapësirë e hapur. Pra, edhe nga etimologjia e fjalës nënkuptojmë se kemi të bëjmë me një objekt në të cilin namazi kryhet në vend të hapur. Në islam është e mirëseardhur arritja e madhësisë në ndërtim të strukturave të xhamive, por e rëndësishme është që fillimisht në ato ndërtime të kryhej në bashkësi namazi dhe predikimi, ashtu që shpirtërisht të besohet në Allahun dhe të falemi atij. Pra, këto janë arsyet pse u ndërtuan namazgjahët në kushte dhe rrethana tejet të vështira, medoemos besimtari mysliman duhej të ishte në falënderim për krijuesin e tij, në kohë paqe dhe lufte, vuajtjeje dhe begatie. Në këtë kuptim ndërtimi i këtyre objekteve të quajtura na-

mazgjahe ishte më së i domosdoshëm, ato edhe pse të ndërtuar në numër të vogël paraqesin rëndësi të madhe për kulturën materiale dhe trashëgiminë e një vendi.

Në hapësirat e arealit kulturor shqiptar këto objekte janë ndërtuar, dhe gjatë historisë kanë pasur rëndësi të posaçme. Prej tyre sot dihet p.sh. për ekzistencën e namazgjahut të Toptanëve në Shqipëri, namazgjahut në Gjakovë etj., por që nuk i kanë mbijetuar kohës. Ndonëse një faktor tjetër i mungesës së dijenisë për namazgjahët mund të jetë edhe vakufnametë. Gjatë hartimit të këtyre dokumenteve pronësore, nëpunësit në mungesë të njohurive për këtë tip të veçantë objektësh arkitektonike i kanë regjistruar ato si mesxhide. Ky rast vërehet në shembullin e Namazgjahut të Opojës, i cili është i regjistruar si mesxhid në vakufnamenë e Kulki beut. Ndonëse objekte të rralla dhe me rëndësi të veçantë kulturore, historike dhe fetare, këtyre objekteve nuk iu është kushtuar rëndësia e duhur, dhe në të gjithë arealin kulturor shqiptar sot kanë mbetur si prova materiale vetëm dy objekte, Namazgjahu i Prizrenit dhe Namazgjahu i Opojës. I pari gjatë vitit 2004, ka pasur një ndërhyrje mbrojtëse dhe restauruese, kurse Namazgju i Opojës vazhdon të mbetet në mëshirë të kohës, duke pritur ndërhyrjen restauruese.

3. Kur u ndërtua Namazgjahu i Opojës

Për të ndriçuar misterin e kohës së ndërtimit të Namazgjahut të Opojës, gjegjësisht të periudhës historike, më është dashur patjetër që të studioj për historinë e Opojës dhe të marr parasysh një varg faktorësh të tjerë historikë dhe shoqërorë të kohës, të cilët edhe u përshkruan më sipër. Këtë e kam zgjedhur në fakt si metodë të punës, duke konsideruar njohjen e kuadrit historik si të domosdoshëm për të analizuar, siç do të shihet në vazhdim të dy mendimet e periudhës së ndërtimit të Namazgjahut të Opojës. Kohën e ndërtimit e konsideroj si një faktor tejet të rëndësishëm për të përcaktuar vlerat e këtij objekti, si monument arkitektonik që jep dëshmi të rëndësishme historike, kulturore dhe fetare, për rajonin dhe mbarë Kosovën.

Dihet se monumentet kulturore dhe veçmas ato të arkitekturës identifikohen dhe vihen në mbrojtje (vlerësohen si të tilla) në bazë të vlerave të tyre, të cilat nxirren sipas kriterëve të aplikueshme ndërkomëtare, ku njëri nga këto kriterë është edhe kriteri i kohës së ndërtimit të monumentit. Së këndejmi një pikë e rëndësishme e restaurimit të monumenteve është edhe përcaktimi i kohës së ndërtimit. Në rastin e namazgjahut si objekt i veçantë arkitektonik, koha e ndërtimit ka rëndësi edhe më të madhe se për të përcaktuar vlerat e këtij objekti si monument kulture, ajo do të nxirrte disa të dhëna mjaft të rëndësishme historike dhe fetare për rajonin dhe më gjerë. Kështu do të përcaktohej p.sh. përkatësia e “pronësisë” si monument kulture se cilit popull i takon¹ (duhet të kuptohet se është trashëgimi kulturore në Kosovë), do të sqaroheshin raportet që banorët e zonës kanë pasur në shek. XV ose XVI (dy supozimet e kohës së ndërtimit të Namazgjahut të Opojës) me kishat (katolike dhe ortodokse), do të jepte të dhëna për përkatësinë etnike të banorëve në atë kohë, apo më mirë të thuhet do t’i mbështeste dokumentet arkivore të kohës dhe do të përdorej si argument (burim material) kundër atyre që këtë periudhë e shfrytëzojnë për ndërtimin e demagogjive politike (caqe të caktuara serbe),² do të mësohej për përhapjen e islamit në këto anë, mënyrat dhe arsyet e shtrirjes së besimit islam, do të nxirreshin fakte të tjera për feudalin e pasur shqiptar të kësaj ane Mehmet Kukën etj.

Për kohën e ndërtimit të Namazgjahut të Opojës, në mesin e studuesve ekzistojnë dy mendime:

¹ Trashëgimia kulturore është e gjithë njëzimit, por ndonjëri prej popujve ose kombeve e ka lindur apo zhvilluar një trashëgimi të caktuar gjatë kohëve e cila tani është e të gjithëve, kjo përkatësi përcaktohet për monumente të arkitekturës nga shfrytëzuesit e monumentit gjatë kohëve si dhe nga stili dhe autorësia e ndërtimit (arkitekti, mjeshtri, parcela, etj.), e pak ose aspak nga investitori [mendim i autorit]

² I referohem botimit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë, të veprës me titull “Šarplaninske zupe - Gora, Opolje i Sredska” e cila u botua në tri pjesë, në vitet, përkatësisht: 1994, 1995 dhe 1997. Pjesa e demografisë së këtij libri mundohet të tregoj se si “serbët e këtyre anëve” janë shqiptarizuar gjatë kohës së fillimit të pushtimeve osmane.

1. Që namazgjahu është ndërtuar në kohën e depërtimit të ushtrive osmane gjatë tentimeve për pushtimin e Prizrenit, para vitit 1455 (shek. XV)

2. Që namazgjahu është ndërtuar në kohën e Mehmet Kukli beut, gjatë dekadës së dytë apo të tretë të shekullit të XVI

Nëse i referohemi mendimit të parë atëherë Namazgjahu i Opojës del të jetë njëri ndër objektet më të hershme osmane në tokat shqiptare, të cilin e ka financuar, ndërtuar dhe fillimisht për një kohë të caktuar e ka shfrytëzuar ushtria osmane, që po përgatiste terrenin për sulm ndaj Prizrenit.³ Namazgjahu asokohe u ndërtua në një vend, ku banorët e fshatrave përreth takoheshin për kremtimin e festave. Ushtria osmane e shfrytëzoi këtë rast për të zhvilluar tregti me banorët dhe meqë vendi ishte i rrafshët atëherë edhe mund të kontrollohet shumë lehtë terreni.⁴

Studiuesit e grupit të dytë, mendojnë se namazgjahu u ndërtua në kohën e feudalit dhe pushtetarit të pasur shqiptar, Mehmet Kukli beut. Kjo mbështetet në vakufnamenë e tij, por jo drejtpërdrejt. Në vakufname thuhet se Kuklibeu ndërtoi në Opojë një mesxhid, për këtë studiuesit mendojnë se është fjala për namazgjahun, pasi mundet që ai i cili e ka përpiluar dokumentin të mos e dinte se çfarë lloj objekti ishte namazgjahu.

Përfundimisht nuk kemi një version të qartë dhe të padiskutueshëm për ndërtimin e namazgjahut, mirëpo nëse analizohen disa fakte atëherë do të arrihet që megjithatë të mendojmë (supozojë) se namazgjahu është ndërtuar në kohën e Kukli beut.

Mendimi i parë është aproksimativ, d.m.th., studiuesit nuk deklarohen se bazohen në ndonjë dokument material. Kohën e ndërtimit (gjatë shek. XV) të namazgjahut të Prizrenit dhe Opojës, e mendojnë edhe restauruesit e Namazgjahut të Prizrenit⁵, por edhe në këtë rast nuk jepen të dhëna për mënyrën se si është arritur deri te ky përfund-

³ "Buletini", organ i FR të LDK-së të Dragashit, nr. 4, shkurt 1992., "Opoja dhe Gora nga periudha e përhapjes së Islamit e kënde" E. Batiu, fq. 7.

⁴ Sipas intervistës së zhvilluar me E. Batiun më 23.11.2008.

⁵ Projekti i restaurimit është kryer nga IMMPz – J. Xhibo dhe F.

im. Megjithatë, kjo ide nuk mund të hidhet përfundimisht poshtë sepse:

1. Namazgjahët janë objekte të tilla që i ka ndërtuar zakonisht ushtria, dhe atë për nevoja të caktuara, në fillim të pushtimeve. Ato janë ndërtuar në vende të hapura, siç edhe është vendi, ku është ndërtuar namazgjahu i Opojës. Përreth objektit kanë varrosur ushtarët e vdekur gjatë luftës, edhe përreth Namazgjahut të Opojës ka varreza që nuk dihet se kujt i përkasin, e që mund të jenë të ushtrive osmane.

2. Mendoj se ekziston edhe mundësia e depërtimit të ndonjë garnizoni ushtarak osman nga rruga që lidhte Tetovën me Opojën, e cila në atë kohë ishte funksionale.

Mendimi i dytë, megjithatë, ofron më tepër siguri:

1. Është edhe një rrethanë historike, që fuqishëm e mbështet këtë mendim, osmanët në Prizren erdhën nga Novobërda, dhe nuk përdorën forcën për pushtimin e Prizrenit, ai u dorëzua, kjo në një farë mënyre e hedh poshtë idenë se mund të këtë depërtuar ushtria osmane nga Tetova, nëpër Opojë drejt Prizrenit. Veç asaj ushtritë osmane kanë qenë të rregullta dhe në numër mjaft të madh, dhe një luftë e tillë nuk iu konvenonte, ata rrethonin kalanë e qytetit, bombardonin dhe në fund thyenin rezistencën, nuk bënë luftë guerile.

2. Një fakt tjetër është edhe se namazgjahët nuk janë ndërtuar vetëm për nevoja të ushtrisë, siç është për shembull rasti i Namazgjahut të Toptanajve në Shqipëri⁶.

3. Pastaj mendimit të dytë i shkojnë në ndihmë edhe karakteristikat e rajonit të Opojës, në një kohë kur fshatrat ishin të shpërndarë në krahinë, numri i besimtarëve nuk ishte i lartë, atëherë në mungesë të xhamive ata duhej të bashkoheshin në një objekt dhe vend të përbashkët dhe të kryenin faljet dhe ceremonitë tjera fetare. Që namazgjahu është përdorur nga të gjithë fshatrat tregojnë edhe banorët⁷. Sipas tyre, në hapësirën e namazgjahut secili fshat e kishte vendit e tyre për t'u falur⁸.

⁶ Nga intervista me N. Krasniqin, dhjetor, 2008.

⁷ Intervistë me plakun R. Nebiu, nëntor 2008.

⁸ Është arsyeja kryesore pse unë e kam quajtur Namazgjahu i Opojës, pra ka qenë gjatë shfrytëzimit të tij shekullor për të gjithë fshatrat, ku në mënyrë legjitime banorët e kanë shfrytëzuar vendin e faljes.

4. Edhe mendimi se nëpunësi i cili e kishte hartuar dokumentin e vakufnamesë së Kukli beut, ka pasur mundësi që të mos dijë gjë për këtë lloj objektësh. Ishte një i tillë në Prizren, por jashtë qytetit⁹, dhe kështu nëpunësi të mos ketë pasur njohuri për këtë emërtim (persisht), prandaj edhe ai e shënon atë si mesxhid. Te banorët ka njohuri rreth objekteve tjera të Kukli beut, të cilat sot nuk ekzistojnë, mirëpo nuk mbahet mend se ka pasur ndonjëherë ndonjë mesxhid në këtë anë.

5. Nevojës dhe arsyes së ndërtimit të një objekti falje në atë vend, i përgjigjej namazgjahu, por ka mundur që të ndërtohet edhe xhami. Nga organizimi horizontal dhe vertikal shihet se mjeshtri ka njohuri rreth ndërtimeve të tilla. Përveç asaj siç do të shihet edhe më poshtë, nevoja edhe për një objekt tjetër faljeje, përveç xhamisë së Kukli beut në Bresanë, ka ekzistuar. Edhe materialet e përdorura dhe teknikat e ndërtimit janë të ngjashme me xhaminë në Bresanë dhe Sarain e tij në fshatin Kuklibek (guri stuko, llaçi, gurët e mbushjes etj.).

Së këndejmi nga faktet të cilat u analizuan, dhe nga arsyet që mendimi i parë për ndërtimin e namazgjahut është i pabazuar në dokumente dhe fakte materiale, ose të paktën nuk është i deklaruar si i bazuar, atëherë unë do të supozoj se Namazgjahu i Opojës është ndërtuar në shek. XVI, në kohën e Kukli beut. Nuk është e qartë se kush ishte mjeshtri, a ishte ai i vendit, por gjatë gjithë kohës së shfrytëzimit të tij, në të janë falur banorët e të gjithë fshatrave të Opojës.

4. Ndërtuesi i Namazgjahut të Opojës - Kukli Beu

Për kohën e ndërtimit të Namazgjahut të Opojës, në mesin e studiuesve ekzistojnë dy mendime: 1. Që namazgjahu është ndërtuar në kohën e depërtimit të ushtrive osmane gjatë tentimeve për pushtimin e Prizrenit, para vitit 1455 (shek. XV) 2. Që namazgjahu u ndërtua në kohën e Mehmet Kukli beut, gjatë dekadës së dytë apo të tretë të shekullit të XVI. Duke u nisur nga studimet e të dy këtyre supozimeve, autori pas një studimi më të zgjeruar ka arritur në përfundim se supo-

⁹ Supozoj se edhe ky namazgjah mund të jetë ndërtuar gjatë kohës së Kuklibeut, kur ai mendohet të ketë qenë Sanxhakbej.

zimi i dytë është i argumentuar në burime materiale, përderisa i pari parqet supozim aproksimativ dhe analogjik, gjë që nuk është real, dhe si i tillë nuk mund të pranohet në aspektin shkencor.

Për Kukli beun, si personalitet mjaft i rëndësishëm i fillim shekullit të XVI në rrethin e Prizrenit, është studiuar mjaft pak, ndërkaq të dhënat në disa raste janë edhe kontradiktore. Për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë materiale të tij është bërë shumë pak, një pjesë e ndërtimeve të tij i ka shkatërruar koha, kurse një pjesë tjetër pavetëdija dhe mendjelehtësia e njerëzve. Kukli beu, sipas disa të dhënave tërthore¹⁰, konsiderohet si sanxhakbej i Prizrenit, por dëshmi të sundimit të tij vërehen në një hapësirë më të gjerë se ajo e Prizrenit. Madje, ai konsiderohet edhe si spahi i Opojës.¹¹

Edhe për prejardhjen e Kuli beut nuk ka të dhëna të mjaftueshme, supozoj se kishte prejardhje nga fshatrat e Opojës, me njërin prind me prejardhje nga familja ‘sulltanore’. Dokument faktik për të konstatuar këtë nuk ka. Kuli beu ka vdekur në vitin 1555¹². Ai kishte pronat tij në të gjithë qytetet e mëdha shqiptare dhe më gjerë. Kukli beu kishte marrë pjesë në luftërat e sulltan Sylejmanit kundër austriakëve, duke qenë kështu edhe pjese e qeverisë dhe shtabit të tij. Duke u nisur nga bashkëpunimi i tij me sulltan Sylejmanin, disa studiues mendojnë se disa projekte të investimeve të Kuli beut mund t'i ketë bërë ose kontrolluar arkitekti i famshëm Mimar Sinani. Ky supozim duhet të studiohet sepse kjo mund të ketë rëndësi të madhe për historinë e arkitekturës sonë. Është interesante të theksohet se që të tri xhamitë e Kukli beut, që kanë mbetur sot, kanë koncept me sallë qendrore, pra me një hapësirë. Kjo ide arkitektonike u formësua nga arkitekt Sinani, që e vërteton se objektet e Kukli beut ishin bashkëkohore për kohën e tyre. Sido që të jetë, investimet e Kukli beut në Prizren dhe Opojë, tregojnë qartë idetë e këtij vasali për zhvillim dhe përparim, këtë e vërteton sidomos hapja e shkollave dhe hamameve. Këto zhvillime mund

¹⁰ H. Meleqi “Opoja dhe Gora” Dragash 1994, f. 57.

¹¹ I. Jasterbov “Stara Srbija i Albania” Beograd 1904, f.84, ciutar sipas H. Meleqi “Opoja dhe Gora” Dragash 1994, f. 57.

¹² Guri i deshifruar mbivarror.

të kenë shqetësuar sulltanin, prandaj gjatë viteve të fundit të jetës Kukli beut, mendohet se ishte në armiqësi me sulltanin. Këtë e vërteton edhe Tuneli në fshatin Kuklibek, i cili lidh Sarain e tij me xhaminë, ku kryente faljet.

Ndër monumentet tjera të rëndësishme që lidhen me emrin e Kukli Beut, të cilat janë evidencuar nga autori, është edhe Xhamia e Kukli beut në fshatin Bresanë. Ngjitur me të është edhe tyrbja, ku është i varrosur Kukli beu me familjen, ndërsa Sarai është rrënuar gjatë viteve 60-ta. E gjithë çka ka mbetur është çeshma e Sarait dhe disa blloqe guri të përmasave të mëdha, relikte të ndryshme, enë, armë etj. Namazxhahu në një kodër artificiale në fshatin Buzes, po ashtu paraqet një vlerë të rrallë kulturore dhe historike për rajonin, por që sot është nën mëshirë të fatit. Në literaturë tregohet se në fshatin Rapqë të Gorës Kukli beu ka ndërtuar edhe 4 mullinj dhe hamam, por sot nuk vërehet ndonjë gjurmë e ekzistimit të tyre.¹³ Në Prizren xhamia e Ilas Kukës, është ndërtuar nga Kukli beu, në vitin 1534, dhe i është vënë emri kështu për nder të gjyshit të tij, po ashtu në Prizren, edhe Xhamia e Saraçhanës, është ndërtuar nga Kukli beu, në vitin 1534.¹⁴

5. Shfrytëzuesit e Namazgjahut të Opojës

Duhet potencuar se një e dhënë e rëndësishme për monumentet arkitektonike dhe historike, janë shfrytëzuesit e tyre gjatë kohës, prej ndërtimit e deri sot. Është interesante se për Namazgjahun e Opojës, studiuesit janë përpjekur vazhdimisht të sqarojnë kohën e ndërtimit, por asnjëherë nuk është folur për kohën e pasndërtimit.

Namazgjahu i Opojës, siç u përshkrua më lart, duhet të jetë ndërtuar aty nga dekada e dytë, gjegjësisht e tretë e shekullit të XVI, kur islami ishte përhapur mjaft shpejt në Opojë, si rezultat i ndërtimeve, shpirtërimeve, tolerancës dhe ndihmës ndaj të varfërve të pasanikut

¹³ Autori vizituar të gjitha këto vende ku është supozuar se mund të gjenden këto objekte si në Sharr, po ashtu edhe në Prizren.

¹⁴ 'Idea', revistë periodike nr.9., Prishtinë 2010; 'Xhamia e Saraçhanës në Prizren' A. Ali, f. 6.

Kukli beut. Nuk është e qartë nëse namasgjahu është ndërtuar më herët a më vonë se xhamia në Bresanë (1525)¹⁵, por duhet cekur se nevoja për këtë objekt në këtë vend gjatë asaj kohe, ishte mjaft e madhe. Fshatrat e Opojës ishin të shpërndara, me numër të vogël banorësh, prej të cilëve në atë kohë kishte me përkatësi myslimane dhe katolike. Shumica e banorëve, nga numri i përgjithshëm i tyre, ishin myslimanë të sapo islamizuar, që përbënin shumicën gati në çdo fshat¹⁶, dhe në pa mundësi të ndërtimit të xhamive nëpër secilin fshat, ata duhej që faljet obligative gjatë festave¹⁷, t'i kryenin në një vend të përbashkët. Pra, gjatë kohës së Kukli beut, kur popullsia vendore ishte islamizuar në masë të madhe namazgjahu është shfrytëzuar aktivisht për kryerjen e faljeve dhe ceremonive fetare. Xhamia në Bresanë ka pasur kapacitet të vogël për tërë banorët e zonës (dim~8x9m).

Edhe pas kësaj kohe (gjysmës së parë të shek. XVI) nevoja për një vend të përbashkët faljeje ishte e madhe, kështu derisa secili fshat ka ndërtuar xhaminë e tij, aktivisht është shfrytëzuar namazgjahu për falje. Nëse i referohemi kronologjisë së ndërtimit të xhamive në Opojë¹⁸, shohim se fshatrat në tërësi kanë pasur nevojë për këtë objekt gjatë tërë shekullit të XVI dhe fillim shekullit të XVII, kur një pjesë e fshatrave kishin filluar të ndërtonin xhamitë e tyre. Po ashtu pjesa më e madhe e fshatrave kishin ndërtuar xhamitë gjatë shekullit të XVIII, pra deri atëherë ata kanë pasur nevojë permanente për objekt falje.

Edhe pas shekullit XVIII, kur ishte thuajse i zgjidhur problemi me objekte për falje, banorët siç mësojmë nga pleqtë e shumë fshatrave e kanë shfrytëzuar aktivisht namazgjahun për falje gjatë shek. XVIII dhe XIX. Kjo, si duket, ishte ndikuar nga parimet islame për falje në bashkësi të mëdha, apo edhe se banorët e konsideronin këtë si një ob-

¹⁵ "Dituria Islame" revistë periodike; nr. 200; fq. 58.

¹⁶ Defteri I hollësishëm i Sanxhakut të Prizrenit i vitit 1530 ; nr. 368 i cili gjendet në Bas-bankalil Arsivi në Stamboll, me përkthimin e tij unë kam ra në kontakt në Arkivin e Kosovës, ku ruhet (e pa publikuar) një kopje e përkthyer e tij.

¹⁷ Në islam disa namaze (xhumaja, bajramet, namazit e xhenazeve etj. medoemos duhet të falen në xhemat – bashkësi njerëzish.

¹⁸ Lista e Bashkësisë Islame, këshilli në Sharr, cituar sipas "Dituria Islame" revistë periodike; nr. 200; fq. 58

jekt me “sevap” të veçantë (objekt i vjetër fetar) për kryerjen e namazeve të tyre.

Siç edhe u tregua më herët hapësira në namazgjah ka qenë e ndarë për secilin fshat, pra banorët e kanë pasur të treguar vendin e tyre të faljes. Kjo formë e funksionimit të namazgjahut ka qenë deri në kohën e pushimit të funksionari si objekt fetar. Prandaj, edhe objekti ishte i të gjithë fshatrave të Opojës, dhe nuk mund të lidhet me asnjë pronë të asnjë fshati, edhe pse në shek. e XIX banorët e fshatit Buzes fillojnë që t’i varrosnin të vdekurit e tyre në hapësirën, ku shtrihet namazgjahu. Më pas, gjatë viteve 90-ta të shek. XX, banorët e këtij fshati kanë rrethuar lokacionin, ndërkaq sot e kësaj dite ky lokacion shfrytëzohet për varreza. Megjithatë, monumenti ka pasur shfrytëzues gjatë gjithë kohës së ekzistimit të tij banorët e të gjitha fshatrave të Opojës, prandaj edhe emërtimi më adekuat është të quhet Namazgjahu i Opojës.¹⁹

Namazgjahu i Opojës, aktivisht me funksionin e tij burimor është shfrytëzuar deri në Luftën e Dytë Botërore, pas të cilës ndikimi komunist ka bërë që ky objekt të lihet pas dore dhe me kalimin e kohës, rreth një gjysmë shekulli, të vihet në pikëpyetje ekzistenca e tij fizike.

Banorët e vjetër të kësaj ane e vlerësojnë mjaft atë, ata e konsideronin si një objekt të veçantë për besimin e tyre. Lënia pas dore dhe fillimi i shkatërrimit të namazgjahut pas Luftës së Dytë Botërore, ishte pritur me nervozizëm nga pleqtë e fshatrave përreth, sipas përshkrimeve, një plakë anëtarëve të shtëpisë së tij, me brengë, shqetësim dhe mallëngjim u fliste se si banorët e fshatrave po merrnin gurë nga namazgjahu për të ndërtuar shtëpi.²⁰ Sidoqoftë, prej pas Luftës së Dytë Botërore ai ka qenë objekt i “vdekur”, dhe nga dhembja e kohës, por edhe nga vjedhësit e gurëve si dhe dëmtimeve që i bënin fëmijët dhe barinjtë, ka pësuar mjaft dëme. Objekti nuk ka pasur as një mereme-

tim gjatë kësaj periudhe dhe ka mbetur deri në ditët tonë (kuptohet mjaft i “cunguar”) vetëm falë gurëve si materiale monumentale ndërtime.

6. Përshkrimi arkitektonik i Namazgjahut të Opojës

Namazgjahu i Opojës u ndërtua në fillimet e përhapjes së besimit islam në trevën shqiptare të Opojës, atëherë kur numri i besimtarëve myslimanë ishte i vogël, por përhapja e fesë islame po bëhej në ritme të shpejta nën ndikimin e bamirësit dhe pushtetarit opoan, Kukli beut. Kështu që prej fillimit të ndërtimit të tij ai u shfrytëzua nga banorët e sapo-islamizuar. Fillimisht shfrytëzimi i namazgjahut ishte domosdoshmëri në mungesë të xhamive në atë kohë, por edhe më pas kur u ndërtuan xhamitë, banorët nuk e braktisën dhe e konsideruan atë si një objekt të rëndësishëm të fesë dhe kulturës së tyre, prandaj Namazgjahu i Opojës u shfrytëzua gati për katër shekuj me radhë në funksionin e tij burimor, deri sa pas Luftës së Dytë Botërore, kur nën ndikimin e ideologjisë komuniste, ai u braktis dhe u la në mëshirë të fatit.

Sot struktura fizike e objektit paraqet një gjysmë gërmadhë, ku procesi i shkatërrimit është duke ecur me ritme të shpejta, dhe në rast mosndërhyrjeje, rreziku i shkatërrimit të tërësishëm të këtij monamenti të rrallë, sa historik ashtu edhe arkitektonik, të kulturës materiale shqiptare, është shumë i madh. Përshkrimi arkitektonik do të bëhet ashtu që do të përshkruhet njëkohësisht gjendja ekzistuese dhe në bazë të hulumtimeve do të tregohet edhe strukturën e supozuar burimore, pasi që për strukturën e vërtetë burimore, mund të kuptohet vetëm atëherë kur gjatë realizmit të projektit restaurues bëhen gërmimet e nevojshme.

Struktura kryesore e cila paraqet edhe hapësirën e faljes është platoja, gjegjësisht bazamenti me dimensione 6m x 6.25m. Kjo plato ngrihet mbi themele nga guri masiv, dhe nga hulumtimet sipërfaqësore nuk duket që gurët e themeleve të jenë lidhur me kllanfa sikurse bie fjala te Namazgjahu i Prizrenit. Gurët janë përpunuar ashtu që të sajohet struktura dhe janë lidhur me llaç. Pas gurëve masivë të futur në

¹⁹ Emeritmi i tillë “Namazgjiu i Opojës” është emërtimi im për objektin, përndryshe ky nuk është përdorur në literaturë në këtë mënyrë, është përdorur si Namazgjiu i Buzezit, i Kukli beut etj. Duket thënë se banorët këtë vend e thirrin, tani, vetëm si namazgjah.

²⁰ Intervistë me H. Ajeti - Aliu (gjyshen e autorit), babi i saj Ajeti, plakë gjashtëdhjetë vjeçar nga fshati Kuklibek, vazhdimisht shqetësohej për rrënimin e namazgjahut, kjo kohë ishte përafërsisht aty ka vitet 50-ta.

tokë, gurët tjerë, deri te niveli 55 cm. i platosë janë dy llojesh, gurët poligonalë të papërpunuar me përmasa mesatare (30-40, 25-40, 20-15 cm), dhe janë të muruar mbi themele dhe gurët e quajtur të rrasës, të përmasave masive (80-180, 65-120 cm). Në fakt gurët e rrasave, në bazë të hulumtimeve sipërfaqësore, duket se janë edhe shtresa finale e dyshemesë, pasi që duhet theksuar se ky gur është tejet i rrafshët, dhe ka mjaftuar shtroja me sexhate²¹ apo fier, që ishte materiali tradicional i shtrimit të dyshemeve në atë kohë në Opojë. Platoja, si duket, ka qenë njësipërfaqëshe, pra nuk ka pasur një sipërfaqe tjetër për myezinin, ngase sikur ta ketë pasur, edhe ajo do të kishte mbetur deri tani sikurse që ka mbetur platoja aktuale. Kjo për arsye se në gjendjen e sotme shihet se platoja aktuale nga ana “ku duhet të ketë qenë” edhe platoja e myezinit është qartësisht e definuar si njësi e mëvetësishme.

Shkallët për ngjitjen në plato, nga vëzhgimet dhe përshkrimet e banorëve, duket se kanë qenë përballë mihrabit, jashtë gabaritit të platosë, ato janë konstruktuar nga materiali i gurit dhe kanë qenë me tri ballore, gjegjësisht dy basamakë dhe njëren ballore e ngrinte vetë bazamenti. Nuk është e qartë pse ato nuk i kanë mbijetuar kohës. Nga hulumtimet sipërfaqësore duket se ekzistojnë ende themelet e tyre, por, supozoj se me që kanë dalë jashtë gabaritit, ato kanë qenë më pak të mbrojtura dhe në mungesë të platosë së myezinit për mbështetje, janë ekspozuar ndikimeve shkatërruese, të erës, të forcave mekanike apo edhe të vjedhjes së materialit gjatë kohës.

Muri i vetëm i objektit është muri perimetral i ngritur nga ana e kibles, ai nga hulumtimet shihet qartë se ka qenë deri në fund të brinjës së platosë kah ana e kiblës. Muri është i ngritur nga niveli i platosë ~ 1.6 m (+50 cm platoja = 210 nga niveli i tokës) me trashësi 65 cm. Struktura e këtij muri është kompozite, e ndërtuar nga gurët shtufë. Në 1.25 m nga muri i mimerit në murin perimetral është e gdhendur nisha, gjegjësisht mihrabi. Nga fotografitë e mëhershme vërehet se ngritja e kësaj gdhendjeje ka qenë në formë gjysmë-cilindri me bazë

eliptike, me boshtin e madhe të elipsës të konstatuar nga gurët e mbetur për afërsisht rreth 80 cm, ndërsa boshti i vogël rreth 40cm.

Mimeri është një strukturë e prezantuar me formë unike dhe plotësisht i formuar. Kështu ai ndërtohet nga shkallët, pushimorja dhe elementi i “baldakinit”. Struktura e mbetur e tij është e përbërë nga pushimorja, elemente të shkallëve dhe një pjesë e “baldakinit”. Nga studimi i mbetjeve të shkallëve dhe logjika e arritjes nga niveli i platosë deri te pushimorja e mimerit, shihet se mimeri ka pasur 7 shkallë me dimensione të përafërta 20x28 cm. Pushimorja e fundit shtrihet në rreth 40 cm nga fillimi i elemetit të baldakinit. Baldakini apo ndryshe te namasgjahu quhet edhe si minarja ka dimensione 90x90 cm. Nga fotografitë shihet se pas nivelit 3.30 m nga platoja (~380 nga niveli i tokës) ka filluar një ngushtim me lartësi rreth 50-60 cm dhe pastaj ky ngushtim në formë të trungut të piramidës ka vazhduar derisa është arritur për afërsisht një bazë, në majë, me rreth 40 x 40cm. Kjo madhësi, në fakt, ka qenë edhe baza e piramidës katërfaqësore, e cila përfundonte minaren, gjegjësisht elementin e baldakinit. Lartësia e piramidës ka qenë për afërsisht 50-60 cm, ngritja është realizuar nën këndin 60°, aq sa për afërsisht ka qenë edhe këndi i ngritjes së gurit piramidë.

Guri piramidë ishte një strukturë e përbërë nga guri masiv i mimerit me ngjyrë tërësisht të bardhë, i cili paraqet një shembull unik të kompozimit të këtyllë të mimbereve si në rastin e mimbereve të xhamive po ashtu edhe të namazgjahëve në vendin tonë dhe më gjerë. Aktualisht ngushtimi që pasonte minaren me dimensione 90 x 90 cm dhe guri piramidë janë shkatërruar por nga fotografitë më të vjetra këto dy elemente janë tërësisht të dukshme.

Namazgjahu ka pasur sigurisht të zgjidhur edhe vendin e abdesit, si një nevojë e obligueshme e objekteve për falje të namazeve, por nga hulumtimet në terren nuk është vërejtur ndonjë gyp prej ndonjë baseni apo ndonjë pusi, megjithatë disa nga banorët kanë treguar se abdesi është marrë në lumin e rrjedhshëm aty afër (rreth 150 - 200 m). Kjo qëndron pasi sipas parimeve islame mund që abdesi të merret edhe në lumenjtë rrjedhës, ndërsa lumi po ashtu ka qenë i pastër, ai vi-

²¹ Qilima që përdoren gjatë namazeve

nte nga malet dhe nga fshati Kuk, prej nga ka përshkruar deri te lokacioni një distancë të konsiderueshme. Edhe për tunelin që supozohet se e ka lidhur namazgjahun me sarain e Kukli beut, nuk është vërejtur ndonjë elementë i dukshëm.

Kompozimin funksional dhe konstruktiv (horizontal dhe vertikal) të hapësirës, të përshkruar më lart, e kanë strukturuar gurët e tri llojeve të ndryshme:

1. Gurët shtufë (sika), gurët poligonalë dhe gurët e rrasave të lidhur ndërmjet vete me llaç gëlqeror. Gurët shtufë janë përdorur edhe në objekte tjera të Kuklibeut, e veçmas në xhaminë e tij në Bresanë, por nuk është e qartë se prej nga janë nxjerrë. Disa legjenda që qarkullojnë në popull thonë se materiali ndërtimor i namazgjahut është nga Gurra e Rrencit, por në pamje të parë nuk vërehen masive të tilla shkëmbore në atë pjesë.

2. Gurët poligonalë janë të marrë nga lumi dhe në përmasa të ndryshme janë muruar në struktura më pak të ekspozuara, pasi që kanë qenë më pak reprezentativë.

3. Gurët e rrasave janë marrë në kreshtat malore të Sharrit, në një distancë të konsiderueshme nga vendi i ndërtimit. Këta gurë kanë qenë tejet masivë dhe kanë shërbyer si për të arritur sipërfaqet e rrashta ashtu edhe për të shtanguar në aspektin horizontal objektin.

Shikuar nga përshkrimi tekniko-konstruktiv i namazgjahut, krijohet përshtypja se kemi të bëjmë me një lloj objektesh mjaft të thjeshta dhe jo plotësisht të formuara në aspektin arkitektonik. Por, nëse shikohen disa askete tjera të këtij lloji të objekteve, dhe posaçërisht vetë Namazgjahut të Opojës, kuptojmë se këto janë objekte të mirëfillta arkitektonike, dhe paraqesin një tip të veçantë objektesh, plotësisht të formuara. Kjo për faktin se namazgjahët dhe vetë Namazgjahu i Opojës është planifikuar dhe projektuar tërësisht sipas parimeve dhe procedurave standarde të projektimit të objekteve arkitektonike. Disa nga këto aspekte të planifikimit dhe projektimit do t'i shpalosim në vijim:

1. Planifikimi. Programi projektues është artikuluar, është analizuar dhe në fund është vendosur për tip namazgjahësh, pra objekt falje i tipit namazgjah. Koha ka treguar se planifikuesit kanë pasur të drejtë,

vetëm ndoshta për një arsye të fuqishme: objekti në gjendjen e tij bu- rimore është shfrytëzuar për gati 500 vjet, edhe pse banorët kanë pa- sur objekte të tjera për falje dhe për qasje më komode në to. Asokohe planifikuesit kanë qenë të vetëdijshëm sa është i rëndësishëm është një namazgjah, një tip i tillë i objekteve arkitektonike, në trevën e shpërndarë të Opojës, ku njëkohësisht duhej që të edukohej popullsia në asketin iluminist dhe atë islam. Pra, edhe pse ata kishin mundësi dhe dinin të ndërtonin xhami, vendosën për namazgjah, sepse ishte pi- kërisht ky lloj objekti që i bashkoji banorët e kësaj ane në besimin e ri gjatë 500 vjetëve në vijim.

2. Vendosja në situacion. Qendra kulturore dhe administrative e zonës në atë kohë ka qenë Bresana, por namazgjahu nuk u ndërtua aty. Kodra që sot quhet nga banorët “namazgjah” ka horizontin më të gjerë në trevën e Opojës. Në këtë kodër shohin të gjithë fshatrat për- rëth dhe anasjelltas, nga namazgjahu shihen të gjitha fshatrat. Gjithash- tu, nga të gjitha pikat e maleve si në gryka, maje, qafa rrugësh etj., shihet namazgjahu. Kjo vendosje e tillë krijonte qartësinë dhe sigurinë e nevojshme si të pjesëmarrësve në ceremonitë fetare, ashtu edhe ba- norëve të cilët pritnin, gjegjësisht shihnin kryerjen e procesit fetar nga shtëpitë e tyre. Kjo ka rëndësi të madhe pasi që ngjarjet fetare si dita e xhuma dhe Bajramet kanë rëndësi të posaçme në punën dhe jetën e besimtarëve. Pra, vendosja në situacionin e objektit ka bërë që të kihet kontakt vizual dhe emocional mes pjesëmarrësve në ceremoninë feta- re që zhvillohej aty, dhe shikuesve të cilët nga distanca, nga shtëpitë, e përcillnin atë.

3. Formësimi i hapësirës. Kushdo që të ketë qenë mjeshtri apo ar- kitekti, ai ka njohur mjaft mirë “lëndën e parë” të arkitekturës, hapësi- rën. Strukturës fizike të formësuar që tani quhet Namazgjahu i Opojës i ka paraprirë një studim i mirëfilltë i proporcioneve, përjetimeve, stan- dardit human të masave etj.

Përmbajtjes funksionale, që në këtë rast është objekti për falje në vend të hapur, me një kompozim horizontal dhe vertikal, me një vo- lum të proporcionuar, me tekstura “emocionale”, është arritur që t'i

jepet karakteri i mirëfilltë sakral dhe simbolika “abstrakte” që e kërkojnë këto objekte në besimin islam.

Hapësira e hapur, ndonëse e tillë, pra e hapur, është e definuar tërësisht. Kompozimi i platos, muri ballor, mihrabi dhe përfundimi i mimerit, është bërë në mënyrë të tillë, që hapësirën e hapur dhe njëshe (siç kërkohet në islam) të definohet plotësisht. Janë këto struktura të cilat njëkohësisht kryejnë funksione, dhe njëkohësisht e definojnë hapësirën në mënyrë të përkryer.

Guri i bardhë në majë të mimerit është një dëshmi se sa i avancuar ka qenë mendimi për arkitekturën dhe hapësirën në atë kohë. Ai, pra guri piramidale, është përvësuar i bardhë në formë piramidale dhe është vendosur si strehë e mimerit, jo pse është dashur që mimeri të mbrohet nga lagështia (sepse kishte edhe gur tjetër që e bënin këtë) e as pse mimeret përfundonin zakonisht në mënyrë të tillë, por për të gjitha këto njëkohësisht dhe për shkak të unit, të autoktonisë, emocioneve, simbolikës dhe definimit të hapësirës që arkitekti i kohës ka dashur të arrijë me objektin e tij. Edhe sot simbolika e këtij guri nuk është harruar nga pleqtë, disa prej tyre të vetmen gjë që mbajnë mend është pikërisht ky gur, kurse të tjerë, që flasin për objektin, gjithsesi që përmendin gurin piramidale. Në këtë tregim është interesante të tregohet se askush nuk ka tentuar që të thotë se ky gur ishte për këtë apo për atë gjë, por vetëm ishte i namazgjahut. Ishte në të vërtetë ky konceptimi për këtë formë, ideja e arkitektit për formësim të hapësirës, e cila me simbolikën “abstrakte” i përgjigjej besimit dhe jepte emocione.

Ishin të sistemuara këto gjera apo arkitekti i studioji vetë? Ishte ky arkitekt një bujk i zakonshëm apo një njeri i urtë e i dijshtëm? Nuk janë shumë të rëndësishme këto përgjigje. E rëndësishme këtu është fakti se u mendua për hapësirën dhe objektin e arkitekturës në mënyrën më moderne të mundshme, shikuar edhe në kohën e tanishme.

Pra gjatë projektimit të namazgjahut kemi një studim të hapësirës mjaft të avancuar dhe parimor. Mësimi që nxjerrim nga këta mjeshtër të lashtë është më se i domosdoshëm edhe sot, kur vlera dhe hapësira në arkitekturë lihen anash dhe kaosi mbizotëron.

4. Teknika e murimit. Teknika e murimit është mjaft komplekse, ndonëse është e tëra e kryer me materiale lokale dhe nga guri. Mjeshtri i kohës i ka njohur mirë llojet e gurëve si në aspektin e punimit të konstruksionit prej tyre, ashtu edhe në aspektin e vetive fizike, mekanike dhe “teknologjike”. Struktura kompozite e gati çdo strukture të objektit tregon për një shije të hollë në projektimin e konstruksionit dhe vetë objektit. Kështu në momente të caktuara mjeshtri ka gdhendur gurin, kurse në disa vende ai nuk e ka përpunuar atë. Gjithashtu, vendosja e gurëve në vende të caktuara të objektit është bërë në harmoni të plotë me funksionin e asaj pjese të objektit. Edhe ndikimi atmosferik në gurë me mënyrën e murimit dhe përzgjedhjen e gurëve në vende të caktuara është mënjanuar gati tërësisht.

Madhështia e këtij kombinimi gurësh nuk qëndron vetëm në aspektin konstruktiv, por edhe atë projektues. Është e drejtë të thuhet se formësimi i hapësirës së këtij objekti në masë të madhe varet nga mënyra e murimit, por kur këtu i shtohet edhe realizimi perfekt i këtyre strukturave në aspektin konstruktiv, atëherë kuptojmë se teknika e murimit ka qenë aspekt mjaft i rëndësishëm i këtij projekti. Mjeshtri i kohës ka pasur përvojë të mëhershme në ndërtim gjatë asaj kohe, ai ka njohur materialet vendore, teknikat e ndërtimit, konstruksionin dhe vetë përjetimin e hapësirës, pra ka njohur mirë projektimin. Vetëm në këtë mënyrë mund të kishim këtë rezultat. Kjo është një dëshmi e pakontestueshme, që njohuritë për arkitekturën dhe ndërtimin në trevën e Opojës në atë kohë kanë qenë mjaft të avancuara. Se kjo teknikë ishte e drejtë dhe e avancuar tregon gjendja e tanishme. Kjo mënyrë e murimit, ndonëse pa standarde dhe ateste të laboratorëve të shekullit njëzet e një, ka mbijetuar 500 vjet. Ishin vjedhjet e gurëve dhe shkatërrimet e pavetëdijshme ato që e prishin strukturën.

Këto katër aspekte në projektimin e objekteve arkitektonike janë fundamentale. Mendimi për to dhe realizimi i tyre, sot i bënë objektet të suksesshme apo të pasuksesshme. Ishin këto parimet që e bëjnë namazgjahun një objekt plotësisht të formuar.




Figurë 1 Namazgjahu i Opojës, foto 1990 /burimi:
“Opoja dhe Gora” H. Meleqi, Dragash 1994/




Figurë2 Monumeti, foto nga viti 2003 / burimi IMMPz/




Figurë 3. Foto nga gjendja e tanishme e monumetit/2009/




Figurë 4. Rilevimi i monumetit, dukja e pestë/autori, 2009/




Figurë 5. Rilevimi i monumetit, pamja jug-perëndimore/autori, 2009/



Figurë 6. Gjendja e supozuar burimore, pamja jug-perëndimore



Figurë 7. Rilevimi i monumetit, pamja veri-lindore/autori, 2009/



Figurë 8. Gjendja e supozuar burimore, pamja veri-lindore



Figurë 9. Gjendja e supozuar burimore, pamje

Agim Aliu

HISTORICAL AND ARCHITECTURAL STUDY OF THE OPOJA NAMAZGAH

(Summary)

Introduction

The namazgah is a structure, which can easily be distinguished from other buildings and serves as a place of prayer for Muslims. The Opoja namazgah is situated in the middle of the Opoja region on the left side of the road between Prizren and the village of Zaplluzha, in the vicinity of the village of Buza. It was constructed on top of an artificial hill, which was named after it. Researchers believe that the hill was a pagan place of worship or a tumulus cemetery. Its location is thought to have been a place of worship in the past. Nowadays, the namazgah and the surrounding area are within the cadastral boundaries of the village of Buza. Yet, the namazgah has always served the people of all the villages of Opoja, thus, it cannot be considered the sole property of a single village.

أغيم على

دراسة تاريخية و معمارية لنمازجاه اوبويا (خلاصة البحث)

مدخل:

يعنير "نمازجاه" البناء المعماري الذي يختلف عن كل الانشاءات الاسلامية و الذي يستخدم لاداء العبادات الاسلامية . يوجد "نمازجاه" أوبويا في وسط منطقة أبويا و اذا اردنا دقة أكثر فهو يقع على الجانب الايسر من الطريق الذي يربط بين مدينة بريزن وقرية زابلوجا قريبا من قرية "بوزا" . نم بناء "نمازجاه" على تلة اصطناعية و التي تحمل نفس الاسم أى تلة نمازجاه. و حسب رأى عدد من المؤرخين بان هذه التلة كانت من قبل مكان عبادة وثنية او مكان مقبرة قديمة و بناءا عليه يمكن القول بأن موقع نمازجاه اوبويا باستمرار كان موقعا او مبنى لاعتقاد ديني سابق.

و اليوم ينتمى المبنى و المساحة حوله الى أملاك قرية "بوزا" مع ذلك يمكن القول بأن نمازجاه. أوبويا كان ملكا لكل قرية من قرى أوبويا عليه فان ملكه لا يمكن ان يرتبط بأية قرية.

Habilit). **E ai** (që iu pranua) **tha**: “**Allahu pranon vetëm prej të sinqertëve**”. (El Maide, 27).

Menjëherë pas erdhi sqarimi me ajetin tjetër kur’anor, ku i Lartësuari thotë:

مِنْ أَجْلِ ذَلِكَ كَتَبْنَا عَلَىٰ بَنِي إِسْرَائِيلَ أَنَّهُ مَن قَتَلَ نَفْسًا بِغَيْرِ نَفْسٍ أَوْ فَسَادٍ فِي الْأَرْضِ فَكَأَنَّمَا قَتَلَ النَّاسَ جَمِيعًا وَمَنْ أَحْيَاهَا فَكَأَنَّمَا أَحْيَا النَّاسَ جَمِيعًا وَلَقَدْ جَاءَتْهُمْ رُسُلُنَا بِالْبَيِّنَاتِ ثُمَّ إِنَّ كَثِيرًا مِّنْهُمْ بَعَدَ ذَلِكَ فِي الْأَرْضِ لَمُسْرِفُونَ

Për këtë (shkak të atij krimi) **Ne u shpallëm** (ligji) **beni israilëve se kush mbytyr një njeri** (pa të drejtë), **pa pas mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa pas bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë** (krimi i tij) **është si t'i kishte mbytur gjithë njerëzit. E kush e ngjall** (bëhet shkak që të jetë ai gjallë) **është si t'i kishte ngjallur** (shpëtuar) **të gjithë njerëzit. Atyre** (beni israilëve) **u erdhën të dërguarit Tanë me argumente, mandej edhe pas këtij** (vendimi) **shumë prej tyre e teprojnë** (kalojnë kufijtë në mbytyje) **në këtë tokë**. (El Maide, 32)

Terrorizmi (*terrorism*) – Fenomen shoqëror i njohur që nga fillet e historisë së regjistruar, i “mirënjohur” në kohën tonë; akt kriminal që është vështirë të përkufizohet. Disa e quajten taktikë dhe strategji, disa të tjerë krim e neveri, e grupe të caktuara edhe reagim të arsyeshëm ndaj dhunës. Terrorizmi është shfrytëzim i trembjes, kërcënimit dhe vrasjeve në mënyrë sistematike për arritjen e synimeve të caktuara politike. Frikë kolektive e krijuar në shoqëri nga një grup i caktuar për të thyer rezistencën popullit ose për dëmtimin e kundërshtarëve politikë. Dhunë e ushtruar ndaj civilëve ose pronës për të arritur synime ushtarake ose politike. Strategji psikologjike për të arritur synime politike ose fetare, duke krijuar klimën e frikës në popullatë. O’Kane-i terrorin e quan dhunë kundër të pafajshmëve.

“Ndërsa në sytë e autoriteteve institucionale është kërcënim për rendin, pushtetin dhe paqen, në sytë e njerëzve të thjeshtë është kërcënim për jetën e përditshme”. Terrorin si metodë e përdorin grupet revolucionare, që duan përmbysjen e pushtetit dhe grupet nacionaliste që kërkojnë vetëvendosje. Zakonisht terroristët shfrytëzojnë kërcëni-

NË FOKUS

Mr. Rexhep Suma

ISLAMI - VIKTIMË E TERRORIZMIT MEDIAL

Shtirja e gjerë e inovacioneve teknologjike u nxit edhe nga mjedisi ndërkombëtar i liberalizuar me orientim nga tregu i lirë, që mbizotëroi e mbizotëron në rendin botëror të pas Luftës së Ftohtë, ku kufijtë midis Lindjes dhe Perëndimit u kthyen në konvencione gjeografike. “Në këtë botë konkurruese ku gjigantët ekonomikë dhe ata të fushës së komunikimit ia lënë vendin njëri-tjetrit, globi është kthyer në një fshat global elektronik dhe informacioni është bërë malli dhe mjete i parë” (Madikiza & Bornman, 2007).¹

Historia e terrorizmit nuk është risi e shekullit njëzet, por kjo është ushtruar nga shoqëri të hershme, të cilat nuk kanë respektuar drejtësinë dhe të drejtat njerëzore.

وَإِنَّا عَلَيْهِمْ نَبَأُ ابْنِي آدَمَ بِالْحَقِّ إِذْ قَرَّبَا قُرْبَانًا فَتُقْبِلُ مِنْ أَحَدِهِمَا وَلَمْ يُتَقَبَّلْ مِنَ الْآخَرِ قَالَ لَأَقْتُلَنَّكَ قَالَ إِنَّمَا يَتَقَبَّلُ اللَّهُ مِنَ الْمُتَّقِينَ

“Lexoju (Muamed) **atyre** (jehudive e të tjerëve) **ngjarjen e vërtetë të dy djemve të Ademit, kur të dy flijuan kurban, nga të cilët njërit iu pranua. Ai** (që nuk iu pranua) **tha: Unë do të të mbys ty”** (Kabili i tha

¹ Madikiza & L.Bornman, E., “International Communication: shifting paradigms, theories and foci of interest”, COMMUNICATO, Volume 33/2, 2007 p.14.

met për të mbjellë frikën, për t'i bindur qytetarët se qeveria është e pafuqishme që t'i mbrojë dhe për t'i dhënë publicitet të përnjëhershëm kauzës së vet. Aktet e terrorizmit përfshijnë edhe vetëvrasjet gjakësore, grabitjen e njerëzve, rrëmbimet e avionëve, llahtarisen me bombë, bombardimet, cyber sulmet, shfrytëzimin e armëve kimike, biologjike, bërthamore dhe radiologjike. Në shënjestër të akteve terroriste janë objektet qeveritare, aeroportet ndërkombëtare, qytetet e mëdha dhe objektet e profilit të lartë. Terrorizmi sulmon edhe tubimet e mëdha publike, infrastrukturën e ujit dhe ushqimit qendrat tregtare etj.

Terroristët përhapin frikën edhe me dërgimin e mjeteve shpërthyes ose kimike e biologjike përmes postës. Ka tri këndvështrime lidhur me terrorizmin: terrorizim i terroristit, i viktimës dhe i përgjithshëm i publikut. Terroristët s'e shohin veten për të këqij, e shohin si luftëtarë legjitimë, të cilët luftojnë në rrugën që besojnë dhe ndjekin, me të gjitha mjetet e mundshme. Viktima e terrorit e percepton terroristin si kriminel pa konsideratë për jetën njerëzore. Opinioni i përgjithshëm i publikut është i lëkundshëm, disa herë terroristin e sheh si një "Robin Hood" e ndonjëherë si barbar. Në vijën e analizës së terrorit ka disa qasje si ajo shkaktare, politike, organizative, fiziologjike, psikologjike etj.

Megjithëse sot terrorizmi në masë të madhe lidhet me fetë, sipas H.Jahjës, "bazë e terrorizmit që shqetëson botën nuk është ndonjëra nga fetë me prejardhje hyjnore, por janë ateizmi dhe shprehja bashkëkohore e ateizmit: darvinizmi dhe materializmi". Në sociologji ka një degë të veçantë që vatrëzon këtë çështje: sociologjia e terrorit, e cila merret me origjinën, dinamikën dhe ndikimet e terrorit në jetën shoqërore. (O'Kane, 2007:28; Whitakker, 2007:7-24; Jahja, p.d.:135).²

Termi terrorizëm nga pikëpamja fetare nuk është i pranueshëm dhe në Kur'an është i përmendur në kuadër të kontekstit të ajetit.

وَأَعِدُّوا لَهُمْ مَا اسْتَطَعْتُمْ مِنْ قُوَّةٍ وَمِنْ رِبَاطِ الْخَيْلِ تُرْهَبُونَ بِهِ عَدُوَّ اللَّهِ وَعَدُوَّكُمْ
وَأَخْرَيْنَ مِنْ دُونِهِمْ لَا تَعْلَمُونَهُمُ اللَّهُ وَمَا تُنْفِقُوا مِنْ شَيْءٍ فِي سَبِيلِ اللَّهِ يُوَفَّ
إِلَيْكُمْ وَأَنْتُمْ لَا تَظْلُمُونَ ﴿٦٠﴾

"E ju përgatituni sa të keni mundësi force, (mjete luftarake), e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre (që tradhetojnë) e me të, (me përgatitje), ta frikësoni armikun e Allahut, armikun tuaj dhe të tjerët, të cilët ju nuk i dini (se kush janë), e Allahu i di ata. Çfarëdo që shpenzoni për rrugë të Allahut, ajo do t'ju kompensohet dhe nuk do t'ju bëhet padrejtë. (El Enfalë, 60).

Islami është fe e mëshirës, paqes. Krijimi i tij është mëshirë, dhe mëshira e tij shtrihet edhe te jo besimtarët. Ajo është bërë e shoqëruar me fjalën "xhihad" nuk do të thotë se domosdoshmërisht duhet luftuar porse përfshin ngjyra të përpjekjeve të respektuara. Por, kjo përfshin luftën e cila nuk ka synim zgjerimin perandorak, as vjedhje e plaçkitje por vihet në mbrojtjen e ummetit islam dhe projektit islam.

وَقَاتِلُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ الَّذِينَ يَقَاتِلُونَكُمْ وَلَا تَعْتَدُوا إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ الْمُعْتَدِينَ

"Dhe luftoni në rrugën e Allahut kundër atyre që ju sulmojnë e mos e teproni se Allahu nuk i do ata që e teprojnë (e fillojnë luftën)". (El Bekare, 190).

Dhe për këtë arsye, duhet të bëhet dallimi mes agresionit dhe shtypjes pa të drejtë dhe të rezistencës legjitime si vetëmbrojtje ose rezistencë kundër pushtimit ose dëbimit e kolonizatorit kushdo qoftë ai. Dhe deri te kjo etapë ka sistem rregullash morale shumë të rrepta. Me këtë shihet se e vërteta e xhihadit legjitim është të rezistojë padrejtësinë, shtypjen dhe diktaturën, pra të rezistojë kundër terrorizmit ashtu siç e cek edhe Kur'ani:

وَمَا لَكُمْ لَا تُقَاتِلُونَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَالْمُسْتَضْعَفِينَ مِنَ الرِّجَالِ وَالنِّسَاءِ وَالْوِلْدَانِ
الَّذِينَ يَقُولُونَ رَبَّنَا أَخْرِجْنَا مِنْ هَذِهِ الْقَرْيَةِ الظَّالِمِ أَهْلُهَا وَاجْعَلْ لَنَا مِنْ لَدُنْكَ وَلِيًّا
وَاجْعَلْ لَنَا مِنْ لَدُنْكَ نَصِيرًا

² Ali Pajaziti. Fjalor i Sociologjisë, Logos-A & UEJL, 2009. f.735-736.

C'keni që nuk luftoni për Zotin dhe për (t'i shpëtuar) të paafitit: nga burrat, nga gratë e nga fëmijët, të cilët luten: "Zoti ynë! nxirrna nga ky fshat (Meka), banorët e të cilët janë mizorë. Jepna nga ana Jote shpëtim e ndihmë!" (En-Nisaë, 75).

Islami dhe terrori

Islami, sikurse fetë tjera botërore, kërkon të arrijë një botë në paqe dhe me drejtësi. Por, edhe me Islamin ka ndodhur ashtu sikurse me krishterimin, judaizmin, hinduizmin, shintoizmin dhe me besimit tjera, të cilat janë përdorur nga elementët radikalë për të justifikuar akte të shëmtuara dhune. Fetë monoteiste, në veçanti, ofrojnë shkrime të pakta, të nxjerra nga kontekste historike të veçanta e të lashta, në të cilat bëhet thirrje për akte të tmerrshme e të gjalla, në emër të Zotit, kundër armiqve të besimit të vërtetë.³

Mediet perëndimore japin shpesh përshtypjen se forma gati për betejë dhe nganjëherë e dhunshme e zellit fetar të njohur si "fundamentalizëm" është një fenomen krejtësisht islamik. Por, nuk është kështu. Fundamentalizmi është një akt global dhe është shfaqur në çdo besim të madh në përgjigje të problemeve të modernitetit tonë. Ka Judaizëm fundamentalist, Hinduizëm fundamentalist, Budizëm fundamentalist, Sikhizëm fundamentalist, madje dhe Konfucianizëm fundamentalist. Ky lloj besimi u shfaq së pari në botën e krishterë në Shtetet e Bashkuara, në fillim të shekullit njëzet. Kjo nuk ishte aksidentale. Fundamentalizmi nuk është një lëvizje monolite; çdo formë e fundamentalizmit, edhe brenda së njëjtës traditë, zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe ka simbolet dhe entuziazmin e saj, por manifestimet e tij të ndryshme kanë të gjithë një ngjashmëri familjare. Është ditur se një lëvizje fundamentaliste nuk lind menjëherë, si një përgjigje e pamenduar ndaj shfaqjes së modernizmit perëndimor, por ajo merr formë vetëm kur procesi modernizues ka përparuar së tepërmi.

Njerëzit fetarë përpiqen në fillim të reformojnë traditat e tyre dhe sjellin një bashkim mes tyre dhe kulturës moderne, siç e kemi parë të

bëjnë reformatoret myslimanë. Por, kur shihet se këto masa të matura nuk pinë ujë, disa njerëz përdorin metoda ekstreme, dhe kështu lind një lëvizje fundamentaliste. Tani mund të shohim se veç duhej pritur që fundamentalizmi të bëhej i njohur së pari në Shtetet e Bashkuara, vitrina e modernizmit, e të shfaqej në pjesë të tjera të botës në një kohë të mëvonshme. Nga të tre fetë monoteiste, Islami ishte në fakt i fundit që do të zhvillonte një tendencë fundamentaliste, kur kultura moderne filloi të hedhë rrënjë në botën islame në fund të viteve 1960. Ndërkohë fundamentalizmi ishte vendosur mirë mes krishterëve dhe hebrenjëve, të cilët kishin pasur një ekspozim më të gjatë ndaj përvojës moderne.⁴

Për fat të keq ende shumë njerëz, e lidhin Islamin me arabët ose indianët dhe pakistanezët: ata vështirë se mund ta pranojnë se një bashkëqytetar evropian mund të jetë mysliman. Në kushte të tilla, kjo do të thotë se myslimani nuk është qytetar autentik dhe se imazhi i tij ende ndërlidhet me disa tipare "të huaja". Historia i mban në ngërç mendjet evropiane, dhe mënyrën se si myslimanët shikohen, e cila në kulturën dhe kujtesën pasive perëndimore, ndërlidhet me Orientin, i cili shikohet si ekzotik, jo gjithaq i largët, por më shumë antagonist sesa mik. Në mënyrë paradoksale, prania e dukshme e miliona myslimanëve në Evropë, në asnjë mënyrë nuk e ndryshon këtë ndjenjë të vjetër dhe thellë të rrënjës: krejt e kundërta mund të vërehet, vazhdimisht dëgjojmë këtë e andej, gjykime të nxituara e të papeshuara që theksojnë se brenda kufijve të Evropës ka shumë të huaj. Dhe Islami vazhdon të trajtohet si problem i imigracionit: duke e vështirë të kuptohet se sot islami është realitet evropian.

Islami që nga dita e parë ka dhënë shenja se është civilizim dhe kulturë e botërore. Pothuaj nga lindja e tij, Islami ishte një perandori botërore dhe një qytetërim botëror, që shtrihej në tre kontinente të banuara nga shumë raca të ndryshme dhe përfshinte në vetvete vatrat e qytetërimeve të lashta si të Egjiptit dhe të Gjysmëhënës Pjellore, të cilëve do t'u shtoheshin shumë shpejt Irani dhe India veriore. Mysli-

³ Grahama E. Fuller. "Islami politik dhe e ardhmja e tij", Arbëria, Tiranë, 2010, f.166.

⁴ Karen Armstrong. "Islami një histori e shkurtër", Logos-A 2011 f.241-242.

manët kishin trashëguar filozofinë dhe shkencën e Greqisë, që Evropës do t'i duheshin shekuj për t'i zbuluar; diturinë dhe artin e qeverisjes së Iranit; dhe deri një pjesë të mirë të trashëgimisë së krishterimit oriental dhe bizantin. Ndërsa Evropa ishte mbyllur ndërmjet Islamit në jug, stepës në lindje, oqeanit në perëndim dhe hapësirave të ngrira në veri, bota e Islamit ishte në kontakt-nganjëherë në luftë me, por shpesh në paqe- me qytetërimet e pasura dhe të lashta të Indisë dhe të Kinës. Nga njëri importuan shënimin pozicional, dhjetor të numrave; nga tjetri letrën, me ndikim shumë të madh si në shkenca ashtu dhe në disiplinat humane, si dhe në administratën publike dhe biznes. Bota islamike zotëronte një kulturë të pasur dhe të larmishme, territore të gjëra dhe burime të bollshme si dhe një ekonomi komplekse dhe të lulëzuar.

Përveç kësaj, shteti islam kishte një shoqëri urbane të sofistikuar dhe respektues të ligjeve, dhe në këtë aspekt kontrasti me Evropën ishte i tillë sa që akoma në epokën e Perandorisë Osmane udhëtarët u mahniteshin nga qyteti i Stambollit, ku fisnikët, deri dhe ushtarët shëtitnin pa armë. Ekumeni islamik ishte një shoqëri unike dhe, për njëfarë kohe, një bashkësi e vetme politike, të cilën e bashkonte besimi dhe përkatësia dhe e lidhte një rrjet rrugësh detare dhe tokësore që ishte krijuar për një qëllim të dyfishtë, për tregtinë dhe pelegrinazhin.

Përveç kësaj, atë e bashkonte një gjuhë e vetme dhe kultura ajo që shprehte. Gjuha arabe përbënte për botën islamike një mjet komunikimi të pashembullt në krishterimin paramodern-një gjuhë e qeverisë dhe tregtisë, e shkencës dhe e filozofisë, e fesë dhe e drejtësisë, me një literaturë të pasur dhe të larmishme që nuk kishte ekuivalentë as precedent për nga shtrirja, larmia dhe finesa. As greqishtja e fosilizuar, as latinishtja e nënvlerësuar, as gjuhët e folura primitive të Evropës së shekujve të parë të Mesjetës nuk ofronin dot diçka që ishte qoftë dhe nga larg e krahasueshme me të.

Krahasuar me Islamin, Krishterimi ishte pra i varfër, i kufizuar, i prapambetur dhe monokromatik. I copëtuar në mbretëri të vogla që grindeshin, me kisha të përçara nga shizmat dhe herezitë, me grindje të vazhdueshme midis kishës së Romës dhe asaj së Lindjes, ai u

shndërrua në një rivalitet midis dy perandorive dhe për njëfarë kohe edhe midis dy papëve.⁵

Ky është islami madhështor që edhe sot jehona dhe mësimet e tij shpojnë çdo zemër humane. Jo ajo që prezantohet sot në medie të cilat bëjnë mbulim medial joprofesional. Edhe pse kushtet e rënda ekonomike, politike e sociale i kanë detyruar myslimanët e varfër të emigrojnë drejt shteteve perëndimore, ata prapëseprapë besimin dhe dinin e tyre nuk do ta ndërrojnë e as japin për asgjë. Dyshimi është bërë shprehje edhe lidhur me përkatësinë e vërtetë të myslimanëve. Ata kanë ardhur në Evropë për të përparuar materialisht, të fitojnë para, por zemrat i kanë diku tjetër. Ata janë “përfitues”, vërejtje këto që u bëhen edhe hebrenjve. Ky konstrukt mental është i forcuar shumë në shumë vende evropiane dhe në veçanti nëpër rajone, ku myslimanët janë të shumtë në numër dhe aty ku ka problem të papunësisë.

Një dimension tjetër duhet t'i shtohet kësaj tabloje. Ndoshta është ky dimension ai i cili ushtron ndikimin më të fortë në mendjet e perëndimorëve, e i cili ndërlidhet me ngjarjet që ndodhin në skenën ndërkombëtare dhe në mënyrë spektakolare mbulohen nga mediet. Trysnia është shumë e fortë, kështu që është bërë e vështirë, ndoshta e pamundur, të gjenden ngjarje të përpunuara mediatikisht qartë dhe objektivist. Ngjarjet nga bota islame, qoftë nga Algjeria, Afganistani ose diku tjetër në botën myslimane, prezantohen bashkë me imazhe të dhunës dhe të kryengritjeve dhe me citate e fjalime radikale dhe të helmëta kundër Perëndimit. Këto imazhe të lënë përshtypjen se Islami për nga natyra e vet ndërlidhet me agresivitetin, dhunën dhe luftën. Përshtjellimi është absolut dhe njerëzit e thjeshtë sot e kanë vështirë të bëjnë dallimin mes myslimanit praktikues (të detyrimeve fetare) dhe një “fanatiku” ose “ekstremisti”. Dëshira e myslimanit evropian për të praktikuar fenë e vet, mendërisht ndërlidhet me përfaqësimet e përhapura televizive.

⁵ Bernard Lewis. "Islami dhe perëndimi". Instituti i Dialogut & Komunikimit. 1993. Tiranë. f.19-20.

Rezultati është refuzimi automatik, virtual sistematik. Dyshimi është thellë i rrënjësor dhe i lidhur me idenë e “rrezikut islam” që po përhapet çdo ditë e më tepër. Myslimanët e Evropës konsiderohen si “ujqër” në petkun e deles ose si “kalë troje”, thënë ndryshe, armik pararojë që ka kapërdirë zemrën e shteteve evropiane. Këto paragjykime ngulmuese i pengojnë shoqëritë evropiane nga jetësimi i bashkëjetesës harmonike mes vendasve dhe myslimanëve. Kjo situatë kërkon vlerësim urgjent, me qëllim që të merren masat e duhura për të ndryshuar këtë prirje të rrezikshme.⁶

Argumentet e pandërprera pretendojnë se media përbën një tip qendror të postmodernizmit dhe, madje, përcakton qytetërimin mbizotërues global të kohës sonë. Përhapja e postmodernizmit, shpresa, paqartësitë dhe sfida e tij, nuk është e mundur të kuptohet pa një kuptim të medias. Myslimanët asgjë nuk i ka kërcënuar në histori si media përrëndimore „as baruti në Mesjetë, të cilin mysli-manët, si baburi, e përdorën me zotësi në fushat e Panipatit, duke fituar kështu Indinë për dinastinë e tij mogule, as trenat dhe telefoni, që i ndihmoi kolonializmin e tyre në shekullin e fundit, madje as aeroplanët, të cilët në fillim të këtij shekulli i vunë në përdorim për linjat e tyre ajrore. Media përrëndimore është gjithmonë e pranishme dhe e kudogjendshme, duke mos qenë asnjëherë në qetësi dhe duke mos lejuar kurrë pushim. Ajo heton dhe sulmon pa pushim, duke mos treguar mëshirë për dobësinë apo brishtësinë.

Mësymja e fuqishme mediale është e komplikuar për mysli-manët: ata duket se nuk kanë kapacitetin për të mbrojtur veten. Më keq akoma, ata nuk duken në gjendje madje për t'i kuotuar natyrën dhe synimet e sulmit. Kërcënimet boshe të udhëheqësve dhe ankimet mendjengushta të dijetarëve i bëjnë ata të duken për të ardhur keq, si xhuxhët, duke folur për veten ndërsa te porta është gjiganti i fuqishëm i një armiku. Është mysli-man i thjeshtë, pandryshueshmërisht më i besueshëm se udhëheqësi dhe dijetari, ku janë përzier gjykimi i shëndoshë dhe instinkti mysli-man, i cili e ndjen madhësinë e rrezikut. Ai

⁶ Tarik Ramadan. “Të jesh mysli-man evropian”, Logos-A, 2011. f.309-310

është i vetëdijshëm për shkallën e mundshme të betejës dhe forcat e rreshtuara kundër tij; tensioni i tij është përkeqësuar për shkak se ai ka aq besim në udhëheqësit e vet.

Në vitin 1258, do të ketë qenë diçka e ngjashme me këtë, kur mongolët u mblodhën jashtë Bagdadit, për të dërrmuar një herë e mirë perandorinë më të madhe arabe në histori. Por, ndërsa abasidët mbetën në rrënoja, u krijuan struktura të tjera, një lloj të rëndësishme, me ngrehina të lavdishme: fatimidët në Egjipt, omejadët në Spanjë, dhe, më vonë, safevitët në Iran, mogulët në Indi. Këtë herë do të jetë një vendim përfundimtar, nuk do të ketë kthim prapa. Demoni është krijuar së xheloze dhe e ligë.⁷

Shtrembërimi i realitetit

Nëse filmi si fuqi e shtatë, ka mundësi të krijojë pasqyrën e botës, çka do të thotë “realitet”? Përshtypjet e krahasueshme shqisore të shumë njerëzve në perceptimin e të njëjtit objekt na tregojnë se ç’është ky realitet. Do të thotë, produkti që prodhojmë ne nuk ekziston në ekran, por në kokat e shikuesve të veçantë.⁸

Në bazë të hulumtimeve të bëra, del se shikuesit e shikojnë televizionin si mjet edukativ dhe si mjet për t’u argëtuar, por edhe si mjet edukativ dhe si pikë referimi për atë çka ndodh në botë.

Është parësore se shikuesit e shohin televizionin si refleksion të besueshëm të jetës reale. Sipas një ankete të bërë nga studiuesit amerikanë Stiven Roberts dhe Linda Litçer, del se 40% e amerikanëve besojnë se “TV e tregon jetën çfarë është në të vërtetë”. Sipas studiuesve, kjo dallon varësisht nga grupe të ndryshme etnike. Zezakët shikojnë më së shumti televizorin, dhe e përdorin atë si mjet edukativ, ngase mësojnë nga ai gjëra që nuk i nxënë në shkollë. Prandaj, nuk është as-

⁷ Akbar S. Ahmed. “Postmodernizmi dhe Islami hallë dhe shpresë”. Logos-A, 2012. f.369.

⁸ Ilire Zajmi. “Pamjet Televizive dhe Realiteti”. Prishtinë, 2011. Rozafa. f.68.

pak befasuese që zezakët e shohin televizorin si refleksion të jetës reale.⁹

Porse mediet vazhdimisht paraqesin pamjet jo reale të gjendjes së myslimanëve kudo qofshin. Qarqe të caktuara ndjekin mënyrën apo edhe bëjnë misionin që pamjet me të cilat prezantohen myslimanët në media të jetë sa më e deformuar, sa më e vrazhdë, vulgare dhe negative. Por, athua çfarë do të thotë të jesh mysliman i Evropës? A është kjo e mundur? Kush janë myslimanët e Evropës? A mund të gjendet një emër i përbashkët për më tepër se 20, e ndoshta deri në 30 milionë myslimanë që jetojnë sot në Bashkimin Evropian?

Pamja e rrënjësor e myslimanit evropian është emigrant ose pasardhësi i emigrantit nga Azia ose Afrika, i ngjyrës së errët ose të zezë të lëkurës, të ndryshëm për nga kjo cilësi, por shpesh edhe nga mënyra e të veshurit, sjelljes dhe jetës së përditshme. Por, edhe të bardhët janë myslimanë. Me këtë rast nuk mendojmë vetëm për të konvertuarit në islam, që e bëjnë këtë për arsye të shumta, por edhe për bashkësitë myslimane autoktone evropiane, të cilat me shekuj ekzistojnë në Evropë. Së pari, është fjala për popujt ballkanikë dhe grupet etnike. Këtu numërojmë shqiptarët, boshnjakët, torbeshët/pomakët, goranët, romët dhe turqit e Ballkanit në Bullgari, Greqi, Maqedoni, Rumani dhe Serbi. Këta myslimanë të bardhë fusin konfuzion në mendimin e rrënjësor për myslimanët si ardhacakë.¹⁰

Pra, myslimanët dhe islami janë bërë cak i sulmeve nga katër anët e botës, edhe pse në forma e mënyrë atë ndryshme qëllimi është i njëjtë. Myslimanët janë të detyruar të qëndrojnë kundër terrorizmit dhe kundër grupeve terroriste, shtetet dhe individët gjithashtu. Islami mbështet pozitën e solidaritetit me të tjerët për të hedhur themelet e sigurisë dhe stabilitetit, paqes dhe luftës kundër varfërisë, sëmundjeve, dhe krimit të organizuar!

Bizneset e Perëndimit, nga ana tjetër, kanë përfutur nga reklama dhe marketingu që shoqëronte produktet dhe shërbimet e tyre në tre-

gjet e huaja. Industritë e informimit dhe argëtimit të Perëndimit kanë shërbyer edhe për të mbështetur dhe superlativizuar mënyrën e jetesës së Perëndimit si dhe vlerat e kapitalizmit dhe liberalizmit në arenën ndërkombëtare. Në këtë mënyrë parimi i qarkullimit të lirë nuk ndihmoi vetëm për forcimin dhe konsolidimin e ndikimit të Perëndimit në luftën e tij ideologjike me Bashkimin Sovjetik gjatë Luftës së Ftohtë. Në përgjithësi, ai ka shërbyer për të përhapur doktrinën e Perëndimit, sidomos atë të SHBA-ve, në komunitetin ndërkombëtarë dhe në vendet e botës së tretë.¹¹

Zhvillimi politik, ekonomik dhe social, global dhe rajonal, në vitet e fundit, ka trazuar fuqishëm marrëdhëniet mes shoqërive perëndimore, evropiane dhe islame. Kudo në botë, njerëzit janë dëshmitarë të ndryshimeve dhe ato ndryshime po shihen si shqetësuese. Si myslimanët ashtu edhe jo-myslimanët u bënë viktimë të terrorit dhe dhunës nga njerëz të pretenduar për të vepruar “në emër të Islamit” apo edhe në emër të vlerave perëndimore e shpeshherë edhe në deklaratat publike janë shprehur edhe si lufta e kryqëzatave. Keqkuptimi dhe paragjykimet duket të rriten në të dy anët, edhe pse informacioni, sistemet dhe mjetet e komunikimit janë shumë të sofistikuar. Në epokën e komunikimit, luftërat fillojnë, vazhdojnë dhe përmbyllen me luftën e medias. Mjetet e komunikimit masiv janë përdorur si armë të rëndësishme për keqinformimin e opinionit publik. Ka një lidhje midis rolit të medieve dhe post-modernizmit, ku media i jep formë botës se si ne e shohim atë. Kjo është një vrojtim i përbashkët që kriza të tilla si luftërat, recesionet ekonomike, tregu i bursës, etika, skandalet dhe katastrofat natyrore shpeshherë e shtojnë opinionin publik drejt bërjes së politikave publike. Një krizë zbulon një problem dhe pastaj një konsensus publik del, ku rezulton me presion mbi politikëbërësit që ata duhet të bëjnë diçka lidhur me të. (Snider, 2006:1).

Këto kriza zbulojnë rol të rëndësishëm të subjekteve transmetuese në krizën e informacionit dhe komunikimit. Ato japin informacion në

⁹ Stiven Roberts, Linda Litçer, “Power of Images”. Oxford Press University, 2000, f. 6.

¹⁰ Tarik Kulenović, “Islami politik konceptet themelore, autorët dhe grupet e një lëvizjeje modern”, Logos –A 2012. f.271.

¹¹ Doc. Jaup Zenuni. “Komunikimi ndërkombëtar”. Shtëpia botuese EXTRA-R. Tiranë, 2011. f.48.

zhvillim për publikun në kohë krize. Por, ato zgjedhin emrat negativë dhe të frikshëm për njerëzit ose grupet që politikëbërësit e fuqishëm nuk e pëlqejnë ose duke përdorur emrat pozitivë për përshkrim të egër mbeten pjesë e mashtrimeve mediale. Në ditët e sotme, fushata të shumta mediale janë në vazhdim e sipër kundër Islamit dhe myslimanëve. Mediet perëndimore me burime të konsiderueshme financiare dhe kanaleve të shumta përpiqen të tregojnë një fotografi (imazh) të keqe të Islamit për publikun e tyre. Në të njëjtën kohë grupe myslimane përmes medieve të ndryshme janë duke u përpjekur për të përcjellë mesazhet e tyre, por në krahasim me dominimin global të medieve perëndimore, përpjekjet e tyre janë disi të kota.

Shumica e medieve perëndimore janë duke përdorur ngjarjet e 11 shtatorit për të kapitalizuar fitimin e tyre politik. Këto media vazhdojnë ta etiketojnë dhe përshkruajnë Islamin si “fundamentalizëm”, “ekstremizëm” dhe “radikalizëm”, “vehabizëm”, “islam politik” etj etj. Natyrisht, në botën moderne, ku media ka rol dhe ndikim qendror, imazhi i realitetit mund të manipulohet për të paraqitur faktet aktuale. Mediet janë përpjekur të paraqesin myslimanët si “terroristë” që paraqesin një kërcënim për sigurinë perëndimore. Duke bërë kështu, ata përpiqen për të justifikuar luftërat në Afganistan dhe në Irak. Në vitet e fundit, kjo mënyrë e qasjes ka çuar në shfaqjen e “islamofobisë”. Megjithatë, pak përpjekje është bërë për t’iu përgjigjur këtyre fushatave negative. Në të kundërtën, akti i grupeve terroriste që vrasin njerëz, sidomos pengjet perëndimore, ndihmojnë mediet e tyre për të treguar se ata janë kolektivisht viktimat të terrorizmit. Me gjithë shpërthimin e mbulimit nga media dhe publikimeve mbi Islamin dhe myslimanët, sfidohet marrja e informacionit të saktë dhe të verifikuar. Politizimi i studiuesve, ekspertët dhe komentuesit e medieve në periudhën e pas 9/11 kanë krijuar një fushë të minuar për politikëbërësit dhe publikun në përgjithësi si ata kërkon përgjigjet në pyetje të tilla si: “Cilat janë shkaqet e radikalizmit dhe anti-amerikanizmit?”, “Pse na urrejnë?”, “Çfarë të bëjnë femrat që mendojnë për statusin e tyre në Islam?” “A është Islami në përputhje me demokracinë?”, “Cilat janë shkaqet e terrorizmit global?” dhe shumë e shumë çështje tjera. Shumë shpesh,

një lexues është kapur mes pozicioneve pretenduar të ekspertëve në dukje të kualifikuar, si dhe kuadri i ri i autorëve islamofob, të cilët përfshihen në një lexim revizionist të Islamit dhe historisë islame. Pra, çfarë duhet të bëjmë? Papritmas një mjet i ri empirik i bazuar shfaqet për të na marrë përtej interpretimeve të kufizuara dhe mendimet e ekspertëve kur u përgjigjur në pyetjen: Çfarë myslimanët mendojnë dhe për çfarë ata interesohen?

Rritet ndjenja e kërcënimit ndaj identitetit islam

Ndjenja e kërcënimit ndaj identitetit kulturor mysliman është rritur si ndjenjë dominuese në shoqërinë perëndimore si e fuqishme që imponon vlerat e saj mbi botën tjetër myslimane. Kur u shtruan disa pyetje të tipit të hapur i p.sh. “Çfarë mendimi keni për Perëndimin?”, përgjigja më e shpeshtë në të gjitha vendet islame qoftë të moderuarit, radikalë, apo politikë ishte “Imoraliteti seksual dhe kulturor”, pasuar nga “etika dhe korrupsioni moral” dhe “urrejtja e myslimanëve”. Një tjetër burim i pakënaqësi vjen nga përshkrimi i myslimanëve në mediet ballkanike. Një studim i bërë nga Jack Shaheen, i cili në librin e tij, *Reel Bad Arabs: How Hollywood Vilifies a People* gjeti se shumica e karaktereve arabe në 900 filmave amerikanë ishin përplot karaktere raciste. Imazhet e jetës së përditshme e të zakonshme dhe myslimanëve të zakonshëm në vendet e tyre janë pothuajse jo-ekzistente ose shtrembëruar në mediet perëndimore. Për më tepër, mediet perëndimore që janë më të popullarizuara në botën myslimane të inkurajuar rivalitet e modës perëndimore, personalitete dhe vlerat. Lajmet e TV janë burimi më i rëndësishëm i njohurive të publikut rreth ngjarjeve botërore, ku përafërsisht 80 për qind e popullsisë mbështetet në atë si burimin e tyre kryesor të lajmeve. (Philo dhe Berry, 2006: 199) mediet perëndimore me burime të konsiderueshme financiare përpiqen për të treguar një pamje të përafërt të Islamit të publikut të tyre. Disa studiues besojnë se ekziston një lidhje direkt mes terrorizmit dhe komunikimit modern global. Studimet e tyre tregojnë se shumica e akteve terroriste janë thjesht propagandë. Terrorizmi është një strategji e tër-

thortë psikologjik, e cila shmang kontaktin e drejtpërdrejtë me kundërshtarët. Pra, pa media.

Për të përmirësuar imazhin e Islamit në Perëndim, kjo kërkon një përpjekje të fortë dhe të vazhdueshme nga vetë myslimanët, si në botën islame dhe në komunitetet myslimane në Perëndim. Pas 9/11 shprehjet “mysliman” dhe “terrorist”¹² u bë sinonim në shumë vende perëndimore. Që nga kjo ngjarje, shumë ekspertë dhe aktivistë në fushën e të drejtave të njeriut kanë paralajmëruar përshkallëzimin e islamofobisë dhe racizmit kundër myslimanëve në shumë vende perëndimore.

Myslimanët pyesin: tani që media perëndimore ka ndihmuar në mposhtjen e komunizmit, kush do të jetë kundërshtari i tyre i ardhshëm? Nuk është vështirë të hamendësohesh: Islami. Islami vazhdon të marginalizohet apo të diskreditohet; Islami mund të marrë dhjetë minuta paraqitje televizive në njëqind orë televizion, ku myslimanët do të jenë duke djegur libra apo duke formuar grupe kërcënuese. Myslimanët janë ftuar rrallë, nëse janë ftuar ndonjëherë, në programet debatuuese popullore, si *Wogan* dhe *The Clive James Show*.

Përfaqësimi i myslimanëve në media ka të bëjë me mungesën e pranimit të dallimeve. Mediet krijojnë panik publik rreth kërcënimit terrorist. Një dijetar ka thënë se lufta kundër terrorizmit është një luftë e imazheve, dhe imazhet më efektive janë ato të viktimave të terroristëve. Por, nga ana tjetër ne shohim diskriminimin lidhur me “islamofobinë”. Ky fenomen përpiket për të treguar se myslimanët janë një kërcënim për sigurinë. Fokusi mbi terrorizmin unifikon mbulimin televiziv të lajmeve myslimane dhe imazhi dominues është “Terrorizëm Islamik”. Ky besim çon në prodhimin e filmave anti-islam si “Fitna” nga parlamentari Geert Wilders. Ajo që është e qartë është se pas sulmeve të 11/9, shumica e ekspertëve flasin për çështjet e sigurisë, ndërsa shkaqet sociale dhe politike të sulmeve ishin harruar. Për-

faqësimi i myslimanëve në media perëndimore duhet të ndryshojë dhe Interkulturalizmi ka për të zëvendësuar islamofobinë.

Përmirësimi i imazhit në Perëndim

Përmirësimi i imazhit të Islamit në Perëndim, kërkon një përpjekje të fortë dhe të vazhdueshme nga vetë myslimanët, si në botën islame dhe në komunitetet myslimane në Perëndim. Këto përpjekje duhet të përfshijë një proces të plotë të reformave. Myslimanët kurrë nuk do të jetë në gjendje për të përmirësuar imazhin e tyre në botë, nëse ata nuk paraqiten si umbet i kulturës dhe qytetërimit. Duhet gjithashtu të ndërmerren iniciativat efektive për të edukuar jo-muslimanët në lidhje me konceptet e sakta islame të paqes dhe tolerancës dhe për të sqaruar qëndrimet jokorrekte të Islamit të mbajtura nga disa. Tensionet mes komuniteteve të emigrantëve myslimanë dhe popullsisë shumicë janë në rritje në shumë vende evropiane. Emigrantët myslimanë janë të ballafaquar me diskriminim dhe intolerancë, kudo që identiteti i tyre lidhet me fenë e tyre. Është e sigurt se sfidat politike, ekonomike dhe sociale të integritetit mund të plotësohen vetëm me përpjekje nga të dyja palët dhe se këto sfida nuk janë të lidhura domosdoshmërisht me fenë në vendin e parë. Një sfidë tjetër mund të shihet në parandalimin e të rinjve për të përqafuar formën radikale. Për shumë myslimanë të rinj, Islami duket se ka bërë një zëvendësim për atdheun e tyre, të cilët mund ta gjejnë në shoqëritë, ku jetojnë jo-myslimanët, edhe për myslimanët, organizatat shtetërore dhe fetare janë të sfiduar në mënyrë të barabartë nga këto zhvillime. Pluralizmi dhe mundësia për të zhvilluar dhe për të jetuar identitete të shumëfishta janë një karakteristikë thelbësore e modelit evropian të jetës. Pika e fillimit nga iniciativat e ndryshme për dialog është bindja se edhe pse feja dhe identiteti fetar kanë fituar gjithnjë e më shumë rëndësi, konfliktet rajonale nuk duhet kuptuar vetëm në aspektin kulturor apo motive fetare. Mungesa e mirëkuptimit të ndërsjellë duhet të tejkalohet me dialog. Forcimi i pluralizmit brenda shoqërive dhe reduktimi i paragjyqimeve dhe imazhet

¹² Akbar S. Ahmed, “Postmodernizmi dhe islami hallë dhe shpresë”, Logos-A, 2012, f.407.

armik qoftë në Evropë apo në shtetet myslimane - gjithashtu luajnë një rol vendimtar.

Dialogu, për këtë arsye, nuk duhet të përmbahet nga polemikat, duhet duruar debate të hapura, në mënyrë që të bëhet kompleksiteti i çështjes në rrezik transparent dhe të mundësojë perceptime të ndryshme, ende ruhet pranimin universal i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Dialogu i vërtetë është i mundur vetëm në prani të njohurive të ndërsjellë dhe pranimin e vlerave kulturore dhe fetare. Pranimi i të tjerëve duhet të thotë më shumë se tolerancë - ajo duhet të thotë pranimi i tyre si anëtarë të komunitetit pa humbur domosdoshmërisht identitetin e tyre etnik. Pranimi i tillë i ndërsjellë duhet të integrojë vlerat e të dyja palëve në një mes të pasur kulturor të komunitetit. Ku ka respekt, do të ketë edhe vullnet dhe gatishmëri për të integruar edhe disa nga ato vlera për pasurimin e vlerave kulturore dhe fetare të dikujt. Respektimi i tillë për të tjerët kërkon njohuri të caktuar të historisë dhe kulturës e të tjerëve, udhët e jetës dhe faktorë të tjerë. Në sajë të zhvillimeve të teknologjisë së komunikimit, njohja e tillë tani është lehtësisht në dispozicion.

Dialogu ndërfaqësor dhe ndërkulturor kërkon të arrijnë një kuptim më të mirë të ndërsjellë dhe për t'u angazhuar në aktivitete të përbashkëta. Qëndrimi i tij kryesor është pajtimi për të krijuar një botë më të mirë dhe më të qetë, që të ndajnë burimet e botës në mënyrë të barabartë dhe për të ndihmuar të paprivilegjuarit. Përkundrazi, ne duhet të punojmë në bashkëpunim për të bërë diçka së bashku, për t'u ngritur mbi diskutimet mbi ngjashmëritë dhe ndryshimet doktrinare dhe ceremoniale. Bashkimi i tillë në bashkëpunim është i mundur vetëm në diversitet dhe në ruajtjen e sa më shumë të jetë e mundur vetë identitetit tonë në një botë gjithnjë e më homogjene.

Këto nuk janë duke konvertuar zhvillime kontradiktore. Kjo është e vërtetë për kombet dhe vendet, ku kufijtë janë duke u bërë më pak të rëndësishëm apo edhe të zhduken, dhe gjithashtu për fetë. Duket qartë se një bashkim i tillë mund të realizohet vetëm duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin në një gamë të përbashkët globale të aktiviteteve. Disa dijetarë thonë se dialogu ndërkulturor është një nga ilaçet më të mëdha

për të kapërcyer sëmundjet e përbashkëta të njerëzimit. Qëndrueshmëria e botës sonë varet, në një masë të madhe, në promovimin e dialogut ndërkulturor. Krijimi i mjediseve të dialogut është një mjet për të vlerësuar mendime të ndryshme dhe për të eliminuar stereotipat shpesh caktuar për “ të tjerët “. Në këtë drejtim, ne kemi nevojë për të edukuar jo-muslimanët për Islamin dhe muslimanët në lidhje me besimet e tjera për të krijuar mirëkuptim të ndërsjellë dhe tolerancën. Për të arritur këtë qëllim duhet ftuar dhe inkurajuar ndarjen e perspektivave të ndryshme, partneritet me organizata të tjera fetare dhe kulturore dhe në organizimin e aktiviteteve arsimore të tilla si seminare, ligjërata dhe panele diskutimi, të gjitha të cilat frymëzojnë dhe të na ndriçuar në përpjekjen tonë për të përmbushur misionin tonë.¹³

Media si burim kryesor i informacionit

Mediet e komunikimit masiv shërbejnë si burim i rëndësishëm informacioni për një numër çështjesh, sidomos për ato politike si dhe për sferat publike.

Gjatë studimit të socializmit të medias është e dobishme që të identifikojmë motive apo stereotipa të qëndrueshme që janë të pranishme në programet e medias. Në një studim zbulohet se rreth 90% e krimeve të shfaqura në TV janë zbuluar. Instancat e zbatimit të ligjit nuk i për afrohen dot një efikasiteti të tillë. Sulmet e 11/9, dhe operacioni Liria e Irakut, e përqendruan vëmendjen në mënyrën se si ishin përshkruar arabët në media. Analiza e programeve të TV zbuloi se burrat arabë zakonisht ishin portretizuar përmes tre stereotipave kryesore negative: (1) terroristë, (2) sheikë nafte dhe (3) endacakë. Gratë arabe shfaqeshin rrallë dhe kur ato shfaqeshin paraqiteshin si valltare *belly* ose si gra haremi (haremet kurrë s'kanë qenë tipike, madje sot nuk

¹³ Mirza MEŠIĆ, “The Perception of Islam and Muslims in the Media and the Responsibility of European Muslims Towards the Media”, www.culturelink.org

ekziston asnjë prej tyre). Po ashtu sa fëmijë arabë keni parë ju në *Same Street*?¹⁴

Në anën tjetër, të spektrit është besimtari që e sheh, në rastin më të mirë, dhunën fetare si një oksimoron (pranëvendosje paradoksale të termave të kundërt), e, në rastin më të keq, si sakatim të besimit të tij/saj fetar. Fetë nuk bëjnë thirrje për dhunë. Mësimet fetare janë paqësore në bazën e tyre, me synim rivendosjen e harmonisë zanafillëse midis qiellit dhe tokës, midis Krijuesit dhe të krijuarve. Por, ndjenja dhe mësimet të caktuar fetare janë manipuluar për të nxitur dhunën për përfitime politike. Dhuna ushtrohet në emër të fesë, por nuk shfaqësohet prej saj. E vetmja kritikë e vlefshme që shekullaristi mund të bëjë kundër fesë është se fetë nuk kanë zhvilluar mënyra efektive për t'u mbrojtur nga manipulime dhe abuzime të tilla. Ashtu siç e ka treguar Juergensmeyer-i në studimin e tij të zgjeruar mbi dhunën fetare në periudhën moderne, dhuna nuk njihet kufij fetarë dhe kulturorë dhe mund të gjejë lehtësisht strehë në mësimet më sublimë dhe më të padëmshme të feve botërore.¹⁵

Gjithsesi fetë gjenden përpara sulmeve apo kritikave kur ato dëshojnë të gjejnë mënyrat e parandalimit të përdorimit të forcës në emër të tyre. Kjo bëhet veçanërisht e rëndë kur ato nuk arrijnë të ngulisin në mendjen dhe në zemrën e pasuesve të tyre një vetëdije paqeje dhe jo dhune. Shkurt, fetë në vetvete nuk mund të shihen si burim dhune. Përgjegjës mund të jenë vetëm disa nga praktikuesit e këqij.

Të dyja pikëpamjet mbështeten në fakte të forta dhe japin argumente të rëndësishme mbi fenë dhe dhunën. Por, të dyja janë njëloj të gabuara në mbështetjen në një përkufizim të prerë të fesë. Dhe, të dyja pikëpamjet e reduktojnë larminë e madhe të praktikave fetare në një traditë të veçantë dhe, për më tepër, në një moment historik apo fraksion të veçantë në atë traditë. Metoda e zakonshme në diskutimin mbi Islamin dhe dhunën, apo mbi Hinduizmin dhe luftën, është vësh-

trimi në shkrimet e shenjta dhe krahasimi e ballafaqimi i tyre me realitete historike që rrjedhin nga ushtrimi i tyre, apo me mungesën nga kjo. Ne i theksojmë ato momente ku ka mospajtim midis tekstit dhe historinë e asaj feje, do të thotë, momentet kur bashkësia nuk ka jetuar e vepruar në përputhje me standardet e fesë, siç është kërkuar nga teksti.

Ndonëse nga kjo qasje mund të përfitohet diçka ajo nuk arrin t'i shohë mënyrat në të cilat janë interpretuar tekstet fetare dhe janë bërë pjesë e përvojës së përditshme të bashkësive të veçanta fetare. Në vend që të vështrohet se me sa vetëdije fetare janë lexuar, se me sa vetëdije fetare janë bërë të njohura dhe të pasuara tekstet obliguese brenda përvojave konkrete të bashkësisë, ne e veçojmë tekstin nga historia dhe pretendojmë disi imunitet historik për tekstin dhe/ose bazat tekstuale për të *gjithë* historinë.

Kjo nuk synon të mohojë pozicionin qendror të shkrimit të shenjtë. Në rastin e islamit, Kur'anit, së bashku me sunnetin e të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), është dhe mbetet burimi kryesor i *weltanschauung*-ut (botëkuptimit) islam. Tekefundit, interpretimet e shumta mbi të cilat mund të flasim, janë interpretime të Kur'anit, të tekstit të vetëm i cili iu nënshtrohet leximeve të ndryshme, nga sufitët dhe hanbelitët dhe modernistët. Fakti se suneti profetik është pjesë e jetës fetare dhe e botëkuptimit islam, pa të cilin ne nuk mund ta kuptojmë një pjesë të mirë të Kur'anit, mund të shihet si vërtetim i rëndësisë së leximit të shkrimit të shenjtë brenda përvojave konkrete të bashkësisë myslimane. Kjo është, në fakt, mënyra se si myslimanët e parë, të cilët u bënë shembuj shpirtërorë dhe moralë të brezave të mëvonshëm, mësuam mbi Kur'anin nën udhëzimin dhe mbikëqyrjen e të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem).¹⁶

Myslimanët dhe shtetet islame kurrë nuk do të jetë në gjendje për të marrë një pozicion si një ndikim po qe se nuk gjejnë rrugë për tejkallimin e mosmarrëveshjeve me popujt dhe të kthejnë të drejtat në vend të vet dhe të hapin rrugën për lirinë e mendimit dhe të lejojnë

¹⁴ Joseph R. Dominick. "Dinamika e komunikimit masiv Media në periudhën digjitale" UET Press, 2012. Tiranë. f.655.

¹⁵ Mark Juergensmeyer, "Terror in the Mind of God: The Global Rise of Religious Violence" (Berkeley and New York: University of California Press, 2000).

¹⁶ Ibrahim Kalin. "Islami, arsyeja dhe bota moderne", Logos-A, 2012, f.217-218.

pluralizmin brenda kuadrit të ligjit. Edhe në qoftë se kjo ndodh ajo ka nevojë të zbatohet me kujdes dhe kjo është një tjetër hap drejt rive-ndosjes së marrëdhënieve me fqinjët e saj, arabëve dhe myslimanëve.

Në jemi në epokën e blloqeve, pakteve dhe aleancave do të rezis-tojë globalizimit ushtarak ekonomik ose kulturor, veçse përmes një kuadri të integruar islamik.

وَالَّذِينَ كَفَرُوا بِعَصْمِهِمْ أَوْلِيَاءُ بَعْضٌ إِلَّا تَفْعَلُوهُ تَكُنْ فِتْنَةً فِي الْأَرْضِ وَفَسَادٌ كَبِيرٌ

“Ata që e mohuan të vërtetën janë miq të njëri-tjetrit. E nëse nuk e bëni atë (të ndihmoni e të kujdeseni për njëri-tjetrin), bëhet trazirë dhe rrëmuje e madhe në tokë”. (El Enfalë, 73)

Transmeton Thubani r.a. nga i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ves-selem): Popujt do të ftojnë njëri-tjetrin te ju ashtu sikurse që ju ftoni mysafirët tuaj për të ngrënë në enën me ushqim.” Ata thanë: “A do të jemi pak, o i Dërguar i Allahut?” Ai tha: “Jo, ju do të jeni shumë atë ditë, por ju do të jeni sikurse shkuma e detit. Allahu do ta heq frikën prej zemrave të armiqve tuaj dhe do të vendosë në zemrat tuaja el-vehn.” Ata thanë: “Çka është el-vehn, o i Dërguar i Allahut?” Ai tha: “Dashuria ndaj kësaj bote dhe urrejtja e vdekjes.” (Ebu Davudi)

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تَقَاتِهِ وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنتُمْ مُسْلِمُونَ ﴿١٠٢﴾

“O ju që besuat, kini frikë Allahun me sinqeritet të vërtetë dhe mos vdisni, pos vetëm duke qenë myslimanë (besimtarë)!” (Ali Imran, 102)

إِنَّ عِدَّةَ الشُّهُورِ عِنْدَ اللَّهِ اثْنَا عَشَرَ شَهْرًا فِي كِتَابِ اللَّهِ يَوْمَ خَلَقَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ مِنْهَا أَرْبَعَةٌ حُرُمٌ ذَلِكَ الدِّينُ الْقَيِّمُ فَلَا تَظْلِمُوا فِيهِنَّ أَنْفُسَكُمْ وَقَاتِلُوا الْمُشْرِكِينَ كَافَّةً كَمَا يُقَاتِلُونَكُمْ كَافَّةً وَاعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ مَعَ الْمُتَّقِينَ

Tek Allahu numri i muajve është dymbëdhjetë (sipas hënës), ashtu si është në librin e Allahut prej ditës kur krijoi qiejt dhe tokën. Prej tyre katër janë të shenjtë. Kjo është fe e drejtë. Pra, mos e ngarkoni (me mëkat) veten tuaj në ata (katër muaj). Luftoni të gjithë idhujtarët pa

dallim, siç ju luftojnë ata juve pa dallim, e dijeni se Allahu është me ata që ruhen prej (të këqijave)”. (Et-Tevbe, 36)

اسْتِكْبَارًا فِي الْأَرْضِ وَمَكْرُ السَّيِّئِ وَلَا يَحِيقُ الْمَكْرُ السَّيِّئِ إِلَّا بِأَهْلِهِ فَهَلْ يَنْظُرُونَ إِلَّا سُنَّتَ الْأَوَّلِينَ فَلَنْ تَجِدَ لِسُنَّتِ اللَّهِ تَبْدِيلًا وَلَنْ تَجِدَ لِسُنَّتِ اللَّهِ تَحْوِيلًا

“(Largim) Për shkak të mendjemadhësisë dhe dredhisë së keqe, por dredhia e keqe nuk godit tjetër vetëm ata që kurdisën. Pra, ata nuk janë duke pritur tjetër vetëm gjurmët e të parëve, e në ligjin e Allahut kurrë nuk do të hasësh devijim”. (Fatir, 43).

فِي بَضْعِ سِنِينَ لِلَّهِ الْأَمْرُ مِنْ قَبْلُ وَمِنْ بَعْدُ وَيَوْمَئِذٍ يَفْرَحُ الْمُؤْمِنُونَ

Brenda pak viteve. Çështja është vendim i Allahut, fillim e mbarim (për disfatë dhe për fitore). E atë ditë (kur do të ftojnë bizantinët) besimtarët do të gëzohen,” (Err-Rrum, 4)

وَمَا كَانَ قَوْلُهُمْ إِلَّا أَنْ قَالُوا رَبَّنَا اغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا وَإِسْرَافَنَا فِي أَمْرِنَا وَثَبِّتْ أَقْدَامَنَا وَانصُرْنَا عَلَى الْقَوْمِ الْكَافِرِينَ

Fjala e tyre nuk ishte tjetër pos vetëm të thoshin: **“Zoti ynë, na i falë mëkatet tona dhe lëshimet në punët tona dhe na forco në vendet tona (në luftë), ndihmona kundër popullit jobesimtar”!** (Ali Imran, 147).

Feja islame vazhdimisht qe nga dita e parë e shekuj me radhë ka qenë tolerante ndaj individëve me përkatësi tjetër qoftë fetare, kom-bëtare etj.

Tolerancë, a (lat. Tolerantia- durimi; sk. Toleranciaj; ang. Tolerante)- a) në politikë, në fe dhe në të folurit e përditshëm: durimi, lejmimi dhe pranimi i të drejtës së tjetrit, apo të tjerëve që të mendojnë, besojnë, vlerësojnë, veprojnë, etj sipas bindjes së tyre; bile edhe atëherë, kur mendimet, bindjet, veprimet e tyre janë në kundërshtim me mendimet, bindjet, veprimet e tyre janë në kundërshtim me mendimet, bindjet dhe interesat tona, tolerance supozon një relativizëm, sipas të cilit asgjë nuk mund të jetë absolutisht e drejtë, e vërtetë, e vlefshme, e mirë etj. Apo absolutisht e padrejtë, e pavërtetë, e pavlefshme, e ke-

qe etj. Së këndejmi, përjashtohet çdo ekskluzivitet dhe lejohet mundësia e koekzistencës ndërmjet mendimeve e besimeve e pikëpamjeve të ndryshme. Toleranca është supozim dhe parakusht domosdoshëm i humanitetit. Toleranca e njëmend është jo vetëm heqja e ekskluzivitetit, jo vetëm mosmarrja e masave ndëshkimore fizike, terrori shpirtëror etj., por edhe respektimi i atij që mendon, beson apo vepron ndryshe. Në mesjetë u kultivua një jotolerancë ndaj feve, besimeve, bindjeve, filozofive, zakoneve tjera që nuk përkonin me krishterimin. Shprehje drastike dhe brutale e kësaj jotolerance ishin themelimi i *Inkuizicionit* famëkeq dhe *Nata e Bartolemeut* (1572), me ç'rast u persekutuan shumë hugenotë. Në këtë kohë nuk toleroheshin jo vetëm fetë tjera, por as rrymat e sektet brendapërbrenda krishterimit. Të parët që në mënyrë të posaçme u angazhuan për një lloj tolerance në fushën e teorisë ishin *Avereosi* (*Ibn Ruzhd*, 1124-1198), *Siger Brabani* (1235-1281), *Duns Skoti* (1270-1308), *Viliem Okami* (1300-1350) etj. me teorinë e tyre mbi “*dy të vërtetat*” të barabarta, mbi “*të vërtetën e dyfishtë*”, atë teologjike dhe atë filozofike. Megjithëkëtë, koncepti “tolerancë” është i lidhur më së shumti me iluministët.

Nën ndikimin e ngjarjeve të përgjakshme ndërmjet katolikëve e hugenotëve, të proceseve gjyqësore të montuara për ata që ishin “fajtorë” vetëm e vetëm pse ishin të fesë apo sektit tjetër. Shumë mendimtarë të lirë e të ndershëm u angazhuan për tolerancën fetare, politike, filozofike etj. Në Francë u formua grupi i quajtur “*Politikanët*”, i cili u angazhua që shteti të ngrihet përmbi konfliktet fetare, divergjencat teorike-filozofike etj., dhe të gjithëve njësoj t’u sigurojë lirinë e mendimit e besimit. Në Angli *Xhon Loku* shkroi *Letrat për tolerancën* (*Letters on Tolerantien*, 1686-1692); Në Francë *Volteri* shkroi gjithashtu *Traktatin për tolerancën*, kurse në Gjermani kështu veproi *Lesingu*.

Çështja e tolerancës edhe sot e kësaj dite është shumë aktuale. Përkundër intolerancës bolshevike e staliniste që mbizotëroi në partinë komuniste dhe në vendet e ashtuquajturit “*realsocializmit*”, ku veprohej me frymën e *Sen Zhistit* (“nuk ka liri për armiqte e lirisë”),

Roza Luksemburg tha se liria është gjithmonë dhe vetëm e vetëm liria e atyre që mendojnë ndryshe.¹⁷

Mbi atë se si paraqitet dhe çfarë padrejtësie e terrori i bëhet islamit dhe myslimanit sot p.sh myslimanët e shtetit të Angolas janë duke përjetuar skenën më të dhimbshme të shkëljes flagrante të të drejtave elementare njerëzore dhe fetare. Institucionet shtetërore kanë shpallur fenë islame ilegale në territorin e saj dhe ka urdhëruar që të gjitha xhamitë që janë në këtë vend të mbyllen menjëherë. Ministrja i Kulturës, Rosa Cruz Silva, ka thënë se xhamitë në këtë vend të krishterë do të mbyllen deri në një vendim të radhës. Ajo e ka përshkruar islam si një “sekt” që do të ndalohet të futet në kulturën dhe traditën e Angolas. Ndërkohë burime tjera thonë se xhamitë në këtë vend afrikanë kanë filluar të shkatërrohen. Nga ana tjetër, edhe presidenti i vendit Jose Eduardo dos Santos, e ka përkrahur këtë vendim të ministritë. “Ky është fundi i ndikimit islam në vendin tonë”, ka thënë ai. Bota demokratike dhe fuqitë vendimmarrëse duhet menjëherë të reagojnë për ta ndalur këtë terror fetar e shpirtëror mbi pakicën myslimane në këtë vend.

Shekularizmi dhunues

Por, edhe në vendin tonë situata nuk paraqitet hiq e kënaqshme pasi që krerët institucionalë në çdo deklaratë të tyre “hyxhymin” e kanë te myslimanët dhe feja islame. Thuajse fajtorë për të pabëmat dhe dështimet politike e ekonomike të tyre i kanë popullata dhe vetë islamit. Sa për ilustrim ministri i Jashtëm Enver Hoxhaj, në një raport të tij të fundit “ndjen”: rrezikun nga “Ekstremizmi fetar rrezik për Kosovën”, siç e quan ai.

Rreziku kryesor për Kosovën, pas strukturave ilegale në veri, i cili mund ta cenojë vendin është ekstremizmi politik fetar. Kështu shkruan në një dokument të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës, i cili ditë më parë i është prezantuar edhe Komisionit për Punë të Jash-

¹⁷ Prof. Dr. Ekrem Murtezai “Fjalor i Filozofisë”, Agjencia e Autorëve e Kosovës, Instituti I Filozofisë dhe Sociologjisë, Prishtinë. Dukagjini, Pejë, 1995. f.828-829.

tme pranë Kuvendit të Kosovës, nga vetë ministri Enver Hoxhaj. Sipas së përditshmes “Zëri” në dokumentin të cilin e posedon gazeta “Zëri”, i emëruar: “Sfidat e sigurisë dhe rreziqet”, radhiten shqetësimet për problemet me të cilat mund të ballafaqohet Kosova në të ardhmen. Sipas kësaj letre, nuk ka perspektivë për ekstremizmin politik ose fetar në Kosovë, që të ketë sukses, pa ndihmën nga jashtë kufijtë e vendit. “Ne kërkojmë që të mbajmë marrëdhënie të mira me autoritetet që zbatojnë ligjin me fqinjët tanë të parë dhe me vendet tjera të brengosura për mundësinë e ekstremizmit politik ose fetar”, thuhet mes tjerash në këtë dokument. Detaje të kësaj strategjie, ministri i Punëve të Jashtme i ka paraqitur edhe në raportimin e tij para Komisionit për Punë të Jashtme në Kuvendin e Kosovës.

Ndërkohë që zyrtarët e kësaj ministrie bëjnë të ditur se nuk ka pasur asnjë reagim nga ky komision sa i përket këtij dokumenti. Këshilltari i ministrit Hoxhaj ka konfirmuar që kjo temë është përmendur në raportimin e fundit që ka pasur ministri te Komisioni për Punë të Jashtme, mirëpo, sipas tij, asnjë pyetje për tri orë rresht sa ka zgjatur raportimi nuk është parashtruar përkitazi me këtë çështje që MPJ e vlerëson mjaft të ndjeshme.”Ne jemi shumë të zhgënjyer me mosreagimin e kryetarit dhe anëtarëve të komisionit ndaj kësaj teme kaq përcaktuese për shtetin dhe politikën e jashtme të Kosovës”, ka thënë Artan Behrami nga MPJ. Sipas zyrtarëve të kësaj ministrie, kryesuesi i komisionit, Albin Kurti, gjatë tërë kohës është marrë me një gomë të shqyer të veturës së Ambasadës së Kosovës në Bullgari. “Këtu shihet se z. Kurti nuk e ka shumë shqetësim për ekstremizmin fetar në rritje. Ai më shumë është përkujdesur që Komisionin për Politikë të Jashtme ta shndërrojë në komision për politika partiake”, ka thënë Behrami.¹⁸

Te ne po zhvillohet një luftë e egër diplomatike karshi fesë islame dhe simboleve të saj. Kemi një sekularizëm dhunues karshi të drejtave më elementare të myslimanëve në këto troje. Nuk ka faj popullata e Kosovës, që sipas shifrave zyrtare, në Kosovë janë mbi 96% të përkatësishë islame.

¹⁸ 26.11.2013.

Ndonëse viteve të fundit është më i pazëshëm, rrëfimi i *shekullarizmit* ka një traditë të gjatë në sociologji. Auguste Comte (1798-1857), i cili e ka shpikur termin *sociologji*, ka pohuar se shoqëria ka kaluar nëpër faza “teologjike”, pastaj nëpër atë “metafizike” dhe, në fund, ka arritur në atë “shkencore”, madje këtë të fundit e ka cilësuar si fazë të fitores së arsyes mbi dogmën dhe si shmangie të mënyrës fetare të menduarit. Max Weber (1864-1920) e ka portretizuar jetën moderne si botë “të çmagjepsur”

Në Perëndim sekularizmi ka pozicionur fenë krishtere në një anë, duke i lënë më shumë hapësirë dekorative se qenësore në proceset dhe vendimmarrjet shtetërore.

Procesi i sekularizmit e ka edhe anën e vet subjektive. Pasi që kemi shekullarizim të shoqërisë dhe të kulturës, natyrisht se ekziston edhe sekularizmi i vetëdijes. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se Perëndimi modern ka prodhuar numër të madh të individëve që botën dhe jetën e tyre e shikojnë jashtë vatrës së interpretimeve fetare.¹⁹

Si konkluzion argumentet dhe faktet e bollshme mbështesin teorinë që redaksitë ndërkombëtare e medieve paraqet imazhe që nuk përputhen me realitetin e myslimanëve. Përveç historive policore, stereotipat kanë karakterizuar edhe përshkrimet për rolet gjinore, përshkrimin e punës, metodave e zgjidhjes së problemeve, portretizimin e shkencëtarëve apo përshkrimin e sëmundjeve mendore. Pra, kemi një invadim elektronik që vazhdimisht kërcënon kulturat e vendeve periferike dhe nxit një stil jetese prej konsumatori në kurriz të vlerave të komunitetit.

Pra këtë çështje, McPhail e quan “*kolonializëm elektronik*” që u referohet pabarazive në infrastrukturën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit, në hardware dhe në rolin e Korporatave Ndërkombëtare (Multinational Corporations) në këtë aspekt.²⁰

¹⁹ Meredith B. McGuire. “Religjioni konjeksti shoqëror”. Logos-A, 2007. f.447

²⁰ Mc Phail, T.L. “Electronic colonialism: the future of international broadcasting and communication”, Beverly Hills, C.A: Sage, 1981.

Mr. Rexhep Suma

ISLAM – A VICTIM OF MEDIA TERRORISM

(Summary)

The widespread diffusion of new technological innovations was incited by the increasingly liberalised free-market-orientated international environment of the post-Cold War order where the borders between East and West have withered away. In this competitive world with its revolving economic and communication giants, the globe has been transformed into a global electronic village and information has emerged as a primary commodity and resource (Madikiza & Bornman, 2007).

Terrorism is not an invention of the 20th century; in fact, it was used since antiquity by groups that had no respect for human rights.

رجب سوما

الاسلام – ضحية للارهاب الاعلامي

(خلاصة البحث)

ان انتشار الواسع للاختراعات التكنولوجية الحديثة و التي تمت باعاز من المجتمع الدولي تحت غطاء نحو التوجه الى التجارة الحرة و التي سيطرت و تسيطر على النظام الدولي الحالى ما بعد الحرب الباردة حيث نم اعادة الحدود بين الشرق و الغرب الى مواقع ثقة جغرافية . "ان فى هذا العالم المتنافس حيث تم ترك محل للآخر للشركات الكبرى و تلك التى فى مجال الاتصالات تحول العالم الى قرية الكترونية عالمية بحيث أصبحت المعلومات البضاعة و الوسيلة الاولى للعرض".

ان تاريخ الارهاب ليست بدعة للقرن العشرين بل تم ممارسته من قبل مجتمعات قديمة لم تحترم العدالة و كذلك حقوق الانسان.

Edhe pse në disa sektorë, roli i femrës nuk është në nivelin e kënaqshëm, megjithatë ajo vazhdon të kontribuojë fuqishëm në shoqëri, në politikë, në media dhe në biznes.

Parathënie

Për shkak të rëndësisë që Islami i jep femrës, e ka vlerësuar si shtylla e shoqërisë. Gruaja është gjysma e shoqërisë dhe ajo është edukatorja e pjesës tjetër të shoqërisë. Ajo është nëna, motra, gruaja, vajza dhe burimi i gëzimit e lumturisë në jetë.

Për rëndësinë që i ka dhënë Islami gruas dëshmon edhe fakti se një sure në Kuran është quajtur Kaptina e Gruas. Islami ka nderuar gruan dhe ia ka kthyer vendin që i takon në shoqëri, pasi që ka qenë e shtypur dhe pa vlerë në të gjitha periudhat para ardhjes së Profetit a.s.

Gratë kanë pasur një rol të rëndësishëm gjatë gjithë historisë së Islamit. Historia islame është përplot me shembuj të grave të fuqishme dhe të pavdekshme, që janë shembuj për gjithë shoqërinë.

Ashtu si edhe në shtetet e tjera islame, edhe në Arabinë Saudite gruaja ka pasur një rol aktiv e shumë të rëndësishëm në zhvillimin e vendit, që do të jetë temë e këtij punimi.

KAPITULLI I HYRJA

1.1. HYRJE

Femra ka një rëndësi të madhe në Islam, dhe ajo është vlerësuar si shtylla e shoqërisë myslimane. Islami është ai që ka nderuar gruan dhe ia ka kthyer vendin që i takon në shoqëri, pasi që ka qenë e shtypur dhe pa vlerë në të gjitha periudhat para ardhjes së Pejgamberit Muhamedit a.s.

Gratë kanë pasur një rol të rëndësishëm gjatë gjithë historisë së Islamit. Historia islame është përplot me shembuj të grave të fuqishme dhe të pavdekshme, që janë shembuj për gjithë shoqërinë.

HULUMTIME

Desarta Vathaj

POZITA E FEMRËS NË ARABINE SAUDITE*

Abstrakt

Femra ka një rëndësi të madhe në Islam, dhe ajo është vlerësuar si shtylla e shoqërisë myslimane. Gruaja është gjysma e shoqërisë dhe për rëndësinë që i ka dhënë Islami dëshmon edhe fakti se një sure në Kuran është quajtur Kaptina e Gruas (“Suretu en-Nisa”).

Para Islamit, gratë në Gadishullin Arabik trajtoheshin si skllave apo si pasuri. Pëlqimi i tyre personal, që kishte lidhje me mirëqenien, nuk kishte asnjë rëndësi dhe konsiderohej i panevojshëm.

Ardhja e Islamit solli ndryshime rrënjësore në shoqërinë arabe në përgjithësi, dhe për femrat në veçanti. Islami anuloi praktikën represive dhe mizore të bëra kundër femrave. Në rastet kur të drejtat e femrave u injoruan apo u anashkaluan, Islami i riktheu ato, dhe në rastet kur femrat gëzonin ndonjë shkallë të lirisë, Islami i rifuqizoi ato.

Roli i femrës saudite është gjithnjë e më shumë në rritje. Ajo ka potencial të madh në bërjen e dallimeve të mëdha në shoqëri. Ajo është e gatshme të kontribuojë në progresin më të madh të vendit.

* Kjo temë diplome e përgatitur nga studentja Desara Vathaj nën mbikëqyrjen e Mr. Sadik Mehmetit, është mbrojtur në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, më 15 janar 2014.

Ashtu si edhe në shtetet e tjera islame, edhe në Arabinë Saudite gruaja ka pasur një rol aktiv e shumë të rëndësishëm në zhvillimin e vendit. Megjithatë, pozita e gruas në shoqërinë islame në përgjithësi dhe shoqërinë saudite në veçanti, është çështje komplekse dhe është keqkuptuar. Midis Perëndimit e Lindjes ekzistojnë dallime kulturore dhe stereotipa për femrën myslimane, që e konsiderojnë si të paedukuar, pa të drejta dhe pa mundësi.

Pasi që Arabia Saudite është një shtet islam, shpesh njerëzit e shoqërojnë “shtypjen e gruas” me Islamin. Ndërsa, mediat perëndimore i bëjnë bujë stereotipit të gruas si të paedukuar, pa të drejtë për të votuar, e pa aftë për të shkuar kudo pa “mahramin” (të afërmin mashkull), dhe e detyruar të veshë nikabin.

1.2. PËRSHKRIMI I PROBLEMIT

Në temën time do të mundohem të trajtojë problemet në vijim:

- i. Analiza e pozitës së femrës në shoqërinë islame;
- ii. Analiza e pozitës së femrës në Mbretërinë e Arabisë Saudite;
- iii. Analiza e politikave që përdor shteti saudit për promovimin e pozitës së femrës;
- iv. Analiza krahasuese me efektet e këtyre politikave për rritjen e aktiviteteve dhe veprimtarisë së femrës në shoqërinë saudite;
- v. Nxjerrja e konkluzioneve dhe rekomandimeve për pozitën e femrës saudite.

1.3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Ky punim është përpjekjet që përmes të analizimit të të dhënave të ndryshme, t’i jepet kontribut temës që diskutohet. Për punimin e kësaj teme do të përdorë metodën historike, metodën analitike, dhe atë krahasuese.

Përmes metodës historike, do të gjurmojë dhe do të promovojmë rezultatet e kërkimeve tona lidhur me pozitën e femrës në Arabinë Saudite.

Përmes metodës së analizës do të mundohemi të zbërthejmë gjykimet e konkluzionet e dhëna për pozitën e femrës saudite në elemente më të thjeshte, si dhe pjesë që kanë lidhshmëri me njëra tjetrën.

Gjatë punimit, do të përdor edhe metodën krahasuese (komparative). Përmes kësaj metode do të mundohem të peshojë elementet krahasuese, veçoritë e përbashkëta ose diferencat të pozitës së femrës para dhe pas ardhjes së Islamit. Me anë të kësaj metode, do të arrijmë deri në konkluzione të ndryshme që kanë të bëjnë me pozitën e gruas saudite.

Ky punim do të ketë rëndësi shkencore dhe praktike për rëndësinë që kanë gratë në shoqërinë islame në përgjithësi, dhe në shoqërinë saudite në veçanti.

Së pari, punimi do të flasë për rëndësinë që gruaja ka në shoqërinë islame.

Së dyti, punimi do të flasë për rolin dhe rëndësinë që kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë femrat në ndërtimin e shtetit modern saudit.

KAPITULLI II FEMRA SAUDITE PARA ARDHJES SË ISLAMIT

2.1. HYRJE

Para Islamit, Gadishulli Arabik kishte një shoqëri patriarkale, ku qëllimi i vetëm i gruas ishte t’i shërbente burrit. Në fakt, rëndësi të madhe kishte lindja e trashëgimtarëve meshkuj që do të përjetësonin superioritetin e tyre.

Nga këtu, statusi i gruas në Islam mund të kuptohet në mënyrë të duhur vetëm kur të kuptohet statusi i tyre para ardhjes së Islamit, apo periudhës që njihet si periudha e injorancës - xhahilitetit. Arsyeja për këtë është e qartë se asnjë revolucion, qoftë politik apo fetar, nuk mund të largojë të gjitha gjurmët e së kaluarës. Vazhdimësia është gjithmonë prezente dhe gjithmonë ka lidhje organike me të kaluarën¹.

¹ Asghar Ali Engineer: The Rights of Women in Islam, fq. 20.

Para Islamit, gratë në Gadishullin Arabik trajtoheshin si skllave apo pasuri. Pëlqimi i tyre personal që kishte lidhje me mirëqenien e tyre nuk kishte asnjë rëndësi dhe konsiderohej i panevojshëm. Madje, ato nuk trajtoheshin as palë në kontratën e martesës.

Gratë nuk kishin asnjë pavarësi, nuk mund të posedonin pasuri dhe nuk lejoheshin të trashëgonin. Ndërsa, gjatë luftërave, gratë trajtoheshin si pjesë e plaçkës.

Shoqëria arabe para ardhjes së Islamit ishte shumë e diversifikuar. Gadishulli Arabik përbëhej nga komunitete diverse me zakone, gjuhë dhe mënyrë jetese të ndryshme. Dallimi në normat sociale e kulturore nga vendi në vend ndikonte edhe në dallimet në të drejtat e gruas. Shoqëria arabe në këtë periudhë kishte kushte të veçanta sociale dhe politike që rrjedhin nga mjedisi, që kishte ndikim të madh në jetët e grave.

2.2. STATUSI LIGJOR I FEMRËS

Shoqëria e Gadishullit Arabik para ardhjes së Islamit ishte shoqëri fisnore. Fisi ishte njësia kryesore e shoqërisë, që i lidhte të afërmit. Nuk mund të kuptohet pozita e femrës para Islamit pa kuptimin e sistemit fisnor. Ishte struktura dhe zakonet fisnore që kishin ndikimin më të madh mbi të drejtat e femrave.

Çdo fis përbëhej nga qindra klane, që kishin shumë individë dhe paraqiste një grumbull tendash. Çdo tendë paraqiste një familje. Lidhja e gjakut që i lidhte të gjithë anëtarët e një fisi, i nënshtrohej autoritetit të liderit të fisit, apo "sheikhut". Lideri i fisit zgjidhej nga udhëheqësit e klaneve nga familjet më të njohura dhe vepronin si gjykatës për të zgjidhur konfliktet e brendshme². Solidariteti grupor apo siç njihet "asabijah" ishte shpirti i fisit. Ai paraqiste besnikërinë nga pjesëtarëve të fisit, që ishte shumë e rëndësishme.

Fisi në vetvete ishte njësi në vetvete dhe e konsideronte çdo fis tjetër si armik, përveçse nëse kishin aleanca për të mbrojtur njëri tjetrin. Nuk kishte infrastrukturë të centralizuar për të mbrojtur njerëzit

² Philip Hitti, History of the Arabs; fq. 24.

apo pasurinë e tyre. Në përpjekje për të mbijetuar, çdo individ duhej të bashkohej me një fis.

Në këtë shoqëri, burri dominonte mbi gruan. Femrat trajtoheshin si skllave dhe ishin në mëshirën e burrit. Ato nuk konsideroheshin qenie njerëzore dhe gati se nuk kishin asnjë të drejtë. Femrat nuk patën asnjë rol në aspektin fetar të jetës para islamit. Thuhet se gratë nuk trajtoheshin ndryshe nga bagëtitë³.

Femrat nuk mund të merrnin vendimet që i dëshironin dhe kishin pak kontroll në martesat e veta. Ato kurrë nuk lidhnin kontratë martesore dhe nuk ju jepej kujdestaria e fëmijëve dhe kurrë nuk merrej pëlqimi i tyre për asnjë çështje. Mendimi i tyre nuk merrej as për martesë e as për divorc.

Nuk gëzonin të drejtat e tyre bazike. Femrat nuk mund të kishin pasuri apo të trashëgonin atë, madje edhe nëse përballeshin me varfëri apo me kushte të vështira jetese. Thjesht ato trajtoheshin si pasuri të burrave. Ato mund të trashëgoreshin apo të lëviznin nga një shtëpi te tjera varësisht nga dëshirat dhe nevojat e bashkëshortit apo familjes së tij.

Në rast se i vdiste bashkëshorti, djali i tij nga martesa e mëparshme mund ta merrte si grua nëse e dëshironte. Gruaja nuk kishte në këto çështje asnjë zgjidhje, përveçse nëse mund të paguante për lirinë e saj, që ishte në shumicën e rasteve e pamundur.

Edhe pse shumica e grave në Gadishullin Arabik të kësaj kohe nuk gëzonte shumicën e të drejtave, kishte një grup të femrave të klasit të lartë që i gëzonin. Ato jo vetëm që martoheshin për para, por shumë u bënë klerike që i jepnin më shumë të drejta. Këto femra mund të posedonin pasuri dhe madje të trashëgonin.

Në fund të shekullit të VII e.s., gratë u pranuan si qenie njerëzore⁴. Megjithatë, kjo nuk pati ndonjë ndikim të madh në statusin e femrës në Gadishullin Arabik. Ato u pranuan si qenie njerëzore me të vetmin qëllim për t'i shërbyer njeriut (burrit). Ato u konsideruan si qenie nje-

³ Usmani, Mufti. "The Miserable Condition of Women Before Islam".

⁴ Mouhamadou, Shaykh. "Women in Islam". Noor Ala Noor.

rëzore, por nuk iu dhanë të njëjta të drejtat si meshkujve dhe nuk kishin të njëjtin trajtim. Në fakt, lindja e vajzave konsiderohej ogur i keq dhe mendohej se i sjellin turpërim familjes.

2.3. PRAKTIKAT MARTESORE

Në shoqërinë para ardhjes së Islamit, fisi ishte entiteti kryesor dhe fokusi i shqetësimeve. Burrat, si pjesë e fisit, punon shumë për jetesë dhe mbështesnin fisin e tyre duke i siguruar gjithë fuqinë që kishte nevojë. Martesa, në shumicën e rasteve, synonte rritjen e numrit të anëtarëve të fisit, dhe si rrjedhojë fuqinë e tij.

Për shkak të rolit të fisit dhe traditave, martesa ishte fleksibile dhe nuk kishte rregullta strikte. Bazuar në ajetet kur'anore dhe hadithet e të Dërguarit a.s., do të përmendim në vijim disa nga praktikat kryesore të martesës⁵:

Martesa me marrëveshje: ishte zakonisht marrëveshje midis burrit dhe familjes së gruas. Nëse burri i takonte një fisi tjetër, gruaja shpesh linte familjen e saj dhe gjente një shtëpi të përhershme te fisi i burrit. Fisi, ku martohej gruaja, mbante fëmijët e saj, dhe ata konsideroheshin si pjesë e fisit.

Në disa fise të tjera, ishte zakon që gruaja nuk linte fisin e vet, por ose martohej me dikë brenda fisit ose martohej me një të huaj që pajtohej të qëndronte te familja e saj. Në këtë rast, fëmijët i takonin fisit të nënës dhe rriteshin në mbrojtjen e tij. Gruaja në këto fise gëzonte më shumë liri dhe kishte të drejtën të dëbonte burrin sipas dëshirës.

Martesa me pushtim: ishte praktikë universale para ardhjes së Islamit. Gjatë luftërave, femrat kapeshin rob dhe shiteshin në tregjet e skllevërve. Në këtë martesë, gruaja pasonte burrin dhe fëmijët që lindte i takonin atij. Gruaja bëhej pronë e burrit dhe humbte plotësisht lirinë e saj. Burri kishte autoritet absolut mbi të, duke përfshirë edhe të drejtën për divorc.

Martesa me blerje: Në këtë martesë, familja e shiste femrën për një çmim, që zakonisht përfshinte deve dhe kuaj. Kjo mënyrë zëve-

ndësonte martesën me pushtim, kur fiset fillonin të zhvillonin marrëdhëniet miqësore. Por, në praktikë, gruaja ishte në gjendje shumë të vështirë, e njëjtë si martesa e mëparshme. Shfaqja e kësaj lloji martese kontribuoi më pas edhe në rënien e vrasjes së femrave.

Martesa me trashëgim: ishte traditë shumë e përhapur në gjithë Gadishullin Arabik. Sipas kësaj tradite, trashëgimtari i të vdekurit trashëgonte bashkëshorten e tij. Pastaj, atë mund ta mbante si grua, apo të hiqte dorë nga martesa për pajë apo ta ndalonte edhe rimartesa. Të drejtat martesore ishin të drejta të pasurisë, të cilat mund pastaj të trashëgoheshin dhe të shiteshin. Kjo lloji martese është shfuqizuar pas ardhjes së Islamit.

Martesa e përkohshme ("Mut'a"): ishte kontratë personale e themeluar në pajtimin midis burrit e gruas pa ndërmjetësimin e familjes së gruas. Nuk kishte nevojë për dëshmitarë. Në këtë lloji martese, gruaja nuk linte shtëpinë e saj, njerëzit e saj hiqnin dorë nga të drejtat që kishin mbi të, dhe fëmijët e martesës nuk i takonin burrit, e as nuk kishin të drejtë në trashëgimi. Kjo lloji martese praktikohet kryesisht nga të huajt dhe udhëtarët, dhe në këmbim të një çmimi që paguhej nga burri te gruaja. Për shkak të këtij çmimi, gruaja nuk mund ta largonte burrin për një periudhë të caktuar kohore për të cilën ishin pajtuar për martesë.

Përveç këtyre, ka pasur edhe shumë forma të tjera të martesës gjatë periudhës para-islamike. Por, ajo që e dallon martesën islame nga praktikat para-islamike është se Islami e njeh femrën si entitet njerëzor me të drejtat e veta. Me këtë, martesa u bë kontratë midis femrës e mashkullit, që ajo e zgjidhte, dhe mehri u bë dhuratë për të në vend të babait të saj.

2.4. STRUKTURA FAMILJARE

Struktura familjare në Gadishullin Arabik para Islamit është shumë e paqartë dhe është e vështirë të dihet struktura e saktë e familjes gjatë asaj kohe. Mendohet se struktura familjare në shoqërinë arabe

⁵ fq. 34 سامية منيسي: محمد صلي الله عليه وسلم و المراه

para-islamike ka qenë patriarkale dhe marrëdhëniet në familje ishin pjesë e marrëdhënieve të tjera me meshkujt.

Ishte vitale për familjet që të kishin djem në vend të vajzave, pasi konsideroheshin më superiorë. Brenda familjes, femra nuk kishte asnjë të drejtë prindërore ndaj fëmijëve të tyre madje edhe në rast të vdekjes së babait, dhe gruaja nuk kishte asnjë të drejtë të trashëgimisë.

Gjatë kësaj periudhe, shkalla e mortalitetit të fëmijëve ishte e lartë dhe ishte e zakonshme që prindërit të humbnin fëmijë gjatë lindjes apo fëmijërisë për shkak të sëmundjeve të përhapura në atë kohë. Në rast se fëmija mbijetonte, komuniteti do të bënte një festë në nderim të mbijetesës së fëmijës, kur do të emëronin fëmijën apo do të prenin kurban në nderim të lindjes së fëmijës.

Gjatë kësaj periudhe, ishte shumë e rëndësishme që femrat të lindnin sa më shumë trashëgimtarë meshkuj, pasi që konsideroheshin superiorë dhe si komponenti më fundamental që ishte në gjendje të luftonte në kushtet e vështira të shkretëtirës⁶.

Planifikimi familjar ishte shumë i rëndësishëm, por kjo nuk zbatohej për secilin. Njerëzit ishin të shqetësuar me rrethanat që mund të kishin ndikim mbi familjen apo komunitetin e tyre. Procesi i planifikimit të strukturës familjare ishte reciprok midis bashkëshortit dhe gruas. Një aspekt i rëndësishëm i strukturës familjare ishte përcaktimi i numrit të fëmijëve që duhej të kishte nëna, dhe sigurimi që shëndeti i nënës dhe fëmijëve të mos rrezikohej.

2.5. VRASJA E FEMRAVE

Shoqëria arabe para Islamit ishte shoqëri pa rregulla, përveçse të fortit dominonin të dobët. Është e arsyeshme të pritet që produkt natyral i një shoqërie të tillë të ishte shtypja e femrës.

Një praktikë johumane e kësaj shoqërie ishte edhe vrasja e femrave⁷. Kjo praktikohesh nga prindërit, të cilët nuk vlerësonin vajzat e tyre

ashtu siç vlerësonin djemtë. Foshnjat femra varroseshin të gjalla në momentin që lindnin. Ato vriteshin për të shmangur turpin që mund t'i shkaktonin familjes dhe fisit.

KAPITULLI III FEMRA SAUDITE PAS ARDHJES SË ISLAMIT

3.1. HYRJE

Ardhja e Islamit solli ndryshime rrënjësore në shoqërinë arabe në përgjithësi, dhe për femrat në veçanti. Islami anuloi praktikën represive dhe mizore të bëra kundër femrave. Në rastet kur të drejtat e femrave u injoruan apo u anashkaluan, Islami i riktheu ato, dhe në rastet kur femrat gëzonin ndonjë shkallë të lirisë, Islami i rifuqizoi ato.

Mësimet islame theksuan faktin se parimet e përgjithshme të barazisë, lirisë, pavarësisë dhe të drejtave të njeriut nuk duhet kufizuar apo definuar nga normat sociale e kulturore, por ato caktohen nga Allahu. Qëllimi primar i sheriatit është të vendosë drejtësinë në tokë, të eliminojë padrejtësinë dhe të mbrojë të drejtat njerëzore të gjithë anëtarëve të shoqërisë, pavarësisht gjinisë, racës apo fesë së tyre. Në këtë mënyrë, Islami kërkon që të sigurojë të drejtat jo vetëm të femrave, por gjithashtu edhe të minoriteteve të tjera që i nënshtroheshin trajtimit abuziv të asaj kohe⁸.

Dispozitat islame ishte revolucion i vërtetë lidhur me të drejtat e femrave. Islami ngriti statusin e femrës në nivelin e barabartë me mashkullin dhe siguroi të drejtat legjitime të femrave nga të cilat ishin privuar për shekuj, jo vetëm në Gadishullin Arabik, por në gjithë botën.

Të drejtat e femrave të rregulluara në Kuran, megjithëse progresive në esencën dhe përmbajtjen e tyre, ishin të kufizuara në fushëveprimin dhe zbatimin e tyre për t'iu përshtatur shoqërisë njerëzore në të cilën kishte zbritur mesazhi hyjnor.

⁶ Nihal, Sahin. "Arabia in the Pre-Islamic Period"

⁷ حقوق المرأة في ضوء السنة : د. نوال بنت عبد العزيز العيد, ف. 40

⁸ Dr. Abdul-Rahman Al-Sheha: Women in Islam & Refutation of some Common Misconceptions, fq. 32.

Në shumicën e fiseve të Gadishullit Arabik para ardhjes së Islamit, femrat ishin të privuara nga të drejtat e tyre bazike, si e drejta për të zgjedhur burrin, e drejta për divorc dhe për të trashëguar nga familja e tyre. Në disa fise të tjera, pozita e tyre ishte më e mirë. Ato mund të martoheshin e divorcoheshin me dëshirë, mund të kishin pasuri dhe të përfshiheshin në tregti. Ajo që diktonte statusin e gruas, ishin traditat e zakonet fisnore⁹.

Në mungesë të një qeverie qendrore, fisi shërbente si autoriteti më i lartë ligjor. Si lidhja supreme e tokës, lidhja fisnore mbizotëronte ndaj të tjerave.

Ardhja e Islamit ndryshoi fokusin nga fisi te individi, balancoi konceptin e komunitetit dhe familjes, dhe institucionalizoi një sistem në të cilin të gjithë ishin të barabartë, pavarësisht gjinisë, racës, moshës apo pasurisë. Në Islam, ishin parimet morale e fetare, e jo përkatësitë fisnore, që definonin të drejtat e gruas. Islami pranoi femrën si qenie të lirë njerëzore me të drejtat e plota. Me liri duhet të vinë përgjegjësitë dhe obligimet.


Islami përmirësoi kushtet e të gjitha femrave, pavarësisht se cilit fis i takonin. Ai ktheu dinjitetin e femrës dhe ngriti statusin e saj në tërësi, që të jetë e barabartë me mashkullin.

3.2. BARAZIMI I FEMRAVE E MESHKUJVE

Në një kuptim, barazia midis mashkullit e femrës është e mundur dhe e arsyeshme, pasi që të dy janë qenie njerëzore. Ndërsa, në kuptimin tjetër, barazia midis mashkullit e femrës është e pamundur dhe absurditet për shkak të dallimeve të tyre natyrore në aspektin fizik, mendor, emocional e psikologjik.

Nëse barazia midis të gjithë pjesëtarëve të një gjinie është e pamundur për shkak të dallimeve natyrore në fuqi dhe në cilësitë e tjera, pavarësisht nëse i takojnë gjinisë mashkullore apo femërore, atëherë është definitivisht e pamundur midis dy gjinive. All-llahu xh.sh. ka thënë:

⁹ مَكَانَةُ الْمَرْأَةِ فِي الْإِسْلَامِ: ذَاكِرُ اللَّهِ أَبُو الْخَيْرِ: fq. 46.



“Dhe Ne krijuam prej çdo sendi dy lloje (mashkull e femër) që ju të përkujtoni (madhësitinë e Zotit)”. (51:49).

Është e natyrshme për një mashkull që të ketë nevojë dhe të gjen prehjen te një femër, dhe për një femër me një mashkull, pasi që ata janë krijuar nga njëri tjetër dhe për njëri tjetrin. Të dytë, janë të lidhur pandashmërisht me njëri tjetrin dhe për këtë asnjëherë nuk mund të gjejnë plotësimin përveçse kur janë në shoqëri me njëri tjetrin.

Në shumë raste, Islami e trajton femrën të barabartë me mashkullin. Disa prej tyre janë përmendur në vijim¹⁰:

1. Meshkujt e femrat janë të babait sa i përket humanitetit të tyre;
2. Obligimet dhe rituale të barabarta fetare janë kërkuar si nga femra, ashtu edhe nga mashkulli. Thënia e shehadetit, namazi, zekati, agjërimi dhe haxhi janë njësoj të kërkuara nga të dytë. Në disa raste, kërkesat janë pak më të lehta për femra për të lehtësuar rastet e vështirësive të tyre;
3. Të dytë, si mashkulli e femra, kanë shpërblime të ngjashme për bindje dhe ndëshkime për mosbindje në këtë botë dhe në botën tjetër;
4. Femrat janë njësoj të kualifikuara dhe të lejuara të përfshihen në transaksionet financiare dhe zotërimin e pasurisë;
5. Islami i ka dhënë femrave të njëjta të drejta si mashkullit sa i përket edukimit dhe kultivimit.

Një nga shenjat më të mëdha të Dashurisë, Mëshirës e Fuqisë së All-llahut xh.sh. është se krijoi për njerëzimin çifte, njërin nga tjetri, në mënyrë që të gjejnë prehje, të jenë të kënaqur dhe të ndihmohen nga njëri tjetri.

¹⁰ Anwar Hekmat: Women and the Koran: The Status of Women in Islam, fq. 34.

وَمِنْ آيَاتِهِ أَنْ خَلَقَ لَكُمْ مِنْ أَنْفُسِكُمْ أَزْوَاجًا لِتَسْكُنُوا إِلَيْهَا
وَجَعَلَ بَيْنَكُمْ مَوَدَّةً وَرَحْمَةً إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِقَوْمٍ
يَتَفَكَّرُونَ ﴿٣١﴾

“Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje te ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë”. (30:21)

Themeli i shoqërisë është familja. Burri e gruaja janë bashkëpartnerë në atë familje, mbi të cilën ngritet shtëpia myslimane. Për suksesin e familjes dhe qetësinë e shtëpisë, Islami u ka dhënë të drejtat dhe obligime të caktuara të dy bashkëshortëve, disa prej të cilave do t'i theksojmë në vijim¹¹:

Mehri: është e drejta e çdo nuse në kohën e martesës. Kontrata martesore nuk konsiderohet ligjore dhe complete derisa të specifikohet mehri. Kjo e drejtë nuk mund të bie, edhe në rast se miratohet nga nusja, deri të kompletet marrëveshja martesore. Mehri i takon gruas që hyn në martesë, dhe ajo ka të drejtën të bëjë çfarëdo që dëshiron me atë që posedon pas përmbushjes së kontratës së martesës.

Mbështetja financiare: Bashkëshorti duhet t'i jap mbështetje të mjaftueshme gruas së tij, në përputhje me mundësitë e tij.

Drejtësia dhe barazia: Meshkujt që janë të martuar me më shumë se një grua duhet të veprojnë me drejtësi dhe barazi me to. Kjo përfshinë sigurimin e veshmbathjes, shtëpisë dhe ndarjen e kohës së tij me to.

Kujdesi dhe marrëdhëniet seksuale: Bashkëshorti duhet të jetojë me gruan e tij në ndershmëri dhe duke e respektuar. Ai duhet të mirëmbajë një pamje modeste, të pastër dhe të pranueshme kur pushon në shtëpinë e tij, ashtu siç e dëshiron për gruan e tij.

3.4. FEMRAT SI NËNA

Të drejtat e prindërve në Islam kanë rëndësi të madhe dhe janë të vendosura para të tjerëve, përveç All-llahut xh.sh. Bindjes ndaj prindërve duhet dhënë prioritet mbi të tjerat, duke përfshirë edhe bashkëshorten. Kjo nuk nënkupton që gruaja duhet të poshtërohet në ndonjë çështje, por vetëm që prindërve duhet dhënë prioritet në bindje para të tjerëve me kusht që nuk i binden All-llahut xh.sh. dhe të Dërguarit të Tij a.s.

All-llahu xh.sh., në mënyrë të përsëritur ka theksuar të drejtën e prindërve në përgjithësi, dhe të nënës në veçanti. All-llahu xh.sh. thotë:

﴿وَقَضَىٰ رَبُّكَ أَلَّا تَعْبُدُوا إِلَّا إِيَّاهُ وَيَالِ الَّذِينَ إِحْسَنًا إِمَّا يَبْلُغَنَّ
عِنْدَكَ الْكَبَرُ أَحَدُهُمَا أَوْ كِلَاهُمَا فَلَا تَقُلْ لَهُمَا أَمْرًا فِى وَلَا
نَهْرَهُمَا وَقُلْ لَهُمَا قَوْلًا كَرِيمًا ﴿١٢﴾﴾

“Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as “of - oh”, as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre, po atyre thuaju fjalë të mira (të buta respektuese)”. (17:23)

Kënaqësia apo pakënaqësia e Zotit me njeriun nuk është vetëmse se indikacion i kënaqësisë së prindërve me fëmijën e tyre. Prindërit duhet të respektohen, të binden dhe t'u ofrohen ndihma financiare nga fëmijët e tyre, madje edhe kanë fe apo besim tjetër nga Islami, për sa kohë që nuk kërkojnë që fëmija i tyre të veprojë diçka që nuk është pajtim me normat e Islamit.

¹¹ Dr. Abdul-Rahman Al-Sheha: Women in Islam & Refutation of some Common Misperceptions, fq. 42.

3.5. FEMRAT SI TË AFËRME

E afërmja, qoftë teze, kushërirë apo çfarëdo e afërme tjetër qoftë pavarësisht distancës, është e përfshirë në akraballëkun ndaj të cilëve All-llahu xh.sh. ka kërkuar që të jemi të mirë, të sjellshëm dhe t'i mbështesin. All-llahu xh.sh. ka thënë:

فَهَلْ عَسَيْتُمْ إِنْ تَوَلَّيْتُمْ أَنْ تُفْسِدُوا فِي الْأَرْضِ وَتَقَطَّعُوا
أَرْحَامَكُمْ ﴿٢٢﴾

“A pritet prej jush (hipokritëve) që në nëse merrni sundimin (ose zbrapseni prej fesë islame) të bëni trazira në tokë dhe të ndërpreni lidhjet e akraballëkut?” (47:22)

Ndërsa, Muhamedi a.s. ka thënë: “Personi që i ndërpret lidhjet me të afërmit, kurrë nuk do të hyjë në Xhenet”. (Muslimi).

Islami i obligon myslimanët që të jenë të mirë me të gjithë fqinjët e tij.

Muhamedi a.s. ka thënë: “Xhibrili ka vazhduar të më rekomandojë që të kujdesem për fqinjin aq shumë, sa që kam menduar se do të ketë pjesë në trashëgimi”. (Buhariu)

Ka shumë aspekte të nderimit, respektimit, kujdesit dhe mbështetjes së femrës sipas mësimave islame që përmbledhin të drejtat e femrave. Këtë shkallë respekti e nderimi nuk do ta ketë kurrë gruaja gjatë gjithë historisë së njerëzimit në tokë. Është e dëshmuar se ligji islamik kurrë nuk ka toleruar krime apo abuzime kundër ndonjë femra në çfarëdo faze të jetës së saj.

3.6. KEQKUPTIMET PËR GRUAN NË ISLAM

Ka disa keqkuptime që janë propaganduar gjerësisht rreth femrës dhe të drejtave të tyre në Islam. Këto keqinterpretime shpesh janë përsëritur nga disa që dëshirojnë të diskreditojnë Islamin dhe myslimanët. Femrat gjatë gjithë shekujve që nga ardhja e Islamit kanë qenë të

nderuara e të respektuara. Krimet e disave që kanë devijuar nuk reflektojnë parimet dhe ligjet mbi të cilat është i bazuar Islami. Në vijim¹², do të japim disa përgjigje për keqinterpretime kryesore lidhur me të drejtat e femrës në Islam dhe pozitës e femrës në islam në përgjithësi.

3.6.1 Poligamia

Poligamia, apo martesë me më shumë se një grua në të njëjtën kohë, është praktikë e vjetër sa edhe vet njeriut. Kjo praktikë është e lejuar në ligjin islam. Poligamia ka qenë e njohur në mesin e fiseve arabe edhe para ardhjes së Islamit, por nuk kishte kufizim në numrin e grave.

Me ardhjen e Islamit, ligji islam e lejoi poligaminë, por e kufizoi me vetëm katër gra dhe me rregulla specifike që rregullojnë këto martesë.

Ka shumë shembuj, kur i Dërguari a.s. ka obliguar ata që kishin më shumë se katër gra, kur pranuan Islamin, që të zgjidhnin katër dhe të divorconin të tjerat në mënyrë të ndershme.

All-llahu xh.sh. thotë:

وَإِنْ خِفْتُمْ أَلَّا تُقْسِطُوا فِي الْيَمَنِ فَانْكِحُوا مَا طَابَ لَكُمْ مِنَ النِّسَاءِ مَثْنَىٰ
وَأُولَئِكَ وَرَبِّعٌ فَإِنْ خِفْتُمْ أَلَّا تَعْدِلُوا فَوَاحِدَةً أَوْ مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُكُمْ ذَلِكَ آدَبُ
الَّذِينَ لَا تَعُولُوا ﴿٢٠﴾

“Në qoftë se frikoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj bonjakeve, atëherë martohuni me ato gra që ju pëlqejnë; me dy, me tri e me katra. E nëse i frikoheni padrejtësisë (ndaj tyre), atëherë vetëm me një, ose (martohuni) me ato që i keni nën pushtetin tuaj (robërshat). Ky (përkufizim) është më afër që të mos gaboni”. (4:3)

Në këtë mënyrë, shohim se drejtësia strikte në trajtim, dhe shmangia e çfarëdo padrejtësie dhe praktikave të gabuara kundër grave,

¹² Dr. Abdul-Rahman Al-Sheha: Women in Islam & Refutation of some Common Misperceptions, fq. 57.

është e përcaktuar dhe e kushtëzuar për ata që dëshirojnë të marrin më shumë se një grua.

Burri impotent nuk duhet të kërkojë martesë, pasi që është i paaftë të plotësojë kërkesat e bazike të gruas. Ai që e din sigurt se është i paaftë financiarisht të mbështesë një grua tjetër dhe familjen, nuk lejohet të kërkojë martesë tjetër.

3.6.2. Fuqia në martesë

Nëse një grua detyrohet të pranojë një martesë të padëshiruar, ajo duhet të prezantojë rastin e saj te gjykatësi mysliman për të kërkuar anulimin e saj. Është i njohur rasti i al-Khansa bint Khadam, e cila ishte e martuar më parë (dhe ishte divorcuar), që erdhi dhe u ankua te i Dërguari a.s. se babai i saj e kishte detyruar të martohej me një person që e përçmonte. Ai nuk e miratoi dhe e shpalli të pavlefshme.

Në jurisprudencën islame, një kusht për një martesë të shëndoshë është pajtimi i plotë i gruas që është pjesë e saj. Muhamedi a.s. ka thënë:

“E veja nuk duhet të martohet derisa të pyetet, dhe të japë miratimin e saj. Dhe virgjëresha nuk duhet të martohet derisa të konsultohet”. Më pas është pyetur: “O i Dërguari i All-llahut, si është leja e saj?” Ai tha: “Nëse heshtë”.

3.6.3 E drejta për divorc

Në periudhën para islamike, divorci ishte armë që përdorej kundër gruas dhe ishte vetëm në duart e burrit. Kurdo që dëshironte të dëmtonte gruan, e divorconte dhe pastaj e kthente ashtu siç dëshironte. Nuk kishte rregulla të vendosura dhe gruaja nuk kishte asnjë të drejtë në këtë çështje. Për këtë, All-llahu xh.sh. e anuloi këtë padrejtësi, duke shpallur ajetin vijues:

الطَّلُقُ مَرَّتَانٍ فَإِمْسَاكُ مَعْرُوفٍ أَوْ تَسْرِيحُ بِإِحْسَنِ

“**Lëshimi** (pas së cilit mund të bëhet rikthimi) është dy herë, e (pastaj) ose jetë e njerëzishme (bashkëshortore) ose shkurorëzim me mirëkuptim” (El-Bekare: 229)

Divorci në Islam është i lejuar si zgjidhje e fundit për t'i ikur çfarëdo dëmtimi që shkaktohet nga dallimet kontradiktore. Mund të bëhet domosdoshmëri në raste të caktuara. Nuk ka rregullta strikte rreth divorcit për të mbrojtur interesat dhe të drejtat e palëve të përfshira: burrit, gruas dhe fëmijëve¹³.

Divorci mund të ndalohej në disa raste, kur nuk mund të zgjidhej problemi dhe shkakton dëme të tepruara për ndonjërin nga dy partnerët në martesë, duke mos arritur beneficionin e nevojitur. Jurisprudencia islame obligon që për të shmangur divorcin, zgjidhjet duhet të kërkojnë kur ndodhin mosmarrëveshje dhe dallime kritike midis burrit e gruas.

Një nga mënyrat më natyrore dhe logjike për të ndihmuar mbajtjen e një martese të suksesshme është lejimi i burrit që të ketë më shumë kontroll mbi divorc sesa gruaja. Kjo, pasi që burri është i obliguar financiarisht të kujdeset për gruan e familjen e tij, dhe ka përgjegjësinë për mirëqenien e tyre. Prandaj, duhet në mënyrë racionale të vlerësojë situatën, të bartë pasojat dhe humbja e madhe financiare e emocionale do të rezultojë nga divorci. Burri do të humbë mehrin që ka shpenzuar për martesë, dhe duhet të kujdeset për mbështetjen e fëmijëve. Kështu, me të gjitha këto konsiderata, ai nuk do të veprojë si pasojë e zemërimit apo emocionit të shpejtë¹⁴.

Njeriu është më i aftë, të paktën teorikisht, të kontrollojë emocionet dhe reagimet personale kur është nervoz lidhur me çështjet më të vogla të jetës, veçanërisht në mosmarrëveshjet me gruan e tij. Divorci kurrë nuk duhet të jetë reagim i shpejtë për disa vuajtje, keqkuptime

¹³ Po aty.

¹⁴ Po aty.

apo dallime në mendime, por vetëm si ngushëllimi dhe zgjidhja e fundit kur jeta bëhet problematike dhe e rrezikshme.

3.6.4. Diciplinimi i gruas

Islami ndalon rrahjen e grave dhe paralajmëron në mënyrë strikte kundër kësaj. I Dërguari a.s. kurrë nuk ka rrahur ndonjërin prej grave apo shërbëtove të tij. Gratë janë në përgjithësi më të dobëta se meshkujt sa i përket fizikut dhe qëndrueshmërisë së tyre. Gratë shpesh janë të paafta të mbrojnë veten kundër dhunës.

Megjithëse rrahja e grave është përgjithësisht e ndaluar, Islami lejon rrahjen e tyre në mënyrë të kufizuar si zgjidhje finale dhe të pranueshme, kur dështojnë të gjitha mënyrat e tjera. Kjo është analoge me rrahjen e fëmijëve kur gjithçka tjetër dështon dhe ata duhet të mësojnë një mësim si bindje për mbrojtjen dhe suksesin e tyre. All-llahu xh.sh. thotë në Kuranin Famëllartë:

وَالَّذِينَ يَخَافُونَ نُشُورَهُمْ فَعِظُوهُمْ وَأَهْجُرُوهُمْ
فِي الْمَضَاجِعِ وَأَضَرُّوهُمْ فَإِنْ أَطَعَكُمْ فَلَا تَبْغُوا عَلَيْهِمْ
سَبِيلًا إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلِيمًا كَبِيرًا

“...E ato që keni dro kryelartësisë së tyre, këshilloni, madje largohuni nga shtrati (e më në fund), edhe rrahni (lahtë, nëse nuk ndikojnë këshillat as largimi), e nëse ju respektojnë, atëherë mos u sillni keq ndaj tyre. All-llahu është më i larti, më i madhi” (En-Nisa: 34).

Në ajetin që cituam më lartë, All-llahu xh.sh. trajton rastin e një gruaje që sillet në mënyrë imorale ndaj të drejtave të burrit. Trajtimi i kësaj çështje jashtëzakonisht të ndjeshme vjen në faza graduale, ashtu siç kemi vënë re nga ajeti i mësipërm.

Fazat që janë përmendur në Kuran janë vetëm mjete të disiplinimit për mbrojtjen e njësisë familjare. Një formë e shkatërrimit të familjes është kur grua bëhet viktimë e divorcit. Islami synon të zbusë dhimbjet, problemet dhe konfliktet e panevojshme.

3.6.5. E drejta për trashëgim

Ata që keqinterpretojnë Islamin, pretendojnë se i bën padrejtësi gruas sa i përket trashëgimisë. Ata mendojnë se është e padrejtë që mashkullit t'i jepet dyfishi i asaj që i jepet femrës, madje pasi të dytë janë fëmijë të të njëjtëve prindër. All-llahu xh.sh. ka ofruar metodë të plotë dhe të detajuar të trashëgimisë së femrës në Kuran dhe Sunet, dhe nëse një student i paanshëm reflekton mbi detajet, do të zbulojë gabimin e këtij opinioni.

All-llahu xh.sh. thotë në Kuran:

يُوصِيكُمُ اللَّهُ فِي أَوْلَادِهِ لِلذَّكَرِ مِثْلُ حَظِّ الْأُنثِيَيْنِ

“All-llahu ju urdhëron për (çështen e trashigimit) fëmijët tuaj: për mashkullin hise sa për dy femra...”. (En-Nisa: 11)

Kjo nënkupton që minimumi i pjesës së saj është gjysma, dhe duke pasur parasysh se femra nuk ka asnjë përgjegjësi financiare si fëmijë, motër, gruas apo nënë, dhe këto përgjegjësi i takojnë gjithmonë kryefamiljarit, kjo në të vërtetë është shumë bujare.

KAPITULLI IV NDIKIMI I GRUAS NË ZHVILLIMIN E SHTETIT SAUDIT

4.1. HYRJE

Ekziston pajtim i plotë në botë se zhvillimi e prosperiteti i civilizimeve e kombeve është në pajtim të plotë me evolucionin dhe zhvillimin kulturor. Për të arritur zhvillim, nuk duhet të ketë ndërprerje midis këtyre dy aspekteve. Në të kundërtën, zhvillimi nuk është i plotë, nuk inspiron historinë dhe është pa vizion.

Në të gjitha civilizimet e kombet, qoftë në të kaluarën dhe të tashmen, femra ka rol esencial në të gjitha aspektet e zhvillimit, arritjeve dhe avancimit. Pavarësisht kësaj, ka dallime në pjesëmarrjen e femrës

në këto zhvillime. Për shembull, ka dallime midis femrës në Lindje e në Perëndim, dhe këto dallime janë natyrale që rezultojnë në dallimet në besim dhe mendime.

Femra saudite nuk është përjashtim nga të tjerat. Ajo jeton brenda një sistemi kulturor, vlerat e mësimet e të cilit rrjedhin nga sheriatu islam. Roli i femrës saudite është shumë i rëndësishëm në progresin dhe zhvillimin që ka arritur ky vend.

Femra saudite ka bërë hapa të mëdhenj në rrugën për të fituar të drejtat e liritë e saj, të cilat kanë qenë të cunguara për shkak të zakonave fisnore që mbizotërojnë në shoqërinë saudite, që bëjnë thirrje për ruajtjen e femrës dhe që të jetë vetëm zonjë e shtëpisë. Shoqëria saudite po jeton sot periudhën e përleshjes së vërtetë midis grupit të femrave që kërkojnë më shumë liri e pjesëmarrje të vërtetë e aktive në shoqëri, njësoj si mashkulli, dhe grupet fetare konservatore në vend.

Roli i femrës saudite është gjithnjë e më shumë në rritje. Ajo ka potencial të madh në bërjen e dallimeve të mëdha në shoqëri. Ajo është e gatshme të kontribuojë në progresin më të madh të vendit. Edhe pse në disa sektorë, roli i femrës nuk është në nivelin e kënaqshëm, megjithatë ajo vazhdon të kontribuojë fuqishëm në shoqëri, në politikë, në media dhe në biznes.

4.2. ROLI I GRUAS NË SHOQËRI

Në shoqërinë saudite traditat janë thellë të rrënjosura në histori dhe identiteti i saj rrjedh nga një trashëgimi antike e krenare. Është vend në të cilin ndërthuren konservatizimi fetar dhe aleancat fisnore. Për një saudit mesatar, të gjitha aspektet e jetës së tij ditore janë të ndikuara nga feja dhe tradita, por valët e ndryshimit po avancojnë dhe ndryshime të mëdha mund të shihen nga gjenerata në gjeneratë.

Sot, femra saudite ndikon në politikat dhe zhvillimin social në rolin e saj si mësuese, mjeke, punëtore sociale, gazetarë, profesoreshë, biznesmene dhe madje si dijetarë islame që shkruan për rolin e femrës.

Roli i femrës në zhvillimin shoqëror ka filluar të ndryshohet gradualisht pas presionit të nevojave të periudhës moderne për më shumë burime njerëzore të trajnuar që do t'i bëjë ballë sfidave bashkëkohore¹⁵.

Shoqëria saudite sot ka për më shumë nevojë për pjesëmarrjen e femrave në planifikimet për zhvillimin dhe integrimin e tyre në projektet që synojnë përmirësimin e jetës, krijimin e një ambienti më të përshtatshëm që do të siguronte kushte më të mira.

Progresi që kanë arritur femrat saudite dhe mundësimi për shkollim, punë dhe pjesëmarrje të përgjithshme, po i kushtohet më shumë rëndësi sot në shoqëri. Femra saudite është treguar e aftë që të kryejë role të shumta në jetën shoqërore, ashtu siç është treguar në role të ndryshme gjatë gjithë historisë. Ajo është shquar në udhëheqjen e shoqërive njerëzore.

Në periudhën bashkëkohore, femra saudite ka rol aktiv në zhvillimin shoqëror, pasi që përbën gjysmën e shoqërisë. Ajo vazhdon të bart përgjegjësitë në zhvillimin shoqëror, pavarësisht pengesave me të cilat përballlet. Pjesëmarrja e femrës në këtë zhvillim po rrit vlerësimin për të dhe mundësitë e saj. Kjo po ndikon në zhvillimin e personaliteteve të fëmijëve.

Kjo pjesëmarrje po ndikon në rritjen e përvojave të vlefshme të lidhura me çështjet e familjes së saj. Si rezultat, kjo po ndikon në rregullimin e duhur familjar, përmirësimin e standardit të jetesës dhe krijimin e kushteve më të mira për fëmijët.

Femra saudite sot është bashkëshorte e partnere në vazhdimësinë e familjes, nënë e mësuesja e parë në ndërtim.

¹⁵ Samar Fatany: Saudi Women Towards A New Era, fq. 12.

4.3. ROLI I GRUAS NË MEDIA

Femra saudite është e punësuar si gazetare dhe si prezantuese e producente televizive. Kjo po dëshmon se roli i femrës saudite në shoqëri është në ndryshim. Mediat po luajnë një rol të rëndësishëm në rritjen e vetëdijes për të zhvilluar potencialin e femrës, në mënyrë që t'i shërbejnë më mirë vendit.

Këto femra kanë rol shumë të rëndësishëm për të adresuar sfidat e shumta me të cilat përballen. Ka pasur shumë keqinterpretime për sauditët, sidomos në Perëndim. Ata kanë sot një imazh që është shtrembëruar nga keqinterpretimet për Islamin dhe e kanë bërë botën më pak të respektuar për femrat myslimane. Islami është portretizuar si fe shtypëse që i privon femrat nga të drejtat e tyre bazike që të respektohen dhe të admirohen.

Në ndryshimin e kësaj, mediat mund të luajnë rol të rëndësishëm. Femrat saudite që janë të angazhuara në media janë trajnuar e inkurajuar që të mobilizojnë bazën kombëtare drejt reformës. Ato po luajnë rol të barabartë në vendimmarrje që do të reformojë shoqërinë saudite¹⁶.

Mediat duhet të theksojnë faktin se femrat janë të afta të përcaktojnë të ardhmen e tyre dhe duhet të kenë më shumë pjesëmarrje në vendimmarrje. Femrat janë gjysma e shoqërisë, dhe idetë e sugjerimet e tyre janë shumë të vlefshme.

Mediat duhet të shërbejnë si platformë për të bërë thirrje për ligje të reja që mbrojnë femrën dhe mekanizma të duhur që mbështesin nëna e divorcuara. Mediat duhet të mbështesin mirëqenien e shoqërisë.

4.4. ROLI I GRUAS NË BIZNES

Përfshirja e femrës saudit në vendimmarrje ka qenë kontroverse për një kohë. Megjithatë, këto barrierat janë marginalizuar dhe roli i femrës është gjithnjë e në rritje.

Femrat saudite janë treguar shumë të suksesshme në drejtimin dhe menaxhimin e bizneseve të shumta në vend, duke kontribuar në rritjen dhe zhvillimin e vendit. Ato janë të anëtarësuara në Asociacionin saudit të menaxhimit, i cili ka 2400 anëtarë në gjithë vendin. Prej tyre, 21% janë femra profesionale.

Këto asociacione po kontribuojnë shumë në rritjen e vetëdijes për aftësitë menaxheriale dhe zhvillimin e rolit udhëheqës të femrës në pozitat menaxheriale. Kjo po iu mundëson zhvillimin e potencialit të tyre për të arritur suksesin ekonomik e social.

Pavarësisht se femra saudite ka shumë potencial sot, ajo ka nevojë të zhvillojë këtë me qëllim që të arrijë më shumë suksese ekonomike. Në këtë drejtim, këto asociacione po përpiqen përmes konferencave e punëtorive të ndryshme të zhvillojnë këtë potencial dhe të promovojnë rolin e femrës në pozitat udhëheqëse.

Këto asociacione, në të cilat janë të organizuara femrat saudite, po i japin mundësi biznesore femrës për të arritur sukses.

Të gjitha këto përpjekje kanë dhënë frytet e para. Sot, femrat saudite janë pjesë e bordeve e udhëheqëse të kompanive të ndryshme dhe të Odave ekonomike në gjithë Arabinë Saudite¹⁷.

Sipas një raporti të Odës Tregtare të Xhides, kursimet e biznesmeve saudite arrijnë mbi 45 miliardë rial, ndërsa investimet e tyre në patundshmëri në rreth 120 miliardë rial. Gjithashtu, duhet theksuar se femrat saudite posedojnë 40% të bizneseve që udhëhiqen nga familja.

¹⁶ Samar Fatany: Saudi Women Towards A New Era, fq. 24.

¹⁷ Po aty.

4.5. ROLI I GRUAS NË POLITIKË

Gjatë viteve të fundit, është rritur edhe roli i femrës saudite në politikë. Më parë, femra saudite nuk ka pasur rol të madh në politikën e vendit dhe nuk ka pasur ndonjë rol. Por, që nga janari i vitit 2013, është fuqizuar ndjeshëm roli i femrës pas dekretit të mbretit saudit, Abdullah.

Me këtë dekret, 30 femra u emëruan anëtare të Asamblesë Konsultative të vendit, që nuk ka drejtë të nxjerrë ligje, por megjithatë kryen përafërsisht funksionet e parlamentit. Veç kësaj, tri femra u emëruan edhe zëvendëse të Kryetarit të Asamblesë. Edhe në të ardhmen, femrat do të kenë kuotën prej 20% të ulëseve në legjislativin e Arabisë Saudite.

Në të kaluarën, femrat nuk kanë pasur të drejtë të votojnë apo të zgjidhen në zgjedhjet lokale. Por, kjo është lejuar në zgjedhjet e ardhshme lokale që do të mbahen në vitin 2015.

KAPITULLI V PËRFUNDIMI

5.1. KONKLuzionet dhe Rekomandimet

- Femra ka një rëndësi të madhe në Islam, dhe ajo është vlerësuar si shtylla e shoqërisë myslimane;
- Para Islamit, gratë në Gadishullin Arabik ishin në gjendje shumë të rëndë dhe ato trajtoheshin si skllave;
- Ardhja e Islamit solli ndryshime rrënjësore në shoqërinë arabe në përgjithësi, dhe për femrat në veçanti;
- Gratë kanë pasur një rol të rëndësishëm gjatë gjithë historisë së Islamit. Historia islame është përplot me shembuj të grave të fuqishme dhe të pavdekshme, që janë shembuj për gjithë shoqërinë;

- Ka disa keqkuptime që janë propaganduar gjerësisht rreth femrës dhe të drejtave të tyre në Islam. Këto keqinterpretime shpesh janë përsëritur nga disa që dëshirojnë të diskreditojnë Islamin dhe myslimanët. Femrat gjatë gjithë shekujve që nga ardhja e Islamit kanë qenë të nderuara e të respektuara;
- Roli i femrës saudite është gjithnjë e më shumë në rritje. Ajo ka potencial të madh në bërjen e dallimeve të mëdha në shoqëri. Ajo është e gatshme të kontribuojë në progresin më të madh të vendit;
- Edhe pse në disa sektorë, roli i femrës saudite nuk është në nivelin e kënaqshëm, megjithatë ajo vazhdon të kontribuojë fuqishëm në shoqëri, në politikë, në media dhe në biznes;
- Për rëndësinë që ka sot femra saudite, vlen të përmendet fakti se sipas një raporti të Odës Tregtare të Xhides, kursimet e biznesmeneve saudite arrijnë mbi 45 miliardë rial, ndërsa investimet e tyre në patundshmëri në rreth 120 miliardë rial. Gjithashtu, duhet theksuar se femrat saudite posedojnë 40 % të bizneseve që udhëhiqen nga familja

Bibliografia:

- John L. Esposito: *Islam and Politics*, Syracuse University Press
- Jane I. Smith: *Islam in America*, Columbia University Press 1999
- Anwar Hekmat : *Women and the Koran: The Status of Women in Islam*, Prometheus Books 1997
- Karin Van Nieuwkerk: *Women Embracing Islam: Gender and Conversion in the West*, University of Texas Press 2006
- Dr. Abdul-Rahman Al-Sheha: *Women in Islam & Refutation of some Common Misconceptions*
- Group Authors: *The Heritage of Islam: Women, Religion, and Politics in West Africa*, Lynne Rienner 1994
- John L. Esposito: *The Future of Islam*, Oxford University Press 2010
- Eleanor Abdella Doumato: *Getting God's Ear: Women, Islam, and Healing in Saudi Arabia and the Gulf*, Columbia University Press 2001

– Group Authors: Saudi Arabia, Its People, Its Society, Its Culture, HRAF Press 1959

– فوزية باشطح: المرأة السعودية بين الفقه و الاجتماعي, مدارك

– أحمد بن عبد المحسن العساف: حركة تغريب المرأة السُّعودية

– Samar Fatany: *Saudi Women Towards A New Era*, Ghalnaa Publications

– د. عثمان قدرى مكانسي: المرأة في حديث رسول الله صلى الله عليه وسلم

– ساميه منيسي: محمد صلى الله عليه و سلم و المراه

– عبد الرزاق بن عبد المحسن العباد البدر: يانة الإسلام للمرأة

– محمد منظور إلهي: دور الإسلام في مقاومة اضطهاد المرأة, المكتب التعاوني للدعوة وتوعية الجاليات بالربوة

– ذاكر الله أبو الخير: مكانة المرأة في الإسلام, المكتب التعاوني للدعوة وتوعية الجاليات بالربوة

Desarta Vathaj

THE POSITION OF WOMEN IN SAUDI ARABIA

(Summary)

Women have a great importance in Islam and are regarded the pillars of the Muslim society. Women make up half of the world's population and their position in Islam is best proved by the fact that one surah of the Qur'an is named An-Nisa. Before the advent of Islam, women in the Arabic Peninsula were treated like slaves or property. Their personal opinion, regarding their own interests, was not taken into consideration and was not deemed necessary. The advent of Islam brought significant changes to the Arab society in general and to women in particular. Islam banned oppressive and cruel practices against women. Islam reinstated women's rights in cases where these rights were bypassed or ignored. Whereas, in cases when women already enjoyed certain rights Islam reinforced them.

دسارا واثناى

مكاتة المرأة فى المملكة العربية السعودية

(خلاصة البحث)

للمرأة فى الاسلام مكانة عظيمة و هى تعتبر ركن من أركان المجتمع الاسلامى . والمرأة تمثل نصف المجتمع أما أحسن دليل على أهمية المرأة و مكانتها فى الاسلام بأن القرآن الكريم خصص سورة كاملة و سماها "سورة النساء". و كانت المرأة قبل الاسلام فى شبه جزيرة العرب تعامل كأنها سلعة تباع و تشتري رأيها بشأن وضعها لم يكن مطلوباً . بعد مجئ الاسلام فى المجتمع العربى حصلت تغييرات جذرية بصفة عامة و بالنسبة للمرأة بصفة خاصة اذ قام الاسلام بالغاء الممارسات الغير الانسانية ضد النساء و فى حالة كانت حقوق المرأة تتجاهل أو لا يعمل بها قام الاسلام باعادتها و فى حالة كانت المرأة تتمتع ببعض حقوقها قام الاسلام بتقويتها .

PORTRETE


Mexhid Yvejsi

Poet me ndikim në lindje dhe perëndim SHEJH MUHAMED IKBALL (1877-1938)

Shejh Muhamed Ikbali është filozof, politikan, shkrimtar, letërkundër, sufi, në veçanti një poet me ndikim në Lindje dhe Perëndim, i cili me poezitë e tij ka frymëzuar dhe frymëzon ende çdo brez. Është poet kombëtar i vatanit, është babai shpirtëror i Pakistanit.

Lindja, ndikimi, arsimimi

Shejh Muhammed Ikbali u lind më 9 nëntor 1877, në qytetin e famshëm Sialkot, në krahinën e njohur Panxhab, në Pakistan, që atëherë ishte nën sundimin britanik. Është djali i Nur Muhammedit, i cili ishte me profesion rrobaqepës, por lexonte shumë, ishte i devotshëm dhe kishte prirje mistike.



*Muhammed Ikbali
(1877-1938)*

Mësimet fillestare i kreu në vendlindje, ku krahas mësimëve kreu edhe Hivzin, e mësoi Kur'anin përmendësh. Në fëmijëri, përveç përndërve, ndikimi kryesor fetar-shpirtëror, që i la gjurmë tërë jetën, i erdhi nga dijetari i madh, Mevlana Mir Husein.

Studioi filozofinë, letërsinë angleze, gjuhën arabe etj, në qytetin Lahor të Pakistanit.

Ka jetuar, studiuar dhe punuar disa vite në Evropë, kryesisht në Angli dhe Gjermani, ku ka doktorur në filozofi.

Veprimtaria e tij frymëzon çdo brez

Shejh Muhamed Ikbali ishte filozof, sufi, politikan, shkrimtar, letërkundër, në veçanti një poet me ndikim në Lindje dhe Perëndim, që me poezitë e tij ka frymëzuar e frymëzon ende çdo brez.

Ka shkruar në tri gjuhë: në urdisht, persisht dhe anglisht.

Ka shkruar poezi në gjuhën perse dhe urdu. Prej afro 12.000 vargjeve, rreth 7.000 vargje janë në gjuhën perse.

Poezia e tij, kryesisht, është ndikuar nga poeti i madh, Mevlana Xhelaluddin Rumi, për të cilin Muhamed Ikbali kishte një nderim të veçantë.

Përmbledhja e parë me poezi e Muhammed Ikbali është botuar më 1915, është shkruar në gjuhën perse, me titull: "Asrar-e-Khudi" (Fshehtësitë e Egos).

Në vitin 1924, botoi librin e dytë me titull: "Payma-e-Mashrik" (Mesazhi i Lindjes).

Kurse në vitin 1927 e botoi përmbledhjen e tretë, me titullin:

"Zebur-e-Axhem" (Psalmet Persiane)...

Ka shkruar dhe botuar edhe libra të tjerë me përmbajtje politike, ekonomike, filosofike, islamike, disa prej të cilave janë:

"Ilmu'l-Iktisad" (Ekonomi Politike), në gjuhën urdu, 1903.

The Development of Metaphysics in Persia ('Zhvillimi i Metafizikës në Persi'; anglisht, 1907 - botuar më 1908).

Stray Reflections ("Përsiatje...."; anglisht, 1910;

The Reconstruction of Religious Thought in Islam (“Rindërtimi i Mendimit Fetar në Islam”; 1930; botimi i zgjeruar i Oksfordit, 1934).

Pejgamberi (a.s.), Kur’ani dhe Vatani

Në poezinë e tij Shejh Muhammed Iballi përdor shumë motive islame (të themi se zarb-i kalim është shkopi i Musait, pastaj bang-i dara që është zëri i kambanës së devesë, i cili besimtarët i shpie drejt karvanit të Pejgamberit (a.s.) që niset në drejtim të Mekkes.

Sipas Fazlur Rahmanit, përdorimi i Iballit i simboleve islame nuk duhet shpjeguar si romantizëm, edhe më pak si vajtim për lavdinë e kaluar historike të islamit, por si thirrje të poetit për islamin dinamik.

Poezitë e Shejh Muhammed Iballit për Muhammedin (a.s.) si njeri model, trupëzim i gjallë i Kur’anit, janë xhevahirë të letërsisë perse dhe urdu, vargjet në vijim e dëshmojnë këtë përkushtim:

*Ai, që i dinte rrugët e Hakkut,
Ishte vula e pejgamberëve
Për syrin e ashkut dhe ekstazës
Ai është i pari e i fundit,
Ai është Kur’ani, ai është Furkani
Ai është Ja-Sini dhe Ta-haja...*

Veprat me ndikim në Lindje dhe Perëndim

Poezia e Iballit është përkthyer në anglisht, gjermanisht, holandisht, arabisht, turqisht, rusisht, çekisht, italisht, spanjisht, boshnjakisht, shqip...

“Në Pakistan Shejh Muhammed Iballin e duan shumë, për të thonë se është i vetmi i dyti pas Kur’anit! Aq e ngrenë lart! Shejh Muhammed Iballin në Iran e duan shumë.

Arabët nuk e njohin shumë Iballin. Janë të rrallë ata që interesohen për të, sikur Shejh Ahmed Zeki Jamani. Në arabisht janë përkthyer vetëm disa vepra të tij. Do theksuar se veprat e Iballit janë të ndaluara në Arabinë Saudite. Iballi në Turqi është shumë i dashur prej kur është përkthyer Xhavidnameja e tij. Në Indonezi dhe në Indi, natyrisht, Iballi, është po ashtu shumë i popullarizuar dhe i njohur.”

Veprat e Shejh Muhammed Iballit, përveç studiueses Annemarie Schimmel, e cila ka shkruar një studim madhështor në gjuhën angleze mbi idetë fetare të Sir Muhammed Iballit (Gabriel’s Wing: A study into the Religious Ideas of Sir Muhammad Iqbal, Leiden, 1963), profesoresha e shquar e studimeve islame, e ka përkthyer në gjermanisht edhe veprën e Iballit Payam-i mashriq me titull Botschaft des Ostens (Wiesbaden, 1963). Për lexuesit perendimor me shumë sukses veprat e Iballit ia kanë paraqitur edhe studiuesit Johann Christoph Burgeli, Alessandro Bausani dhe Seyd Abdul Vahidi.

Në vazhdim një poezi e Iballit që sjell frymëzim!

Shkenca dhe feja

Një herë shkenca i tha fesë:

“Syri im

Mund të shoh çdo gjë

Që në këtë botë

Është e krijuar,

Bota e tërë

Është në rrjetën time

E shtrënguar, e pushtuar.

Unë jam e interesuar

Vetëm për gjërat materiale,

Ato sjellin fitime, fitore,

Ç’më duhen mua

Çështjet shpirtërore?

Unë mund të zbuloj

Mijëra melodi,

Haptas mund të shpall

Çdo fshehtësi...

Feja i tha shkencës:

Me magjinë tënde

Madje valëve në det

I vëni flakën,

Detin e kallni krejt.

Ju mund ta ndotni,
 Ta fëlliqni atmosferën
 Me gazra helmues
 Që janë vdekjeprues.
 Kur ndahesh prej meje,
 Drita jote s'është dritë,
 Ajo bëhet terr, varr,
 Flakë, zjarr.
 Në jetën tokësore
 Ti ke prejardhje Hyjnore,
 Por jeni e verbuar,
 Nuk po e vëreni
 Se jeni e kurthuar,
 Në rrjetë e pushtuar,
 Nën kthetrat
 E shejtanit të mallkuar.
 Lirohu. Eja. Kthehu.
 Këtu, këtë tokë djerrinë,
 Këtë tokë shkretëtirë
 Shndërroje në kopsht të mirë.
 Huazo prej meje pakëz mirësi,
 Huazo prej meje pakëz dashuri,
 Dhe tokën ku jetojmë
 Xhennet mund ta bëjmë.
 Që nga dita e Krijimit
 Ne bashkë kemi jetuar,
 Të jetojmë bashkë përsëri,
 Ne jemi zëra të ndryshëm
 Por kemi të njëjtën melodi.”

Përktheu nga anglishtja:
Mexhid YVEJSI, Gjakovë

Shejh Muhammed Ikbali ndërroi jetë më 21 prill 1938.



Varri i Ikbalit në hyrje të xhamisë Badshahi në Lahor





Babai, Shejh Nur Muhammedi dhe nëna e Ikbalit duke lexuar Kur'an



Muhammed Ikbali gjatë namazit



Në shenjë nderimi, një rrugë në qytetin Heidelberg, Gjermani quhet Muhammed Ikbali



Disa nga veprat e dr.M. Ikbali në gjuhën urdu, perse, angleze...

Burimet kryesore:

1. Schimmel, Annemarie, Gabriel's wing: a study onto the religious ideas of Muhammed Iqbal. (1962)
2. Kuliya Iqbal, Iqbal Academy Publications, 1990, Lahore, Pakistan.
3. Ayesha, Jalal (1994). The Sole Spokesman: Jinnah, the Muslim League and the Demand for Pakistan. Cambridge University Press.
4. Allama Iqbal – The spiritual father of Pakistan, Daily Dawn, 8 8 November 2003.
5. Mir, Mustansir, Iqbal. I.B. Tauris, (2006).
Anil Bhatti. "Iqbal and Goethe "(PDF). Yearbook of the Goethe Society of India. 2011.
6. Sharif, Imran, "Allama Iqbal's 73 anniversary observed with reverence", Pakistan Today, 21 April 2011.

Mexhid Yvejsi

**SHEIKH MUHAMMAD IQBAL (1877-1938) -
A POET OF GREAT INFLUENCE IN BOTH,
THE EAST AND THE WEST**

(Summary)

Sheikh Muhammad Iqbal was a philosopher, politician, writer, Sufi, and in particular a poet of great influence in both, the East and the West. His poems inspired generations. He is the national poet of his fatherland and the spiritual father of Pakistan.

مجيد عويسى

الشاعر الذى أثر على الشرق و الغرب

لشيخ محمد اقبال ١٨٧٧-١٩٣٨

(خلاصة البحث)

يعد الشيخ محمد اقبال فيلسوفا و سياسيا و كاتباً و أدبياً و صوفياً و بصفة خاصة شاعراً كان له تأثير فى الشرق و الغرب ز أشعاره الهمت و تلهم الكثيرين من كل جبل ليكتبوا الشعر . وكما يسميه الكثيرون من أبناء وطنه فهو ساعر قومى لوطنه كما هو أب روحى لباكستان .

KUMTESË

Mr. Qemajl Morina

FEJA SI FAKTOR PËR TË ARDHMEN E KOSOVËS

Në referatin tim, rreth temës bosht “Kosova, shtet i pavarur dhe sovran”, dëshiroj të përqendrohem në aspektin e perspektivës fetare dhe rolit të fesë në rrjedhat e deritanishme dhe në të ardhmen e Kosovës. Këtë me të vetmin qëllim, sepse tema e fesë pothuajse është anashkaluar apo rrallëherë është objekt diskutimi në qarqet shkencore shqiptare, që, sipas mendimit tim, është një mangësi e institucioneve tona. Feja, sot, është një temë e pashmangshme në të gjitha rrjedhat shoqërore, politike e gjeostrategjike. Një numër i madh i problemeve akute të botës së sotshme zanafillën e tyre e kanë në mosmarrëveshjet fetare. Andaj, studimi i këtyre problemeve edhe në aspektin fetar mund të na ndihmojë në eliminimin e disa keqkuptimeve, të cilat kohë pas kohe shfaqen jo vetëm në opinionin kosovar, por edhe më gjerë, për shkak të mosnjohjes së rolit dhe misionit që duhet të luajnë fetë në shoqëritë njerëzore.

Kjo mosnjohje nganjëherë shoqërive tona u kthehet si bumerang me pasoja të mëdha. Këtë më së miri e ilustron rrënimet e 218 xhamive gjatë viteve 1998/99 në Kosovë nga ushtria, policia dhe forcat paramilitare serbe, si dhe rrënimi i disa kishave ortodokse serbe pas

hyrjes së forcave të paktit NATO në Kosovë, si shenjë revanshizmi për rrënimin e xhamive. Këtu vlen të përmendim edhe pamjet gjatë trazirave të 17 e 18 marsit të djegies së kishave ortodokse serbe në Kosovë, si dhe të djegies së xhamive në Beograd e Nish. Ky duhet të jetë një alarm së paku për ne njerëzit e fesë, që diçka në shoqërinë tonë nuk është në rregull. Prandaj, kemi obligim fetar dhe njerëzor që t’u bëjmë një analizë gjërave të këtilla, që ato të mos përsëriten në të ardhmen. Mllefet dhe frustrimet nuk duhet të lejohen që të manifestohen me djegien apo rrënimin e objekteve fetare të kujtdo qofshin ato.

Kësaj teme një rëndësi të veçantë i kushton ish-sekretarja amerikane e Shtetit, Madeline Albright¹, në librin e saj të fundit me titull “The mighty and the almighty”, (I fuqishmi dhe i plotfuqishmi), ku argumenton se formuluesit e politikave duhet të kuptojnë rolin e fesë kur analizojnë situatën në vende të ndryshme të botës dhe se në rast konfliktesh, feja duhet të luajë një rol për nxitjen e paqes dhe jo acarimit të mëtejshëm të konfliktit.

Në këtë kuadër, zonja Albright thotë se shpeshherë konflikteve racionale, qëllimisht, u janë dhënë nuanca fetare. Si shembull, ajo përmend luftën në Kosovë. Sllobodan Milosheviqi, thotë Albright, i kishte thënë në ato vite, se populli i tij kishte luftuar në shekuj për të mbrojtur “Evropën e krishterë”, megjithëse, shton ajo, burimi i konfliktit, ashtu sikurse edhe në luftërat kundër Sllovenisë, Bosnjës dhe Kroacisë, ishte në fakt shthurja e ish-Jugosllavisë.

Albright, megjithatë, shton se, në të vërtetë, ekziston një partneritet midis fesë dhe politikës, por kur shfrytëzohet siç duhet, ai mund të jetë një formë pozitive për drejtësinë dhe paqen.

Albright thotë se në konflikte të ndryshme aktuale duhet të merret parasysh trashëgimia fetare. Por, ajo mendon se udhëheqësit fetarë nuk duhet të jenë të pranishëm në tryezën e bisedimeve për zgjidhjen e konflikteve. Ajo shton se ata duhet të luajnë rolin për t’i bashkuar njerëzit e jo për t’i përçarë ata.

¹ Express, 17 tetor 2006, Prishtinë.

Në këtë kontekst, Albright thotë se nuk është aspak dakord me rolin që po luan peshkopi Artemije në çështjen e Kosovës dhe shton: “Unë mendoj se udhëheqësit fetarë duhet të synojnë t’i bashkojnë njerëzit e jo t’i ndajnë ata; kam lexuar së fundi se peshkopi Artemije, të cilin e kam takuar dhe kam shkuar në manastirin e tij, po përpiqet të pengojë përpjekjet për pavarësinë e Kosovës dhe se, për t’i rënduar problemet edhe më tej, ai ka vendosur tani lidhje me disa priftërinj evangjelistë në SHBA, për të krijuar mbështetje për këto çështje. Veprime të këtilla nuk duhet të ndodhin, udhëheqësit fetarë duhet të ndihmojnë që njerëzit ta kuptojnë fenë dhe bazën fetare të një argumenti, sepse kështu mund të ndihmohet në zgjidhjen e konfliktit”.

Albright flet për rëndësinë e bashkëpunimit mes feve të ndryshme, kur ato bashkëjetojnë në një vend, duke theksuar nevojën e respektit reciprok mes tyre. Përsëri ajo i referohet Ballkanit dhe Kosovës.

“Kur isha në Kosovë gjatë konfliktit, pashë xhami të shkatërruara, të rrethuara me tela me gjemba. Por, fatkeqësisht, në udhëtimin tim më të fundit atje pashë se kishte ndodhur e kundërta: pashë kisha të shkatërruara dhe të rrethuara me tela”.

Albright shton se, ndërsa duhet punuar më tepër në drejtim të mirëkuptimit të feve në Ballkan, ka edhe raste pozitive të përpjekjeve të bashkëpunimit. Ndryshe nga peshkopi Artemije, thotë ajo, At Sava luan një rol pozitiv në Kosovë.

Duke mbrojtur kurdoherë idenë se fetë e ndryshme kanë shumë gjëra të përbashkëta në thelb, siç është predikimi i paqes, dashurisë dhe ndërgjegjes shoqërore, Albright nxjerr përfundimin se feja mund të bëhet një forcë shtytëse për lirinë dhe tolerancën në botë.

Roli i fesë në konfliktin e Kosovës

Nuk ka dyshim se feja është një komponent me rëndësi në jetën shpirtërore të çdo popull. Ajo luan një rol me rëndësi në formimin e vetëdijes edhe të popullit të Kosovës. Ky ndikim, varësisht prej rrethanave të caktuara, ndonjëherë është më i theksuar e ndonjëherë më pak. Kur është çështja e pranisë së faktorit fetar në konfliktin në Ko-

sovë dhe sa ishte ndikimi i tij, do të ishte me interes të citoj disa të dhëna të Raportit të Grupit Ndërkombëtar të Krizave, të publikuar më 31 janar 2001 me titull: “RELIGJIONI NË KOSOVË”², në të cilin, përveç të tjerash, thuhej:

“Tri fetë - islami, ortodoksizmi dhe katolicizmi kanë bashkëjetuar për një kohë të gjatë në Kosovë. Shumica e shqiptarëve të Kosovës, së paku formalisht, i përkasin besimit islam. Një pakicë, afro 60.000 janë katolikë. Shumica e serbëve të Kosovës, edhe ata që nuk janë besimtarë praktikë, ortodoksizmin e konsiderojnë një komponent tejet të rëndësishëm të identitetit të tyre nacional. Megjithatë, nuk mund të thuhet se feja ka pasur ndonjë rol të theksuar në konfliktin ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve.

Shqiptarët e Kosovës nuk e bëjnë identifikimin e tyre nacional nëpërmjet religjionit, por e bëjnë nëpërmjet gjuhës dhe ata kanë një qasje tejet relaksuese ndaj fesë islame. Nuk ka asnjë lider fetar islam apo ndonjë imam që të ketë luajtur ndonjë rol të theksuar gjatë fushatës paqësore të okupimit tetëvjeçar serb të Kosovës apo rezistencës së armatosur të viteve 1998/99. Islami politik dhe fundamentalizmi social, si terma aq të respektuar në Lindjen e Mesme, kanë një mirëkuptim shumë të vogël në Kosovë.

Imazhi i serbëve të Kosovës dhe manastireve të tyre, zakonisht paraqitet si i një populli të vuajtur dhe të rrezikuar nga popullata shumicë shqiptare. Kjo ishte pjesë e propagandës së Milosheviçit dhe përkrahësve të tij, me qëllim që të manipulonin emocionet e popullit. Kisha Ortodokse Serbe vazhdimisht ishte e ndarë sa i përket Milosheviçit. Ajo në fillim e përkrahu atë në një masë të madhe, për atë që ajo e quante viktimizimi i kombit serb nën sundimin e komunizmit si dhe forcimin e pranisë serbe në Kosovë. Mirëpo, përvoja komuniste e Milosheviçit vështirësoi pozitën e Kishës Ortodokse Serbe. Në fillim të viteve nëntëdhjetë, patriarku Pavle kritikoi haptazi Milosheviçin, ndërkohë që disa nga prijësit ortodoksë serbë në hierarkinë më të lartë të Kishës, e përkrahën atë. Pas vitit 1999, peshkopi Artemije, lider i Ki-

² Religion in Kosovo, International Crisis Group, January, 31 2001

shës Ortodokse Serbe në Kosovë, iu kundërvu liderëve politikë serbë, të cilët bashkëpunonin me bashkësinë ndërkombëtare që ishte në Kosovë.

Gjatë luftës, forcat serbe rrënuan një numër të madh të xhamive, përfshirë edhe të gjitha bibliotekat dhe arkivat. Pas luftës, këtyre akteve shqiptarët iu përgjigjën duke rrënuar disa kisha ortodokse. Këto veprime reciproke të akteve vandaliste ishin më tepër të motivuara nga dëshira e të dy palëve për çrrënjosjen e pranisë së palës tjetër në Kosovë sesa nga fanatizmi fetar.

Rreth rolit të fesë në konfliktin midis shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë po sjellim edhe mendimin e historianit të mirënjohur anglez, Noel Malkolm³, i cili thotë: “Mendoj se këtu ekzistojnë dy anë - ana serbe dhe ajo shqiptare. Pala serbe, në retorikën publike të nacionalizmit serb, feja ka qenë zhvilluar si një pikë e fuqishme. Dhe kam takuar serbë, të cilët janë të bindur se Kosova është djep i fundamentalizmit islam. Madje edhe serbë të shkolluar e inteligjentë në Beograd pohojnë kështu, ashtu e kanë mësuar ata të vërtetën për Kosovën. Në anën e shqiptarëve, më duket se konflikti i fundit nuk ka të bëjë fare me religjionin. Nuk mund të shohë asnjë rol esencial të fesë në anën e shqiptarëve në natyrën e rrjedhave historike në këta dhjetë vjetët e fundit. Do të ishte shumë me rëndësi që të gjurmohen arsyet e kësaj”, thekson Malcolm.

Ai pohon se kjo mund të bëhet përmes krahasimit të historisë së Kosovës me historinë e Bosnjës në 10-20 vitet e fundit.

“Mendoj se është shumë interesant që në Sarajevë keni pasur institucione islamike të niveleve më të larta. Keni pasur zhvillime të llojit islamik të klasës islame, që këtu më duket se nuk është bërë asnjëherë. Dhe, ndoshta, është simbolike që në rastin e Bosnjës keni pasur Alija Izetbegoviçin, i cili nuk është fundamentalist, por me siguri është një mysliman i sinqertë dhe intelektual islamik, por interesat e tij intelektuale janë, pa dyshim, në rrafshin islamik. Dhe cili është ekuivalenti i tij në Kosovë, një ligjërues universiteti, i shkolluar, i specializuar në

letërsi e estetikë, i cili ka studiuar në Paris dhe derisa Izetbegoviçi e ka lexuar Kur-anin, Rugova e ka lexuar Roland Martinë. Mendoj se ky është dallimi simbolik ndërmjet këtyre dy rasteve. Nuk them se islami nuk është i rëndësishëm për njerëzit e rëndomtë, jam i bindur se në fshatra ai ka qenë pjesë e jetëve të njerëzve dhe nuk dua të them asgjë kundër tij, por po them se në konfliktin modern politik, nuk po shoh rol të rëndësishëm të fesë”, pohon Malcolm.

Feja si faktor mobilizues

Këtu vlen të përmendet se feja te pala serbe ishte faktor mobilizues si për faktorin e brendshëm, ashtu edhe për të jashtmin. Këtë më së miri e vërteton vetë fakti se gjatë viteve nëntëdhjetë, nën sundimin e regjimit komunist të Milosheviçit në Kosovë, u ndërtuan disa dhjetëra kisha ortodokse serbe në të gjitha anët e Kosovës, bile edhe në ato vende ku nuk kishte serbë, si në Gjakovë, apo aty ku kisha nuk e ka vendin, si ndërtimi i kishës në hapësirën e Universitetit të Prishtinës, me të vetmin qëllim që me anë të kishave të bëhet serbizimi i Kosovës dhe të krijohet përshtypja se Kosova është tokë serbe.

Po ashtu edhe manifestimi i 600-vjetorit të Betejës së Kosovës më 28 qershor 1989 në Gazimestan, u shfrytëzua nga ana e Milosheviçit, natyrisht edhe me bekimin e Kishës Ortodokse Serbe, për shpалosjen e platformës së tij nacionaliste, në njërën anë, po edhe si një simbol i vijës ndarëse në mes Lindjes dhe Perëndimit apo krishterimit dhe islamit, në anën tjetër.

Kur është fjala për shqiptarët, ashtu siç vërejtëm edhe më lart, feja në konfliktin serbo-shqiptar nuk kishte kurrfarë roli, bile lirisht mund të themi se faktori fetar ishte dekurajues dhe i papërfillshëm. Kjo mund të argumentohet duke u nisur nga personalitetet më të larta dhe më me influencë të shoqërisë shqiptare e deri tek ato të rangut më të ulët. Kështu, për shembull, kryetari i Kosovës, dr. Ibrahim Rugova⁴, pyetjes së një gazetari të huaj rreth përkatësisë së tij fetare, iu përgjigj: “simbolikisht jam mysliman”, kurse përfaqësuesi i UÇK-së në Zvicër,

³ Koha ditore, 12.10.1999, Prishtinë, f.6.

⁴ Java, 4 dhjetor 2003, (marrë nga intervista dhënë gazetës italiane “Corriera della Sera”).

në vitin 1999, ish- i burgosuri politik Jashar Salihu, lidhur me fenë dhe rolin e saj në luftë, thotë: “Feja për ne nuk do të thotë asgjë. Ne jemi evropianë dhe nuk kemi asgjë të përbashkët me muxhahidinët si dhe me ekstremistë të tjerë.”

Dialogu ndërjetar pa alternativë

Me gjithë problemet dhe vështirësitë me të cilat u ballafaquam gjatë periudhës së kaluar nëpër të cilën kaloi shoqëria kosovare, nga përvoja mund të pohoj se dialogu ndërjetar në Kosovë i parapriu shumë më herët dialogut në rrafshin politik. Që nga 1 marsi 1999, kur për herë të parë me ndërmjetësimin e Konferencës Botërore Fetë për Paqe (WCRP), një organizatë ndërkombëtare me seli në Nju-Jork, u mbajt takimi i parë i grupit ndërjetar në Prishtinë, në nivel të tri bashkësive fetare tradicionale të Kosovës, ai vazhdoi kohë pas kohe edhe në nivele të liderëve fetarë. Kështu, gjatë periudhës së kaluar u mbajtën disa takime, siç ishin takimi i Vjenës më 15-16 mars 1999, i Amanit-29-30 nëntor 1999, i Sarajevës- 9 shkurt 2000, i Prishtinës- 9-10 prill 2000, i Oslos- 29 shtator - 1 tetor 2001, i Sarajevës- 1 tetor 2003. Po ashtu, pati edhe takime të tjera me raste të ndryshme, të cilat në të shumtën e rasteve u organizuan nga përfaqësuesit e lartë ndërkombëtarë, që vepronin në Kosovë, qofshin ata ushtarakë apo civilë. E takimet e grupeve ndërjetare kanë qenë pothuajse të rregullta deri para ngjarjeve të 17 e 18 marsit të vitit 2004.

Dialogu ndërjetar në Kosovë, i filluar shtatë vjet më parë, edhe pse nuk solli rezultate aq inkurajuese, gjithsesi ishte një përvojë e mirë se si edhe në raste krizash të mëdha, liderët fetarë gjetën forcë dhe inkurajim për të biseduar midis tyre për çështje që i preokuponin besimtarët e tyre. Por, mund të them lirisht se, nëse të gjitha palët janë të sinqerta dhe kanë qëllime të mira, dialogu do të kurorëzohej me suksese edhe më të mëdha, edhe pse atij duhet t'i paraprijë dialogu politik, sepse esenca e problemit në Kosovë ishte e karakterit politik, etnik dhe social, e më pak e atij fetar.

Pengesa më e madhe për dialogun ndërjetar në Kosovë gjatë viteve të kaluara, ishte përzjerja e kreut të Kishës Ortodokse Serbe për Kosovë, peshkopit Artemije, në rrjedhat politike të Kosovës. Ai deri para pak kohësh ishte kryetar i Komitetit Nacional Serb për Kosovën, e kjo bie ndesh me pozitën e tij si përfaqësues shpirtëror i popullit serb të Kosovës. Vërejtjet e njëpasnjëshme që i janë bërë atij nga dy kolegët e tij, ish-kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, dr. Rexhep Boja, dhe i ndjeri ipeshkvi i Kishës Katolike të Kosovës, z. Mark Sopi, që ai të mos përzihet në aspektin politik, nuk kanë dhënë ndonjë rezultat. Në të gjitha takimet e përbashkëta është theksuar vazhdimisht se çështjet politike duhet t'u lihen liderëve politikë, ndërsa liderët fetarë të merren me çështje që kanë të bëjnë me natyrën e punës së tyre. Në anën tjetër, ajo që ka vështirësuar dialogun ndërjetar, ishte pafuqia dhe hezitimi i peshkopit Artemije si dhe Kishës Ortodokse Serbe që të distancoheshin dhe të kërkonin falje për krimet e kryera nga pala serbe (ushtria, policia dhe forcat paramilitare serbe) mbi shqiptarët si dhe në objekte fetare islame në emër të serbizmit dhe ortodoksizmit, si dhe mosgatishmëria e tyre për të pranuar realitetin e ri të krijuar në Kosovë pas hyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë në qershor të vitit 1999. Një deklaratë e këtillë e krerëve fetarë të Kishës Ortodokse Serbe do ta lironte popullin serb nga barra e fajit kolektiv, të cilin po e bart mbi supet e tij për gjenocidin dhe krimet që janë bërë në emër të tij nga kriminelët e regjimit të Milosheviçit dhe do t'i hapte atij perspektivën për një integritet në shoqërinë e re kosovare. Mirëpo, si duket, këtë hap Kisha Ortodokse Serbe nuk është në gjendje ta bëjë, së paku në një të ardhme të afërt, e me këtë ajo po e vështirëson pozitën e saj dhe pozitën e popullit serb në Kosovë.

Trazirat e marsit dhe bojkotimi i dialogut nga Kisha Ortodokse Serbe

Gjatë ngjarjeve të 17-18 marsit 2004, edhe pse Bashkësia Islame e Kosovës në mënyrë publike u distancua nga veprimet e protestuesve, duke i quajtur ato të papranueshme, dhe nëpërmjet apeleve e komunikatave të shumta u mundua, për aq sa pati mundësi, të ndalojë shkallëzimin e tyre, si dhe dënoi në mënyrën më të ashpër djegien e kishave ortodokse serbe, megjithatë, Kisha Ortodokse Serbe refuzoi në mënyrë të prerë çfarëdo tubimi ndërfetar në nivele të tri bashkësive tradicionale fetare të Kosovës. Ky gjest i Kishës Ortodokse Serbe që i pamatur dhe nuk përputhet fare me deklaratat e nënshkruara të tri bashkësive fetare të nivelit më të lartë në takimet e mëhershme për respektimin e normave morale të përbashkëta. Po të kishte ndjekur këtë mendësi, Bashkësia Islame e Kosovës kishte qindra shkaqe për të mos u ulur asnjëherë në një tryezë të rrumbullakët me Kishën Ortodokse Serbe. Por, ne jemi të bindur se bojkotimi i dialogut ndërfetar në asnjë mënyrë nuk është metodë për zgjidhjen e problemeve. Dialogu hap shtigje të reja dhe perspektiva të reja për të gjithë kosovarët, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre nacionale a fetare. Pas çdo dialogu, palët dalin më të liruara nga barrierat psikike dhe me perspektiva të reja për një të ardhme më të mirë për secilin. Prandaj, duke u nisur nga këto parime, Bashkësia Islame e Kosovës së bashku me Kishën Katolike morën pjesë në Konferencën Ndërfetare, që u mbajt në Patriarkanën e Pejës më 2-3 maj 2006 me të vetmin qëllim të vazhdimit të dialogut ndërfetar në Kosovë, sepse ai është garancia e vetme për një perspektivë më të mirë për të gjithë banorët e Kosovës, por edhe për komunitetin serb. Bojkotimi dhe getoizimi i popullatës serbe nëpër enklava, nuk janë mënyra për një perspektivë të tyre e as për prosperitetin dhe ardhmëninë e Kosovës. Prandaj, sa më herët që ta kuptojnë këtë liderët serbë, të nivelit fetar dhe politik, do të jetë më mirë për ata si dhe për popullatën serbe. Nga Konferenca në fjalë kemi vërejtur se Kisha

Ortodokse Serbe ishte e ndarë. Një grup i peshkopëve në krye me peshkopin e Baçkës Irineji Bulloviq, ishte për vazhdimin e dialogut, kurse peshkopi Artemije, i cili është përgjegjës për Dioqezën Rashkë-Prizren, është kundër dialogut dhe bojkotimit të të gjitha institucioneve të Kosovës, sepse, sipas tij, dialogu ndërfetar shkon në interes të shqiptarëve dhe u hap rrugën atyre drejt pavarësisë. Në mesin e konkluzave të Konferencës së Pejës ishte që Konferenca e ardhshme të organizohet deri në fund të viti 2006, mikpritëse e së cilës do të ishte Bashkësia Islame e Kosovës. Konferenca në fjalë deri më tani nuk është mbajtur për shkak të pengesave të peshkopit Artemije, i cili bën çmos që shqiptarët e Kosovës t'i etiketojë si “fundamentalistë” dhe “xhihadistë”. Mbajtja e kësaj konference do t'ia ndërpriste rrugën për një propagandë të tillë.

Në Kosovë lypset të ruhet harmonia ndërfetare e trashëguar shekuj me radhë dhe në këtë aspekt bashkësitë tona fetare duhet të jenë shumë të kujdesshme që të mos lejohet shkallëzimi i çfarëdo lloji të mostolerancës ndërfetare ndaj kujtdo qoftë. Sepse ky është obligim fetar, por edhe njëri prej standardeve të vlefshme të çdo shoqërie demokratike dhe të qytetëruar.

Bashkësitë fetare mund të luajnë një rol të rëndësishëm për kthimin në rrjedha normale të gjendjes në Kosovë, natyrisht nëse ekziston vullneti i mirë dhe sinqeriteti te njerëzit e fesë, si dhe nëse ekziston përkrahja nga institucionet vendore. Njerëzit e fesë janë në kontakt më shumë se kushdo me të gjitha shtresat e popullatës dhe në të gjitha situatat, në raste gëzimi a hidhërimi, gjatë lutjeve të përditshme, javore e vjetore - dhe fjala e tyre ka peshën e vet te besimtarët.

Nga përvoja e kaluar duhet të mësojmë se asnjë regjim a ushtri, cilado qoftë ajo, nuk mund t'i sigurojë kujtdo qoftë paqe dhe siguri më shumë se fqinji fqinjit të vet. Kosova ka qenë gjithmonë vend ku janë gërshtuar vlerat e kulturave dhe të civilizimeve të ndryshme. Këtu ka pasur vend për xhami, kisha ortodokse, kisha katolike dhe sinagoga. Ky mozaik i objekteve të fesë vetëm sa ia ka shtuar bukurinë asaj. Ne na mban shpresa se Kosova do të mbetet e tillë edhe në të ardhmen.

Mundësitë tona dhe ndikimi ynë nuk mund të jetë vendimtar, mirëpo ai as nuk duhet të nënçmohet. Të bëjmë diçka për eliminimin e barrierave të luftës dhe urrejtjes. Ta kthejmë besimin e humbur midis fqinjëve. Të ndërtojmë urat e mirëkuptimit dhe mirëbesimit. Të bëjmë diçka që fëmijët tanë të mos e shikojnë njëri-tjetrin me mosbesim. Të mos mbeten qytetet dhe fshat dhe kombëtar. Për këtë na detyrojnë librat tanë të shenjtë, të cilët i lexojmë gjatë lutjeve tona të përditshme. Misioni i njerëzve të fesë është që midis njerëzve të kultivojnë dashurinë, respektin e ndërsjellë e të luftojmë urrejtjen dhe armiqësinë. Prijësit e fesë janë më kompetentë se çdokush që njerëzit t'i kthehen ardhmënisë. Ata duhet të kontribuojnë që Kosova të kthehet në një oazë paqeje dhe bashkëjetese midis të gjithë njerëzve që jetojnë në të, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike apo fetare.

Mr. Qemajl Morina

RELIGION AS A FACTOR FOR THE FUTURE OF KOSOVA

(Summary)

In my presentation on the topic “Kosova, an independent and sovereign country” I would like to focus on the role of religion on the developments in Kosova so far as well as its future. This is due to the fact that the issue of religion has seldom been discussed by Albanian scientific circles. Part of the blame for this lies on our institutions. Nowadays, religion is a topic which cannot be bypassed when discussing social, political or geostrategic issues. A large number of acute problems in the contemporary world are the result of religious disputes. Thus, the study of these problems may help us eliminate certain misunderstandings, which arise time after time, not only in Kosova, but even further. This is due to the lack of understanding on the role and mission of religion in the human society.

كمال مورينا

الدين كعامل لمستقبل كوسوفا

(خلاصة البحث)

ورقة بحثي حول محور الموضوع "كوسوفا دولة مستقلة و ذات سيادة" سوف أحاول أن أتناول مجال المنظور الديني و دوره في مجريات الامور حتى الان و مستقبل كوسوفا و ذلك ايمانا مني بأن موضوع الدين هو غير وارد او يذكر نادرا في الدوائر العلمية الالبانية الامر الذي أعتبر تقصيرا على مؤسساتنا . و ذلك بسبب أن الدين اليوم يعتبر موضوعا لا مفر منه في جميع مجريات الامور الاجتماعية و السياسية و جئواستراتيجية و ذلك لان عددا من مشاكل اليوم يكمن في الاختلافات الدينية التي تحصل بين الشعوب المختلفة فان دراسة هذه الامور من زاوية دينية ييمكن أن يزيل بعض من سوء تفاهم الذي يمكن أن يحدث من وقت الى آخر ليس في الرأي العام الكوسوفي بل في مجتمعات أوسع لعدم معرفة الدور و الرسالة التي يجب ان تلعبها الاديان في المجتمعات الانسانية.

DORËSHKRIME

Ismet ef. Limani

OMER IBNUL-HATABI r.a.

Omeri ishte biri i Hatabit të Neufejlit, njëhej me pseudonim Faruk, është rritur dhe edukuar në një familje, e cila gëzonte famë dhe autoritet të madh, i pajisur me virtyte të larta njerëzore, tejet i sinqertë dhe besnik. E ka çmuar të vërtetën dhe bujarinë, ishte kundërshtar i denjë i të gjitha padrejtësive. Gëzonte autoritet të madh në kohën e injorancës dhe zuri pozitë të lartë, si përfaqësues i fisit kurejsh, të cilët i përfaqësonte në shumë negociata luftarake, që i bënin ku-rejshët me fiset tjera.

OMER IBNUL-HATABI

Omeri ishte biri i Hatabit të Neufejlit të Hadezë, i quajtur në qendrë të kësaj qyteze. Ebu Hake, njëri nga pseudonimet e Faruk. Ka lindur në vitin për lindjen e Muhamedit a.s. - vit 534. Edhe nën atë që është e ditur se ai ishte i famës, e cila gjente famë dhe autoritet të madh. Ishte i përgjigjur me vlerë të larta njerëzore, tejet i sinqertë dhe besnik. E ka çmuar të vërtetën dhe bujarinë, ishte kundërshtar i denjë i të gjitha padrejtësive. Gëzonte autoritet të madh në kohën e injorancës dhe zuri pozitë të lartë, si përfaqësues i fisit kurejsh, të cilët i përfaqësonte në shumë negociata luftarake, që i bënin ku-rejshët me fiset tjera.

Islaminimi i Omerit

Muhamedi a.s. është dëshirë të flaktë që Omeri të pranonte fejen islame, për atë edhe i bëri lutje Zotit:

“O Zoti jonë, forco islamin me njërin nga dy më të dashurit të ti: Me Omer bin Hatabin ose Amrin bin Isham, i cili është quajtur Ebu-Xhe-hël”.¹

Më në fund deshi Zoti dhe Omeri r.a u nis në rrugë të drejtë të islamit duke lënë fenë pagane, në të cilën besuan të afërmit e tij. Në kohën kur pranoi islamin Omeri r.a kishte 26 vjet, ishte trim i pashoq. Pas pranimi të islamit Omeri r.a i urdhëroi myslimanët të shpallin publikisht islamin e tyre, përkundër urrejtjes aq të madhe që kishin idhujtarët ndaj tyre.

Para se Omeri r.a të pranonte fenë islame idhujtarët i prematuan një dhuratë të madhe nëse do të arrinte qëllimin e tyre për vrasjen e Muhamedit a.s. Omeri r.a u bind nga shpifjet dhe intrigat e idhujtarëve dhe mori përsipër këtë obligim, që t’i qërojë hesapet me Muhamedin a.s dhe besimtarët e fesë islame. Nga armiqësia që kishte fituar ndaj Muhamedit a.s dhe myslimanëve ai u nis një ditë për ta vrarë Muhamedin a.s, mirëpo, rrugës u takua me Nu’ajm bin Abdullahun, i cili e kishte pranuar islamin fshehurazi, kur e pa vrazhdësinë e tij që kishte, ai u mundua ta largojë Omerin r.a nga Muhamedi a.s, e pyeti, ku je nisur Omer? Ai u përgjigj. Jam duke shkuar te Muhamedi, i cili është duke thirrur njerëzit në fe të re, ky me këtë veprim po krijon përçarje mes nesh, unë dua ta vras atë! Nu’ajmi i tha: “Pse o Omer po shkon ta vrasësh Muhamedin, kur motra juaj Fatimja dhe burri i saj Seidi, i biri i Zejdit e kanë pranuar fenë islame.”

Posa i dëgjoi Omeri r.a fjalët e tij e ndërroi drejtimin dhe u nis te motra e tij, kur arriti atje Fatimja dhe Seidi ishin duke lexuar kaptinën e Kur’anit Ta-ha, pasi u ndal dhe dëgjoi se ç’ishin duke lexuar hapi

¹ Termidhiu 3681.

derën dhe hyri brenda, i pyeti se çka ishin duke lexuar? Motra e tij Fatimja e mori letrën dhe e fshehu. Atë letër ia kishte sjellë Habab Bin Ereta, i cili kishte ardhur për t'ua mësuar këtë kaptinë të Kur'anit. Fatimja iu përgjigj: *"Asgjë nuk ishim duke lexuar."* Omeri tha: *"Po, për Zotin diçka ishit duke lexuar, unë ju dëgjova se diçka lexuat."*

Papritmas Omeri sulmoi Zejdin kurse Fatimja u përpoq ta mbrojë të shoqin e saj, mirëpo ai pa mëshirë sulmoi edhe motrën e vet dhe ia përgjaku fytyrën. Kur Fatimja e pa se Omeri nuk do të ndalet dot ajo tha:

"Po jemi bërë myslimanë familja jonë, na nuk e lëmë këtë fe po edhe sikur të na vrisni".

Atëherë Omeri urdhëroi që t'ia dorëzojnë atë copë letër që ishin duke lexuar. Pasi e mori letrën filloi ta lexojë, nga përmbajtja e saj ai u frymëzua dhe nga përshtypja e madhe që kishte me rastin e leximit të asaj kaptine (Ta-ha) iu mbush zemra plot mëshirë. Pastaj iu drejtua së motrës dhe i tha: *"Kush ju solli këtë kaptinë të Kur'anit, më tregoni ku gjendet Muhamedi? Fatimja iu përgjigj: "Ai gjendet te shokët e tij".*

Në atë moment erdhi Hababi, i cili ishte shumë i gëzuar, i tha Omerit.

Unë kam ardhur që t'i mësoj këta myslimanë të rinj, meqë dje dëgjova Muhamedin a.s duke bërë lutje me këto fjalë:

"O Allahu im, ndihmoje islamin dhe bëje të famshëm atë me Omer bin El-Hatabin, ose me Ebu Xhehl b.Hishamin".²

Fati yt Omer paska qenë që të pranosh fenë islame, i tha Hababi. Pastaj i treguan Omerit, se ku ishin tubuar myslimanët së bashku me Muhamedin a.s.

Kur e panë myslimanët se po vinte Omeri me shpatë në dorë, ata u frikësuan se mos po vinte me ndonjë qëllim të keq. Hamza u tha të rinjve myslimanë që të mos frikësohen. *"Nëse vjen me ndonjë qëllim të*

mirë, mirë se vjen, po nëse vjen me ndonjë qëllim të keq, unë do t'ia pres kokën me shpatën e tij."

Omeri r.a trokiti në derë dhe kërkoi leje që të hyjë brenda. Pas një qetësie të shkurtër ata i dhanë leje Omerit të hyjë. Para se të ngrihet Hamza, u ngrit Muhamedi a.s dhe e pyeti: *Me çfarë mendimi ke ardhur Omer? Omeri iu përgjigj: Unë kam ardhur që ta pranoj fenë islame.* Në atë çast u ngritën të gjithë në këmbë, dhe prej gëzimit që Omeri r.a pranoi islamin brohoritën: *All-llahu Ek-ber, All-llahu Ek-ber.* Atëherë Muhamedi a.s iu falënderua Allahut duke thënë: *"I falënderohemi Zotit, i cili me ardhjen e Omerit në islam e përforcoi fenë islame".*

Pastaj Omeri r.a bëri pyetje se sa është numri i myslimanëve, të pranishmit u përgjigjën se kishte arritur në dyzet, duke përfshirë edhe Omerin r.a. Ai propozoi që prej atij momenti të dalin publikisht pa kurrfarë frike t'ua komunikojnë idhujtarëve këtë fe të pastër.

Omeri r.a këtë e bëri nga trimëria, guximi dhe mëshira që kishte, prej urrejtjes që ndiente ndaj Muhamedit u shndërrua në simpati. Pranimi i fesë islame nga ana e Omerit r.a ishte një ndihmë e madhe për tërë myslimanët.

Omeri r.a në Medinë

Kur Omeri r.a vendosi të emigrojë prej Mekës në Medinë, ku kishte emigruar edhe Muhamedi a.s, ai nuk iku fshehurazi, por doli publikisht. Së pari shkoi të vizitojë babanë e vet, e mprehu shpatën, e bëri gati për dyluftim dhe bërtiste me një zë të lartë:

"Kush është ai i cili do të lë nënën pa djalë, e fëmijët jetimë pa babë, gruan të vejë pa burrë, le të më dalë përpara se unë jam nisur për të emigruar nga Mekja në Medinë (për në Hixhret)".

Asaj thirrje të Omerit r.a nuk iu përgjigj askush, nuk guxoi askush të konfrontohet me të, sepse të gjithë ia kishin frikën atij. Omeri r.a ishte i tillë i ashpër edhe në Medinë për të pafetë, shikonte dhe përcillte çdo lëvizje të njerëzve hipokritë, por ishte i mëshirshëm ndaj atyre njerëzve që ishin myslimanë të mirë. Muhamedi a.s e ka respektuar pa

² Safijurrahman el Mubarekfuri, Nektari i vulosur i Xhenetit, Komiteti i bashkuar saudit, Prishtine, f. 121.

masë Omerin r.a. Me të ka marrë pjesë në shumë beteja të rëndësishme, siç ishte beteja e Uhudit pastaj në betejën e Hunejnit etj.

Zgjuarsia e Omerit r.a

Omeri r.a ishte i zgjuar dhe mendjekthjellët, këtë e dëshmon edhe Zoti në Kur'an. Muhamedi a.s lidhur me këtë thotë:

“Nëse ndokush pas meje do të ishte transmetues dhe inspirues lidhur me disa gjëra të fshehta ai do të ishte Omeri r.a”.

Këtë e ka dëshmuar shpallja e disa ajeteve të Kur'anit në përputhje me mendjen e tij, në të shumtën e rasteve në përmbajtjen e dispozitave të shariatit islam, do t'i përmendim disa të tilla si më të rëndësishme.

Ndalimi i alkoolit

Duke parë shkaqet dhe pasojat e atyre që pinin alkool, Omeri r.a i lutej Zotit pandërprerë që të ndalojë këtë veti të keqe, duke iu drejtuar me këto fjalë. “O Zot na sqaro çështjen e pirjes së alkoolit dhe na ofro një zgjidhje bindëse për të!”

Lidhur me shpjegimin e pasojave dhe dëmet që sjell alkooli kanë zbritur dy versete (ajete) të Kur'anit. Për t'iu treguar myslimanëve se sa është gabim dhe mëkat i madh për njeriun përdorimi i alkoolit dhe loja e bixhozit. Si udhëzime kanë arritur këto ajete:

﴿يَسْأَلُونَكَ عَنِ الْخَمْرِ وَالْمَيْسِرِ ۖ قُلْ فِيهِمَا إِثْمٌ كَبِيرٌ وَمَنْفَعَةٌ لِلنَّاسِ وَإِثْمُهُمَا أَكْبَرُ مِنْ نَفْعِهِمَا﴾

“Të pyesin ty për verën dhe bixhozin. Thuaj: Që të dyja janë mëkat i madh, e ka edhe dobi në to (të pakta materiale) për njerëz, por dëmi i tyre është më i madh se dobia...”³

Ajeti i dytë thotë:

³ El-Bekare 219.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَقْرَبُوا الصَّلَاةَ وَأَنْتُمْ سُكَرَىٰ حَتَّىٰ تَعْلَمُوا مَا تَقُولُونَ وَلَا جُنُبًا إِلَّا عَابِرِي سَبِيلٍ حَتَّىٰ تَغْتَسِلُوا

“O ju që besuat, mos ju afroni namazit duke qenë të dehur, derisa të dini se ç’flisni, e as duke qenë xhunube (të papastër) derisa të pastroheni...”⁴

Pas një kohe jo edhe as të gjatë zbriti ajeti i tretë kur’anor që e sqaroi krejtësisht çështjen e alkoolit dhe nuk la fije dyshimi në të.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا إِنَّمَا الْحَمْرُ وَالْمَيْسِرُ وَالْأَنْصَابُ وَالْأَزْلَامُ رِجْسٌ مِّنْ عَمَلِ الشَّيْطَانِ فَاجْتَنِبُوهُ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ

“O ju që besuat, s’ka dyshim se vena, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall), janë vepra të ndyta të shejtanit. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar.”⁵

Me këtë ajet Zoti xh.sh e ndaloi rreptësisht pirjen e alkoolit si dhe lojërat e bixhozit, ndërkaq ky ajet është vendimtar për çdo mysliman që të largohet njëherë e përgjithmonë nga kjo veti e keqe.

Mbulimi i femrave

Omeri r.a në përgjithësi ka qenë shumë i ashpër dhe xheloz për femrat e të gjithë myslimanëve, posaçërisht për gratë e Muhamedit a.s. Ai kishte dëshirë që gratë e myslimanëve të jenë të mbuluara, e më tepër dëshironte që gratë e pejgamberit a.s të mos jenë të zbuluara. Ai këtë iniciativë të tij e sqaronte me argumente bindëse, se kur është femra e zbuluar është e pamundur që epsi i njeriut të jetë i pastër nga veprat e ndyra.

Omeri r.a gjithnjë ka folur për mbulesën e femrave, madje ai vazhdimisht çështjen e mbulesës së femrave e bisedonte edhe me Muhamedin a.s. Njëherë Muhamedit a.s i kishte thënë:

⁴ En-Nisaë 43.

⁵ El-Maide 90.

“O pejgamber i Zotit te ju po vijnë njerëz të mirë dhe njerëz të këqij, po të kishim urdhëresë nga ana juaj do të ishte shumë më mirë”. Shpeshherë në këtë mënyrë Omeri r.a kërkonte zgjidhje definitive. Një ditë Zejnebja, gruaja e Muhamedit a.s i kishte thënë: Omer, ti po dëshiron që urdhrin tënd ta zbatosh në këtë shtëpi, ku vazhdimisht vijnë shpallje nga Zoti xh.sh.

Pas një kohe nga Zoti xh.sh zbriti ajeti i Kur’anit:

وَإِذَا سَأَلْتُمُوهُنَّ مَتَاعًا فَسْأَلُوهُنَّ مِنْ وَرَاءِ حِجَابٍ ذَلِكُمْ أَطْهَرُ لِقُلُوبِكُمْ وَقُلُوبِهِنَّ

“E kur kërkonit prej tyre (grave të Pejgamberit) ndonjë send, atë ta kërkonit pas perdes, kjo është më pastër për zemrat tuaja dhe të tyre.”⁶

Mbulimi i femrës myslimane është obligim nga i madhi Zot xh.sh, andaj pikërisht me zgjuarsinë e Omerit r.a u rregullua edhe çështja e mbulimit të pjesëve të caktuara të trupit, ja si thotë ajeti për këtë çështje:

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ قُلْ لِّأَزْوَاجِكَ وَبَنَاتِكَ وَنِسَاءِ الْمُؤْمِنِينَ يُدْنِينَ عَلَيْهِنَّ مِنْ جَلِيبِهَا ۚ ذَٰلِكَ أَدْنَىٰ أَنْ يُعْرَفْنَ فَلَا يُؤْذَيْنَ ۚ وَكَانَ اللَّهُ غَفُورًا رَحِيمًا

“O ti Pejgamber, thuaju grave tua, bijave tua dhe grave të besimtarëve le të vënë (mbulojnë) e veta mbi trupin e tyre, pse kjo është më afër që ato të njihen (se nuk janë rrugaçe) e të mos ofendohen. Allahu fal gabimet e kaluara, Ai është mëshirues.”⁷

Ky është ajeti që zbriti për parandalimin e zhveshjes së motrës myslimane. Në islam Zoti ndaloi zbulimin e pjesëve të caktuara të trupit për të parandaluar më të keqen, si rezultat i zhveshjes përhapet binaja, për këtë në islam ndalohen gjërat që nga fillimi pa ardhur te më e keqja.

⁶ El-Ahzabë 53.

⁷ El-Ahzabë 59.

Lejimi-Marrja e lejes

Zgjuarsia e Omerit r.a siç duket nuk ka të ndalur, Allahu e begatoi atë me këtë mendjehollësi. Transmetohet se Muhamedi a.s herët në mëngjes e kishte dërguar tek Omeri r.a një djalosh të enësarëve, pasi trokiti djaloshi në derë hyri brenda dhe gjeti Omerin r.a duke fjetur. Pasi u zgjua Omeri nga gjumi tha:

“Kam dëshirë që Zoti ta ndalojë hyrjen pa leje në këtë kohë të fëmijëve tanë, grave tona dhe robërve tanë.”

Djaloshi pasi u kthye te Muhamedi a.s i tregoi fjalët e Omerit r.a që ai ia kishte thënë. Po në atë çast kishte arritur ajeti për marrjen së lejes për hyrje, qoftë ajo shtëpi apo kudo qoftë duhet që së pari të marrim leje për hyrje. Fjalët e Zotit xh.sh janë këto:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لِيَسْتَفْذِنَكُمْ الَّذِينَ مَلَكَتْ أَيْمَانُكُمْ وَالَّذِينَ لَمْ يَبْلُغُوا الْحُلُمَ مِنْكُمْ ثَلَاثَ مَرَّاتٍ مِّن قَبْلِ صَلَاةِ الْفَجْرِ وَحِينَ تَضَعُونَ ثِيَابَكُمْ مِّنَ الظَّهِيرَةِ وَمِن بَعْدِ صَلَاةِ الْعِشَاءِ

“O besimtarë juve duhet t’u kërkojnë leje tri herë, ata që janë nën kompetencat tuaja, dhe ata të cilët nuk e kane arritur moshën e pjekurisë. Para faljes së sabahut dhe në kohë të drekës, kur i hiqni rrobat tuaja nga të nxehtit dhe pas faljes së jacisë, pa tjetër duhet të kërkonit leje.”⁸

Pejgamberi a.s e ka lavdëruar Omerin r.a me këto fjalë.

“Zoti xh.sh e ka dërguar të vërtetën në gjuhën dhe në zemrën e Omerit r.a dhe e ka quajtur Faruke, që do të thotë ndarës i të drejtës, i së vërtetës nga e padrejta dhe e pavërteta.” Omeri r.a ka qenë shok i ngushtë i pejgamberit a.s dhe Ebu Bekrite r.a.

⁸ Nurë 58.

Omeri r.a udhëheqës i shtetit Islam

Pas vdekjes së pejgamberit a.s dhe Ebu Bekrit r.a, të cilët ishin udhëheqës të njohur islamë që lanë gjurmë në historinë e udhëheqjes së drejtë e të sinqertë, vjen Omeri r.a, i cili po ashtu ishte i njohur për udhëheqjen e shtetit islam. Omeri r.a pasi mori sundimin në duart e veta, ai siguroi kufijtë e shtetit, dërgoi ushtarë të fuqishëm (të armatosur) në luftë kundër Perandorisë së Romës dhe kundër shtetit të Persisë.

Duke u mbështetur në aftësitë e veta, si dhe të bashkëpunëtorëve të tij, e më tepër me ndihmën e Zotit xh.sh, ai arriti t'i nënshtrojë perandoritë më të fuqishme të asaj kohe, Persinë dhe një pjesë të konsiderueshme të Perandorisë Romake. Nën sundimin e shtetit islam, në kohën e Omerit r.a ishin: tokat e Sirisë, të Palestinës dhe të Egjiptit, dhe gjithnjë zgjeroheshin kufijtë e shtetit islam.

Në këtë shtet të gjithë ishin të lumtur, të gjithë popujt ishin të bindur në mirësinë dhe parimin e sundimit të drejtë të Omerit r.a, këta përjetonin një jetë të lumtur, që kurrë më parë nuk e kishin përjetuar e as që i kishin gëzuar këto të drejta.

Epoka dhe historia arabe

Me ndikimin e Omerit r.a u vendos Epoka Arabe, apo historia e lavdishme e tyre, që e morën ditën e emigrimit të Muhamedit a.s, si vit i llogaritjes historike për gjithë myslimanët arabë dhe popujt tjerë, që ishin deklaruar se kishin pranuar fenë islame. Para kësaj kohe arabët si llogaritje historike e merrnin vitin e fundit, pikërisht vitin kur u lind Muhamedi a.s, atëherë pra kur pati vendosur mbreti i Jemenit Ebrehe për ta shkatërruar Çaben, atë vit e quanin si vit të fundit llogaritës.

Në disa raste për llogaritje të kohës merrnin edhe disa ngjarje tjera para se të vendosej data historike e migrimit të Muhamedit a.s.

Omeri r.a një ditë i tuboi arabët dhe i pyeti se çfarë viti historik do të marrim. Ai propozoi që të jetë dita e emigrimit si ditë historike, e për ne tha ai le të shënohet si epokë historike, duke e konsideruar si ditë më të rëndësishme për gjithë arabët dhe myslimanët në mbarë botën. Prandaj, prej asaj kohe Muhamedin a.s së bashku me shokët e vet me entuziazmin më të madh filluan celulat e para për themelimin e shtetit islam dhe zgjerimin e tij jashtë vendit, gjë e cila pas një kohe u bë realitet. Këtë kohë llogaritëse unanimisht e pranuan të gjithë që ishin prezentë me Omerin r.a në atë tubim madhështor. Kjo ngjarje u shënua si fillim i kalendarit historik për gjithë myslimanët e botës.

Kujdesi i Omerit r.a për pasurinë e myslimanëve

Omeri r.a ka qenë mbrojtës dhe mbikëqyrës i kujdesshëm i pasurisë së myslimanëve dhe mbarë pronave si dhe i fondeve të shoqërisë myslimane, ai shpeshherë thoshte:

“Unë e çmoj pasurinë e myslimanëve dhe mbarë fondin islam, si pasuri të jetimit, nëse nuk kam nevojë kurrë nuk marr në të, por nëse kam nevojë e shfrytëzoj në mënyrë racionale, dhe marr vetëm aq sa kam nevojë”.

Një rast e tregon Rebije ibën Zijadi, i cili njëherë kishte shkuar tek Omeri r.a dhe ishte habitur me qëndrimin modest të tij. Rebije, i habitur me modestin e Omerit r.a tha:

“O Omer, o prijës i myslimanëve, a nuk është e drejtë e jona, që të ushqehemi më mirë, e të vishemi me rroba të këndshme e të bëjmë një jetë të qetë?”

Omeri r.a ishte mbështetur, duke mbajtur në dorë një shkop u drejtua dhe e preku Rebien në kokë dhe i tha:

“Për Zotin nuk kam pasur qëllim tjetër, pos që të afrojmë afër meje, a dëshiron që unë të tregoj shembullin tim dhe të vëllezërve myslimanë. Ne jemi si një njeri që ka udhëtuar diku, e pasurinë e vet e ka lënë në duar të dikujt tjetër që ai ta shpenzojë. A bën që ai ta shpenzojë atë pasuri pa kurrfarë parimi, pa masë e pa nevojë”.

Rebia u përgjigj se jo.

Atëherë ndërhyri Omeri r.a:

“Njësoj është shpenzimi ynë pa nevojë dhe në mënyrë joracionale e pasurisë së myslimanëve.”

Me këtë kujdes ndaj shtetit dhe pasurisë së tij Omeri r.a arriti sëmptatinë e popullit të tij dhe të gjithë ishin të kënaqur me udhëheqjen e tij.

Sjelljet e Omerit r.a me misionarët e vet

Omeri r.a hartoi një statut, të cilin ua dërgoi misionarëve të tij, që të vepronin sipas tij, duke i porositur:

“Veproni dhe silluni ndaj njerëzve në mënyrë të barabartë, të largët konsiderojeni si të afërt, pra për të gjithë njerëzit të ketë barazi, të keni kriter. Të keni kujdes ndaj shpenzimeve të panevojshme, ndaj gjykit të pabazë, pikërisht të akuzave të pabaza! Të mos keqtrajtohen njerëzit, kur janë të hidhëruar!

Omeri r.a i dërgoi një shkresë edhe misionarit të tij Ebu Musa El-Eshariut duke i thënë:

“Mbikëqyrësi ma i lumtur është ai kur populli është i lumtur nga sundimi i tij. Të keni kujdes nga argëtimi i tepërt, sepse qytetarët nuk do t’u përmbahen rregullave të sundimit tuaj, e nuk do t’i përfillin urdhrat tuaja!”

Nga këto udhëzime të tij ne mund të nënkuptojmë se Omeri r.a gjatë sundimit të tij ishte sundues i drejtë dhe personalitet i dalluar. Ai e ndiente veten shumë të obliguar para Zotit xh.sh dhe prekej shumë nëse dikujt i bëhej ndonjë e padrejtë, nga ana e atyre që ishin në pushtet. Ai me këtë sjellje të shkëlqyeshme dhe me këto metoda të dalluara ka mundur t’i realizojë qëllimet e tij të drejta, ku populli jetonte i qetë dhe i sigurt në atë shtet të fortë e stabil, ku dominonin e drejta, preciziteti e kjo arrihej me frikë ndaj Allahut xh.sh.

Ai konsideronte obligim të domosdoshëm që në çdo provincë të zbatoheshin e drejta, nuk i harronte asnjëherë obligimet që i kishte marrë përsipër. Njëherë Omeri r.a u kishte thënë këshilltarëve të vet:

“Çka mendoni ju nëse unë ju udhëzoj që të bëni vepra të mira? “Urdhri im është që të zbatoni të drejtën, të veproni drejt dhe mirë në kryerjen e çdo pune. Në fund po ju pyes: A e keni kryer obligimin tim?” Ata u përgjigjën pozitivisht. Pastaj Omeri r.a iu drejtua atyre me këto fjalë:

“Jo, derisa unë nuk shoh rezultatet e këshillave të mia a janë përfillur ato në nivel të duhur, unë nuk bindem me premtime por, për çdo gjë më tepër bazohem në vepra, se a është kryer një punë si duhet a jo...”

Omeri r.a i konsultonte dhe ua bënte llogaritë përfundimtare misionarëve të vet, të cilët sundonin në shumë provinca të shtetit islam. Këto llogari i bënte në mënyrë precize, në mënyrë të saktë ua llogariste pasurinë atyre mëkëmbësve që i caktonte në detyra të reja, si dhe atyre që ktheheshin nga misionet e kryera nëpër provincat e ndryshme të shtetit islam. Nëse te dikush kishte humbje, ata mëkëmbës sanksionoheshin me masa ndëshkuese përkatëse.

Atje ku kishte tepriçë, këto në mënyrë parimore ktheheshin në arkën e shtetit. Ata që kishin lëshime në punën e tyre, varësisht nga shkalla e lëshimeve të bëra, merrej edhe masa ndëshkimore ndaj tyre, dënimet ia shqiptonte në mënyrë publike, ashtu që pasardhësit tjerë të merrnin mësim.

Rregullimi dhe stabiliteti ekonomik i shtetit

Pas stabilizimit të shtetit dhe pasi që përforcoi kufijtë e shtetit islam dhe rregullimin e tij të brendshëm, bëri shtypjen e disa regjistrave dhe në shumë qytete i vuri në përdorim regjistrat e kontabilitetit, gjë që shumë vende vonë e njohin këtë formë të kontrollit të të hyrave, kështu që nga aspekti ekonomik rregulloi çështjen e mbikëqyrjes së tregjeve. Të gjitha shitblerjet që bëheshin ishin nën mbikëqyrjen e shtetit, kjo përmirësoi gjendjen e popullit në çdo fushë. Ndërtoi shumë bujtina në qytete, si në vendbanime të vogla po ashtu edhe nëpër vende më shumë të frekuentuara nga njerëzit, ndërkaq nga të ardhurat e realizuara të bujtinave krijoi fonde të posaçme.

Kishte një interesim të jashtëzakonshëm për mirëqenien e popullit të vet, në çdo çaste ditë e natë, gjithnjë interesohej për prosperitetin e tërë banorëve të shtetit islam. Omeri gjithnjë ishte i mprehtë dhe syçelë ndaj të gjitha problemeve që paraqiteshin. Çdo problem që paraqitej e zgjidhte me mençuri dhe precizitet. Në tërësi i mbronte interesat e popullit, në mënyrë të palodhshme angazhohej në çdo sferë të jetës, duke qenë në shërbim të shtetit.

Përfundimi i jetës së Omerit r.a

Askush nuk kishte besuar se jeta e Omerit r.a, të birit të Hatabit do të mbaronte në atë mënyrë. Ai ishte personaliteti më i drejtë dhe më i devotshëm i kohës së tij. Një ditë herët në mëngjes doli për ta falur namazin e sabahut, ajo ditë ishte ditë e mërkurë, më 23 dhulhixhe, duke u bërë gati për të dalë imam në atë çast e theri me thikë Fejrui, i quajtur Ebu Lulu. Nga këto plagë të rënda Omeri r.a vdiq!

Sipas historianëve, tregohet se Ebu Luluja një ditë paska shkuar tek Omeri r.a për t'u ankuar, se zotëria i tij Mugire ibn Shuebe, ia kishte parashtruar si obligim që çdo ditë t'ia japë nga dy dërrhem. Omeri e pyeti atë, për profesionin e tij, ai u përgjigj:

“Unë me profesion jam zdrukthëtar, farkëtar dhe piktor”.

Omerit r.a, aspak nuk i shkoi ndërmend se ai do të jetë dorasi i tij. Në realitet mbytja e Omerit r.a ishte një komplot i planifikuar i kundërshtarëve të fesë dhe i hipokritëve, që i kishin zemrat plot urrejtje ndaj myslimanëve, e aq më tepër kundër sunduesve dhe udhëheqësve myslimanë. Megjithëse Omeri r.a ishte i plagosur rëndë, nga plagët që ia sollën vdekjen, ai nuk u largua nga namazi, por në atë moment e urdhëroi Abdurrahman ibn Afiin, që t'ua falë namazin e sabahut të pranishmëve në faltore. Në ato çaste të vështira ai nuk harroi t'i udhëzojë bashkëpunëtorët më të afërt për çështjen e pasardhësit të tij. Ai zuri në gojë gjashtë personalitete më të aftë, ata ishin: Osman ibn Afani, Ali ibn Ebutalibi, Zubejr ibn Avami, Talha ibn Ubejdullahu, Abdurrahman ibn Afani dhe Seid ibn Vekasi dhe e porosi djalin e vet Abdullahun që të angazhohej në zgjedhjen e udhëheqësit, pra njëri në mesin

e atyre gjashtë personave e ai të mos ketë të drejtë të zgjidhej, por të ndihmojë zgjedhjen e tyre. Këta gjashtë As-habë i caktoi Omeri r.a. Zoti pastë mëshirë në të për arsye se pas vdekjes së Muhamedit a.s ai ishte shumë i kënaqur me sjelljet, aktivitetin dhe veprimtarinë e gjithmbarshme të tyre në prosperitetin e shtetit islam. Në këtë mënyrë ndërroi jetë Omeri r.a, Zoti pastë mëshirë ndaj tij, u varros pranë varrit të pejgamberit a.s dhe Ebu-Bekrit r.a në Medine.

Shënim

Myderriz Ismet ef. Liana, kishte një diapazon të gjerë të njohurive, ishte modest, i durueshëm dhe mjaft inteligjent. Ishte edhe anëtar i Shoqatës së Ulemave pranë Këshillit të Prishtinës, i cili veçohej me angazhimin dhe punën e tij të palodhshme, si në shkrime po ashtu edhe në shpërndarjen e literaturës së atëhershme. Përveç gjuhës amtare, mjaft bukur dhe rrjedhshëm njihte gjuhën arabe. Shkrimet të cilat Myderrizi kishte arritur t'i botonte në revistën “Dituria Islame” ishin: Në lëmin e fikhut kishte përkthyer një artikull për Namazin⁹, po ashtu kishte filluar të shkruante për biografinë e pasardhësve të pejgamberit a.s, si personalitete të shquara të fesë islame. “Në shoqërinë e As-habve të pejgamberit a.s.” Ebu Beker Es-sidiku¹⁰, të cilën e kishte botuar. Kishte shkruar edhe për Omer ibn Hatabin, Osman ibn Afanin, Ali ibn Ebi Talibin, Lajmi-Marrija e lejes, por nuk kishte arritur t'i botonte, janë mbetur si dorëshkrime. Ne jemi munduar që me mundësitë tona t'i rishikojmë dhe me lejen e Zotit t'i botojmë ato dorëshkrime të gjitha, në mesin e tyre është edhe ky.

*Përgatiti për shtyp:
Refik Vitia*

⁹ Përktheu: Ismet Limani, Namazi, “Dituria Islame”, Nr.37, Maj, Prishtinë, 1992, f. 14.

¹⁰ Ismet Limani, Në shoqërinë e as-habve të Pejgamberit a.s, “Dituria Islame”, Nr.17, Gusht, Prishtinë. 1990, f 11-14.

Ismet ef. Limani

UMAR IBN AL-KHATTAB

(Summary)

Umar was the son of al-Khattab. The title al-Farouq was conferred on him. He was born and raised in a family which was held in great respect and was equipped with the greatest human virtues. Umar showed great frankness of manner and loyalty. He appreciated the truth and benevolence and was a worthy opponent to any kind of injustice. He enjoyed great authority in the times of ignorance and held a high position, acting as an agent of the Quraish in talks with other tribes.

عصمت ليماني

عمر بن خطاب رضى الله عنه

(خلاصة البحث)

عمر بن خطاب بن نوفيل هو مشهور باللقب الفاروق ولد و تربى فى عائلة كبيرة عرفت باخلاق الكريمة و بصفة خاصة فلا الصدق و الامانة . و كان يقدر و يضمن الحقيقة و الكرامة و كان من أشد المنتقدين الى كل أنواع الظلم . و كان فى عصر لجاهلية يتمتع بشرف عظيم و كان له مكانة عالية ممثلا لقبيلة القريش فى محادثات حول الحروب التى كانت تدور بين قريش و القبائل الاخرى العربية.

HISTORIOGRAFI

Zachary Karabell

XHIHADI I SALAHUDINIT?

Ushtarët u shfaqën në periferi të Jerusalemit në fund të shtatorit, pak para vjeshtës solstike më 1187. Kishin kaluar gati një shekull që kur frankët kishin pushtuar qytetin, dhe asnjë ushtri myslimane nuk kishte qenë afër rimarrjes së tij. Pas masakrimit të ish-banorëve të tij më 1099, mbretëria e Jerusalemit hyri në një periudhë të gjatë të qetësisë dhe prosperitetit. Pelegrinët nga Evropa vinin e shkonin lirshëm, dhe mbreti merrte haraçin e qyteteve dhe zotëronte bregdetin e Palestinës.

Gjatë dekadave, megjithatë, frankët dështuan të zgjerojnë fitoret e tyre të para. Në vjeshtën e vitit 1187, megjithëse sundimtarët në Jerusalemin ishin të vetëdijshëm për kërcënimin e afërt, ata ishin akoma të përgatitur keq, kur më në fund arriti në muret e tyre. Shtylla e ushtrisë së mbretërisë ishte shkatërruar vetëm disa muaj më parë, kur Salahudini, sulltani i Egjiptit dhe sundimtari i Damaskut dhe Alepit, asgjësoi ushtritë e Templarëve dhe frankëve në betejën e Hatinit. Mbreti i Jerusalemit u kap dhe u mbajt peng, ndërkaq administrata e qytetit iu la mbretëreshës, Sibylla, dhe patriarkut. Fjala për avancimin e Salahudinit në Jerusalemin, pas një sulmi në Askalan, i parapriu arritjes së tij,

por mbretëresha nuk mund të bënte asgjë veçse të shikonte qytetin nën rrethim.

Për pjesën e tij, Salahudini ishte fitues me madhështinë e asaj që ishte gati të arrinte. Ai, gjatë pesëmbëdhjetë vjetëve të mëparshme, ndryshoi peizazhin politik të Lindjes së Afërt dhe krijoi një dinasti të re që bashkoi Egjiptin dhe Sirinë për herë të parë në shekuj. Gjatë vjetëve të betejave taktike kundër të krishterëve dhe myslimanëve, ai kishte një qëllim në mendje: dëbimin e frankëve dhe krijimin e një perandorie të re me veten si sulltan në shërbim të Zotit. Tani, me ushtritë e tij të rreshtuara dhe të përgatitura për të pushtuar Jerusalemin, ai kujtoi se pse ishte aty në radhë të parë.

Vetëm disa javë më parë, jashtë Askalanit, një delegacion i tregtarëve nga Jerusalemi iu drejtua atij me një ofertë paqeje. Propozimi i tyre ishte që pasuria e Jerusalemit të mbetej e pavarur dhe e paprekur, por Salahudini do të bëhej sundimtar i rrethinave të tij. Salahudini, reputacioni i të cilit për drejtësi madje më vonë u bë edhe legjendë, mori me seriozitet sugjerimin e tyre. Ai e dinte se ajo që kishte ndodhur herën e fundit kur qyteti kishte ndryshuar sundimtarët, kur u boshatis dhe vendet e tij të shenjta u kthyen në skena të masakrave, dhe ai nuk dëshironte përsëritje. “Besoj”, i tha delegacionit, “se Jerusalemi është Shtëpi e Zotit, siç besoni ju gjithashtu, dhe unë me vullnet nuk do ta rrethoj Shtëpinë e Zotit apo ta sulmoj”. Ai tha se në këmbim për dorëzimin, ai do t’i lejonte të krishterët të mbanin pronat e tyre dhe një pjesë të tokës. Kjo ishte një ofertë e ngjashme me atë që kishin shpresuar, por ata refuzuan.

Në çdo çast tjetër gjatë shekullit të kaluar, kjo do të nënkuptonte fundin e qytetit dhe banorëve të tij. Por, Salahudini kishte një natyrë tjetër. I vendosur për të nderuar Jerusalemin, ai detyroi Balianin, një fisnik të ngarkuar me detyrën e pamundur të mbrojtjes së qytetit, që të vinte për marrëveshje. Pasi që myslimanët çanë muret, Baliani, i nxitur nga patriarku, shkoi nën flamurin e armëpushimit të tenda e Salahudinit. Armët e vetme që i kishin mbetur ishin fjalët, dhe ai paralajmëroi Salahudin që kalorësit e Jerusalemit, dhe Templarët e Hospitalerët mbi të gjithë, ishin të gatshëm të vdisnin si martirë duke

mbrojtur qytetin. Ata mund të humbnin në fund, tha ai, por do ta bënin këtë shtrenjtë. Salahudini hodhi poshtë paralajmërimin si një blufë të një njeriu të mundur, dhe ia kujtoi Balianit se çka kishte ndodhur kur të krishterët kishin marrë qytetin dekada më parë. A dëshironte Baliani të ishte përgjegjës për një masakër madje edhe më të madhe? Nuk ishte një kërcënim bosh. Salahudini kishte reputacion për tolerancë, por ai gjithashtu kishte shfaqur çaste zemërimi dhe mizorie. Sikur çdo sundimtar i suksesshëm i asaj kohe dhe vendi, ai ishte i aftë për dhunë. I përballur me realitetin e humbjes, frankët u dorëzuan.

Të premten, më 2 tetor 1187, trupat e Salahudinit morën kontrollin e Jerusalemit. Ata ishin shumë të drejtë ndaj të pushtuarve. Mbajtën disiplinën, ndërkaq qyteti ndryshoi pronarët shpejt dhe pa gjak. Njerëzit e Salahudinit rimorën Kubën e Gurtë dhe Xhaminë Al Aksa, dhe ata e bënë këtë në një ditë plotë simbolizëm. Sipas kalendarit mysliman, ishte përvjetori i udhëtimit të natës të Muhamedit, kur, për nder të pasionit të Krishtit, ai u transportua me një krijesë magjike që i ngjante kalit, Burak, në Kubën e Gurtë dhe nga atje në qiell.

Salahudini ishte i nderuar me madhështinë e asaj që kishte arritur. Ai interpretoi rimarrjen e Jerusalemit, si një shenjë të kënaqësisë së Zotit, dhe ishte i vendosur për të shfaqur respektin e tij. Kronistët e mëvonshëm të pallatit u përfshinë vetë në përshkrimin e asaj që ndodhi. Pas sigurimit të qytetit, Salahudini u fokusua në pastrimin e Xhamisë Al Aksa. Pasi ishte e okupuar nga Templarët për aq shumë vjet, kjo nuk ishte një detyrë e lehtë. Por, me njerëz që punonin ditë e natë, ajo u restaurua shpejt. Pastaj, sipas kronistit Imad ad-Din:

Lexuesit e Kur'anit arritën, u bënë lutjet zyrtare, asketët dhe të devotshmit u mblodhën... Ata u bashkuan në grupe për t'u lutur dhe për t'u gjunjëzuar, duke përlutur veten dhe duke rrahur gjokset e tyre, njerëz me pozitë dhe asketë, gjykatës dhe dëshmitarë, fanatikë dhe luftëtarë në Luftën e Shenjtë, duke qëndruar e duke u ulur, duke bërë rojë dhe të vendosur për t'u lutur gjatë natës... Tradicionalistët recituan, oratorët e shenjtë qetësuan zemrat e njerëzve, dijetarët debatuan, avokatët diskutuan, folësit rrëfyn.

Megjithëse një numër i konsiderueshëm i të krishterëve të qytetit u mbajtën për haraç, ata u trajtuan ndershëm. Duke ditur angazhimin e Salahudinit për parimet bazike të Islamit, kjo kishte kuptim. Ai i mori seriozisht urdhrat e Kur'anit rreth Ithtarëve të Librit, dhe kjo mund të kishte udhëzuar zgjedhjen e predikuesit, i cili bëri predikimin e parë në Xhaminë e rishenjtë të Al Aksës: kryegjykatësi i Alepit, i njohur për elokuencën dhe diturinë e tij, i cili mbajti një leksion të pasionuar rreth rëndësisë së Jerusalemit për myslimanët kudo.

“O njerëz”, thirrri ai,

Gëzohuni lajmeve të mira. Zoti është i kënaqur me atë që keni bërë, dhe ky është kulmi i dëshirës së njeriut; Ai ju ka ndihmuar që të ktheni këtë deve të humbur nga rruga e gabuar dhe ta drejtoni në tuftën e Islamit, pasi që të pafetë e kishin keqtrajtuar atë për gati njëqind vjet. Duke iu gëzuar pastrimit të Shtëpisë... Ajo ishte vendbanimi i babait tuaj Ibrahimit (Abraham), vendi ku profeti Muhamed, Zoti e bekoftë, u ngjiti në Qiej, kibla nga e cila jeni drejtuar për t'u falur në fillim të Islamit, vendbanimi i profetëve, streha e të shenjtëve, varri i të shenjtëve, vendi ku ka zbritur shpallja e Zotit, dhe ku gjithë njerëzit duhet të mblidhen në Ditën e Ringjalljes dhe Ditën e Gjykimit... Ai është qyteti në të cilin Zoti ka dërguar shërbëtorët dhe apostujt e tij, dhe Fjala, e cila ka hyrë te Maria dhe Jezusi.¹

Rimarrja e Jerusalemit ishte kulmi i ëndrrës për Salahudin. Në fillim të jetës së tij, ai dedikoi veten unifikimit të Sirisë dhe Egjiptit si një hap i parë i domosdoshëm për një sulm të koordinuar mbi shtetet kryqtare dhe xhevahirin e tyre, mbretërinë e Jerusalemit. Duke veshur mantelin e luftës së shenjtë, ai arriti ambicien e jetës së tij dhe dëboi të krishterët nga Kubeja e Gurtë. Dhe, në atë moment të lavdisë, pre-

¹ Imad al-Din është cituar në Gabrielli, *Arab Historians of the Crusades*, 160ff.; përgjigja e Salahudinit për delegacionin nga Jerusalemi dhe fjalimi i gjykatësit (kadi) të Alepit në xhaminë al-Aksa është cituar në Stanley Lane-Poole, *Saladin: All Powerful Sultan and the Uniter of Islam* (New York: Cooper Square Press, 1898, 2002), 224-25, 236ff., e cila është përkthyer nga Ibn Khallikan. Shih gjithashtu Runciman, *A History of the Crusades*, vol. 2, *The Kingdom of Jerusalem and the Frankish East, 1100-1187*.

dikuesi i tij i zgjedhur bëri një predikim triumfues që lidhte Jerusalemin me traditën biblike të Abrahamit dhe Jezusit.

Jerusalemi ishte i shenjtë për Islamin, pikërisht pasi kishte qenë i shenjtë për hebrejtë dhe të krishterët. Më vonë u bë i shenjtë për Muhamedin dhe komunitetin mysliman, por vetëm për atë se ishte qytet i apostujve. Shkurtimisht, Jerusalemi ishte shenjtëruar në sytë e myslimanëve jo vetëm për këtë, por pasi ishte i shenjtë i të shenjtëve për Ithtarët e Librit. Për Salahudin, Jerusalemi ishte zemër që lidhte Ithtarët e Librit me Islamin. Lufta e tij e shenjtë që kishte bërë kundër shteteve myslimane dhe të krishtera që i dolën rrugës së unifikimit të gjithë komunitetit të besimtarëve - krishterë, hebrej dhe myslimanë - nën flamurin e Islamit dhe shtëpisë së Salahudit.

Kjo është një thirrje e largët se si është parë zakonisht kjo periudhë. Thjesht bardhë e zija jonë kundër tyre, myslimanët kundër të krishterëve, nuk i afrohet shpjegimit se pse Salahudini bëri atë që bëri, dhe kuptimi modern i luftës së shenjtë nuk ndihmon. Megjithatë Salahudini është një nga disa myslimanët historikë, i cili gëzon imazh favorizues në Perëndim, kjo nuk do të thotë se ai kuptohet. Ai mund të ketë qenë një person fisnik krahasuar me bashkëkohësit e tij, por gjithashtu ai ishte njeri i kohës së tij. Ai zhvilloi xhihad kundër pushtuesve të krishterë nga Evropa, si pjesë të një strategjie të madhe për të ndërtuar një dinasti dhe për t'ia kthyer Lindjes së Afërt madhështinë e shekujve VII dhe VIII.

Lufta e shenjtë

Salahudini nuk ishte i pari që përdori gjuhën e luftës së shenjtë, por para tij, ajo ishte e paefektshme. Madje, edhe me dështimin e Kryqëzatës së Dytë, më 1147, dhe paaftësisë së princërve të krishterë për të pushtuar Damaskun, Jerusalemi mbeti i paprekur dhe i pasfiduar. Emirët turq dhe arabë të Sirisë dhe Egjiptit mbetën të paktën po aq të angazhuar në luftimin e njëri-tjetrit, ashtu siç ishin në luftimin e frankëve apo bizantinëve. Diku mes shekullit XII, megjithatë, peizazhi filloi të ndryshojë. Një varg i princërve të fuqishëm turq dhe kurdë u

bashkuan për të formuar shtetin e frikshëm rival të Jerusalemit. Plasaritja e parë që u shfaq në fasadën e frankëve ishte rënia e Edessas, dhe tjetra ishte debakli i të krishterëve në portat e Damaskut gjatë Kryqëzatës së Dytë. Nismëtar i kësaj të çare ishte sundimtari i Alepit, Nur al-Din.

Balanca politike në Lindjen e Afërt ishte përcaktuar nga dy rivalitete: një midis Alepit dhe Damaskut, tjetri midis mbretërisë së Jerusalemit dhe shteteve të afërta myslimane. Në Alep, Nur al-Din i njohur si “Mbreti i Shenjtë”, pasoi babanë e tij, Zengi, më 1146. Babai i tij paraqiste një hije të gjatë, prandaj frikësohej që emiri rival i Damaskut kishte hyrë në aleanca me mbretin e Jerusalemit vetëm për ta frenuar atë. Ky ishte rasti klasik i “armiku i armikut tim është miku im”. Gjithashtu, ky ishte edhe biznesi zakonisht në Lindjen e Afërt në këtë kohë. Një muaj, ushtritë ishin rreshtuar në anën e besimit, dhe të krishterët u bënë ballë myslimanëve. Pastaj, posa të vdisnin disa nga princërit, apo vriteshin, aleancat e vjetra prisheshin dhe formoheshin të reja, që nuk bazoheshin në besim, por në atë se kush çka dëshironte. Në rërenë lëvizëse politike të rajonit, Bizantinët, shpërngulën frankët, ndërprejnë kryqëzatat nga Evropa, Fatimitët e Egjiptit, sulltanët selxhukë dhe emirët arabë garonin për epërsi. I vendosur në mënyrë strategjike në qendër të rrugëve dhe pozitës tregtare midis shteteve frankë të brigjeve të Mesdheut dhe tokës turke, Damasku ishte çmimi kryesor.

Sundimtari i Damaskut, bëri një aleancë të ftohtë me frankët në perëndim dhe kërcënimin e Alepit dhe Nur al-Dinit në veri e lindje, duke u përpjekur ta trajtonte njësoj. Derisa ruajti teknikisht paktin e tij me Jerusalemin, ai në mënyrë agresive u përpoq ta mundte Nur al-Din, i cili përfundimisht u pajtua me partneritet. Kjo prishi balancën midis Damaskut dhe mbretërisë së Jerusalemit, dhe ndihmoi fillimin e Kryqëzatës së Dytë. Nur al-Din pastaj shfrytëzoi rastin e krijuar pas largimit të ushtrive të dështuara të kryqtarëve pas vitit 1147 dhe shtriu sundimin e tij. Shtatë vjet më vonë, ai bëri atë që ushtritë e Kryqëzatës së Dytë nuk e bënë dhe pushtoi Damaskun.

Aneksimi i Damaskut, jo vetëm që transformoi Nur al-Dinin në një nga lojtarët më të fuqishëm në rajon; për shkak të karakterit të tij të pazakontë, por gjithashtu ishte shtytje e ndryshimit në ton. Nur al-Dini ishte më pak i prirë për të akomoduar frankët. Në vend të kësaj, ai dëshironte të largonte perëndimorët e shpërngulur. Ndryshe nga shumica e komandantëve myslimanë, të cilët i frikësoheshin mizorisë së tyre apo talleshin për druajtjen e tyre, por rrallë, nëse ndonjëherë, lavdëroheshin për karakterin e tij, Nur al-Dini lavdërohej për përlulësinë dhe devotshmërinë e tij. Dhe ndryshe nga shumë para tij, ai nxitej jo vetëm nga ambicia, por edhe nga feja.

Imazhi i luftëtarit mysliman duke hyrë në betejë me Kur'anin në një rëndësi mund të jetë i njohur, por për myslimanët e Lindjes së Afërt në shekullin XII, mund të ketë qenë i huaj. Nur al-Dini ishte i shquar, jo pasi ishte model, por për shkak se ishte aq i ndryshëm. Ambicia ishte e zakonshme, por devotshmëria ishte një cilësi e rrallë te një princ. Juristët myslimanë, duke njohur që sundimtarët përdornin Kur'anin kryesisht kur iu konvenonte dhe bënin atë që dëshironin kur nuk duhej, kanë ardhur në konkluzion se është më mirë vuajtja nga mizoritë e të gjallit, madje edhe të sundimtarit të padrejtë, sesa rreziku i kaosit që mund të vijë si pasojë e përpjekjes për ta përmbysur atë.

Rezultati ishte një filozofi politike e akomodimit. Teologët myslimanë ishin hezitues të sfidonin ligjshmërinë e një sundimtari, nëse ka nderuar ai sundimtar apo jo ligjet e Islamit, që rrallë e bënin. Me rënien e fuqisë dhe prestigjit të kalifatit në Bagdad, dijetarët myslimanë adaptuan një qasje pragmatike për komandantët ushtarakë dhe e mbuluan me justifikim religjioz. Kjo nuk ishte tepër e vështirë, duke ditur se Islami, në zemër, përfshin nënshkrimin ndaj autoritetit final, Zotit. Të ballafaquar me ndarje politike, ulemaja theksuan detyrën e myslimanëve për t'iu nënshtruar me bindje sundimtarit. Nëse sundimtari ishte i padrejtë, ai në tekefundit do t'i përgjigjej para Zotit, dhe ndërkohë, ishte përgjegjësi e çdo myslimani t'i bindej autoritetit të sundimtarit. Ulemaja, për pjesën e tyre, kishin detyrë që të siguroheshin se ligji religjioz, Sheriati, të ruhej dhe të nderohej, nëse jo nga sundimtari, atëherë të paktën nga gjykatësit dhe dijetarët.

Karakteri i akomodimit dhe bindjes ishte sfiduar shpesh nga individët, por pa religjion të unifikuar, ulemaja ishin më pak të aftë për t'i rezistuar vullnetit të një sundimtari të veçantë në vend të peshkopëve, kardinalëve dhe papëve në Evropë në atë kohë. Nganjëherë, disa dijetarë do të denonconin sundimtarin për veprimet e tij, por zakonisht nga një distancë. Një gjykatës që jetonte në Bagdad, mund të shante pa rrezik ndonjë emir në Siri, por mund të rrezikonte jetën e tij nëse thoshte të njëjtat gjëra në Damask. Ishin të rrallë individët, të cilët kishin qëndrim kundër shkeljes së perceptuar të ligjeve religjioze nga ndonjë sundimtar, dhe ndodhte edhe më rrallë që ndonjë individ, i cili pastaj nuk duhej të largohej nga zemërimi i sundimtarit.

Për dallim, Evropa në atë kohë ishte në mes të luftës të gjatë disa shekuj midis Kishës dhe shtetit. Kryqëzatat ishin mjete për t'i dhënë fund Kishës Katolike, e cila përdori thirrje për luftë kundër jobesimtarëve, si një mënyrë për të fituar ndikim dhe fuqi. Kryqëzatat ishin zhvilluar jo vetëm kundër myslimanëve në Lindjen e Afërt, por gjithashtu kundër fiseve pagane në Baltik, kundër heretikëve në Evropë, dhe natyrisht kundër myslimanëve në Spanjë. Shumica e këtyre kryqëzatave ishin të nxitura nga kisha dhe papati, të cilët garonin me liderët politikë për pozitë dominuese në shoqëri.

Por në botën myslimane, klasa politike ishte dominuese. Në Bagdad, kalifati abasid vazhdoi përpjekjet për të tërhequr ndjenjat kolektive të pjesëve të botës myslimane, kryesisht për shkak se ishte përkujtues i një uniteti ideal. Fakti se një unitet i tillë rrallë kishte ekzistuar ishte më pak i rëndësishëm se fakti që ideali gjithmonë kishte qenë në qendër. Askush nuk mund të debatonte se bota myslimane kishte qenë e ndarë për shekuj, por dëshira për një komunitet (umet) të bashkuar nuk u venit kurrë. Nëse ndonjë gjë, ajo u rrit më fuqishëm sesa realiteti i botës myslimane që nënvizonte mungesën e tij. Si rezultat, derisa invadimi i kryqtarëve fillimisht nuk çoi në kundërreagim, inspirimet ishin atje. Paaftësia e shteteve myslimane të Lindjes së Afërt për të zmbarsur frankët ishte një përkujtues i zymtë i ndarjeve të tyre. Pas një përgjigje të vakët e tronditëse gjatë pjesës së parë të shekullit XII, liderët politikë dhe ushtarakë të Lindjes së Afërt

nisën të kanalizojnë ankthin dhe e përdorën atë për të krijuar një balancë të re të aftë për të sfiduar pushtuesit.

Është e pamundur të kuptohet ngritja e Nur al-Dinit, dhe pasuesit të tij Salahudinit, me këtë kontekst. Myslimanët nuk ishin të ndarë vetëm përballë të krishterëve perëndimorë, por ata vuanin nga trashëgimia e molisur e përçarjes doktrinare që kishte shqetësuar umetin që nga koha e Aliut dhe formimi i shiitëve. Për sunitët, shteti shiit i Fatimitëve në Egjipt ishte po aq shqetësues sa shtetet kryqtare në Palestinë. Që të dyja përfaqësonin pasojat e tmerrshme të përçarjes. Që të dyja demonstironin atë që mund të ndodhte nëse ndahej umeti.

Kur Nur al-Dini vdiq më 1174, ai u lavdërua kudo në Lindjen e Afërt, si sundimtar i urtë, i matur dhe i devotshëm. Por, nuk ishte menjëherë e qartë se kush do ta pasonte. Kandidati më i mundshëm ishte zëvendësi i tij, Salahudini, guvernatori i Egjiptit, i cili kaloi më shumë se një dekadë, duke u marrë me invadimet e frankëve dhe intrigat e shtetit Fatimit, që u shkatërrua shpejt. Nga viti në vit, Salahudini fitoi më shumë ndikim, i ndihmuar nga vdekja e rastësishme e rivalëve të ndryshëm. Fitoret e tij në fushat e betejave ishin impresionuese, por instinktet e tij politike ishin gjithashtu shumë të mprehta. Pas shumë vjetëve të manovrimit delikat, ai më në fund përfundoi jetën e perandorisë së dobët Fatimite dhe urdhëroi që emri i kalifit fatimit të hiqet nga lutjet e së premtës dhe emri i kalifit abasid sunit të përfshihet në vend të tij. Pastaj, kur dëgjoi për vdekjen e Nur al-Dinit lëvizi me shqetësim.

Ishte e natyrshme për Salahudin që të besonte se ishte trashëgimtar i duhur i Nur al-Dinit. Sikur ish-zotëria i tij, ai deklaroi angazhimin e thellë për të sjellë Lindjen e Afërt nën një sundimtar sunit. Të paktën, kjo është përshtypja që i ka mbijetuar shekujve. Gjykuar nga disa histori bashkëkohore që kanë mbijetuar, është e vështirë të besohet se Salahuni ishte njeri prej mishi e gjaku. Ai ose ishte mjeshtër i propagandës apo ishte vërtet i bekuar me mirësi e bujari dhe i motivuar nga një pasion i sinqertë për të bërë komunitetin mysliman një të tërë. Në të vërtetë, ai mund të ishte që të dyja.

Është ironike se Salahudini është i njohur në Perëndim. Në ditët e tij, ai ishte mbrojtësi më i madh i konceptit të xhihadit në botën myslimane. Sipas fjalëve të njërit nga biografët e tij,

Salahudini ishte tepër i kujdesshëm në zhvillimin e luftës së shenjtë, dhe ajo ishte në mënyrë konstante në mendjen e tij. Ndonjëri mund të betohet me dorën e djathtë pa u frikësuar se po bie në kontradiktë me këtë, që nga koha kur u nis, kishte synim xhihadin, derisa vdiq, ai nuk shpenzoi asnjë monedhë ari apo argjendi përveç në xhihad dhe vepra të mira. Zemra e mendja e tij ishin aq shumë të pushtuara nga ky zell i flaktë për xhihad sa që nuk mund të fliste për asgjë tjetër. Nga dëshira për të luftuar për kauzën e Zotit, ai la pas tij familjen, fëmijët, vendin e shtëpinë e tij.

Përveç që ishte luftëtar i shenjtë i përkushtuar dhe njeri i Zotit, ai ishte “i shoqërueshëm, i sjellshëm dhe i këndshëm... Pastërtia e karakterit të tij ishte gjithmonë e evidente: kur ishte në shoqëri nuk i lejonte askujt të fliste keq në prezencën e tij, duke preferuar të dëgjonte vetëm tiparet e tyre të mira; kur fliste vetë, kurrë nuk ishte i prirë të fyente ndokënd”.²

Nëse kjo nuk mjafton, ai ishte gjithashtu në dukje i pashëm, me sy të bukur e të plotë dhe mjekër të rregulluar. Ai ishte i prirë të sillej me bujari dhe fisnikëri në bashkëveprimet e tij me gra e fëmijë. Është thënë se ai ndante ushqimin e tij me lutësit e vizitorët, në nderim të një zakoni të vjetër të arabëve, në vend se të fshihej prapa ritualeve të përgatitura të monarkëve të mëvonshëm. Ai falej rregullisht dhe publikisht, dhe kënaqej me dëgjimin e ajeteve të Kur'anit të recituara nga lexues të zotë. Ai ishte dyshues ndaj filozofëve dhe mistikëve, të cilët shkonin përtej asaj që kishte diktuar Kur'ani dhe tradita. Është thënë pas vdekjes së tij se një nga pendimet e tij të vetme ishte se kurrë nuk ishte në gjendje të kryente pelegrinazhin në Mekë. Në fund të një liste të gjerë të tipareve të shquara të Salahudinit, të cilat përfshijnë shumë faqe e mijëra fjalë, një nga biografët e tij shpjegoi se ato ishin “thjesht

² Kronika për karakterin e Salahudinit vjen nga Baha al-Din ibn Shaddad, të cituar në Hallam, 155-5.

disa shembuj të tipareve të zemërgjerësisë dhe fisnikërisë së tij. E kam kufizuar veten... me qëllim për të mos zgjatur tepër këtë libër dhe për të mos mërzitur lexuesin”.

Me kalimin e kohës, Salahudini u përball me ushtritë e Kryqëzatës së Tretë, dhe imazhi i tij ishte lustruar në perfeksion. Por, në vitet menjëherë pas vdekjes së Nur al-Dinit, ishin disa që nuk u pajtuan me portretin e lavdisë. Pasi shumica e kronikave që mbijetuan janë biografi shenjtërosh, jo gjithçka që u shkruan për Salahudinin ishte aq lajkatuese. Një satirik ka përshkruar orgjitë e dehura, qatipët budallenj, ministrat gungaçë dhe gjeneralët frikacakë, të cilët luftonin vetëm kur fitorja ishte e sigurt. Sikur karagjozët e pallatit në Evropë, satirikët lejoheshin të përqeshin të fuqishmit, në një pikë. Ana e errët e devotshmërisë së Salahudinit mund të ketë qenë mungesë e humorit për vetveten, dhe ai aq u ofendua nga një përshkrim sa që dëboi autorin. Njeriu i gJORë u lëndua dhe u habit, dhe shkroi një letër të hidhur, ku pyeste se çka kishte bërë për të merituar një trajtim të tillë. “Pse ke dëbuar një njeri të besueshëm, i cili nuk ka bërë asnjë krim dhe as vjedhje? Dëno myezinin (i cili thërret besimtarët të falen) nga tokat tua, nëse po largon të gjithë ata që po flasin të vërtetën”.³

Këto shënime të hidhura, megjithatë, u mbytnë nga kori i lavdërimeve, jo vetëm në kohën e tij, por edhe gjatë gjeneratave të ardhshme. Historianët perëndimorë ishin veçanërisht të impresionuar. Një nga studiuesit kryesor të shekullit XX të historisë së Lindjes së Mesme, H. A. R. Gibb, përmbloodhi trashëgiminë e Salahudinit në gjuhën që do ta bënte krenar një historian të pallatit. “Për një moment të shkurtër, por vendimtar, me mirësinë absolute dhe vendosmërinë e karakterit, ai ngriti Islamin nga brazda e demoralizimit politik”. Lavdërimi i madh nga një zotëri anglez i matur, por asgjë krahasuar me portretin e begatë të lënë nga Edward Gibboni në shekullin XVIII. Gibboni, i cili rrallë hezitoi të përdorë lapsin e tij për t’i bërë vetëvrasje karakterit, lartësoi Salahudinin mbi postin e tij dhe radhën e njerëzimit. Ai shkroi

³ Cituar në Malcolm Cameron Lyons dhe D. E. P. Jackson, *Saladin: The Politics of Holy War* (New York: Cambridge University Press, 1982), 119-20.

se Salahudini, duke qenë i dhënë pas verës dhe grave si i ri, i pa gabimet e rrugëve të tij dhe e transformoi veten.

Veshja e Salahudinit ishte nga leshi i trashë; uji ishte pija e tij e vetme; dhe derisa rivalizonte përmbajtjen, ia kalonte thjeshtësisë së profetit të tij arab (Muhamedit)... Drejtësia e divanit të tij ishte e pranueshme edhe për lutësin më të dobët kundër tij e ministrave të tij... Aq e pakufishme ishte bujaria e tij sa që ndau 12 mijë kuaj në rrethimin e Akras... dhe në një pushtet ushtarak, haraçet pakësohen, dhe qytetarët e pasur, pa frikë apo rrezik, shijojnë frytet e ndërmarrjeve të tyre.

Por, Gibboni nuk ishte i verbër ndaj thelbit të Salahudinit. “Në një epokë fanatike, vetë fanatik, tiparet e singerta të Salahudinit komandonin respektin e të krishterëve; perandori i Gjermanisë mburrej me miqësinë me të; perandori grek (bizantin) kërkonte aleancën e tij; dhe pushtimi i Jerusalemit përhap, dhe ndoshta lartësoi famën e tij në Lindje dhe Perëndim”.⁴

Gibboni, i cili mishëronte vorbullën e kontradiktave që rrjedhin përmes shoqërisë angleze në shekullin XVIII, e cila ishte akoma e lidhur me kishën duke testuar kufijtë e asaj aleance, kuptoi se Salahudini ishte besimtar në thelb dhe krijues i perandorisë. Se cila kishte prioritet në shpirtin e Salahudinit është e pamundur të përcaktohet. Por, është e sigurt të supozohet se ringjallja e një shteti perandorak arab dhe shërbimi ndaj Zotit ishin një dhe të njëjta për të. Ambiciet e tij politike ishte plotësisht në pajtueshmëri me pasionet e tij religjioze, dhe entuziazmi i tij religjioz i dha atij fuqi dhe vendosmëri që shumicës së rivalëve të tij u mungonin.

Disa historianë perëndimorë kanë argumentuar se Salahudini ishte kryesisht pjesë e dinastisë, i cili manipuloi me shëmbëlltyrën dhe gjuhën religjioze për të justifikuar veprimet dhe për të krijuar imazhin e tij. Ata shkruan, drejtësisht, se midis vitit 1174, kur vdiq Nur al-Dini, dhe 1187, kur u mor Jerusalemi, Salahudini kaloi gati tre vjet në më-

⁴ Gibbon është cituar në Hillenbrand, 185. Shih gjithashtu Edward Gibbon, *The Decline and Fall of the Roman Empire*, vol. 3 (New York: Heritage Press, 1946), 2084-85.

nyrë aktive, duke luftuar sundimtarët tjerë myslimanë, dhe pak më shumë se një vit duke luftuar kryqtarët. Madje, edhe duke luftuar myslimanët tjerë, Salahudini përdori justifikimin e luftës së shenjtë. Kundër Fatimitëve shiitë kjo ishte e lehtë: luftërat midis sekteve rivale myslimane ishin saktësisht ishin po aq të këqija dhe ideologjike sa luftërat midis sekteve të krishtera. Dhe duke gjykuar nga Testamenti i Vjetër, luftërat midis fiseve të ndryshme izraelite nuk ishin edhe aq çështje të civilizuara. Por, Salahudini u mbështet gjithashtu në gjuhën e luftës së shenjtë për të bërë të ligjshme fushatat kundër shteteve të tjera myslimane sunite.

Gjatë gjithë karrierës së tij, Salahudini i shkroi letra kalifit abasid në Bagdad, duke shpresuar të merrte bekimin. Madje edhe në mungesë të tij, ai pohonte se po vepronte si shërbëtor besnik i Komandantit të Besimtarëve dhe si shpatë e kalifit. Si i tillë, ai mund të largonte heretikët dhe të sillte qytet-shtetet myslimane endacake të rajonit përsëri në tufën e komunitetit të besimtarëve. Këto qytete që i rezistuan përgjërimit të tij, ai i sulmoi pasi po qëndronin në rrugën e Vullnetit të Zotit. Kur emiri i Mosulit refuzoi të përkulej, Salahudini pohoi se qyteti ishte elementi kyç në planin kryesor. Me Mosulin e sigurt në kampin e Salahudinit, pjesa tjetër e rajonit mund ta ndiqte, pa dyshim siç ndjek nata ditën tjetër. Çdo marrëveshje mund të jepej, dhe pastaj Jerusalemi dhe në fund Kostandinopoja, “derisa fjala e Zotit të jetë supreme dhe kalifati Abasid të shpërndante fjalën e pastër, duke i kthyer kishat në xhami”. Më vonë, ballë për ballë me liderët e Mosulit, Salahudini theksoi se kishte vetëm një arsye që kërkonte qytetin, dhe kjo nuk kishte të bënte asgjë me rrënjët e tij kurde. “Ne kemi ardhur”, deklaroi ai, “për të bashkuar fjalën e Islami dhe për të rikthyer gjërat, duke larguar dallimet”.⁵

Për Salahudin, përfundimet tekefundit justifikonin mjetet. Megjithatë dukej se nuk kishte asnjë kënaqësi në luftë, ai e shihte këtë si

një instrument të domosdoshëm. Në çdo fazë të karrierës së tij, ai ishte i gatshëm të identifikonte se çka duhej për të kaluar në fazën tjetër. Pasi që kishte ngurtësuar pozitën e tij në Egjipt, e dinte se akoma nuk mund të paraqiste një sfidë kredibile për mbretërinë e Jerusalemit. Për të bërë këtë, duheshin burimet e kombinuara të shteteve të ndryshme të Lindjes së Afërt. Nëse nuk i nënshtroheshin vullnetarisht atij, ai do t'i detyronte t'i bashkoheshin atij. Nëse kjo do të thoshte luftë, atëherë ai do të luftonte.

Por, xhihadi i Salahudinit nuk ishte xhihadi i shekullit XXI. Ai nuk ishte luftë e shenjtë e urrejtjes. Ai ishte luftë e rregullimit, luftës për Islam ortodoks më shumë sesa kundër të krishterëve apo kundër myslimanëve, që devijuan nga rruga sunite. Kishte një arsye që Salahudini kaloi më shumë kohë duke luftuar kundër myslimanëve të tjerë - duke përfshirë kultin e egër, fanatik dhe nganjëherë vetëvrasës të Vrasësve, të cilët ishin Al Kaeda e atyre ditëve - sesa bëri kundër të krishterëve. Por, kjo arsye nuk ka të bëjë asgjë me doktrinën. Ajo ishte taktike. Vetëm një Lindje e Afërt myslimane e unifikuar mund të mposhte mbretërinë e krishterë të Jerusalemit.

Nëse lufta e shenjtë kuptohet kryesisht si luftë kundër jomyslimanëve dhe myslimanëve që kanë devijuar, Salahudini nuk ishte shumë koherent. Por, problemi këtu nuk është xhihadi i Salahudinit; por sesi xhihadi është definuar nga perëndimorët dhe myslimanët në botën moderne.

Ashtu si ka evoluar Islami, ashtu ka ndodhur edhe me idenë e xhihadi. Tradicionalisht, ekzistojnë dy lloje të xhihadi në Islam: xhihadi i madh, i cili është lufta individuale për pastërti, dhe xhihadi i vogël, që është fushata kundër atyre që çnderojnë apo humbin komunitetin e besimtarëve. Xhihadi i madh është diçka që të gjithë individët e devotshëm duhet ta zhvillojnë kundër dëshirave të tyre, veçanërisht atyre dëshirave që janë në kundërshtim me leximet kryesore të Kur'anit. Mistikët e Islamit, shpesh kanë folur për xhihadin si një natë e errët e shpirtit, ku luftëtari përballlet me demonët e tij dhe duhet të konfrontohet me ata që të qëndrojnë në rrugën drejt Zotit. Xhihadi i vogël mund të marrë formën e luftës kundër jobesimtarëve, por gjithashtu mund të

⁵ Të dy citimet në Lyons dhe Jackson, 194 dhe 228, janë statistika rreth kohës që kryqtarët e kanë kaluar në fushatën kundër myslimanëve. Gjithashtu, për një portret skeptik të Salahudinit, shih, Andrew Ehrenkreutz, *Saladin* (Albany: State University of New York Press, 1972).

jetë çdo përpjekje e fokusuar për të kthyer shoqërinë myslimane. Lufta është një mjet; reforma politike mund të tjerë tjetri; dhe politikat ekonomike mund të jenë po ashtu.⁶

Kur Salahudini fliste për xhihadin, ai mendonte ribërjen e shoqërisë myslimane në Lindjen e Afërt, pasi që kjo ishte gjëja e duhur për të bërë, dhe pasi vetëm atëherë myslimanët mund të sundonin sërish Jerusalemin. Asnjëherë ai nuk është akuzuar për hipokrizi duke përdorur gjuhën e xhihazit për të avancuar ambiciet e veta, në shkallë të gjerë, pasi ai së pari kujdesej për shtëpinë e tij shpirtërore. Shkurtimisht, dukej se kishte pranuar xhihadin e madh para se të fillonte të voglin. Dhe këtu gjendet shpjegimi se pse Salahudini, luftëtari i shenjtë i pakrahasueshëm, është megjithatë i admiruar në Perëndim dhe mbetet një ikonë në Lindjen e Afërt dhe në shumë pjesë të botës myslimane.

Kryqëzata e tretë

Por, ashtu si ishte edhe vazhdon të jetë i lavdëruar, Salahudini ishte gjithashtu një luftëtar i vërtetë. Admirimi i Salahudinit nga perëndimorët është po aq i mirë dhe i pastër sa që është gati karikaturë. Salahudini real, megjithatë, nuk ishte i prirë gjithmonë të falte armiqet e tij apo t'i trajtonte me butësi. Ai kishte pak tolerancë për mistikët, të cilët refuzonin të luftonin dhe në vend të kësaj i tërhoqi nga shoqëria për të provuar kuptimin e brendshëm të Kur'anit, dhe zhvilloi një urrejtje të ngulitur për të paktën një kundërshtar të krishterë, të quajtur Reynaldi i Châtillonit. Ky Salahudin, gjenerali i zemëruar, komandanti kokëfortë, i cili nuk ishte as kureshtar rreth teologjisë e as i mirë me ata që ishin, ishte lënë mënjanë i sigurt në të kaluarën.

Kjo do të thotë, ai nuk ishte ashtu sado që Reynaldi kishte shkaktuar neverinë. Ai kishte karrierë të ndryshueshme, si një aventurier, kalorës dhe i burgosur politik, i cili u martua më 1176, dhe kështu u bë sundues i njëres prej fortesave më madhështore në Jordani, kështje-

llës Kerak. Gërmadhat e saj ende inspirojnë frikë, të vendosura lart mbi Detin e Vdekur në tokën biblike të Moabit. Para se Reynaldi të bëhej pronar kështjelle, ai ishte i njohur për brutalitetin e tij. Në një rast ishte përfshirë në rrahjen e patriarkut të Antiochit, dhe pastaj ia leu plagët në fytyrë me mjalte, duke e lënë jashtë midis verës në shkretëtirën siriane që të torturohej nga mizat dhe mblodhi ngordhësira derisa u pajtua të paguante një shpërblësë të tepruar. Posa mori kontrollin e kështjellës, Reynaldi siç duket u kënaq me flakjen e armiqve nga mbrojtja e tij.

Salahudini nuk do të brengosej shumë rreth asaj që Reynaldi i bëri patriarkut të Antiochit apo të krishterëve të tjerë që e kundërshtuan, por ai u ofendua nga sulmet e Reynaldit ndaj karvanëve të pelegrinëve të drejtuar për në Mekë. Jo vetëm rruga veri-jugore përmes Sirisë ishte arterie kryesore për pelegrinët, ajo ishte - ashtu siç ka qenë për shekuj - rruga kryesore tregtare. Duke shqetësuar karvanët, duke dëmtuar pelegrinët dhe duke vjedhur gjërat e tyre paraqiste një sfidë serioze për Salahudin. Të njëjtën gjë e bënë sulmet e suksesshme të Reynaldit përgjatë Detit të Kuq. Çdo sundimtar, i cili ka aspirata të pranohet si një sulltan i suksesshëm duhet të jetë në gjendje të mbrojë qasjen në vendin më të shenjtë të Islamit. Nëse Salahudini nuk mund të garantonte sigurinë e pelegrinëve për të bërë haxhin vjetor në Mekë dhe Medinë, ai nuk mund të kërkonte respektin e botës myslimane. Sulmet e Reynaldit gjithashtu rrezikonin të ardhurat e Salahudinit. Mbrojtja e karvanëve do të thoshte jo vetëm respekt, por të drejtën për të mbledhur pagesat modeste për shërbimin.

Sulmet e ndërmarra nga Reynaldi provokuan përgjigje vdekjeprurëse. Salahudini deklaroi luftë, mblodhi një ushtri prej mbi 12 mijë kalorësve dhe sulmoi mbretërinë e Jerusalemit. Frankët, duke njohur seriozitetin e kërcënimit, tejkaluan dallimet e tyre. Konti i Antiochit, i cili kishte flirtuar me Salahudin dhe madje kishte hyrë në aleancë preliminare me të, u bashkua dhe bëri paqe me Templarët dhe Hospitalerët. Shtetet kryqtare mblodhën një ushtri të frikshme, por kjo vetëm se keqësoi humbjen e tyre pasuese. Strategjia e tyre ushtarake ishte keq e konceptuar dhe dëshmoi se nuk pati përshtatje për kundër-

⁶ Shih David Cook, *Understanding Jihad* (Berkeley: University of California Press, 2005); Sayyid Hossein Nars, *Islam: Religion, History and Civilization* (San Francisco: HarperSanFrancisco, 2003), 91ff.

shtarin e tyre. Ata u gënjyen në përballje me Salahudin në vendin që kishte zgjedhur, në terrenin që kishte dëshiruar, dhe në orën që kishte zgjedhur. Rezultati më 1187, ishte një betejë shkatërruese në Cepin e Hattinit, një labirint i kodrave shterpë në perëndim të Detit të Galileut.

Në mëngjesin e 3 korrikut 1187, për ushtritë franke nuk pati agim. Në vend të kësaj, qiejt ishin mbuluar me tym të nxehtë. Ata kishin kaluar ditën paraprake në luginën e thatë të Hattinit, dhe edhe pse e dinin se Salahudini ishte afër, ata nuk e dinin saktësisht se ku. Atë mëngjes, të gllabëruar nga tymi i gjeneruar prej djegies së shkurreve dhe barit të thatë të shkaktuar nga forcat e Salahudit, frankët e çorientuar u rrethuan dhe u asgjësuan. Mbreti i Jerusalemit dhe zotërinjtë e Templarëve dhe Hospitalerëve u kapën rob. Kështu i ndodhi edhe Reynaldit të urryer dhe reliktit të çmuar e të pazëvendësueshëm: një pjese të Kryqit të Vërtetë.

Me të vdekur që ishin akoma në fushëbetejë, të kapurit robër u sollën në tendën e Salahudit. Sipas një kronike franke të asaj që ka ndodhur, Salahudini urdhëroi sjelljen e një shurupi të holluar me ujë në një kupë ari. Ai e shijoi, pastaj ia dha mbretit të pinte, duke i thënë: “Pi fort”. Mbreti piu, si një njeri i etur shumë, dhe pastaj ia dha kupën Princit Reynald. Princi Reynald nuk duhej të pinte. Salahudini u zemërua dhe i tha: “Pi, pasi më kurrë nuk do të pish!”. Princi iu përgjigj se nëse kjo kënaqte Zotin, ai kurrë nuk do të pinte apo hante asgjë nga këto. Salahudini e pyeti: “Princ Reynald, nëse më kishe mbajtur në burgun tënd ashtu siç po të mbaj në timin, çka, sipas ligjit tënd, do të më kishe bërë?” “Le të më ndihmojë Zoti”, iu përgjigj ai, “do të preja kokën”. Salahudini u tërbua shumë me këtë përgjigje të pacipë, dhe tha: “Derr! Ti je i burgosuri im, dhe akoma më përgjigjesh me këtë arrogancë?” Mori shpatën në dorë dhe e goditi drejt e në trup. Memlukët, të cilët po qëndronin afër tij, nxituan dhe ia prenë kokën. Salahudini mori pak gjak dhe e hodhi mbi kokë si praninë se ishte hakmarrë. Pastaj, urdhëroi bartjen e kokës në Damask, dhe ajo u tërhoq zvarrë për t’i treguar saraçinëve, ndaj të cilëve princi kishte bërë padrejtësi, se çfarë hakmarrje pati.

Kronikat myslimane dallojnë vetëm në detajet e vogla. Në një, Salahudini dënoi Reynaldin që sulmoi pelegrinët në rrugën e tyre për në vendet e shenjta të Islamit. Por, të gjithë pajtohen se vetë Salahudini ekzekutoi Reynaldin, dhe pastaj kurseu jetën e mbretit të Jerusalemit dhe të tjerëve.⁷

Fitorja në Hattin hapi rrugën për rënien pasuese të Jerusalemit, e cila nxiti një valë tjetër të ushtrive kryqtare evropiane të vendosura për rikthimin e qytetit. As okupimi i Jerusalemit e as vrasja hakmarrëse e Reynaldit nuk njolloosi reputacionin e Salahudit. Në vend të kësaj, Reynaldi mori goditjen e zemërimit të historisë. Megjithatë disa polemistë bashkëkohorë të krishterë denoncojnë Salahudin dhe e përshkruajnë atë si djall i personifikuar, gjatë kohës ideja e sajuar e propagandës së luftës u zbeh dhe u shfaq një version më i butë.

Në shekullin XIX, Sir Walter Scott ktheu ekzekutimin e Reynaldit në një metaforë për fisnikërinë e Salahudit. Në *Hajmali*, Reynaldi është zotëria i madh i Templarëve dhe hipokrit intrigant besnik i lakmisë së tij të shtrembëruar. Vdekja e tij është prezantuar, jo si një akt hakmarrjeje, por si një vepër heroike. Skena fillon me pritjen e Salahudit për Richard Zemërluanin dhe shpurën e tij në një tendë në fushëbetejë të mbushur me qilima të materialit më të shtrenjtë me jastëk për mysafirët”, së bashku me llamba, sheqerka, “dhe hollësira të tjera të gatimit lindor”. Pastaj, derisa mysafirët shijonin sherbetin e ftohtë, Salahudini papritmas heq nga këllëfi kordhën e tij dhe ia pret kokën zotërisë së madh të Templarëve. Para se mysafirët e tij të tmerruar të nxjerrin shpatat e tyre, Salahudini shpjegon se i vdekuri kishte komplotuar kundër jetës së Richardit. Në këtë histori, Scotti rimodeloi ekzekutimin si një akt altruist të princit, i cili ruante nderin dhe kalorësinë.

Megjithatë, karakteri fisnik, në marrjen e Jerusalemit, Salahudini kishte kapur xhevahirin e kurorës së kryqtarëve. Mbretërit e Evropës, të nxitur nga papa, u përgjigjën me Kryqëzatën e Tretë. Richard Ze-

⁷ Kronika franke e Ernoul, e shkruar në vitin 1197, përkthyer nga Peter Edbury dhe Paul Hayams, në Fordham’s Medieval Sourcebook, www.fordham.edu/halsall/source/1187.ernoul.html. Shih gjithashtu kronikën e Ibn al-Athirit në Gabrielli, 122-25.

mërluani i Anglisë, Philip Augustusi i Francës, dhe Frederick Barbarossa i Gjermanisë u përgatitën për luftë. Deri tani, ideja kryqtare ishte sajuar në fabrikën e Evropës Perëndimore dhe Qendrore. Si asnjë lëvizje atraktive më parë kryesisht për të rinjtë, kryqëzata u bë fokusi qendror për kishën dhe fisnikërinë. Ushtritë e Kryqëzatës së Tretë ishin elita e Gjermanisë, Francës dhe Anglisë, dhe ata mund të kishin pasur sukses, por për fatkeqësinë e Frederick Barbarossas, i cili u mbyt në lum pas fitores bindëse kundër selxhukëve të Anadollit. Rivaliteti midis Richardit dhe Philipit nuk ndihmoi shumë, dhe kokëfortësia e Richardit, derisa ishte në avantazh në fushëbetejë, nuk e bëri atë një aleat të lehtë.

Kryqëzata e Tretë kujtohet, nëse kujtohet fare, për luftën epike midis Richardit dhe Salahudinit. Ushtarakisht, të dy ishin madje të barabartë, por Salahudini, i pjekur, me shkathtësinë e mprehtë si një gjeneral në rënie, ia hodhi Richardit. E vetmja gjë më e keqe se humbja dhe rruga qorre në fushëbetejë është humbja e reputacionit të saj. Këtu humbi Richardi. Megjithëse secili kishte historianë dhe përkrahës pallati, Salahudini u shfaq si kampion i padiskutuar i luftës së propagandës.

Përveç për atmosferën e nxehtë në historinë e Robin Hoodit, mbreti Richard mbijetoi si një sundimtar i patrembur dhe i ashpër i nxitur nga koprracia, epshi dhe tërbimi. Megjithëse kurrë nuk ta dimë sesi ishte në të vërtetë, ndoshta ka më shumë të vërtetë në imazhin që ka mbijetuar. Fëmija i Henryt II, dhe pastaj legjendari Eleanor i Aquitaine, Richardi krijoi një reputacion të hershëm dhe të qëndrueshëm si lider, për të cilin mprehtësia dhe urtësia ishin koncepte të huaja. Kjo nuk ishte çështje e etikës së kohës së luftës, megjithëse edhe këtu, Richardi menaxhoi të ofendojë madje ndjeshmërinë më të egër të kohës së tij. Ajo ishte çështje kulture. Anglia mezi ishte larguar nga konfederatat fisnore analfabete, dhe shoqëria angleze kishte vetëm mbulimin mospërfillës të Krishterimit me shkrim e lexim të vogël të kufizuar në manastire. Egjipti dhe Siria e Salahudinit, në anën tjetër, kishin provuar gjashtë shekuj të sundimit mysliman dhe kishin përfituar nga kultura e lartë e Damaskut dhe Bagdadit. Kjo kulturë, e cila çmonte

letërsinë, artin, shkencën, mjekësinë, astronominë, inxhinierinë, ligjin dhe bujqësinë, ishte ndërtuar mbi themelet e Greqisë, Romës dhe Bizantit, dhe pastaj ishte përzier me traditën e pallatit të Persisë së lashtë. Kryqtarët nuk ia kaluan myslimanëve në aspekte të caktuara – veçanërisht në ndërtimin e kështjellave, dhe jorastësisht, në ndërtimin e mjeteve të rrethimit për t'i kapur ata. Por, në shumicën e aspekteve, rivaliteti midis Richardit dhe Salahudinit, sikur luftimi fillestar midis ushtrive kryqtare dhe myslimanëve të Lindjes së Afërt një shekull më parë, vuri përballë muskulin kundër trurit.

Muskuli nganjëherë kishte një avantazh dallues. Richardi, fizikisht një kuqo madhështor, i cili më vonë më shumë do të vërsulej mbi pre në sesa të komandonte nga lartësitë, sulmoi Lindjen e Afërt nga deti, pushtoi Qipron si një vend të avancuar, dhe pastaj mori Akrën pas një rrethimi të pasinqertë. Komandanti i garnizonit të Akrës u dorëzua para se të merrte urdhrat e Salahudinit që mos ta bënte këtë, dhe Richardi mori kontrollin e një numri të madh të robërve. Rregullat që i trajtonin të burgosurit e luftës ishin të ndershme: do të vendosej haraçi, mjaft i lartë për të qenë fitimprurës për fituesit dhe ndëshkues për humbësit, por jo aq i lartë sa të mos mund të paguhej. Richardi, megjithatë, ishte i shqetësuar për të ruajtur gjendjen momentale dhe dëshironte të avanconte në brendësi. Ai nuk mund të shkonte askund derisa të zgjidhej fati i të burgosurve të tij. Negociatat ndaluan, dhe Richardi vendosi se nuk kishte nevojë për para apo bezdi. Urdhëroi ushtarët e tij të vrisnin tre mijë burra, gra dhe fëmijë të Akrës, të cilët ishin aq fatkeq sa të kapeshin. Një apologjet i krishterë ka thënë se ushtarët – që kërkonin të hakmerreshin për të krishterët e vdekur nga duart e Salahudinit – të gëzuar zbatuan detyrën e heqjes së kokës të zënëve rob”.⁸

⁸ Runciman, *A History of the Crusades*, vol. 3, *The Kingdom of Acre and the Later Crusades*, 53. Për kronistin e krishter shih *Itinerarium Peregrinorum et Gesta Regis Ricardi*, ed. William Stubbs, Rolls Series (London: Longmans, 1864), IV, 2, 4 (pp. 240-41, 243), përkthyer nga James Brundage në *The Crusades: A Documentary History* (Milwaukee: Marquette University Press, 1962), 183-84.

Masakra u ballafaqua me atmosferë miqësie. Për shumë muaj, ushtritë e Richardit dhe Salahudinit luftuan me ndalesa. Të kampuar afër njëri-tjetrit, kalorësit dhe ushtarët e secilës anë u miqësuan gjatë periudhave të gjata të pasivitetit. Sipas disa kronikave, luftëtarët madje mund të ndalonin luftimet midis betejës nëse perceptonin se asnjëra palë nuk ishte në avancim. Armët do të uleshin poshtë; do të kishte konverzacion dhe tregim historish; një anë do të bënte ftesë për darkë. Herëve të tjera, mbaheshin gara për të parë se kush kishte më shumë mjeshtëri në artet e luftës, dhe pastaj të gjithë lartësonin fituesit.⁹

Këto skena nuk përputhen me imazhin e luftëtarëve të egër të Zotit, që konfrontohen kundër njëri-tjetrit me entuziazmin e besimtarëve të vërtetë. Në vend se të gjeneronte zemërim dhe urrejtje, besimi i Salahudinit shpesh krijonte dhembshuri. Ai respektonte gatishmërinë e të krishterëve për të luftuar dhe vdekur për Jerusalemin, dhe njëherësh dërgonte ushtritë për të vrarë sa më shumë që ishte e mundur prej tyre. Dhe me përjashtim të Reynaldit, ai mund të bënte gjithë këtë pa urrejtje. Besimi i tij, nëse duhet të besojmë se ai ishte po aq i sinqertë sa pohojnë kronistët, ishte i bazuar në përlulje. Islami i tij ishte Islami i nënshtrimit, i bazuar në vlerësimin se të gjithë njerëzit janë të gabueshëm dhe të gjithë janë mëkatarë. Zoti është rruga, dhe vetëm Zoti është gjykatësi. Salahudini bëri xhihad për lavdinë e Zotit dhe për Islam, e jo xhihad kundër armiqve të tij. Pati pengesa, por ato nuk ishin objekti.

Të krishterët gjithashtu kundërshtojnë karakterizimin e lehtë. Ata mund të flasin për të këqijat e të pafeve dhe lavdinë në masakrën e tyre. Ata mund të udhëtonin mijëra milje për të kthyer Varrin e Shenjtë nën kontrollin e krishterë dhe për ta pastruar Tokën e Shenjtë nga papastërtia e sundimit mysliman. Ata jo vetëm ishin të gatshëm të miqësoheshin me këta të pafe në ditët e mërzitshme të luftës në verën e nxehtë, por në vjeshtën e vitit 1191, ata ishin të gatshëm gjithashtu të anulonin gjithë këtë dhe të martoheshin.

⁹ Runciman, vol. 3, 27.

Kjo nuk ishte zgjidhja më e kuptueshme, por pas më pak se dy vjet, ushtritë e Richardit ishin tendosur dhe avancimi i frankëve kishte ndaluar. Salahudini kishte absorbuar goditje më të mëdha pa u shkatërruar, dhe veç fitores së tij të përgjakshme në Akra, Richardi kishte bërë pak më shumë sesa sigurimi i bregdetit që deri së fundmi kishte qenë me vendosmëri nën kontrollin e mbretërisë së Jerusalemit. Me Frederick Barbarosën të vdekur, gjermanët ishin në çrregullim, dhe Philip Augustusi ishte sëmurë dhe ishte kthyer në Francë, i kishte mbetur Richardit të sfidonte i vetëm Salahudinin. Por, i erdhi fjala se në Angli, vëllai i tij John po përpiqej t'ia uzurponte fronin, dhe Richardi kishte nevojë të largohej. Ai nuk kishte dëshirë të fitonte në Palestinë vetëm për të humbur fronin e tij në Angli.

Richardi bëri diçka që kishte shumë kuptim për të, megjithëse habiti bashkëkohësit e tij. I shkroi Salahudinit, “Dua të të përshëndes dhe të them se myslimanët dhe frankët po gjakosen deri në vdekje. Vendi është plotësisht i shkatërruar dhe të mirat e jetët janë sakrifikuar te të dyja palët. Ka ardhur koha për të ndaluar këtë. Çështjet kundërshtuese janë Jerusalemi, Kryqi dhe toka”. Richardi deklaroi se nuk mund të largohej pa siguruar të drejtën e krishterëve për t'u lutur lirshëm në Jerusalemin, dhe as nuk mund të largohej pa Kryqin e Vërtetë që ishte marrë nga Salahudini në betejën e Hattinit. Salahudini iu përgjigj shpejt, “Jerusalemi është yni po aq sa është i juaji; në të vërtetë ai është më i shenjtë për ne sesa për ju. Ai është vendi nga i cili profeti ynë përfundoi udhëtimin e tij të natës dhe vendi në të cilin komuniteti ynë do të mbledhet në Ditën e Gjykimit. Mos imagjino se mund ta braktisim atë... Toka ishte fillimisht e jona, ndërsa ju sapo keni ardhur dhe e keni marrë për shkak të dobësisë së myslimanëve që jetonin në atë kohë”. Ndërsa, për kërkesat e tjera të Richardit, Salahudini nuk i tha as po e as jo.

Negociatat pastaj morën një kthesë interesante. Nuk është e qartë se kush propozoi çka, por propozimi ishte i thjeshtë. Motra e Richardit, Joanna e Sicilisë do të martohej me vëllanë e Salahudinit, Seyf ad-Din, dhe të dytë “do të bëheshin monarkë të përbashkët që do të sundonin nga Jerusalemi. Të gjithë të burgosurit që mbaheshin nga të

dy palët do të liroheshin: Kryqi i Vërtetë do të kthehej në Varrin e Shenjtë, dhe Richardi do të lundronte në shtëpi në Angli.

Kur Salahudini dëgjoi kushtet, udhëzoi delegatët e tij të thonë jo, me sa duket për shkak se mendonte se kjo ishte ose kurth ose një shaka. Vëllai i tij e mori idenë me më seriozitet, dhe pa hezitim u pajtua. Pa njohurinë e Richardit, një nga aleatët e tij të mëparshëm po negocionte gjithashtu kushtet me Salahudin, dhe Salahudini, kështu, e dinte se kishte luksin për të vënë kushte nga pozita e fuqisë. Por, oferta e Richardit për dorën e motrës së tij ishte e sinqertë, dhe të paktën për të, i bëri përshtypje të mirë strategjike. Luftërat midis princërve në Evropë shpesh përfundonin me krushqi midis familjeve rivale. Duke bërë fuqishëm fushatë kundër një armiku të denjë, ai vendosi se ishte koha për të ndaluar dhe për të lëvizur përpara. Martesa dukej natyrore dhe e domosdoshme, një komponent për të siguruar një paqe të qëndrueshme.

Kryqtarët e tjerë ishin më pak ekumenikë. Richardi kuptoi se jo vetëm motra e tij kundërshtonte idenë, por ajo kishte mbledhur edhe të tjerët në anën e saj. Atij iu bë presion për të tërhequr ofertën. Në vend të kësaj, ai i shkroi Salahudinit për të ndryshuar propozimin e tij fillestar. “Të krishterët nuk pranojnë martesën e motrës sime pa u konsultuar me Papën”, shkroi Richardi. “Nëse ai autorizon martesën, kjo do të ishte më mirë. Nëse jo, të jap dorën e mbesës sime, për të cilën nuk ka nevojë për pëlqimin e Papës”.

Salahudini, për pjesën e tij, mund të ketë qenë jo i gatshëm të nënshkruante një marrëveshje, duke ditur se lufta të cilës ia kishte kushtuar jetën ishte ende larg nga qëllimi final i dëbimit të frankëve nga Palestina. Por, ai pa rrënojat që kishin shkaktuar luftërat, dhe me Jerusalemin e sigurt në vathën e myslimanëve, u pajtua t’u jepte fund armiqësive. Atij iu përkujtua nga një gjykatës i ditur se madje edhe Kur’ani këshillon bërjen e paqes kur ishte e leverdishme. “Nëse ata anojnë nga paqja, edhe ti duhet të anosh nga ajo”. Sipas Imad ad-Din, Salahudini duhej të bindej nga komandantët e tij se paqja ishte e nevojshme, megjithëse ia kishte kushtuar jetën xhihadit. Ai ishte një portretizim i favorshëm, nëse ishte në mënyrë strikte i vërtetë apo jo, pasi

i lejonte atij të ruante reputacionin si luftëtar, por jo të atij të verbëruar nga entuziazmi saqë nuk mund të bënte atë që ishte më e mira për nënshtetasit e vet.

Rezultat i këtyre negociatave ishte marrëveshja që ua linte frankëve kontrollin e Antiochit, Tripolit dhe pjesës më të madhe të bregdetit. Tregtarët – pavarësisht besimit apo vendit të origjinës së tyre – u lejuan të vazhdonin tregtinë pa iu nënshtruar obligimeve të rënda. Dhe më e rëndësishmja nga të gjitha, Salahudini premtoi se çdo të krishterë që dëshironte të bënte pelegrinazhin në Varrin e Shenjtë në Jerusalem do t’i mundësohej udhëtimi i sigurt dhe hyrja pa pengesa.¹⁰ Me këtë, përfundoi Kryqëzata e Tretë.

Dhe kështu, çka duhet të themi për xhihadin e zhvilluar nga një mysliman i devotshëm kundër një kryqëzate të ndërmarrë nga të krishterët që përfshinte masakra dhe heqje koke, por gati përfundoi me një martesë midis familjeve të dy kundërshtarëve kryesorë. Si duhet të interpretojmë Salahudin, i cili ishte njëkohësisht luftëtar i pakrahësueshëm dhe kundërshtar fisnik i imagjinatës perëndimore për shekuj më pas? Dhe më kompleksja nga të gjitha, si i ngremë idetë bashkëkohore rreth luftës, religjionit dhe Islamit me botën e shekullit XII?

Imazhi i sotëm i xhihadistit, si një individ, identiteti i plotë i të cilit është përfshirë në një ideologji bart vetëm ngjasimin kalues me Salahudin. Në fakt, nocioni i thjeshtë i një ideologjie që dominon të gjitha aspektet e jetës ka qenë i huaj për shumicën e kulturave gjatë gjithë historisë. Në shekullin XII, realitetet ditore të bujqësisë, transportit, strehimit, mbijetesës së sëmundjes dhe luftimit në luftëra të rënda e të lodhshme ishin zakonisht ide njoftimi.

Religjioni dhe besimet ishin një pjesë e kaleidoskopit. Nganjëherë, fjalët e Kur’anit dhe hadithit (traditave) shtynë njerëz si Salahudin të vepronin ashtu siç bënë. Nganjëherë, fjalët e Biblës dhe papës nxitën njerëz si Richardi të luftojnë, apo të mos luftojnë. Por, herëve të tjera, çështjet familjare, sfidat e dinastisë, problemet shëndetësore dhe riva-

¹⁰ Shumica e kronikave për propozimin martesor është marrë nga Baha ad-Din, në Gabrielli, 225-31. Ngurrimi i Salahudinit për t’u pajtuar për marrëveshjen është në Imad ad-Din, gjithashtu në Gabrielli, 236-37.

litetet politike kishin më shumë rëndësi. Nganjëherë njerëzit luftonin me fjalët e tekstit të shenjtë që kumbonte në veshët e tyre; dhe nganjëherë ata takoheshin në fushëbetejë, duke i rënë njëri-tjetrit në shpinë, dhe bënë lojëra.

Para rënies së Jerusalemit më 1187, shtetet kryqtare qeverisnin dhe bashkëjetonin me një popullatë të madhe të krishterë dhe me një popullatë myslimane edhe më të madhe. Rezultati ishte gati ekuivalent me Kordobën, por nuk ishte periudha e konfliktit e definuar nga besimi. Lufta midis Salahudinit dhe Richardit ka shenjë e konfliktit religjioz, por në fund, ajo ishte vetëm një luftë midis sundimtarëve që përfundoi në rrugë qorre dhe gati në paqe të siguruar nga martesat. Rrënja e konfliktit në botën moderne mund të gjendet në kryqëzata, por vetëm duke harruar pjesën më të madhe të asaj që në të vërtetë ka ndodhur.

Derisa lëvizja e kryqëzatave vazhdoi të lulëzojë për mbi një shekull në Evropë, Jerusalemi nuk u kërcënua sërish nga të krishterët perëndimorë. Më 1204, ushtritë e Kryqëzatës së Katërt, të transportuar nga flota veneciane, morën rrugë të tërthorë dhe zbarkuan në Kostandinopojë. Qyteti u grabit dhe u terrorizua nga ushtritë perëndimore, synimi i të cilave ishte çlirimi i Tokës së Shenjtë. Egërsia me të cilën Kryqëzata e Katërt, e kombinuar nga fisnikët francezë dhe gjermanë, sulmoi bastionin e Krishterimit Lindor ishte ndërtuar për shumë vjet. Madje, që kur Alexius Komneni dërgoi Kryqëzatën e Parë në rrugën e saj, fyerja e Bizantit ishte rritur. Venecianët gjithashtu lakmonin pasurinë dhe ndikimin e Bizantit mbi rrugët tregtare detare të Mesdheut.¹¹

Salahudini vdiq shpejt pas largimit të Richardit, dhe djemtë e tij krijuan një dinasti që u shpërnda për një kohë shumë të shkurtër. Pasuesit e tij ishin gjithçka që ai nuk ishte: despotik, hedonist, të padi-siplinuar. Pushtimi pasues mongol që shkatërroi kalifatin abasid më 1258 do të kishte vazhduar në Kajro dhe ndoshta matanë Afrikës Veriore, po të mos kishte qenë ushtria e robërve memlukë, të cilët së pari

mbështetën dhe pastaj përmbysën djemtë e nipërit luksozë të Salahudinit në pallatet e tyre në Kajro. Ushtria memluke ndaloi mongolët në betejën Ain Jalut afër Nazarethit më 1260, dhe kalorësit kurrë nuk kërcënuan më Lindjen e Afërt.

Egjipti i memlukëve ishte një shtet stabil e i prosperuar, i lidhur me tregtinë me Perëndimin e Lindjen falë klasës së tregtarëve të suksesshëm hebrej, të krishterë dhe myslimanë të të gjitha kategorive. Frankët dhe gjermanët kuptuan rëndësinë e Egjiptit, dhe kryqëzatat e mëvonshme të shekullit XIII synuan Egjiptin duke besuar se ishte çelësi strategjik për në Jerusalemin. Këto përpjekje dështuan. Egjipti i zmbrapsi me lehtësi ushtritë e Evropës, dhe Kajroja mbeti e paprekur.

Siguria relative e Kajros ishte magnet, dhe midis shumë personave që joshi ishte një hebre spanjoll nga Kordoba, i cili arriti me pak më shumë se rrobat dhe disa libra të tij, pasi iku nga dhuna e kaosi që kishte gllabëruar atëherë Andaluzinë. Duke parë atdheun e tij të vërshuar nga ushtritë berbere nga Maroku dhe qyteti i tij, Kordoba, të shkatërruar sërish nga flakët, shkoi matanë Mesdheut në Egjipt. Po të kishte mbetur në Kordobë, ndoshta kurrë nuk do të kishte shkruar atë që bëri, apo të mësonte atë që mësoi. Por, pasi u mirëprit në pallatin e Salahudinit, ai lulëzoi, u ngarkua me një trishtim të thellë, por ishte i nxitur nga etja intelektuale. Trashëgimia më e rëndësishme e Salahudinit për Islamit është pushtimi i Jerusalemit. Pa pasur ndonjë qëllim, ai gjithashtu i dha formë evolucionit të Judaizmit modern, kur administratori i pallatit të tij në Kajro punësoi një të ikur hebre, Moses Maimonides, si mjek të pallatit.

Përktheu nga anglishtja:

Fuad Morina

¹¹ Për një kronikë të fundme të shkëlqyer, shih Jonathan Phillips, *The Fourth Crusade and the Sack of Constantinople* (New York: Penguin Group, 2004)

Zachary Karabell

SALADIN'S JIHAD

(Summary)

Saladin's army reached the outskirts of Jerusalem by the end of September 1187. More than a century had passed since the city had fallen to the Franks and no Muslim army had been close to recapture it. After the massacre of the Muslims and Jews in 1099, the Kingdom of Jerusalem entered a long period of calm and prosperity. Pilgrims from Europe could travel freely to the Holy Land. Tribute had to be paid to the king, who controlled the coast of Palestine.

زقارى قرابيل

جهاد صلاح الدين

(خلاصة البحث)

ظهر الجنود في أطراف مدينة القدس في أواخر شهر سبتمبر قبل بضعة أيام من بداية فصل الخريف لسنة ١١٨٧ . قد مر على احتلال الافرنجة للمدينة قرابة قرن و لم يحاول أى حيش اسلامى استرداده . بعد المذبحة الجماعية التى مارسها الافرنجة ضد السكان السابقين للمدينة فى سنة ١٠٩٨ يبدو بأن مملكة القدس قد دخلت فترة طويلة للهدوء و الازدهار . كان الحجاج من اوربا يأتون و يذهبون بحرية تامة و كان الملك يأخذ الضرائب من المدن و كان يسيطر على شاطئ فلسطين .

SHTYPI NË KOHË

Nuridin Ahmeti

SHQIPTARËT PAS LARGIMIT TË PERANDORISË OSMANE, SIPAS SHTYPIT TË KOHËS

Hyrje

Vitet 1912-1913, në literaturën historiografike shqiptare njihen edhe si Periudha e Luftërave Ballkanike, dhe për shkak të ngjarjeve që kanë ndodhur, cilësohen si vitet më tragjike për fatet e popujve të Ballkanit në përgjithësi dhe për fatin e popullit shqiptar në veçanti.

Luftërat Ballkanike nga viti 1945 e deri në ditët e sotme janë objekt studimi të disa studiuesve shqiptarë, si: Arben Puto, Thoma Murzaku, Zekeria Cana, Xheladin Shala etj., duke ofruar fakte dhe analiza shkencore, për rolin e shqiptarëve, pasojat etj., gjatë viteve 1912-1913.¹

Në këtë punim do të paraqesim pasojat e këtyre luftërave shikuar nga prizmi i shtypit shqiptar gjatë viteve 1912-1913, periudhë kjo pas largimit të Perandorisë Osmane nga trojet tona, ardhjen e ushtrive të

Aleancës Ballkanike të Serbisë, Bullgarisë, Greqisë dhe Malit të Zi, dhe veprimet e tyre ndaj popullatës shqiptare dhe pasurisë së tyre.

Në shtypin shqiptar të kohës, që përfshin vitet 1912-1913, kemi evidencuar mbi 100 artikuj që flasin për këto masakra, që përshkruajnë tmerre nga më të ndryshmet. Në pamundësi për t'i përfshirë të gjithë këta artikuj, kemi përzgjedhur vetëm disa prej tyre, që mendojmë se japin një pasqyrim thuajse të përgjithshëm.

Gazetat që kemi marrë në shqyrtim janë: “Shypnia e re”, “Dielli”, “Taraboshi”, “Liria e Shqipërisë”, “Përlindja e Shqipërisë” etj.

Luftërat ballkanike dhe pasojat

Vjeshta e vitit 1912, po numëronte edhe ditët e fundit të Perandorisë Osmane në Ballkan dhe në tokat shqiptare. Largimi i Perandorisë Osmane nga tokat shqiptare, rrethanat e reja politike të krijuara, do të rrisin marramendshëm ambiciet e fqinjëve, posaçërisht të shteteve të Aleancës Ballkanike për zgjerim të territoreve në dëm të hapësirave shqiptare. Këto rrethana bënë që edhe Lëvizja Kombëtare Shqiptare të shikonte pozicionin e saj kundruall kërkesave, nga lufta për autonomi që kishin kërkuar dikur, të kalonin në kërkesa për Pavarësi.

Për rrezikun që po u kanosej tokave shqiptare dhe popullatës nga shtetet e Aleancës Ballkanike në prag të largimit të Perandorisë Osmane nga Ballkani, prifti katolik, veprimtari i njohur i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe më pas, Abati i Mirditës, Prend Doçi², në bisedë me miken e shqiptarëve znj. Edith Durham rreth largimit të Perandorisë Osmane nga Ballkani dhe pasojat që mund t'i ketë populli shqiptar pas largimit të Perandorisë deklaroi: “*Të punosh kundër turkut tani është gabim. Turku nuk është më armiku më i egër i Shqipërisë..., tani është një armik tjetër, madje shumë më i egër se turku, një armik që po forcohej dita-ditës. Ky armik është sllavi. Rusia me kishën e saj*

¹ Esilda Luku, *Luftërat ballkanike (1912-1913) në këndvështrimin e historioigrafisë shqiptare (1945-1990)*, në: “Kosova”, nr. 31-32, Instituti i Historisë - Prishtinë, 2009, f. 289-300.

² **Prend Doçi (1846-1917)** - Poet klerikë. Lindi në Bulgër të Mirditës. Studimet teologjike krishtere i kreu në Shkodër dhe Romë. Me kthimin e tij në atdhe zuri poste të larta në hirakin kishtarë, si abat i Mirditës më 1880. Ishte njëri nga themeluesit e shoqërisë “ Bashkimi” më 1899 në Shkodër. U muar edhe me shkrime. Luigj Martini, *Abati i Mirditës-Prend Doçi*, Geer, Tiranë, 2012.

fanatike dhe bandat e saj të egra serbe dhe bullgare, ishte gati ta shkretonte Shqipërinë dhe t'i zhdukte njëherësh katolikë e myslimanë bashkë"³.

Nuk duhet harruar se ky qëndrim është i një njeriu që nuk kishte reshtur së foluri dhe së punuari kundër Perandorisë Osmane, por si njohës i rrethanave të kohës, ai jep mendimin e tij, që në ato rrethana i dukej se ishte i qëndrueshëm. Në fakt, frika e Prend Doçit doli të ishte e vërtetë, sepse me largimin e Perandorisë Osmane ambiciet e Aleancës Ballkanike për zgjerime të territoreve në kurriz të tokave shqiptare, përveç intrigave diplomatike, luftës psikologjike ndaj shqiptarëve etj., ishin të shoqëruara edhe më masakra të llahtarshme.

Se deri në çfarë mase kishte arritur niveli i këtyre masakrave në këto vite ndaj shqiptarëve, tregon edhe fakti se këto masakra tërhoqën vëmendjen e opinionit botëror, rajonal dhe atij vendor.

Përveç shumë raporteve të dërguara nga konsujt e ndryshëm, që ishin të vendosur nëpër qendrat e Vilajeteve Shqiptare raportet i dërgonin edhe në qendrat e tyre përkatëse, ku pasqyronin qartë se deri në çfarë mase kishte shkuar çmenduria e ushtrive të Aleancës Ballkanike, një ngjarje e tillë nuk la pa u vërejtur edhe nga shtypi botëror, rajonal dhe vendor i kohës, të cilave po u kushtonte një kujdes të veçantë në pasqyrimin sa më real.

Në arenën botërore, përmes shtypit këto masakra po pasqyroheshin nga Leo Frendlich, Llav Trocki e Edit Durham, në rajon nga Dimitrije Tucoviç, dhe në hapësirat shqiptare po e pasqyronin shtypi vendor, si gazetatat: "Shypnia e re", "Taraboshi", "Liria e Shqipërisë", "Përlindja e Shqipërisë", "Besa Shqiptare" etj.

Kështu, gazeta "Shypnia e re", datës 24 gusht të vitit 1913, në rubrikën: "*Mbi masakrat sllave në Shkodër, si dhe mbi mosmarrjen e masave nga Fuqitë e Mëdha për normalizimin e gjendjes*", jep të dhëna trishtuese mbi atë se çfarë po ndodhte në Shkodër, me popullatën e këtij qyteti dhe rrethinës, dhe gjithashtu kjo gazetë nuk mbeti pa

³ Edith Durham, *Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe shqiptarët*, (ribotim) ShB, Naum Veqilharxhi, Tiranë, 1998, f. 348.

shprehur edhe mllëfin e vet ndaj Fuqive të Mëdha të kohës, që përballë atyre masakrave, siç shkruante, bënë sehire.

Ngjashëm vepronte edhe Gazeta "Toroboshi"⁴, e datës 18 tetor 1913, në artikullin: "*Serbët e malazeztë mbytin gra, pleq e fëmijë*". Është interesante të potencohet se në çdo artikull, apo raport që botohej në gazetatat shqiptare të kohës, përmendjen e masakrimit të fëmijëve, thuajse e hasim në çdo artikull të çdo gazete shqiptare që shkruhej për këto masakra, dhe kjo për mendimin tim mund të shpjegohet për dy arsye kryesore:

E para - për drejtuesit e gazetave, por edhe për çdo njeri me ndërgjegje, mbytja e fëmijëve është e pajustificueshme në çfarëdo rrethane që ndodh kjo.

E dyta - mbytja e fëmijëve në këtë mënyrë, masakrimi i tyre, nuk ishte i njohur për shqiptarët e asaj kohe, prandaj kjo bëri që popullata ta ndjente thellë këtë gjë, sepse kjo ishte jashtë rregullave kanunore që dominonin te shqiptarët në atë kohë. Kjo ishte një gjë e paparë, ishte një tmerr i vërtetë që nuk mund ta perceptonin shqiptarët, dhe këtë e shprehnin ata, siç shihet edhe nga opinionet e tyre që i botonin gazetatat e kohës.

Sa do që krimet e forcave xhon-turke janë të njohura ndaj popullatës shqiptare, për drejtuesit e gazetës "Dielli", që botohej në Boston të SHBA-ve, krahasuar me krimet e ushtrive të Aleancës Ballkanike që po bënin ndaj shqiptarëve, ushtria osmane u "*tregua e qytetëruar*"⁵, sepse sipas drejtuesve të kësaj gazete ushtria osmane se "*s'trazoj, s'prishi, s'theri njeri*"⁶.

Drejtuesit e gazetës shkojnë aq larg sa ushtritë e Aleancës Ballkanike i përshkruajnë edhe me epitete të ndryshme negative si: qen, kanibalë, vandalë etj., "*Për çudi moti 1912 - 1913 na tregoi që Turqia megjithëse humbte luftën, por ushtria e saj u tregua e qytetëruar, se*

⁴ "Toroboshi", 18 tetor 1913, f. 2.

⁵ "Dielli", 1 Gusht, 1913, f. 3; Shpend Avdiu, *Çështja shqiptare më 1913-1914*, në: "Shenja", nr. 27, Shkup, 2013, f. 33-35.

⁶ "Dielli", 1 Gusht, 1913, f. 3.

*s'trazoj, s'prishi, s'theri njeri, përkundër Aleancës Ballkanike që bënë të gjitha barbarizmat, ushtritë e tyre qenë bashibozukë, kasapë, vandalë dhe kanibalë. Këta s'lanë gurë mi gurë, përmbysën, theren, dogjën, çnderuan, të tëra të ligat i bënë këta qenë. Pastaj kanë sy e fytyrë e faqe e thonë luftojmë për kryq e të krishterë*⁷.

Në vitet 1912-1913, grekët ambiciet e tyre territoriale nuk po i realizonin sipas parashikimeve të tyre. Qytetet e jugut të Shqipërisë si: Korça, Gjirokastra, Delvina, Himara dhe Përmeti etj., ishin vendosur që t'i mbesin Shqipërisë. Sipas gazetës “Dielli”, kur grekët morën vesh se këto qytete nuk u mbetën atyre, ata (grekët N. A) *”u tërbuan me barbari të cilat as hotentotët e Afrikës nuk do të pranonin ndonjëherë ta bëjnë. “Në Korçë, ushtarët grekë zënë dhe dhunojnë gratë dhe vajzat në mes të rrugëve, si kafshë të egra! Burrat që guxojnë të kundërshtojnë i vrasin menjëherë”*⁸.

Përball padrejtësive të tilla, sidomos ndaj dhunimit të vajzave dhe grave, popullata vendëse nuk mund të qëndronte indiferent, skenat të tilla kishin prekur thellë njerëzit ku ndodheshin këto tragjedi, andaj është e natyrshme që të kishte edhe reagime, për t'u dalë në mbrojtje motrave dhe nënave të tyre. Gazeta, “Dielli”, për njërin nga këto raste shkruante: *“Të birin e Delian Panaritit e vranë, duke e goditur me një dru në kokë, nga se tentoi ta mbronte një zonjë, të cilën oficerët e Greqisë e kishin zanë ta turpëronin”*⁹.

Gazeta “Dielli”, mund të thuhet se u bë zëri më i guximshëm për denoncimin e këtyre masakrave dhe informimin sa më të drejtë për ngjarjet tjera që po zhvilloheshin në hapësirat shqiptare.

Gazeta “Përlindja e Shqipëniës”, e cila ishte edhe gazeta e parë e qeverisë së Vlorës, e kryesuar nga Ismail Qemali, masakrave serbo-malazeze mbi popullin shqiptar u dha hapësirë të konsiderueshme, du-

ke evidencuar çdo fshat të djegur, njerëzit e mbytur, shtëpitë e djegura, deri edhe numrin e kafshëve të mbytura etj.¹⁰

Të dhënat që ofron “Përlindja e Shqipëniës”, i prezanton te lexuesi si të dhëna zyrtare në disa vazhdimë me titull: *“Barbarizmat e mizorinat e serbëve kundër shqiptarëve”*¹¹.

Dokumente interesante mbi masakrat e serbëve në Shqipëri, ofron edhe gazeta “Atdheu”, e vitit 1913. Në titullin *“Keqbërjet e serbëve në Shqipëri”*, duke prezantuar edhe dokumente, jepte informacione të hollësishme mbi atë se çfarë po ndodhte në Veriun e Shqipërisë.¹²

Një shqetësim dhe një tmerr tjetër për qytetarët e viseve shqiptare në ato vite ishte edhe përballja me mbytjen e kafshëve të tyre të shtëpisë, që ishin shumë jetike për mirëqenien e popullatës në atë kohë, kjo në njërin anë, kurse në anën tjetër, tregon se deri në çmasë kishte arritur shkatërrimi dhe barbaria ndaj shqiptarëve, pra duke mos kursyer, as jetën, as kafshët dhe as pasurinë e tyre.

Kështu, Gazeta **“Shqypnia e Re”**, e datës 20 nëntor 1913, në shkrimin: *“Barabarizmat serbe në Kosovë”*, lajme këto siç vë në dukje kjo gazetë, i kishte marrë nga gazeta serbe **“Radničke Novine”**, duke përshkruar djegiet dhe barbaritë që kishin bërë ndaj fshatrave shqiptare midis Tetovës e Prizrenit, përveç tjerash, shkruan: *“Ndër të gjitha këto katunde shqyptare kjene mbytur të gjithë njerëzit, e deri te qejt e pulat”*.

Në të gjitha viset shqiptare, ku këto gazeta merrnin informacionet e tyre nga banorët vendorë, shprehnin dhembjen e tyre, sado që ardhja deri të informacioni nuk ishte e lehtë për rrethanat teknike të kohës kur ato mbuluan gjithë hapësirat shqiptare. Për rajonin e Maqedonisë së sotme, të dhëna më të shumta hasim te gazeta “Liri e Shqipërisë”, e datës 12 tetor 1913. Në dy artikuj të kësaj gazete përshkruhen në deta-

¹⁰ “Përlindja e Shqipëniës” vjet’i II, nr. 1, 14 kallënduer 1914, f. 4; Sali Bashota, *“Përlindja e Shqipëniës”*, gazeta e Parë e Qeverisë së Vlorës, në: “Media”, nr. 4, UP – FF – Dega e Gazetarisë, Prishtinë, f. 75 – 79.

¹¹ “Përlindja e Shqipëniës” vjet’i II, nr. 1, 14 kallënduer 1914, f. 4.

¹² “Atdheu”, 30 shtator, 1913, f. 2.

⁷ “Dielli”, 1 Gusht, 1913, f. 3.

⁸ “Dielli”, 22 Gusht, 1913, f. 2.

⁹ “Dielli”, 22 Gusht, 1913, f. 2.

je masakrat dhe tmerret që përjetoi krahina e Dibrës dhe Manastiri me rrethinat e tyre.

Për Manastirin me rrethinë, kjo gazetë, përveç të tjerash, raporton se si serbët dogjën katundet dhe masakruan popullsinë e këtyre anëve, si i ndanë fëmijët nga nënat e tyre etj.

Kurse në Dibër, raportohet edhe për masakrimin e figurave fetare islame, dhe jo rastësisht kishte ndodhur kjo, kur dihet se Dibra dhe figurat fetare islame të kësaj krahine kishin qenë gjithmonë pararoje e interesave kombëtare në çdo lëvizje me karakter kombëtar.

Duhet thënë se shtypi shqiptar i asaj kohe, pikërisht për arsyen që u tha më sipër, gjithmonë me theks të veçantë kishte raportuar për masakrimin e figurave fetare shqiptare të të gjitha komuniteteve. Me një shqetësim të madh shtypi shqiptar i kohës kishte ngritur zërin për vrasjen në Kosovë nga ushtritë serbo-malazeze edhe të priftit At Luigj Palaj etj.

Përfundimi

Për fund mund të thuhet se shtypi shqiptar i viteve 1912-1913, bëri një prezantim dhe paraqiti, për aq sa lejonin mundësitë politike dhe teknike të kohës, në mënyrën më të mirë të mundshme, gjendjen e popullit shqiptar pas largimit të Perandorisë Osmane dhe tmerret që përjetoi kjo popullatë nga ushtritë e Aleancës Ballkanike.

Të dhënat që i jep shtypi shqiptar i këtyre viteve për masakrat në trevat shqiptare dhe më gjerë, sado që nuk merren si burime të dorës së parë, ndihmojnë që të kemi një pasqyrë sa më të mirë të asaj që ka ndodhur në këto vite dhe në këto hapësira. Po ashtu këto të dhëna, krahas dokumenteve të kohës, traditës gojore dhe raporteve të konsujve të ndryshëm, ndihmojnë për ndriçimin sa më të mirë të gjithë atyre vrasjeve, masakrimeve dhe shkatërrimeve që kishin bërë ushtritë në fjalë.

Një mendim të asaj se çfarë po ndodhte në trojet shqiptare gjatë viteve 1912-1913, e ka dhënë edhe humanistja e njohur dhe mikja e madhe e popullit shqiptar, znj Edith Durham, e cila me pak fjalë pre-

zanton panoramën e njerëzve, të këtyre trevave, konkretisht vuajtjet e tyre në këto troje dhe pasojat e ardhjes së ushtrive ballkanike në këto vende.

Janë fjalë jo të një udhëtareje të zakonshme por të një dëshmitareje të drejtpërdrejtë dhe njohëse e mirë e rrethanave ndërkombëtare të kohës dhe të asaj çfarë po ndodhte me popullatën e pambrojtur të këtyre trojeve, e cila ndër të tjera shkruante:

“Tani që serbët erdhën në Ohër dhe grekët në Korçë, fillova ta ndjeja veten fajtores pse dikur kisha uruar që turku të largohej nga Europa. Sa ishte turku aty, shpresat nuk ishin shuar. Ndërsa këta pushtues “të krishterë” ishin njëqind herë më të këqij”.

(Edith Durham).¹³

¹³ Edith Durham, *Vep. e cit.*, f. 394.

Nuridin Ahmeti

ALBANIANS AFTER THE WITHDRAWAL OF THE OTTOMAN EMPIRE FROM THE BALKANS (ACCORDING TO THE PRESS OF THE TIME)

(Summary)

Introduction

The period between 1912 and 1913, in Albanian historiographical literature, is known as the period of the Balkan Wars, and due to the events that took place then, is considered as one of the most tragic periods for the peoples of the Balkans in general and the Albanians in particular.

Since 1945 the Balkan Wars have been the object of study for many Albanian scholars (as are: Arben Puto, Thoma Murzaku, Zekeria Cana, Xheladin Shala, etc.), who have studied the role of the Albanians during this period, the consequences of the Balkan Wars, etc.

نورالدين أحمدى

الالبانيون بعد رحيل الامبراطورية العثمانية حسب صحف الوقت (خلاصة البحث)

نعبر سنوات ١٩١٢-١٩١٣ في مراجع التاريخ الالباني كفترة الحروب البلقانية و ذلك بسبب الاحداث المأسوية التي حصلت لشعوب البلقان بصفة عامة و الشعب الالباني بصفة خاصة .

و كانت الحروب البلقانية منذ سنة ١٩٤٥ و حتى يومنا موضوع دراسة لبعض من المؤرخين الالبان مثل :

أريان بوتو و ثوما مورزكا و زكريا سانا و جلالدين شالا و اخرون مقدمين ادلة و تحليلات علمية عن دور الالبان و العواقب خلال سنوات ١٩١٢-١٩١٣ .

jashtme e njeriut të jetë në përputhje me brendësinë e tij dhe veprimet e tij të fshehta të jenë identike me ato publike”.

Rëndësia e sinqeritetit

Domosdoshmërinë dhe rëndësinë e sinqeritetit në fe, e dëshmojnë shumë ajete të Kur’ani Kerimit që gjatë studimit të tyre do të vërehet qartë se Allahu xh.sh, ka kërkuar sinqeritet në besim, adhurim, dhe çdo punë tjetër që bëhet për hir të Tij.

Pra, të mos mendojë besimtari që për ta arritur kënaqësinë e Allahut xh.sh, duhet kryer një pjesë e adhurimeve me të cilat na ka obliguar Allahu xh.sh, dhe na ka porositur Muhamedi a.s. Por, çdo gjë që vepron besimtari që është e lejuar (hallall) në Islam si psh: gjumi, të ngrënit, studimi, puna, martesë, marrëdhëniet bashkëshortore etj., në qoftë se i bëni për hir të Zotit të Madhëruar dhe për t’u larguar nga harami, edhe me këto vepra fitoni kënaqësinë dhe shpërblimin e Allahut xh.sh.

Për këtë All-llahu xh.sh thotë në Kur’an:

“Thuaj: *"Namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve"*¹.

Sinqeriteti në jetën e myslimanit është një mjet i domosdoshëm për të fituar kënaqësinë e Allahut të Madhëruar. Allahu i Lartësuar thotë në Kur’an:

“Ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin Allahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij, të pastër në besim, ta falin namazin, ta japin zeqatin, dhe kjo është Feja e Drejtë”².

Në një ajet tjetër Allahu xh.sh. thotë:

“Thuaj: *"Unë jam i urdhëruar ta adhuroj All-Allahun, të jem i sinqertë në adhurimin ndaj Tij!"*³.

MIRËSJELLJA ISLAME

Mr. Sc. Burim Bibaj

RËNDËSIA E SINQERITETIT NË ISLAM DHE DOBITË E TIJ

Falënderimi i takon vetëm Allahut të Madhëruar, ndërsa paqja dhe mëshira e Tij qofshin mbi të dërguarin Muhamed a.s, familjen e tij, shokët tij dhe mbi të gjithë ata që e pasojnë rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Me të vërtetë nga çështjet më të rëndësishme të Fesë Islame është vërtetimi i sinqeritetit ndaj Allahut në të gjitha adhurimet, lidhur me këtë disa dijetarë islam kanë thënë: *“Sinqeriteti do të thotë se përgjatë veprave tua të mos kërkojsh dëshmitar tjetër përveç Allahut dhe as shpërblyes përveç Tij.*

Ndërsa në një përkufizim tjetër thuhet: “Nocioni i sinqeritetit në vetvete e përfshin raportin e sinqertë ndaj Allahut xh.sh. nëpërmjet kryerjes me përpikëri të adhurimeve. Pastaj marrëdhëniet e sinqerta ndaj nefsit personal, ashtu që dëshirat e tij të jenë në pajtim me atë që Allahu xh.sh. e ka caktuar, gjegjësisht me Sheriatin e Tij. Me radhë vinë raportet e sinqerta me njerëzit, edhe atë në të folur, në premtime dhe në marrëdhëniet e ndërsjella mes tyre, siç janë: shitblerja dhe martesë, duke u larguar nga mashtrimet, nga falsifikimet, pra derisa ana e

¹ En`am: 162

² El Bejjine, 5.

³ Zumer, 11.

Ndërsa Muhamedi a.s nëpër shumë hadithe të tij flet për rëndësinë e singëritetit. Transmeton Abdullah ibën Mesudi r.a. “Se i Dërguari i Allahut, ka thënë: Singëriteti shpie në mirësi, kurse mirësia shpie në xhenet. Vërtet, njeriu i cili vazhdimisht është i singërtë (në besim dhe në të folur), tek Allahu shkruhet besimtar i vërtetë. Gënjeshtër shpie në prishje (morale), kurse prishja shpie në xhehenem. Njeriu që gënjen vazhdimisht më në fund tek Allahu shkruhet si gënjeshtar i madh”⁴.

Personat të cilët janë të singërtë Allahu xh.sh do t’ua heq hallet dhe fatkeqësitë në këtë botë. Për këtë Pejgamberi a.s në një hadith thotë:

Tre veta nga popujt që kanë qenë para jush, i zë nata në një shpellë në mal. Për shkak të shiut që binte, rrëshqet një shkëmb nga mali dhe zë daljen e shpellës. Duke parë gjendjen në të cilën gjendeshin, njëri prej tyre u tha shokëve: “Nuk do të mund të dalim prej kësaj gjendjeje, ku jemi veçse duke e lutur Zotin e Madhëruar me veprën më të mirë që kemi bërë për hir të Tij”.

Filloi i pari të lutej: “O Zot, ti e di që unë kam pasur prindërit e moshuar dhe fëmijët e vegjël. Sa herë që milja bagëtinë, nuk u jepja fëmijëve qumësht derisa të pinin prindërit e mi. Një natë u vonova me bagëtinë në kullotë dhe kur shkova t’u çoj qumështin prindërve, i gjeta duke fjetur. Megjithatë fëmijët qanin nga uria, unë nuk u dhashë pasi e kisha bërë zakon që të pinin prindërit të parët. Qëndrova me enën me qumësht te koka e tyre derisa u zgjuan në mëngjes. Pasi pinë prindërit, më pas ushqeva fëmijët. O Zot, nëse këtë e kam bërë për hatrin Tënd dhe për të arritur shpërblimin Tënd, na e largo këtë shkëmb nga hyrja e shpellës”. Në atë çast shkëmbi lëvizi pak, por pa pasur mundësi të dalin.

Pastaj filloi i dyti, të lutej me fjalët: “O Zot, ti e di që gjendja ime financiare ka qenë e mirë. Kur më erdhi njëherë një grua të kërkojë diçka për të ushqyer fëmijët e saj, unë i kërkoja të më lejonte të bëjë ç’të dua më të. Ajo refuzoi fillimisht, por kur uria iu shtua më shumë,

erdhi dhe më tha: “Bëj ç’të duash veç më jep diçka për fëmijët”. Kur mbeta vetëm me të në dhomë, ajo m’u drejtua me fjalët: “Ki frikë Allahun nga kjo që po bën”. Në atë çast u pendova dhe i thashë: Merri paratë dhe largohu. O Zot, nëse këtë e bëra vetëm për hatërin tënd, na e largo këtë të keqe që na ka rënë”. Në atë çast shkëmbi lëvizi përsëri, por pa i krijuar atyre mundësi të dilnin.

Atëherë filloi i treti të lutej dhe tha: “O Zot, tek unë punonin argatë njerëz të ndryshëm, të cilëve u jepja hakun. Njëri prej tyre u largua pa e marrë atë që i takonte. Të hollat që kishte për të marrë, unë i përdora në tregti dhe për një kohë të shkurtër ato u shtuan shumë. Kur erdhi pas disa kohësh për të marrë atë që i takonte unë i dhashë paratë që kishte punuar dhe ato që ishin shtuar me tregti, duke i treguar atë që kisha bërë. Ai i mori dhe u largua duke më falënderuar. O Zot, nëse këtë e bëra vetëm për hatërin Tënd, na e largo këtë shkëmb nga hyrja e shpellës”. Në atë çast shkëmbi lëvizi përsëri dhe ata arritën që të dalin nga shpella⁵.

Por ne vallë, a kemi vepruar ndonjë punë të mirë me të cilën ta lusim Zotin e Madhëruar në vështirësi për të na larguar atë vështirësi që kemi.

Transmetohet nga Ebu Musa El Esha’riu r.a. se një burrë erdhi te Pejgamberi a.s. dhe i tha: “O i Dërguar i Allahut, dikush lufton për pasuri, e dikush lufton që të përmendet, dikush tjetër lufton që të shihet pozita e tij, pra cila nga këto është në rrugë të Allahut?” Pejgamberi iu përgjigj: “*Kush lufton që fjala e Allahut të jetë më e larta, ky luftim është në rrugën e Allahut*”⁶.

Pejgamberi a.s thotë: “Ajo që kam frikë prej jush është shirku i vogël”, Shokët e pyetën: “Çfarë është shirku i vogël o i Dërguar i Allahut?” “Syfaqësia” - u përgjigj ai.

Dijetari i njohur islam imam Gazaliu thotë: “Të gjithë njerëzit janë të humbur, përveç të diturve. Të gjithë të diturit janë të humbur përveç

⁵ Imam Nevevi, “Rijadus-salihin”, Hadithi 13, fq.15, Pristineë 1997.

⁶ Sahih Buhari (2/309) nr.(2810), Sahih Muslim (3/1512) nr. (1904).

⁴ Muslimi në Sahih, nr.4721.

vepruesve (me atë që dinë). Të gjithë vepruesit janë të humbur përveç të singertëve".

Është pyetur Sehl et Testeri: "Cila gjë është më e rëndë për epshin"? U përgjigj: "*Sinqeriteti*".

Sufjan Eth-Theuri në lidhje me këtë ka thënë: "Nuk kam shëruar diçka më të rëndë te vetja se nijetin...".

Ndërsa në librin e dijetarit të njohur islam Ibën Tejmije "Të qenit rob i Allahut" përmendet Fudejl ibën Ijad, i cili në lidhje me ajetin thotë: "**Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t'ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë...**" (El Mulk, 2) tha: Ajo është vepra më e singertë dhe më e saktë. Nëse vepra bëhet si duhet por nuk është e singertë nuk pranohet. Nëse është e singertë por nuk është e saktë nuk pranohet. E singertë është kur është për Allahun, e saktë është nëse është në pajtim me sunnetin. Pastaj e lexoi ajetin: "**Kështu, kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira dhe të mos i shoqërojë askënd në adhurim Zotit të vet!**" (El Kehf, 110)⁷. Kanë thënë disa prej dijetarëve: "Kur robi është i singertë, prej tij largohen dyshimet e shumta dhe syefaqësia".

Disa prej të parëve tanë kanë thënë: "**Ai i cili gjatë jetës së tij një çast është i singertë vetëm për Allahun do të shpëtojë, kjo është nga madhështia e sinqeritetit, dhe është shumë rëndë që zemra e tij të zmbropset, sepse e singertë është ajo që nuk kërkohet përmes saj vetëm se afrimi tek Allahu**".

Sinqeriteti është kusht për pranimin e veprës dhe vepra nuk pranohet vetëm se me dy kushte:

E para: Vepra të jetë në përputhshmëri me ligjin e Allahut apo me udhëzimet e Pejgamberit a.s. Transmeton Aishja r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Kush shpik në çështjen tonë diçka që nuk është prej saj, ajo nuk pranohet".⁸

E dyta: Vepra të bëhet vetëm për hir të Allahut të Madhërishëm.

Transmetohet nga Omer ibn Hatabi r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Me të vërtetë veprat janë sipas qëllimit, dhe çdokujt i takon ajo që e ka për qëllim, dhe kush shpërngulet për hir të Allahut dhe të Dërguarit të tij, shpërngulja e tij është për Allahun dhe të Dërguarin e tij, dhe kush shpërngulet për çështje të kësaj bote që të përfiton prej saj, apo për ndonjë grua që ta marton atë, shpërngulja e tij është për atë që ka pas për qëllim".⁹ Këtë e vërteton Allahu i Lartëmadhëruar në Kur'an ku thotë: "**Thuaj: Unë jam vetëm njeri, sikurse edhe ju, mua më shpallet se Zoti juaj është vetëm një Zot, e kush shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë vepër të mirë, dhe në adhurimin e tij ndaj Zotit le të mos e përziejë askënd**".¹⁰

Frytet e sinqeritetit dhe dobisë e tij

Sinqeriteti është kushti i pranimin të veprave dhe fjalëve. Në të kundërtën, humbja e sinqeritetit është shkak për mospranimin e veprës. Transmetohet nga Ebu Hurejra r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Njerëzit e parë që do të gjykohen Ditën e Gjykimit janë: Një dëshmor që ka vdekur në luftë, i cili do të sillet dhe atij do t'i përmenden mirësitë e Allahut që ia ka dhënë dhe ai i vërteton ato, dhe i thuhet: Çka vepro ve me ato mirësi që ti dhashë? Thotë: Kam luftuar vetëm për Ty derisa rashë dëshmor. Allahu i përgjigjet: "Gënjen, ti nuk ke luftuar për tjetër gjë vetëm se që njerëzit të të thonë "trim", dhe ashtu të thanë.", dhe urdhërohet që të tërhiqet me fytyrë për toke dhe hidhet në zjarr. Dhe një person i cili e ka mësuar diturinë dhe ua ka mësuar të tjerëve, ka lexuar edhe Kur'anin, dhe atij do t'i përmenden mirësitë e Allahut që ia ka dhënë dhe ai i vërteton ato, dhe i thuhet: "Çka vepro ve me ato?" Ai përgjigjet: "E mësova diturinë dhe ua mësova të tjerëve dhe kam lexuar Kur'anin vetëm për Ty" I thuhet: "Gënjen, ti e mësove diturinë që të të thonë "dijetar" dhe e lexove Kur'anin vetëm që të të thonë se je lexues i mirë i Kur'anit, dhe të thanë", dhe urdhërohet që të tërhiqet me fytyrë për toke dhe hidhet në zjarr. Dhe një person të

⁷ Medarixhu Salikin, 2/93.

⁸ Sahihul-Buhari (2/267) nr. (2697), Sahihul Muslim (3/1343) nr. (1718).

⁹ Sahihul-Buhari (1311) nr. (1), Sahihul Muslim (3/1515) nr. (1907).

¹⁰ Surja el-Kehf, 110.

cilit Allahu i dhuroi pasuri nga të gjitha llojet, dhe atij do ti përmenden mirësitë e Allahut që ia ka dhënë dhe ai i vërteton ato, dhe i thuhet: Çka veproje me ato të mirësi që t'i dhashë? Thotë: “Nuk kam lënë vend në të cilën Ti dëshiron që të jepet në të, vetëm se e kam dhënë dhe këtë nuk e kam bërë për dikë tjetër vetëm se për Ty”, i thuhet: “Gënjen, ti këtë e bërë vetëm që të thonë për ty “bujar” dhe ato e thanë këtë”, dhe urdhërohet që të tërhiqet me fytyrë për toke dhe hidhet në zjarr.¹¹

- Pastaj sinqeriteti është kusht i pranimi të lutjeve.
- Forcon imanin e njeriut dhe ndihmon në tejkalimin e vështirësive
- Sinqeriteti ngrit pozitën e njeriut në dynja dhe ahiret.
- E largon njeriun nga cytjet dhe iluzionet.

- E liron njeriun nga nënshtrimi ndaj tjetërkujt përveç ndaj Allahut si dhe forcon lidhjet shoqërore. Në hadithin që e transmeton Ebu Sufjani r.a., i cili flet për takimin e tij me Herakliun, mes tjerash thuhet edhe kjo: “...(Herakliu e pyeti) Çfarë ju urdhëron i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ve selem)?”

Ebu Sufjani r.a. u përgjigj: “Ai thotë: “Adhurojeni vetëm Allahun xh.sh dhe mos i përshkruani Atij asnjë shok! Largohuni prej asaj që e thonë baballarët tuaj! Por, edhe na e urdhëron namazin, sinqeritetin, dëlirësinë dhe ruajtjen e lidhjeve farefisnore.”¹²

- Ndihmon në qetësimin e njeriut dhe i mundëson të shijojë lumturinë e vërtetë. Transmetohet se Hasan ibën Ali ibën Ebi Talibir r.a. ka thënë: “Kam mbajtur në mend prej të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ve selem, si vijon: “Largohu dhe lëshoje atë që e nxit dyshimin dhe mosbesimin te ti në dobi të asaj që nuk të nxit. Me të vërtetë, sinqeriteti jep qetësi, ndërsa gënjeshtër dyshim.”¹³

- Lehtëson arritjen te bereqeti. Transmetohet se Hakim ibën Hazami r.a. ka thënë: “I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: “Shitësi dhe blerësi kanë të drejtë në kthimin e mallit derisa

nuk largohen. Nëse janë të sinqertë në raporte mes tyre dhe e sqarojnë gjendjen e mallit, atëherë do të kenë bereqet në transaksionin e shitblerjes. Mirëpo, nëse gënjejnë dhe e fshehin ndonjë të metë, do t'iu shkatërrohet dhe fshihet bereqeti i shitblerjes së tyre.”¹⁴

- All-llahu xh.sh në Kur'an ka përmendur njerëzit të cilët kanë si virtutet sinqeritetin.

All-llahu xh.sh thotë:

“Ata janë që për hire të Tij, u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të zënëve robër. Ne po ju ushqejmë vetëm për hir të Allahut dhe prej jush nuk kërkojmë ndonjë shpërblim apo falënderim”¹⁵.

- Për shkak të sinqeritetit tënd dhe lidhjes që ke me Zotin e Madhëruar të largohet shejtani dhe nuk ka mundësi të ngacmojë. Për këtë dhe hipokritët kanë dënimin më të madh dhe që t'u pranohet pendimi duhet të tregohen të sinqertë me Allahun e Madhëruar.

All-llahu xh.sh thotë:

“Me të vërtetë që mynafikët do të jenë në vendet më të thella të zjarrit dhe nuk do të gjendet për ta kush t'i ndihmojë. Përveç atyre që u penduan dhe u treguan të sinqertë në besimin ndaj Zotit”¹⁶.

Si ta arrijmë sinqeritetin?

Ajo që të çon drejt sinqeritetit dhe të bën të hysh në derën e tij, është nijeti (qëllimi i mirë). Thotë Pejgamberi a.s lidhur me këtë: “Vepërta varen nga qëllimi (nijeti) dhe çdo njeri do shpërblehet sipas qëllimit. Kush ka emigruar për hir të Zotit dhe Pejgamberit a.s, emigrimi i tij është për Zotin dhe pejgamberin a.s. Ndërsa kush ka emigruar për diçka të kësaj bote, apo të martohet me ndonjë grua, emigrimi i tij është për atë qëllim që ka emigruar”¹⁷. Këtë hadith Pejgamberi [salallahu alejhi ve sel-lem] e tha kur u pyet rreth një burri i cili emi-

¹⁴ Buhariu në sahih, 4/275 .

¹⁵ Insan, 8-9.

¹⁶ Nisa, 146.

¹⁷ Idriz Xhigoli, Dyzet hadithe të zgjedhura nga Imam Neveviu, fq. 11, Prishtine 2000.

¹¹ Sahihul Muslim (3/1514) nr. (1905).

¹² Buhariu në Sahih, 1/30.

¹³ Tirmidhiu në Sunen, nr.2520.

groi nga Meka për në Medine, vetëm për t'u martuar me një grua dhe jo si bindje ndaj Zotit dhe Pejgamberit a.s.¹⁸

Rregulloje nijetin tënd o vëlla dhe çdo vepër që ta besh, bëje vetëm për Allahun, pasi shpërblimi vjen sipas qëllimit. Dijetarët thonë: që një vepër të mirë të vogël, mund ta zmadhojë qëllimi i mirë dhe një punë të madhe e zvogëlon përsëri qëllimi.

Gjërat për të cilat nevojitet qëllimi i mirë janë tre:

E para janë adhuret. Mos bëj asnjë hap, pa bërë nijet që po e bën vetëm për hir të Zotit. Nëse dëshiron të shkosh në xhami, para se të dalësh, mendo që po dal vetëm për hatrin tënd O Zot, prandaj më pajis me sinqeritet.

Kur vdiq një nga shokët e Pejgamberit a.s, një nga banorët e Medinës i thotë një tjetri: "Eja të marrin pjesë në varrimin e filanit". "Më prit një moment"- ia kthen. Qëndron një çast i menduar dhe i thotë: "Po, eja të shkojmë". "Po përse u mendove?" E pyet i pari. "U ndala për të rregulluar qëllimin për të cilin po shkoj "- iu përgjigj.

Për një vepër të njëjtë, dy veta mund të shpërblehen ndryshe. Ai që ka si qëllim që me këtë vepër të arrijë kënaqësinë e Allahut dhe shpërblimin e tij, do të shpërblehet më shumë se ai që e kryen i shkujdesur.

Për këtë veprat e mira kur kthehen në rutinë e humbasin vlerën. Për çdo të mirë që të bësh mendo më parë mbi qëllimin që po e bën dhe shpërblimin që pret prej saj. Kjo më qëllim që të të përtërihet vendosmëria dhe si rrjedhojë të forcohet besimi.

Nëse shikon dikë që zbehet nga një punë që më parë e vepronte me dëshirë, dije se ai nuk e ripërtërin nijetin e tij. Nëse shikon që një vajzë e heq shaminë pasi e ka mbajtur me vite, dije se në fillim e kishte si qëllim hatrin e Zotit, por më pas e harroi këtë qëllim dhe nuk e kishte më parasysh bindjen ndaj Zotit dhe shpërblimin e Tij. Nëse do të ruash sinqeritetin, gjithmonë kontrollo nijetin dhe qëllimin me të cilin e kryen diçka.

E dyta janë gjërat e zakonshme. Dijetarët thonë që qëllimi i mirë e kthen diçka të zakonshme në adhurem p.sh. të studioarit. Shumë studente sot studiojnë me qëllim që të kenë mundësi të punësohen më pas dhe të kenë një të ardhme më të mirë. Kurse ti o besimtar, kur të ulesh të studiosh të kesh si qëllim që si besimtar, të jesh nga të dalluarit dhe të jesh shembull në shkollë. Të mësosh me qëllim që nesër të zësh një pozitë të lartë shoqërore, të cilën do e shfrytëzosh për të thirrur njerëzit në islam. Po e pate këtë qëllim, do të shpërblehesh për çdo shkronjë që lexon.

Njerëzit sot vishen bukur me qëllim që të duken mirë para njerëzve, kurse ti o vëlla besimtar, veshjen bukur ta kesh si mjet për të ftuar njerëzit në Islam, për t'u thënë atyre që besimtari vishet mirë dhe bukur dhe për këtë do shpërblehesh nga Zoti.

Dikush tjetër kërkon të jetë i pasur me qëllim që të ketë mundësi të plotësojë qejfet e tij. Kurse ti o besimtar, mos kërko të jesh i pasur thjesht për të plotësuar kënaqësitë e tua, por për të shpenzuar paratë në rrugë të Allahut.

Dikush martohet thjesht për të pa sur fëmijë. Kurse ti o besimtar bëje me qëllim që të kesh fëmijë që të adhurojnë Allahun. Pra gjërat e zakonshme, nijeti i kthen ato në adhurem ndaj Allahut dhe shpërblehesh për ta.

E treta, janë gjërat të cilat nuk i posedojmë. Pejgamberi a.s. thotë: "Kush i kërkon Allahut me sinqeritet që të vdesë si shehid, All-llahu do ia jap atë gradë edhe sikur të vdes në shtrat".

Nëse dikush i kërkon Zotit me sinqeritet tani që të vdesë si shehid, i tillë do të vdesë edhe nëse vdes në vdekje të zakonshme dhe Ditën e Kiametit do të ringjallet pranë Hamzait dhe dëshmorëve të tjerë.

Kur Pejgamberi a.s po kthehej nga beteja e Tebukut me ushtrinë, u tha të pranishmëve: "Në Medine ka disa njerëz të cilët megjithëse nuk kanë marrë pjesë me ne në luftë, kanë marrë pjesë në shpërblimin e luftës".

Pejgamberi thotë: "Kjo botë është për dy veta: Njërit Zoti i ka dhënë pasuri dhe ai e shpenzon atë në gjëra që e kënaqin Zotin. Kurse

¹⁸ Ibid.

tjetrit Zoti nuk i ka dhënë pasuri, por thotë: Nëse Zoti do të më kishte dhënë pasuri do e jepja dhe unë sikur e jep i pasuri".

Në fund e lusim Allahun xh.sh. të na pajisë me sinqeritet në fjalë dhe vepra, të na mundëson që çdo vepër të mirë ta kryejmë me sinqeritet dhe për hir të tyre, të na mundësojë shpërblimin në këtë botë dhe botën tjetër.

Literatura:

- Kur'ani me përkthim dhe komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti.
- Sahihul-Buhari.
- Sahihul Muslim.
- Imam Neveviu, "Rijadus-salihin".
- Sunen i Tirmidhiut.
- Idriz Xhigoli, Dyzet hadithe të zgjedhura nga Imam Neveviu, fq. 11, Prishtine 2000.

Mr. Sc. Burim Bibaj

THE IMPROTANCE OF SINCERITY IN ISLAM AND ITS BENEFITS

(Summary)

Introduction

All praise is due to Allah, and Allah's Peace and Blessings be upon His Final Messenger, his pure family, his noble Companions, and all those who follow them with righteousness until the Day of Judgment.

One of the most important principles in Islam is to achieve sincerity to Allah in all acts of worship. With regards to this some Islamic scholars have said: "*The meaning of Sincerity is: You do not need a witness for your work but Allah and you seek no reward but from Him*".

بوریم بیبای

أهمية الصدق في الاسلام و فوائده
(خلاصة البحث)

الحمد لله وحده و سلامه و رحمته على نبينا محمد صلى الله عليه و سلم و على آله و أصحابه و على الذين اتبعوه الى يوم الدين .
يمكن القول بأن من أهم الأشياء في الاسلام هو أن يلتزم المؤمن بالصدق نحو الله سبحانه و تعالى و حول هذا قال بعض علماء الاسلام: "الصدق معناه أن الانسان في عمله ألا يطلب شاهدا سوى الله سبحانه و تعالى و جازيا سواه!"

INTERVISTË E HUAZUAR

INTERVISTA ME NOEL MALCOLM (BIRN – JETA XHARRA)

- Doktor Malcolm, Kosova është e pavarur për dy vjet tani. Ka tërhequr njohje vetëm nga shtetet perëndimore dhe ka probleme në komunikim dhe njohje nga vendet e botës arabe dhe vendet e botës afrikane dhe Amerikës Latine. Çfarë duhet të bëjnë kosovarët gjatë bisedave me këto vende?

- Malcolm: Është vështirë për mua të jap këshilla, sepse nuk jam diplomat profesional as diplomat. E di që Ministria e Punëve të Jashtme në Prishtinë, është duke bërë shumë gjëra lidhur me këtë, por nuk i di detajet e negociatave. Mendoj që ka probleme për Kosovën tani. Në fillim ka qenë e qartë që fuqitë e mëdha perëndimore do të ndihmojnë dhe do të bëjnë punën kryesore që t'u drejtohen shteteve dhe t'u rekomandojnë njohjen e pavarësisë. Puna është përfunduar me ato shtete që janë përgjigjur me lehtësi këshillave të Britanisë apo Amerikës. Nuk mund të shkosh në shumë vende të Afrikës, si një fuqi e mëparshme kolonialiste si Britania dhe t'i tregosh se çka duhen të bëjnë me politikën e tyre të jashtme. Dhe Amerika, siç e dimë, ka pësuar disa dëme në reputacionin e saj në politikën e jashtme, veçanërisht në botën islamike, por edhe në Amerikën Jugore. Nuk besoj që është mirë për Amerikën të ketë për detyrë të këshillojë se çfarë duhet bërë me politikën e jashtme. Mendoj që është detyrë e Kosovës të bëjë këtë. Por, mendoj që duhet të merret me disa probleme të veçanta. Njëra

është presioni i politikës ruse. Rusia ka qenë shumë aktive, duke bërë presion në vendet e botës islamike që të mos njohin Kosovën.

- Kosovarët janë të brengosur të theksojnë identitetin e tyre islamik, nga frika që të mos identifikohen si shtet islamik. A duhet kjo brengë ende të vazhdojë?

Si paraqitje të përgjithshme për botë, se çfarë është Kosova dhe si ajo e identifikon veten, kjo është një brengë e arsyeshme. Nuk ka arsye që Kosova ta prezantojë përgjithësisht veten si një vend islamik, është shumë më ndryshe se vendet arabe islamike. Por, në negociatat e saj me shtetet islamike mbi këto çështje, mendoj që ka të drejtë që t'ia kujtojë që shumica e popullatës së saj ose është e fesë islame, apo së paku me një sfond islamik apo me trashëgimi kulturore.

- Për shembull, a duhet Kosova të adresojë këto vende në letër me *Salam alejkum*? A duhet ta thonë këtë?

- Nuk e di se si duhen t'i shkruajnë letrat individuale. Por, mendoj që kjo është diçka me të cilën mund t'ua kujtojnë vendeve dhe kur dërgojnë delegacione në vendet islame kanë të drejtë të sjellin libra mbi trashëgiminë islame të Kosovës. E di që është një libër me fotografi të xhamive dhe ndërtesave të tjera islame, të cilat janë shkatërruar apo dëmtuar nga Serbia në vitin 1999. Ky lloj i materialit në njëfarë mënyre ka efekt psikologjik. Kur Arabia Saudite e njohu Kosovën, kanë thënë: "Jemi duke e bërë këtë jo vetëm pse e njohim vullnetin e popullit, por po ashtu për shkak që njohim lidhjet e tyre kulturore dhe fetare me popullin tonë".

- Po me afrikanët? Çfarë mund të theksojnë kosovarët kur flasin me afrikanët? Kjo është, nëse do të kanë ndonjëherë rastin të shkojnë pasi që pasaportat e Kosovës nuk janë të pranueshme atje, nuk mundemi as të dërgojmë një delegacion atje.

- Mendoj që çështja e pasaportave është vetëm një detaj praktik. Vendet perëndimore mund të ndihmojnë në këtë rast dhe nëse është e nevojshme mund të rregullojnë pasaportë speciale diplomatike. Me-

ndoj që ky nuk është problemi kryesor. Po, Afrika është një rast tjetër me probleme tjera. Mendoj që njëra nga temat që Kosova në mënyrë të arsyeshme mund të theksojë kur bisedon me shumë vende afrikane dhe me vendet e botës së tretë, është që në shumë mënyra Kosova ka qenë në situatë të vendit dhe shoqërisë së kolonizuar. Dhe këto nuk janë fraza që i përdori lehtë. Në vitet 1920, Serbia ka pasur një program zyrtar të kolonizimit dhe kanë pasur zyra të kolonizimit në Beograd. Kanë dërguar 70 000 njerëz që të kolonizojnë Kosovën, që në atë kohë ka qenë 10% e popullsisë së përgjithshme. Dhe e dini që natyra e politikës serbe përgjatë shekullit të XX, jo pjesa më e mirë gjatë periudhës së Titos, por pjesa tjetër e shekullit të XX ka qenë shumë si një politikë koloniale. Dhe kjo është diçka me të cilin afrikanët mund të lidhen drejtpërdrejt.

- *Më duhet t'ju pyes pasi që e përmendët procesin e kolonizimit. Keni shkruar për procesin e rikthimit të pronës, si ka ndodhur nga Serbia në Kosovë. Dua t'ju pyes, sa duhet të kthehet mbrapa Kosova, nëse synon rikthimin e pronës, duke ditur kontekstin e tanishëm. Ndërkombëtarët shpesh e përmendin procesin e rikthimit të pronës të Kishës ortodokse. Por, rikthimi i pronave të shqiptarëve të viteve të 1920, që është marrë nga serbët nuk përmendet. Çfarë mendoni, sa duhet të shkojë larg ky proces në Kosovë, nëse fillon?*

- Kjo është e vështirë. Logjika sugjeron që më së largu që mund të ktheheni në kuptim praktik, ndoshta është një jetë e tërë. Kështu që njerëzit më të moshuar sot në Kosovë, ndoshta 80 ose 90-vjeçar. Në të vërtetë, mund të ktheheni në atë prirje të 1920, por, ka probleme tjera, ka probleme praktike, kur është në pyetje prona private, me dokumentacion. Shumë njerëz nuk kanë pasur dokumente, shumë dokumente që kanë ekzistuar kanë qenë dokumente të vjetra otomane dhe shumë prej tyre janë shkatërruar. Një numër i tyre është marrë në Beograd qëllimisht para vitit 1999, dhe mendoj që nuk mund të kthehen, sepse janë shkatërruar. Kështu që ka shumë probleme praktike. Disa vende evropiane, në mënyrë të natyrshme janë kthyer në momentin para Luftës së Dytë Botërore për shkak të ndryshimeve të mëdha që

kanë ndodhur në shtetet e tyre. Në disa shtete ka precedent, ku kufiri për këtë është dikur rreth 50 vjet mbrapa. Mendoj që në parim është diçka që duhet të bëhet që të plotësohen kërkesat themelore të së drejtës natyrore. Por, po ashtu mendoj që problemet praktike nuk duhen të nënvlerësohen.

- *Ju e keni shkruar historinë e parë ndërkombëtare të Kosovës. Sa është e përforcuar dhe e rrënjëzuar Kosova, si një territor i veçantë dhe cilat janë, sipas juve, rrënjët e identitetit të Kosovës?*

- Varet nga ajo se çfarë mendon kur thua e "përforcuar" dhe e "rrënjëzuar" si një territor i veçantë. Nuk është e nevojshme për një territor të veçantë të tregojë një ekzistencë të vazhdueshme si entitet politik që nga kohët e mesjetës që sot të bëjë një kërkesë të mirëfilltë dhe të vlefshme për shtetësi të pavarur. Nëse e zbatojmë këtë test shumë prej shteteve evropiane do të kishin dështuar. Belgjika u bë Belgjikë në vitin 1830. Ka shumë vende evropiane, të cilat u bënë shtete më vonë. Shikoni Gjermaninë dhe Italinë, siç i njohim sot. Kështu që, mendoj që nuk ka nevojë që të kërkohet një justifikim i gjatë historik për kufi të caktuar shtetëror në hartë. Çfarë është me rëndësi, është popullata, e cila jeton aty, ndoshta historia e 100 vjetëve të fundit. Kjo është maksimumi i një kohe të jetës njerëzore dhe rregullimi politik nën të cilin njerëzit kanë jetuar. Dhe është absolutisht e qartë që Kosova ka jetuar në sistem të paktën për 50 vjet të fundit me kushtetutat e Titos. Kosova me kufijtë prezentë ka qenë një njësi politike, duke vepruar në mënyrë të pavarur, duke marrë vendimet e veta në strukturën federale, duke përfaqësuar vetveten në nivelin federal, dhe në këtë mënyrë ka pasur të drejtat dhe fuqitë e barabarta, të njëjtin justifikim që të bëhet shtet pas shpërbërjes së Jugosllavisë në nivel të njëjtë si Sllovenia, Kroacia dhe të tjerët. Dhe kjo është e mjaftueshme, historikisht është e mjaftueshme.

- *Kjo është sa i përket territorit. Sa i përket popullit, sot disa e quajnë vetveten kosovarë, por të tjerët i kritikojnë, duke thënë që nëse i thoni vetvetes kosovarë, atëherë e mohoni identitetin shqiptar. Çfarë mendoni për këtë?*

Fjalët dhe emrat zhvillohen, krijohen në bazë të përdorimit të përgjithshëm. Një individ nuk mund të bëjë që ato të ndodhin apo të largohen. Dhe nëse termi "kosovar" është zhvilluar në këtë mënyrë dhe mendoj që është, supozoj që fillimisht ka nënkuptuar çdokush që ka jetuar në Kosovë, përfshirë edhe njerëzit që nuk janë shqiptarë. Por, është zhvilluar në këtë mënyrë dhe tani përdoret në këtë mënyrë. Nuk e shoh poentën në bërjen e ndonjë fushate që kjo të ndalohet. Lidhur me pyetjen tuaj, se a është gabim për këta njerëz të përdorim ndonjë term tjetër përveç atë "shqiptar", Kosova është shtet dhe ka kombin e saj dhe në një kuptim politik-ligjor, kjo është kombësia e tyre. Ata nuk i përkasin shtetit të Shqipërisë. Ndoshta në një kontekst është dobishëm që të jetë një fjalë tjetër. Mendoni për një paralele më të thjeshtë, mendoni për Austrinë dhe Gjermaninë. A është e gabueshme për austriakët të thonë që janë austriakë e jo gjermanë? Flasin gjermanisht, kanë kulturë gjermane. Nëse ktheheni mbrapa para rregullimit definitiv të kufirit, para krijimit përfundimtar të shtetit të Gjermanisë më 1870, njerëzit do të thoshin që Austria është vetëm një përcaktim territorial, njerëzit që kanë jetuar aty mund t'i quani austriakë apo gjermanë, ndoshta Austria do të bëhet pjesë e Gjermanisë. Por, sot askush nuk kundërshton që t'i quajmë austriakë dhe askush nuk i fajëson nëse nuk e quajnë vetveten gjermanë. Këto gjëra zhvillohen gjatë kohës.

- *Në ndërtimin e këtij identiteti të ri të kosovarëve, Kushtetuta e Kosovës thotë se Kosova është para së gjithash shoqëri shumëetnike. Disa thonë që shqiptarët është dashur të thonë këtë që të marrin pavarësinë. Pyetja ime është se, a është kjo një ideologji, pasi fakti është që 60 % të kushtetutës sonë ka të bëjë me të drejtat e minoriteteve kur janë mbi 90 % të shqiptarëve? A është kjo një ideologji dhe a jemi duke e mashtruar vetveten, ndoshta ky është një status i përkohshëm, status i përkohshëm i pavarësisë së Kosovës, në diçka tjetër në afat të gjatë? Apo është ky një model i drejtë, një themel i mirë për një kontekst të shtetësisë së shekullit XXI?*

- Kur pyesni se a është kjo diçka që është dashur ta thonë që të marrin pavarësinë, një nivel i përgjigjes është po. Nëse kishin refuzuar të thonë këtë nuk do ta merrnit pavarësinë. Por, nuk është vetëm diçka që duhet të thuhet, nuk është një formulë e vogël që nuk ka asnjë rëndësi. E kanë thënë pasi që ka qenë e rëndësishme dhe ka qenë e nevojshme të thuhet. E dimë pse ka pasur rol aq të rëndësishëm në negociatat e Ahtisarit dhe në dokumentin kushtetues që doli nga ky plan. Dhe po, ndoshta 60% e kushtetutës duket që është një përqindje e zmadhuar. Por, parimi themelor që Kosova është vend shumëetnik duhet të thuhet. Duhet të thuhet për çdo shoqëri në Ballkan. Është një kusht themelor i jetesës së vërtetë për çdo vend në Evropë. Të gjithë kanë minoritete. Dhe madje, një shtet i cili refuzon të pranojë që ka minoritete etnike, jam duke folur për Greqinë, siç e dimë ka minoritete etnike, ndonëse politikanët grekë ende e kanë të ndaluar të thonë këtë. Ndoshta, mund të fillojmë të përmirësojmë kushtetutat e vendeve tjera. Por, e kemi këtë kushtetutë në Kosovë, ka qenë e nevojshme të kemi këtë kushtetutë për të marrë pavarësinë. Parimi në esencë nuk është gabim. Vëmendja e drejtuar në të mund të ketë qenë e zmadhuar në kuptim që ndonjëherë të huajt kanë folur për Kosovën, thuaja ky ka qenë i vetmi problem. E dimë që ka shumë probleme të tjera ekonomike dhe sociale që duhen të adresohen. Por, nuk e kundërshtoj parimin.

- Në historinë e Kosovës i kemi dy hero dhe ikona të ndryshme që kanë përcaktuar, që kanë çuar në pavarësi dhe janë dy ekstreme. Në njërin anë e kemi Rugovën, me rezistencën e tij paqësore dhe durimin, që është larg nga ajo se si shqiptarët e imagjinojnë veten si luftëtarë dhe kryengritës. Ndërsa në anën tjetër, është ekstremi tjetër Ademi Jashari, duke sakrifikuar një duzinë të anëtarëve të familjes së tij dhe fqinjëve për mbrojtje deri në vdekje të shtëpisë familjare. Si i shihni këto dy ekstreme? Si do të shpjegoni këto dy ekstreme në udhëheqjen e historisë të fundit të Kosovës? Dhe këto dy figura kundërshtuese me identitetin qendror të Kosovës, vetë identitetin?

- Duket si një kontrast dramatik. Por, që e shoh si një historian, është që këto janë dy produkte të së njëjtës situatë politike. Pothuajse të dy anët e një monedhe. Dhe kjo situatë ka qenë një situatë me rritje jotolerante të krijuar në Kosovë nga politikat e Millosheviqit. Mbi të gjitha nga politikat e tij, por në kuptim më të gjerë nga një karakter afatgjatë të politikës së Beogradit ndaj shqiptarëve të Kosovës. Në thelb, kriza e krijuar nga Millosheviqi ka pasur pasojë të pashmangshme. Një prej pasojave ka qenë që mobilizimi politik ka pasur nevojë të ketë një karakter të posaçëm, ka pasur nevojë që të jetë jo vetëm një parti, por një lëvizje popullore. Rugova e ka plotësuar këtë rol në kohën kur ka qenë patjetër e nevojshme që të jetë dikush i durueshëm dhe i kujdesshëm, një figurë e unifikuar që është figurë evropiane, një intelektual me reputacion në Evropë, i cili nuk do të paraqitet si një ekstremist vendor, i cili nuk do të paraqitet si një radikal islamik. Dikush që nuk është një ekstremist vendor, nuk është radikal islamik. Rugova i ka plotësuar të gjitha këto role. Ka qenë shumë me rëndësi për popullin e Kosovës që ka qenë dikush si Rugova në atë kohë. Madje, ka mbijetuar reputacionin për takimin me Millosheviqin në mes të pastrimit etnik. Po, por ato kanë qenë rrethana të jashtëzakonshme kur ai është mbajtur në terr mbi shumëçka që ishte duke ndodhur. Në të njëjtën kohë, rëndësia e Adem Jasharit shpjegohet me të njëjta ngjarje. Nga fakti që ky lloj i politikës ka qenë i nevojshëm për të tërhequr simpatinë dhe përkrahjen e Perëndimit. Përkrahje e thellë në nivel moral, por shumë ngurruese në nivelin praktik. Në fund, kjo politikë

nuk do të përfitonte drejtpërdrejt nga Millosheviqi, gjërat që kanë qenë absolutisht të nevojshme. Kjo ndjenjë e dëshpërimit ka çuar drejt veprimeve ushtarake dhe drejt veprimeve ndonjëherë të mburrjes, ndonjëherë të heroizmit, ndonjëherë të therorisë. Është e nevojshme që të shihen që të dy këto fenomene si pjesë e të njëjtit proces.

- A mund t'ju pyes pak për Ballkanin dhe modeli të sjelljes sonë të cilën e tregojmë sipas raportit të progresit të BE-së dhe kritikët për Ballkan thonë që kemi vese të përbashkëta si vende, çdo vit kur marrim raporte për vendet tona. Dhe këto vese janë sjellje të korruptuara, klasa politike, nepotizmi, klanizimi, krimi i organizuar, jofunksionaliteti i sundimit të ligjit... Dua t'ju pyes, a janë këto sjellje të përcaktuara nga mostrat e kaluara të sundimit? Si për shembull, sociologu Robert Putnam në studimin e tij "Making Democracy Work" thotë që tendenca e Italisë jugore për klientelizëm dhe krim të organizuar është atribut i trashëgimisë të sundimit të normanëve dhe burbonëve. Në këtë kuptim, a duhet ne të fajësojmë Perandorinë Otomane dhe atë të Habsburgut apo njërin më shumë se tjetrën?

- Si historian, jam i befasuar të dëgjoj që mafia të fajësohet për shkak të sundimit të normanëve. Ky është kthim në mesjetë. Është njëjtë sikur të fajësohet familja Balsha apo Kastriotët për atë çfarë ndodh në Kosovë apo Mal të Zi, është shumë e çuditshme. Historia e lë vulën e vet në shoqëri nganjëherë në mënyrë të qartë, ndonjëherë në mënyrë të rregulluar dhe subkoshiente. Jam skeptik lidhur me këtë argument, që duhemi të kthehemi një apo dy shekuj mbrapa që të gjejmë arsye pse sot ka korrupsion, ryshfet apo krim të organizuar. Nëse shikojmë përreth, menjëherë do të shohim arsyet para nesh, nuk duhet t'i drejtohem librave të historisë për këtë. E dimë që korrupsioni ndodh në kushte të posaçme ekonomike-sociale dhe në kushte të posaçme politike. Kur fuqia politike është e dobët, kur gjyqësia është e dobët, kur vlerat e shtetit nuk janë të zgjeruara plotësisht në shoqëri dhe kur ka ndjenjë që njerëzit duhet të shikojnë vetëm vetveten dhe që s'ka rëndësi, mungesë e përgjegjësisë, ideja e pagesës të tatimit është diçka që vetëm njerëzit budallenj e bëjnë. Jam duke menduar për Itali-

në këtu sa edhe për Ballkanin. Këto gjëra kanë shpjegime të tyre politike. Në rast të Ballkanit do të thosha 50 vjet të komunizmit janë shumë më të rëndësishme si pjesë e një historie sesa rreth 500 vjet të sundimit Otoman. Dhe mendoj që nuk duhet t'i fajësojmë austro-hungarezët për asgjë. Nëse shikon se çfarë ka ndodhur në Bosnjë me ardhjen e austro-hungarezëve, ka pasur reforma të mëdha në shoqëri dhe benefite të mëdha.

- Nëse shikoni hartën e Evropës sot dhe shikoni se ku është Ballkani, a do të thoni që Ballkani është ende një fushë e lojës, ku fuqitë e mëdha janë ende duke i rregulluar punët e tyre?

- Jo, jo në mënyrën që ishte në shekullin e 19-të, për shembull në Kongresin e Berlinit. Jo në mënyrë që ishte më 1914, kur një vrasje në Sarajevë solli tërë sistemin e fuqive në një luftë botërore.

- Atëherë, në çfarë mënyre?

- Në një kuptim më të kufizuar. Mendoj, posaçërisht nëse shikohet politika ruse ndaj Kosovës. Është vështirë të shihet ndonjë arsye e brendshme në Kosovë, apo brenda situatës së ngushtë në Ballkan, që Rusia të ketë qëndrime apo dëshira aq të forta që të bllokojë politikën perëndimore. Kjo është një lojë shahu për arsye tjera. Dhe është pjesë e dëshirës të madhe të Putinit që të krijojë telashe për politikën perëndimore, që të tregojë që Rusia ka fuqi që të bllokojë gjëra, të kërkojnë shpërblime për çështje tjera për të cilat janë të interesuar, por tërësisht jashtë Ballkanit. Rusia ende është duke e trajtuar Ballkanin në mënyrë instrumentale, dhe besoj që është duke trajtuar Serbinë në mënyrë instrumentale. Njerëzit në Beograd, të cilët imagjinojnë që kanë një vëllazëri të madhe dhe që një simpati sllave është e drejtuar kah ata nga Moska, janë shumë në gabim. Ata janë të përdorur dhe të manipuluar. E kemi parë këtë me manovrimin e Rusisë me naftësjellësin dhe me blerjen e industrisë së naftës të Serbisë me një çmim qesharak të ulët. Rusia është duke luajtur loja me ata dhe në fund do t'i braktisë. Pra, mendoj që Rusia është një rast ku është fjala për fuqi politike të madhe. Kur është fjala për fuqitë evropiane, ata kanë një interes të

drejtpërdrejtë. Nuk janë duke e bërë këtë në mënyrë të vjetruar, sepse duan që të zhvillohet një situatë koherente dhe përparimtare në kufijtë e tyre. Dhe në rast të SHBA-së, mendoj që është më afër pozitës evropiane, shumë më afër sesa është me mentalitet të Moskës.

- Atëherë çfarë do të thoshit, në cilin drejtim është duke shkuar Ballkani sot? Kur e dimë që marrëveshjet që kanë ndaluar luftën e viteve të 1990 kanë ndikuar deri tash, por nuk janë dizajnuar që të zhvillojnë këto vende. Marrëveshja e Dejtonit, e cila e ka mbajtur Bosnjë e Hercegovinën në status-quo, për shembull përpjekjet e fundit të Carl Bildt dhe James Steinber të sjellin reforma në Bosnjë e Hercegovinë nuk kanë treguar sukses; Dodik është duke insistuar në ndarjen e Republikës Serbe nga Bosnja. Pastaj, Serbia është duke refuzuar që të pranojë shtetësinë e Kosovës, dhe është duke mbajtur Veriun si peng, duke penguar themelimin e sundimit të ligjit atje dhe duke e përdorur këtë si monedhë për bisedime për statusin e Kosovës, sikurse shpresojnë. A është ardhmëria e Ballkanit në rrezik meqë vëmendja e bashkësisë ndërkombëtare po kalon në vende tjera të botës?

- Nuk do të kisha gjeneralizuar lidhur me Ballkanin. Por, dy vendet që i përmende, Bosnja dhe Kosova, kanë me të vërtetë probleme dhe rreziqe, ka rreziqe sidomos në rast të Bosnjës. Nuk mendoj që në rastin e Kosovës ka ndonjë rrezik të madh. Rreziku i vetëm është ngecja dhe mospërmbushja e përparimit sa më shpejt që Kosova duhet bërë dhe sa mundet të bëjë. Në rast të Bosnjës është një rrezik i vërtetë, një rrezik politik. Dhe mendoj që komenti i juaj i fundit që ndoshta vëmendja e fuqive perëndimore ka kaluar diku tjetër është absolutisht e vërtetë. Është e vërtetë për Amerikën që për disa vite tani, involvimi i madh në Irak dhe Afganistan ka marrë energjinë e Departamentit të Shtetit. Tani ka më shumë një lloj të mentalitetit të mbajtjes gjallë të operacioneve kur shikojnë Ballkanin. Kështu që më shumë përgjegjësi u takon fuqive evropiane. Dhe kam frikë që Evropa është tani në një moment të vështirë. Është momenti kur për herë të parë është duke u munduar që zyrtarisht të zhvillojë një politikë të jashtme evropiane, me një përfaqësues të politikës së jashtme, me një kuazi-Ministri të

Punëve të Jashtme, me diplomatë. Ky është një projekt i vështirë, sepse tekefundit, politika e jashtme në çdo vend evropian është plotësisht çështje kombëtare. Dhe e dimë që këto kombe nuk pajtohen në shumë çështje kyçe, e kemi parë këtë me çështjen e Kosovës.

- *Cilat janë rreziqet nëse nuk pajtohen? Çfarë efektesh mund të kanë këto çrregullime që vijnë nga Kosova dhe Bosnja tek anëtarët e BE-së? Nëse ka çrregullime të tilla?*

- Siç e thashë, nuk mendoj që rreziku për Kosovën është një lloj i çrregullimit serioz, nuk shoh luftime apo tanke që shkojnë në ndonjë drejtim në Kosovë.

- *Jo, por për shembull mospranimi që të hyjmë në BE për shkak se Spanja, Sllovakia dhe Qipro nuk na njohin dhe nëse vazhdon kështu për dekada e më shumë...*

- Kjo është ajo që e quaj ngecje serioze. Ka rreziqe për zhvillim ekonomik, ka rrezik që një valë e njerëzve që nuk gjejnë punësim në Kosovë të vërshojnë vendet tjera evropiane, duke kërkuar punë. Jam i sigurt që këto rreziqe kuptohen. Mendoj që rreziku në Bosnjë është më serioz. Është problem që ka qenë i qartë që nga Marrëveshja e Dejtonit. Shumë njerëz kanë shkruar për këtë, shumë njerëz kanë folur për këtë, nuk ka asgjë të re të thuhet për këtë. Marrëveshja e Dejtonit ka dështuar të zgjidhë problemet themelore. Thjesht ka ngrirë situatën, ku ka ndodhur pastrimi etnik dhe ku njerëzit përgjegjës për pastrim etnik janë ende në fuqi në një pjesë të madhe të Bosnjës. Ka ngrirë këtë situatë dhe pastaj njerëzit në terren që e zbatojnë këtë kanë refuzuar që të përdorin fuqitë e tyre që ta bashkojnë Bosnjën siç duhet.

- *A ka ndonjë zgjidhje historike për këtë? Sepse për rastin e Kosovës keni thënë dhe më është dukur kontroverse, që nuk do të befasoheni me formimin e Shqipërisë etnike nëse kushtet e lejojnë formim e një shteti etnik shqiptar. Por, për rastin e Bosnjës, a mendoni që një zgjidhje historike çon në këtë drejtim?*

- Më fal, a kam thënë që nuk do të befasohesha me formimin e një vendi etnik shqiptar?

- *Unë kam lexuar dhe kuptuar, që ju mendoni që do të ishte natyrale që Kosova dhe Shqipëria të jenë një shtet, jo tani por në kushte të tjera, ndoshta për 50 apo 100 vjet ajo mund të ndodhë.*

- Për 50 apo 100 vjet shumë gjëra mund të ndodhin. Mbi çështjen e bashkimit të Kosovës dhe Shqipërisë, të cilën nuk e kemi diskutuar, mendoj që krejt varet. Është një shembull klasik i çështjes politike që çdo gjë varet nga mënyra se si e përpiloni pyetjen. Nëse e pyetni ndonjë shqiptar në Shqipëri apo shqiptar në Kosovë, se a mendojnë një ditë do të ishte mirë që këto të dyja të bashkohen dhe të keni një shtet të madh shqiptar? Jam i sigurt që një shumicë e madhe do të thotë po, një ditë kjo do të ishte mirë. Dhe natyrisht nëse pyetni se a është bërë një padrejtësi historike më 1913, kur u krijua versioni i parë i këtij kufiri dhe ndarja, të gjithë do të thonë që kjo ishte një padrejtësi e madhe. Kështu që nëse e shtroni pyetjen në këtë mënyrë, natyrisht që do të merrni përgjigje që duket si një thirrje e madhe për bashkim. Por, mendoj se nëse i pyetni njerëzit në një referendum të mirëfilltë politik sot apo nesër se a do të preferojnë të janë shtet i bashkuar, kështu që politika juaj dhe vendimet që ndikojnë në jetën tuaj mund të janë të dominuara nga politikanë nga vendi tjetër dhe jo nga vendi juaj. Për vite kam pyetur shumë njerëz se çfarë mendojnë mbi atë se si këto referendume mund të zhvillohen dhe shumica e njerëzve që njohin Kosovën dhe Shqipërinë mirë, përfshirë politikanë kryesorë më kanë thënë që sinqerisht mendojnë që nuk do të arrijnë të marrin shumicën. Nga të dyja anët e kufirit. Kështu që nuk mendoj që do të ndodhë në nivel praktik shpejt. Në nivel teorik mund të ndodhë, por njerëzit nuk marrin vendime tani për atë që do të ndodhë për 50 vjet. Dhe në ni-

velin se a është në parim e gabuar që kjo të ndodhë, më duket e qartë që nuk do të ishte gabim nëse të dy vendet në mënyrë demokratike vendosin të bëjnë këtë.

- *Por nga ana tjetër, ky është argumenti që është duke u përdorur nga njerëzit në Republikën Serbe, nëse e lejoni këtë, pse nuk na lejoni të bashkohemi me Serbinë?*

- Ka një përgjigje të thjeshtë për këtë. Që Kosova është një shtet i vërtetë që ka dalë nga një status federal i vërtetë në ish-Jugosllavi. Republika Serbe nuk është shtet, ka dalë nga procesi i pastrimit etnik dhe nga vrasjet masive, dhe ky është themeli i Republikës Serbe. Më vjen keq tingëllon pakëndshëm kur e them kështu troç, por është e theme-luar në vrasje masive dhe ky është themeli i Republikës Serbe, ashtu siç ekziston në hartë. Ekziston në hartë pasi që armata pushtoi territo-rin dhe përzuri njerëzit me tytë, thikë dhe vranë shumë prej tyre gjatë kësaj.

- *Madje edhe sot ky rajon është duke e ndaluar pjesën tjetër të Bosnjës të ecë përpara. Cilat është zgjidhja?*

- Jam duke e thënë këtë gati që nga vetë Dejtoni. Dhe më bie ndër mend kur e kam thënë këtë në Uashington në vitin 1997, dhe më thanë që jam i nxituar, që jam gabim dhe që Dejtoni është një marrëveshje e mirë, që Amerika ka investuar shumë prestigj në të dhe dot ë ishte gabim që të ndërrohet tani dhe vazhduan të thonë këtë, atë... Ishte e qartë që ishte duke e ngrirë situatën dhe duke ndërtuar gjëra shumë më të këqija në kuptim të realizimit të Bosnjës si shtet. Mendoj që tani është shumë më vështirë të merremi me këtë problem se që ka qenë atëherë. Sepse atëherë fuqitë e Përfaqësuesit të lartë kanë qenë shumë të mëdha, janë rritur në Petersberg, me marrëveshjen e Bonit, e cila i zmadhoi fuqitë. Tani, shumica e këtyre fuqive është zhdukur, qeveritë perëndimore kanë hedhur poshtë këto përgjegjësi. Por, e kanë fuqinë themelore që të thonë që nuk mund të pranojnë kurrë që Republika Serbe të bëhet shtet i pavarur. Vërtet, këtu prestigji i tyre është në pyetje. Sepse nëse e lejojnë këtë do të shkatërrojnë themelet e marrëve-

shjes paqësore, të cilën e kanë hartuar. Kjo jo vetëm që do të zhbëjë të kaluarën, por do të hapë lloje të ndryshme të precedentëve për të ardhmen. Sepse kur një herë lejon që territoret të cilat janë krijuar në bazë të dhunës etnike të shpallin veten si shtete të pavarura, territoret të cilat nuk kanë pasur status politik në mënyrë të cilën Kosova qartë e ka pasur në sistemin federal të Jugosllavisë, atëherë çfarë ndodhë? Çfarë do të ndodhë nëse minoritetet etnike në Maqedoni vendosin për dhunë, çfarë ndodh nëse shqiptarët në Serbinë Jugore vendosin për dhunë? Kjo është kutia e Pandorës dhe Perëndimi e di këtë. Kështu që duhet të jenë plotësisht të qartë në lidhje me këtë. Republika Serbe nuk do të bëhet shteti i pavarur. Mendoj që në kuptim praktik, fuqia tani është më shumë në duart e Brukselit dhe në politikën evropiane. Dhe si do të modelojnë, çfarë thonë për proces të lëvizjes drejt pranimi në Evropë. Kjo është kyç, kjo është kyç për Serbinë dhe kjo është kyç për Bosnjën.

- *A mendoni që do të lejojnë, duke e njohur Evropën, si ajo operon dhe mentalitetin e saj, a do të shohim që Serbia do të hyjë në Evropë pa e njohur Kosovën dhe pastaj do të bllokojë? Siç është duke ndodhur me Slloveninë dhe Kroacinë me konfliktin e tyre për kufi?*

- Nëse njerëzit në Evropë janë shumë budallenj, atëherë po. Ndoshta e keni vërejtur, por nuk jam admirues i madh i BE-së. Mendoj që nuk është projekt politik koherent. Mendoj që ka çuar drejt një politike të jashtme jokohërente, për arsye që i përmenda, që së fundi qeveritë kombëtare kanë ide dhe preferenca thellësisht ndryshe. E kemi parë këtë shumë qartë me tërë debatin me EULEX-in dhe me një situatë të çuditshme, ku BE-ja pohon që është përgjegjëse për zhvillimin e Kosovës si shtet, por duhet të dërgojë mision që nuk e njeh Kosovën si shtet, e cila pohon që është neutrale dhe në këto kushte kjo do të thotë jo neutralitet, por refuzim që të njohë atë që është e pavarur. Kjo nuk është një recetë për një politikë-bërje koherente. Kështu që bregosem për politikën evropiane. Sinqerisht mendoj që kanë përcjellë një drejtim të gabueshëm mbi Qipron. Dhe kemi parë një prej pasojave të kësaj me vijën e ashpër të qeverisë së Qipros kundër njohjes të

Kosovës. Nëse më kujtohet mirë, ata kanë thënë që edhe nëse Serbia e pranon Kosovën, Qipro nuk do ta njohë Kosovën kurrë. Kjo është e çuditshme. Kështu që nuk jam optimist në lidhje me politikën e Brukselit. Por, Brukseli ka njerëz mirë të informuar dhe inteligjentë dhe së fundi duhet t'u përgjigjet qeverive kombëtare që do të shtojnë argumente inteligjente dhe mirë të informuara. Kështu që shpresoj që do të krijojë një politikë inteligjente për këto çështje shumë të rëndësishme.

- Ballkani është ndërtuar në mite si rezultat të udhëheqjeve të këqija. Dhe ka çuar drejt një besimi që rajoni është i prirë për një urrejtje të vjetër etnike. Në disa vende të Ballkanit ksenofobia është në rritje dhe oreksi për një kontroll më të madh shoqëror të disa qeverive vazhdon të ndërtojë mite të reja. Çfarë mendoni, çfarë mund të bëhet me këto mite që të mos mbajnë si peng rajonin në tërësi në të ardhmen?

- Miti i urrejtjes së vjetër etnike pjesërisht është prodhuar nga të huajt injorantë, nga udhëtarët në fillim të shekullit 20 dhe më tej. Mendimi që do të jetë më lehtë dhe ekzotike për lexuesit e tyre, nëse thonë që kjo është një vorbull i pashpjegueshëm i urrejtjes së vjetër. Kjo e bëri ekzotike dhe misterioze. Pjesërisht vjen nga kjo. Pjesërisht vjen nga historia e fundit, nga një manipulim dhe ngatërrim i bërë me qëllim për opinionin perëndimor. Nga njerëzit që kanë dëshiruar të mendojnë që luftërat që janë shkaktuar drejtpërdrejt nga politikanët, para së gjithash nga Millosheviqi në Beograd, që këto nuk janë shkaktuar nga politikanët modernë, por që janë shkaktuar nga njerëz antik me shpata dhe nga kujtimet e njerëzve. Ka pasur marrëzi në njërën anë dhe manipulim e ngatërrim të qëllimshëm në anën tjetër. Dhe nëse shikoni realitetin, këto urrejtje të vjetra shkojnë jo më larg se mesi i shekullit të 19-të. Dhe janë produkte, produkte normale të proceseve të shtetndërtimeve që zhvilloi nacionalizma të ndryshëm me mite të tyre nacionale. Dhe zhvilloi konflikte politike, sepse këto nacionalizma konkurronin për territor. Kjo është e ashtuquajtura "urrejtje e vjetër etnike". Dhe pyetja juaj se si do t'i ndalojmë apo t'i zvogëlojmë në të vërtetë është pyetje e arsimimit në një kuptim më të gjerë. Jo vetëm

ajo që shkruan në libra shkollorë, por çfarë njerëzit thonë në publik, çfarë politikanët thonë, çfarë është thënë në media. Nuk jam duke folur për një larje të trurit apo një ideologji të re, që Ballkani ka qenë gjithmonë një vend i tolerancës së ndërsjellë, jo. Një histori normale dhe një mirëkuptim normal. Dhe ndoshta një mirëkuptim normal që çdo vend në Evropë ka disa elemente, ka disa minoritetet etnike që përçmohen nga fqinjët apo e kundërta. Nuk ka asgjë unike lidhur me këtë, asgjë.

- Doktor Malcolm faleminderit për intervistën.

RECENSION

MUHARREM BLAKÇORI, PËRKTHYESI I PARË I KUR'ANIT NË GJUHËN SHQIPE

Përkthimi i Kuranit (me koment) nga gjuha arabe në gjuhët e tjera ka lindur si nevojë e popujve myslimanë, të cilët nuk e kanë arabishten gjuhën e tyre të nënës.

Ky fakt evidentohet që në kohën e Profetit Muhamed (a.s.) ku Selman el-Farisi, me lejen e tij, kishte përkthyer suren Fatiha në gjuhën perse. Edhe më vonë vijnë përkthimet e Kuranit Falmëllartë në gjuhë të ndryshme për të kuptuar mesazhin dhe urdhrat e Allahut.

Në gjuhën shqipe përkthimet e para të sureve dhe ajete të Kuranit janë bërë nga intelektualit dhe poeti i madh i letrave shqipe, Naim Frashëri në librin e tij me titull "Thelb' i Kur'anit", që është botuar në veprën e tij "Mësimet" në vitin 1894, në Bukuresht.

Përkthyes i disa pjesëve të Kuranit në gjuhën shqipe më 1921 është edhe Ilo M. Qafëzezi, i cili merr për bazë



përkthimin e Kuranit në gjuhën angleze të autorit Georg Sale.

Më vonë bëhen përkthime të pjesëve të Kuranit nga H. Ali Korça. Në kompletin e botuar nga shtëpia botuese Logos-A janë mbledhur në një libër përkthimet e Kuranit në gjuhën shqipe. Në shënimet dhe studimet për biografinë e H. Aliut thuhet se ka bërë

komentimin e gjithë Kuranit, por fatkeqësisht ato nuk i mbijetuan regjimit komunist.

Në këtë fushë shquhet dhe H. Ibrahim Dalliu, si me përkthimin e disa sureve në gjuhën shqipe, po ashtu edhe me komentimin, të cilin e ka titulluar "Ajka e kuptimevet të Kur'ani Qerimit", vepër e botuar në vitin 1929.

Disa pjesë të Kuranit në gjuhën shqipe janë përkthyer edhe nga H. Abdulla Zemblaku, Ferit Vokopola etj.

Përkthimi i parë i plotë i Kuranit në gjuhën shqipe njihet ai i akademikut kosovar Feti Mehdiu, në vitin 1984. Ky përkthim botohet në vitin 1985 nga Bashkësia Islame e Kosovës me titullin "Kur'an-i", i cili ka 878 faqe.

Tre vite më vonë pason përkthimi i Hasan Nahit dhe po në të njëjtin vit përkthimi i Sherif Ahmetit. Ky i fundit mban titullin "Kur'an-i, përkthim me komentim në gjuhën shqipe", i botuar në vitin 1988 nga Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës dhe është përkthimi më i përhapur i Kuranit në gjuhën shqipe. Më pas do të pasonin përkthime të tjera të Kuranit në gjuhën shqipe nga autorë të ndryshëm.

Por, a është me të vërtetë Feti Mehdiu përkthyesi i parë i plotë i Kuranit në gjuhën shqipe?

Nëse jo, kush e ka përkthyer për herë të parë Librin e Zotit në gjuhën shqipe?

Nga faktet që ne disponojmë del se, nuk është Feti Mehdiu përkthyesi i parë i Kuranit në gjuhën shqipe, por Muharrem Blakçori, një patriot shqiptar nga Peja që ka banuar në Kavajë.

Përkthimi i tij i Kuranit është bërë në vitin 1968 gjatë periudhës së regjimit komunist, rreth 16 vjet para përkthimit të Feti Mehdiut. Ky përkthim për shumë arsye nuk ka mundur të gjejë dritën e botimit dhe është ende në dorëshkrim, i ruajtur me fanatizëm nga nipi i tij, Xhevdet Blakçori.

Po kush është Muharrem Blakçori?

Muharrem Blakçori lindi në Pejë në vitin 1894 në një familje zejtare, që merrej me prodhimin e armëve. Mësoi herët të lexojë e shkruajë gjuhën shqipe dhe u shqua për zellin në përhapjen e mësimin të gjuhës shqipe në shtëpitë e bashkëqytetarëve. Ndoqi dy vjet studime në një medrese në Pejë ku mësoi gjuhën arabe, turke dhe perse. Më pas me vullnet të fortë arriti t'i perfeksiononte këto gjuhë.

U përmdoq nga pushtuesit serbë dhe për t'i shpëtuar ndëshkimit të egër kapërcen kufirin dhe vjen në Shqipëri. Emërohet mësues në Shijak e më pas në Kavajë, ku merr pjesë aktive në Shoqërinë "Bashkimi" duke dhënë ndihmesën e vet në fitoren e Revolucionit të Qershorit 1924.

Në fillim të dhjetorit 1924 niset nga Qeveria e Nolit në zonën e Gjirokastres për të propaganduar rrezikun e rikthimit të Zogut e për të nxjerrë vullnetarë në mbrojtje të Qeverisë së Nolit.

Me rikthimin e Zogut pushohet nga puna, dënohet me vdekje, por me ndërhyrjen e miqve internohet në Skrapar. Atje punon më shumë se dy vjet dhe kthehet në Kavajë.

Në vitin 1941 shkon në vendlindjen e vet në Pejë dhe hap të parën shkollë shqipe.

Në vitet 1960-1968 ndërmori përkthimin Kuranit e “Historisë islame”, “Akaidi dhe fiku”, Fjalor arabisht-shqip” (rreth 2000 fjalë), vepra të cilat ua la dorëshkrim trashëgimtarëve të vet. Ndërroi jetë në vitin 1968 i pezmatuar për ndalimin e fesë.

Përkthimi i Kuranit dhe veçoritë e tij

Muharrem Blakçori parandiente ndalimin e fesë dhe riteve fetare prandaj vendos të përkthejë Kuranin në gjuhën shqipe dhe përgatitjen e librave fetarë për fëmijët dhe nipërit e tij. Kur e mbaron përkthimin mbas një


pune të lodhshme nga viti 1960 deri në 1968 u thotë fëmijëve dhe nipërve se ky është përkthimi i Kuranit në gjuhën shqipe dhe fenë e Allahut mund ta mësojnë nga këta libra.

Përkthimi është i përbërë nga katër fletore të mëdha, që të gjitha në dorëshkrim. Fletorja e parë ka 190 faqe, e dyta 730 faqe, e treta 921 faqe dhe e katërta 1168 faqe. Gjithsej 3019 faqe.

Të gjitha suret e Kuranit janë të përkthyera sipas radhës, nga ‘Fatiha’-ja deri tek sureja ‘Nas’ dhe të ndara në xhuze.

Fillimisht ai jep një shpjegim në lidhje me shkronjat e Kuranit duke i ilustruar me figura. Në këto ilustrime tregon se cilat janë shkronjat arabe, nga dalin dhe si shqiptohen. Më pas fillon me xhuzin e parë të Kuranit.

Çdo sure e fillon me emrin e saj në arabisht dhe shkronja latine. Më pas jep informacione për çdo sure, sa ajete përmban, në ç’vend është zbritur (Mekë-Medinë) dhe shkaku të zbritjes nëse ka. Pastaj ajetin/et e shkruan në arabisht, më pas shqiptimin me shkronja latine dhe në fund përkthimin.



Formë të ngjashme e gjejmë edhe në tefsirin e H. Ibrahim Dalliu ku autori e ka marrë për bazë. Mirëpo përveç formës, nuk ka marrë gjë tjetër nga ky tefsir. Ajetet janë të gjitha përkthimi i vetë autorit. Këtë e vërejmë

nga krahasimi midis ajeteve të përkthyera nga H. I. Dalliu, por edhe në stilin që e shoqëron përgjatë gjithë përkthimit. H. I. Dalliu e ndan përkthimin nga komentimi dhe është më preciz në përkthimin e tij duke u mu-

nduar t'i mbetet besnik tekstit. Ndërsa veçoria e përkthimit të autorit tonë, është se nuk është thjesht përkthim, por në të njëjtën kohë edhe komentim.

Një element tjetër i rëndësishëm i këtij përkthimi është dhe gjuha shumë e pasur dhe fjalori i pastër që ka përdorur. Ky fakt tregon se sa mirë e zotëronte gjuhën arabe, gjuhën amtare dhe njohuritë e gjera në fushën e fesë dhe komentimit të Kuranit. Një person që e lexon këtë përkthim është në gjendje të kuptojë se për çfarë bën fjalë ajeti/et. Kjo falë përkthimit të pasur me komente brenda ajetit, herë pas here në veçanti edhe pas ajetit.

Për ta zbukuruar, ilustruar dhe treguar më mirë se kujt i drejtohet ajeti kuranor e fillon me fjalët "O i Madhënueshmi Perëndi!" apo "O i Dashtuni Muhammed!". Kjo lloj forme përdorimi ka mjaft vlere artistike, letrare por edhe fetare. Lexuesi nuk futet në monotoni dhe nuk mërzhitet, por e shijon më tepër përkthimin.

Le të japim disa shembuj nga përkthimet e autorit për të dëshmuar më mirë punën e tij vlerashumë.

O Zot! Më ruaj prej shejtanit (djallit) të mallkuem që asht i ndeshkuëm!

Po filloj me emnin e mëshiruesit Perëndi që mëshiron.

I qoft shumë shyqyr e falenderime Zotit të Madhënueshëm i cili ka kriue të gjithë botnat (gjithësinë) e jau jep ushqimin të gjitha krijesave kudo që të

jenë në dynja edhe ne ahiret, dhe asht meshiruës i madh, dhe pronar i gjithësisë edhe gjykates absolut i ditës së kiametit!

O i Madhënueshmi Perëndi! Ty po të lutemi e po baj ibadet e adhurim, se veç teje nuk ka tjetër që meriton falje, lutje e adhurim. Pra ty po të lutemi o i Madhënueshmi Perëndi: na drejto e na shpje në rrugën e drejtë, në at rrugë që ja ke mësue të dashtunit tand H. Muhammedit a.s. me të cilën ai ka ftue njerzinë, në rrugën që ka shumë niëmete e mirësi të mëdha.

O Zot! Mos na le në rrugën e të humbur të errësinës, por na ndritço e na ço në rrugën e të dashtunve tu, të njerzvetëmirë.

O i dashur! Thuaj atyre që dëshirojnë me e mësueqyshqënjën e Madhënisë s'ime.

I Madhi Zot është një, veç tij nuk ka tjetër që meriton adhurim "ti bahet ibadet", Zoti është kriuesi i gjithësisë, është veliniëmet "tytor" i gjithë krijesave. Ai jau siguron rrizkun "ushqimin".

Është gabim me atribue Zotit lindje, është qyfyfyr i madh. Madhënia e Zotit as nuk ka le, as nuk lind, përherë ka qenë dhe ka me qenë. Zoti është mynezze "i çueshem" prej çdo çilësie të krijesave.

Shkurt Zoti është i adhuruemi apsolut që si afrohet, as nuk i ngjan kurr-

gja Madhënisës'tij. Nuk ka shembullues e urdhnuës.

Duke parë vështirësitë në të cilën po kalonte feja në periudhën kur autori jetoi, ai parandjeu mbylljen e saj. Kjo e shtyu Muharrem Blakçorin të bënte përkthimin e Kuranit dhe përgatitjen e librave të tjerë fetarë. Ai me këtë akt po i paraprinte fatkeqësisë së madhe që do kaplonte kombin, ndriçimin e tij me dritën e Kuranit. Puna kolosale e autorit nuk ka vetëm vlerën e përkthimit, por edhe të komentimit të Kuranit.

Prandaj duhet të ndreqim edhe faktin historik se nuk është Feti Mehdiu përkthyesi i parë i Kuranit nga arabi-

shtja në gjuhën shqipe, por Muharrem Blakçori, një patriot me orgjinë nga Kosova. Me këtë shkrim nuk dua t'i heq ndonjë meritë akademikut kosovar për punën e tij të vyer, por t'i japim hakun që i takon mësues Muharremit, që për shumë kohë dhe arsye mbeti në harresë deri më sot. Duke shpresuar të marrë vendin dhe vlerat që i takojnë për punën e tij të çmuar, lusim Allahun t'ia shpërblejë me Xhenet!

Ledian Cikalleshi

Marrë nga Portali: Islam
Gjakova.net

RECENSION

Nuridin Ahmeti

610 VJET HISTORIE NË 100-VJETORIN E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË

**(Feti Mehdiu: “Reflektime të luftës së shqiptarëve për Pavarësi 1389- 1999”,
Shoqata e Orientalistëve të Kosovës, Prishtinë, 2012, f. 248).**

Për nder të jubileut të 100-të të Pavarësisë, por edhe në jubiletë e mëherëshëm, te ne sikur është bërë traditë të përkujtohen ngjarje e figura emblematike dhe kyçe në ato rrjedha. Prandaj, dhe në këtë 100-vjetor të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, ishim dëshmitarë të organizimeve të shumta; simpoziume, konferencave, përkujtime ngjarjesh e betejash etj.

Në këtë jubile janë botuar libra nga autorë të ndryshëm vendorë dhe të huaj, për ngjarjet dhe personalitetet që kontribuuan gjithanshëm në shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë. Këta tituj kur vijnë nga njerëz të kualifikuar, pa mëdyshje, pikësëpari autorët i bëjnë nder vetvetes, pastaj edhe lexuesit dhe

sigurisht i begatojnë edhe bibliotekat tona.

Në këtë 100-vjetor të Pavarësisë, studiuesit dhe lexuesit kanë pasur mundësinë ta kenë në dorë edhe një libër të titulluar: “*Reflektime të luftës së shqiptarëve për Pavarësi 1389-1999*”, i shkruar në periudha të ndryshme kohore nga ish-nxënësi i Medresesë “Alauddin” në Prishtinë, ish-aktivisti i Lëvizjes ilegale e quajtur “Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve”, orientalisti, përkthyesi i parë i Kur’anit në gjuhën shqipe, profesori shumëvjeçar i Universitetit të Prishtinës, autori i shumë librave, akademik Feti Mehdiu, të cilin e ka botuar Shoqata e Orientalistëve të Kosovës më 2012.

Derisa, dikur një vogëlush i kishte bërë një pyetje fëmijërore babit të tij; *Baba, më shpjego, pra, përse shërben historia?* autori March Bloch, i ishte përgjigjur me një libër të titulluar: “*Apologji për historinë*”, ku mes tjerash shkruan: “Për një njeri që shkruan nuk mund të përfytyroj lëvdatë më të bukur sesa të dijë t’u flasë me të njëjtin ton edhe të diturve edhe shkollarëve.” Libri i akademik Feti Mehdiut, me informacionet dhe të dhënat që ka, të ofruara nga burime nga më të ndryshmet, si edhe me gjuhën e pasur e stilin e rrjedhshëm, jep mundësi për t’u kuptuar jo vetëm nga studiuesit dhe studentët e historisë, por edhe për masën e gjerë të lexuesve që dëshirojnë ta kuptojnë historinë sa më saktë e sa më me objektivitet. Akademik Feti Mediu është edhe vetëkritik kur thotë; “Historia i shpërblen dhe i sanksionon të gjitha veprimet dhe mosveprimet e të gjithë neve”.

Akademik Feti Mehdiu ka kaluar në dallga të ndryshme gjatë jetës së tij, si në rrafshin profesional edhe atë njerëzor, dhe në këtë moshë si një gjysh i mirë, i regjur nëpër pore të ndryshme të jetës, ka vërejtur se ne si popull kemi mësuar shumë pak histori, e kur nuk mësohet sa dhe si duhet nga historia, ka mundësi që ajo të përsëritet. Që të mos na përsëritet e kaluara, akademik Feti Mehdiu, duke ua dedikuar librin nipit dhe mbesave të tij: Blinit,

Linës dhe Erinës, përmes të cilëve iu drejtohet edhe atyre që kanë fatin ta kenë këtë libër në dorë, jep porosinë: “*Të nxjerrin mësim nga historia, edhe për të tjerët*”.

Libri i akademik Feti Mehdiut, ka 248 faqe dhe është i pajisur me aparaturën e nevojshme shkencore, nuk është i ndarë në kapituj, gjë që e bën librin të lexohet më një frymë, në fakt ky libër është një përmbledhje punimesh të autorit të shkruara dhe të përkthyer në etapa të ndryshme kohore.

Libri fillon me punimin: “Shtypi arab për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”, që në fakt siç sqaron edhe autori, nuk është përfshirë i gjithë shtypi arab, por vetëm ai egjiptian, ku autori i librit kishte hulumtuar gjatë qëndrimeve të tij për specializimin e gjuhës arabe në Kajro. Shteti i Egjiptit, i themeluar nga Mehmet Ali Pasha, një pasha me origjinë shqiptare, po ashtu edhe gazetaret të cilat i hulumtoi autori ishin themeluar në ato vite nga Mehmet Ali Pasha, dhe lajmeve që vinin për ngjarjet që kishin të bënin me shqiptaret, gazetaret e Egjiptit iu jepnin hapësirë të konsiderueshme. Këto informacione të dobishme për historinë tonë, që të mos mbesin në pluhurin e harresës, akademik Feti Mehdiu, i hulumtoi, i sistemoi dhe ua vuri në dispozicion lexuesve mbarëshqiptarë, fillimisht duke i botuar disa pjesë në revistën e Institutit të Historisë “Koso-

va”, nr. 5, 1976, me titull: “Disa të dhëna të shtypit arab për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”.

Pse duhet potencuar kjo veprimtari hulumtuese e akademik Feti Mehdiut në Egjipt? Sepse siç e dini në këtë kohë një numër i konsiderueshëm i studentëve shqiptarë ishin në Egjipt për studime, e gjithë ata ishin të fokusuar në studimin e shkencave islame, pas kryerjes së studimeve janë kthyer në vendlindjet e tyre, duke u shërbyer në mënyrën më të mirë vendit dhe popullit që i lindi dhe i rriti, natyrisht puna e tyre është për t’u çmuar, por, fatkeqësisht edhe sot e kësaj dite, vazhdon e njëjta traditë, studentët shqiptarë shkojnë në botën arabe, kthehen me profesione dhe me dije të tyre nga fusha islamistikës, e që për mua nuk ka asnjë të keqe, por në kohën kur kuadri i islamistëve nëpër Kosovë është shtuar gjithandej, do të duhej që dikush të orientohej edhe për hulumtime shkencore nga fusha e albanologjisë, që padyshim do t’i bënin nder shkencës në përgjithësi dhe albanologjisë në veçanti, prandaj, këtë privilegj e gëzojnë akademik Feti Mehdiu, së bashku me Qemal Morinën, të cilët sipas mendimit tim, janë pionierët e parë shqiptarë të hulumtimeve për historinë shqiptare në këtë pjesë të kontinentit.

Akademik Feti Mehdiu, është ndër të parët që studiuesve shqiptarë ua ka bërë me dije se bota e Lindjes ruan një

thesar të çmuar për albanologjinë, ndërkaq kësaj pjese të botës studiuesit shqiptarë duhet t’i qasen në mënyrë objektive dhe pa paragjykitime. Fatkeqësisht, një mendësi e tillë e paragjykitimit po vazhdon të jetë prezent edhe në ditët e sotme.

Libri vazhdon me punimin: “Lidhja Shqiptare e Prizrenit në “Tyrxhemani Shark”, kryeredaktori i së cilës ishte ideologu i Rilindjes Kombëtare Shqiptare Sami Frashëri, botimeve që ishin bërë deri në atë kohë, mbi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, po u ofrohej edhe një burim i rëndësishëm, gazeta “Tyrxhemani Shark”. Sado që autori i librit me plot të drejtë në këtë punim e potencon gazetën si burim plotësues dhe të dorës së dytë. Për këtë ngjarje, por edhe ngjarjet që ndodhën më pas disa autorë të cilët janë marrë me çështjen e historisë së shtypit dhe rëndësinë e tij për historinë shqiptare, e që edhe mua më duket një konstatim i tillë i drejtë kur thuhet: “Shtypi është burim i dorës së dytë, por në mungesë të burimeve dokumentare, shtypi mbetet burim i dorës së parë”.

Disa herë më ka rënë të dëgjoj, kur flitet për Betejën e Kosovës, të vitit 1389, edhe si student, por edhe si pjesëmarrës në tubime të ndryshme në të mirë të albanologjisë, se: “kjo ngjarje, apo kjo periudhë është e errët”, “turqit i kanë mbyllur këto dokumente dhe nuk i vënë në dispozicion për studiuesit e huaj”, etj, etj. E gjithë kjo ishte në kuadër të propagandës nacional-komuniste, e cila ka sjellë edhe deri te paragjykitimet në historiografinë tonë për shumë ngjarje e figura historike.

Studiuuesi Husamedin Feraj kur flet për zhvillimin historiografik gjatë periudhës moniste dhe për figura historike thotë: “Në shumë raste në historinë shqiptare, ai person që ishte, shqiptar dhe pro-serb u shpall hero, ndërsa ata që ishin shqiptarë dhe proturq u shpallën tradhtarë të kombit”.

Nisur nga kjo, Beteja e Kosovës, as nuk ishte një mit, as nuk u mbyllën dokumentet për studiuesit e huaj, por, problemi qëndronte dhe ende është prezent mungesa e kuadrit shqiptar për t’u përballur me një mal dokumentesh gjithandej nëpër arkivat turke dhe botërore të shkruara në gjuhën osmane për shqiptarët.

Për ta demantuar këtë edhe më, dy osmanologët e njohur boshnjakë, Sali Trako dhe Fehim Bajraktareviqi, botojnë në gjuhën boshnjake dy punime serioze për Betejën e Kosovës, të vitit 1389. Sali Trako në vitin 1969, do të botojë në “Priloz za Orientalnu Filologiju”, të Sarajevës me titull: “*Beteja e Kosovës 1389 në historinë e Idriz Bitlisit*”, dhe Fehim Bajraktareviqi me titull: “*Një burim bashkëkohor persian për Betejën e Kosovës*”, të botuar më 1953 në “Priloz za Orientalnu Filologiju”, të Sarajevës, në fakt përkthimi i

parë i këtij botimi të F. Bajraktareviqit është bërë nga specialisti i arkivistikës në Arkivin e Kosovës, Ismail Rexhepi, dhe më pas nga akademik Feti Mehdiu. Sido që të jetë, këto dy punime të përkthyer në gjuhën shqipe janë të botuara në librin e akademik Feti Mehdiut. Këto dy punime me interes për shkencën dhe për lexuesin, autori përmes përkthimit në gjuhën shqipe ua ofroi edhe lexuesve shqipfolës.

Tri punimet në vazhdim të këtij libri janë punime që kryesisht janë të mbështetura në “Sallnamet” apo “Vjetarët” e Perandorisë Osmane, që bëjnë fjalë për Vilajetet Shqiptare, të cilat autori i ka shfrytëzuar me kujdes dhe sigurisht se janë burime të rëndësishme për historinë shqiptare, e ato janë punimet me tituj: “Organet administrative shëndetësore në Sanxhakun e Manastirit, sipas sallnames së Vilajetit të vitit 1896”, “Institucionet arsimore në Sanxhakun e Manastirit dhe të Dibrës, në fund të shekullit XIX”, dhe “Personeli i administratës islame në vitin 1915, sipas sallnamës Ilmije”.

Pjesa e dytë apo e fundit e librit në fjalë janë recensione që akademik Feti Mehdiu bën vlerësime për disa nga libra të botuara nga autorë si: Iljaz Rexha, Muhamed Arnauti, Ahmet Qeriqi dhe Qemal Morina.

Libri i akademik Feti Mehdiut “*Reflektime të luftës së shqiptarëve për Pavarësi 1389-1999*”, sado që puni-

met e botuara janë shkruar dhe janë përkthyer para disa viteve në periudha të caktuara, këto punime edhe sot e kësaj ditë mbeten punimet për të cilat studiuesi mund t'ju referohet, me një fjalë janë punime që i kanë qëndruar kohës. Prandaj, botimi në një vepër siç ka vepruar autori, do t'ua lehtësonte hulumtimin studentëve dhe studiuesve që dëshirojnë të merren me këto periudha historike.

Autorit akademik Feti Mehdiut, i dëshiroj shëndet dhe punë të mbarë edhe në shkrimin e veprave tjera, kurse Shoqatës së Orientalistëve të Kosovës, fillim të mbarë në botime nga kjo fushë, sepse albanologjia ka nevojë për këto botime dhe gjithashtu ende vazhdon të ndihet e mangët në këtë aspekt.

NË SHENJË PËRKUJTIMI

Hajrullah Hoxha

Mulla TEFIK ef. GASHI (shkurt 1943 - dhjetor 2013)

Mulla Tefik ef. Gashi, Allahu xh.sh. e mëshiroftë, u lind me 15 shkurt 1943, në fshatin Majac komuna e Podujevës, nga babai H. Sulejmani dhe nëna Zejnije. Ai rrjedh nga një familje me tradita të dalluara fetare dhe atdhetare. Këtë më se miri e dëshmon fakti kur dihet se stërgjyshi i tij H. Idrizi, qysh në kohën e sundimit të Turqisë në vitin 1904, e kishte kryer detyrën e haxhit, kur njerëzit, shkonin në Qabe me kuaj dhe me deve.

Rrugën e devotshmërisë fetare e ndoqën edhe pasardhësit e tij, H. Fejza i biri dhe nipi i tij H. Syla, përkatësisht babagjyshi dhe babai i mulla Tefikut. H. Syla ka qenë njeri i devotshëm dhe dashamirë i dalluar i fesë. Leximin e Kur'anit e kishte më-



Mulla TEFIK ef. GASHI
(1943-2013)

suar nga hoxha i njohur mulla Bahtir Gashi, ndërsa detyrën e haxhit e kishte kryer në vitet e shtatëdhjeta të shek. të kaluar.

Pas vendosjes së mulla Bahtirit në Prishtinë, H. Syla ua kishte mësuar kushtet e fesë Islame dhe leximin e Kur'anit një numrit të madh të djemve dhe vajzave të lagjes së tij e më gjërë. Si autodidakt i zellshëm ishte lexues i rregullt i shtypit fetar, që botohej si në Sarajevë në gjuhën boshnjake ashtu edhe në Prishtinë në gjuhën shqipe. Nga dashuria e madhe që kishte ndaj fesë Islame, s'pari e dërgoi djalin e madh Tefikun në medresenë Alaudin në Prishtinë, e pastaj edhe djalin e tretë Jusufin.

Shkollën fillore katër vjeçare mulla Tefik ef. Gashi e kreu në vendlindje dhe në vit. 1955 u regjistrua në medresenë e ultë Alaudin në Prishtinë. Pas kryerjes së medresesë, ai u regjistrua në medresenë e Gazi Hysrev begut në Sarajevë dhe diplomoi në vitin 1965. Me qëllim të shkollimit të mëtejshëm u regjistrua në universitetin e Beogradit, dega e orientalistikës. Pas një kohë të shkurtër, ai takohet rastësisht në Bajrakli xhami me ambasadorin e atëhershëm të Irakut në Beograd, i cili i premton ndihmën e tij nëse dëshiron, për të studiuar në Bagdat. Një ofertë të tillë mulla Tefiku e pranon me kënaqësi dhe pas nxjerrjes së pasaportës, shkon dhe regjistrohet në Universitetin e Bagdatit. Pas diplomimit të tij në vit. 1971, ai kthehet në Prishtinë dhe e paraqet kërkesën për punësim në Bashkësinë Islame. Edhe pse ishte ndër kuadrot e para që kishte diplomuar në botën Islame, ai u detyrua dy-tre vite të qëndrojë i papunësuar, ngase si organet e pushtetit ashtu ato të bashkësisë Islame kishin një lloj rezerve ndaj kuadrit të ri të diplomuar. Pas një kohe të shkurtër që kishte punuar në agjensinë Turist Kosova, në vit. 1974 ai ishte pranuar si edukator në medresenë Alaudin në Prishtinë, ndërsa pas një viti ishte emëruar mësimdhënës i lëndës së Kur'anit, të cilën e dha plot 33 vjet deri në shkuarjen e tij në pension në vit. 2008. Krahës detyrës së lartpërmendur, Mulla Tefiku për një kohë të gjatë e kreu edhe detyrën e imamit në xhaminë e Majacit.

Për të pasur një pasqyre sa më të qartë mbi jetën dhe veprën e mulla Tefik ef. Gashit, me këtë rast po e shënojmë një pjesë të intervistës

së tij dhënë revistës Dituria Islame nr. 234, janar, vit. 2010, përmes kryeredaktorit të saj Z. Rexhep Suma:

“Prof. Tefik ef. Gashi është njëri nga profesorët më të shquar të lëndës së Kiraetit apo Kur’anit, që punoi përgjatë 33 vjetësh në medresenë “Alaudin” të Prishtinës. Mësimdhënës i afërt, i sjellshëm me nxënës, i singjertë. Reflektonte butësi dhe dashuri në mësimet e tij. Ishte pikëmbështetje për zgjidhjen e shumë problemeve me të cilat ballafaqoheshin nxënësit. Njeriu që nuk ia ktheu shpinën vatanit, as gjatë fushatës së bombardimeve të NATO-s të vitit 1999.

“Dituria Islame”: Jeta studentore është jeta më e bukur e njeriut, a ishte edhe për ty kështu, edhe pse studioje në Bagdad?

Prof. Tefik Gashi: Nuk ka dyshim se po. Sa për kuriozitet, udhëtimin me tren në relacion Prishtinë - Bagdad e kam bërë për tri ditë vetëm, pa asnjë shok. Normalisht që 15 ditët e para ishin shumë të lodhshme për mua, sa që mu mërzi gjithçka dhe desha të kthehesha, por një shok nga Turqia më bindi të qëndroja. Në atë kohë nuk kishte institut të gjuhës dhe u detyroja të hyja drejt në fakultet që ishte një sfidë e veçantë për mua, por me angazhim dhe punë sistematike, i përfundova studimet në afat optimal. Pra në Irak qëndrova nga 1966 deri me 1971, kur diplomova në fakultetin “Kul-lijetu esh-sheriatu vel adab” (fakulteti i sheriatit dhe filologjisë) dhe isha shqiptari i parë në Bagdad. Më pastaj, gjatë pushimeve verore pata marrë dokumentet dhe të 10 studentëve të tjerë që u pranuan në Bagdad. Unë endë kam respekt të veçantë për popullin irakian dhe profesorët e mi, sepse vërtetë kanë qenë të dashur dhe të afërt me ne. Dhe vazhdimisht kemi qenë të shoqëruar nga ana e tyre, po edhe sjelljet tona kanë qenë në përputhje të plotë me Islamin. Për çdo vërejtje që kishin ndaj ndonjë studenti shqiptar mu drejtoheshin mua. Ishte vërtet një jetë e kënaqshme dhe më e ëmbla, po edhe e vështirë në të njëjtën kohë. Më vonë mora edhe bashkëshorten time atje edhe atje më lindi vajza e parë. Kishte vështirësi materiale, për shok të mi nga Buhara, Malajzia etj, më ndihmonin pa e ditur unë fare. Njëherë jam ndier shumë keq, sa që i pata qortuar ashpër, por ata me ndihmonin vetëm për hir të Zotit dhe në shenjë respekti për mua.

“Dituria Islame”: Pas kthimit tuaj nga Bagdadi si i diplomuar, tre vjet keni qëndruar i papunë, apo keni punuar atje ku nuk keni dashur?

Prof. Tefik Gashi: Po, për fat të keq, sa erdha në Prishtinë, në vitin 1971, kërkova punë në Bashkësinë Islame, por, po them të drejtën, strukturat e atëhershme nuk më pritën mirë dhe u detyrova të punoja në një agjenci turistike si kontabilist dhe për të nxjerrë viza për klientë. Por, elhamdulillah, me angazhimin e shkove të mi, prof. Bajrushit dhe prof. Qazimit, me 15 nëntor 1974 u pranova në Medrese si edukator dhe i disa lëndëve të tjera kur nevojitej, derisa u pensionova në vitin 2008 pra 33 vjet të plotë në arsim”.

“Dituria Islame”: Si i përshkruani marrëdhëniet me kolektivin por edhe me nxënësit në atë kohë?

Prof. Tefik Gashi: Dua të them se marrëdhëniet tona në kolektiv ishin të shkëlqyera dhe kurrë me askënd, për sa kam qenë në arsim, s’kam pasur as problemin më të vogël. Medreseja për mua ka qenë shtëpia ime e dytë, dhe kam pasur një jetë e kujtime të ëmbla nga gjithë ato vite. Normalisht që gjithnjë udhëtimin nga fshati im, në fillim e bëja në këmbë, e pastaj me autobus dhe më vonë me makinë. Kur hyja në medrese, lehtësohesha nga lodhja dhe ndieja një kënaqësi shpirtërore.

“Dituria Islame”: Jeni ndër edukatorët dhe profesorët sjellja dhe morali i të cilëve ka reflektuar vazhdimisht në formimin e personalitetit të nxënësve?

Prof. Tefik Gashi: Puna ime si profesor kërkonte të isha vazhdimisht afër me nxënësit, ndoshta shumë raste më i afërt se vetë prindi. Nxënësi për mua ka qenë gjithçka dhe kujtoj me ëndje gjeneratat që kanë dalë nga duart tona. Unë vazhdimisht e konsideroja nxënësin si shok dhe kisha kënaqësinë shpirtërore, sidomos me ata që mësonin mirë dhe ishin të zellshëm. Shpeshherë më ta bisedonim dhe për gjera private dhe ata kishin besim në mua. Gjithmonë jam munduar të jap

maksimumin tim në edukimin dhe formimin e gjeneratave të reja, ngase këtë e ndienim si obligim fetar e kombëtar.

“Dituria Islame”: *Gjatë okupimit klasik të Kosovës, në periudhën 1989-1999 keni qenë profesor. Si i kujtoni ato vite kur për çdo ditë duhej të udhëtonit nga fshati Majac në Prishtinë, me gjithë vështirësitë e shumë postblloqeve serbe?*

Prof. Tefik Gashi: Të jeni të bindur se ato kohë janë të paharrueshme dhe inshallah ma kurr s’i përjeton populli ynë. Më shumë e kishim gajle për nxënësit tanë sesa për familjet tona, sepse ne kishim përgjegjësi drejtëpërdrejtë për ta; ata ishin emanet yni. Në atë kohë drejtor i medresesë së mesme “Alaudin” të Prishtinës ishte Prof. Naim ef. Tërnavë. Ne profesorët dhe edukatorët ishim nën kujdestari permanente, sepse kishim frikë se mos po u ndodhte ndonjë e keqe nxënësve tanë. Edhe fundi na erdhi shumë keq, u ndamë. Unë kam qenë në medrese deri më 31 mars; dhe kur filluan bombardimet, ne kemi zhvilluar mësim në medrese. Në atë kohë me vete kisha 30 nxënës, të cilët nuk i lejonim të shkonin në shtëpitë e tyre në Drenicë, për shkak të sigurisë dhe, si përfundim, serbët hynë në Medrese po ne dolëm prapa Medresesë dhe shpëtuam. Prof. Naimi këtë situatë e pati menaxhuar shumë mirë dhe shpeshherë ia kujtoj atij duke i thënë: “Medresenë nuk guxon kush me e prekë”. Më thoshte: Pse, nga e di ti? I thosha: “Medreseja është ngritur me sadaka dhe djersë të popullit, prandaj s’ka me guxue kush me e prekë as damtue”.

Dhe kështu, pasi kishin filluar bombardimet e NATO-s mbi caqet serbe, më 31 mars 1999 unë, me familjen time dhe Naimi me familje, e lëshuam Prishtinën duke u drejtuar për Shtime, ku kemi qëndruar në shtëpinë e Ahmet Sadriut në Davidovcë, një muaj të plotë, për se e falënderojë, se kemi pasur mikpritje bujare e vëllazërore, që asnjëherë nuk e harroj...

“Dituria Islame”: *Më fal, sa ishte e vështirë t’ia ktheje shpinën Medresesë?*

Prof. Tefik Gashi: Unë, kur e kamë lëshuar Prishtinën, kam menduar se më kurrë nuk do të ktheheshim në vendin tonë. S’e dija se ku po na çonte fati. Por deshi i Madhi Zot, e u ktheva, se unë s’dola jashtë fare, edhe pse kisha presione prej familjes që ta lëshonim Kosovën, po unë isha i vendosur që kurrë të mos e lëshoja vendin. Prandaj, më 30 prill u ktheva në Prishtinë, e cila digjej flakë dhe kundërmonte erë baruti gjithandej, dhe u vendosa tek vëllezërit e mi në lagjen Emshir, edhe pse nuk e dija a ishin gjallë ata apo jo. Ndërkaq, të tre djemtë e mi kanë qenë në radhët e UÇK-së në rajonin e Llapit.

“Dituria Islame”: *Çfarë mesazhi keni për profesorët e Medresesë?*

Prof Tefik Gashi: Kam dëshirë të jenë të bashkuar e të unjësuar në qëndrime e punë. Të punojnë si anëtarë të një familjeje. Të ndihmojnë njëri-tjetrin. Suksesi nuk është vetëm brenda katër mureve të klasës, sepse nxënësit të përcjellë edhe jashtë klase. Të kenë një dashuri mes vete fi sebililah (vetëm për Zot). Të kenë obligim moral ndaj nxënësve, edhe ndaj atyre nxënësve që janë pak problematikë, t’i ndihmojnë më shumë që edhe ata të kenë sukses. Profesorët është e pamundur që të kenë të gjithë dituri në të gjitha fushat, por duke ndihmuar dhe përkrahur njëri-tjetrin, do të korrin rezultate.

Ndërsa Dr. Fehmi Krasniqi në veprën e tij: “Majasi - Lugina e Kaçanollit me rrethinë 1912-2000, botuar në vit. 2006 në Prishtinë, personalitetin dhe veprën e mulla Tefikut i vlerëson në këtë mënyrë: “Ishte aktivist i shquar dhe përkrahës i aksioneve të shumta, për rregullimin e rrugës së fshatit Majas, për ndërtimin e shkollës fillore “Drita” në Majas, e sidomos ka merita të pazëvendësueshme për përhapjen, formimin dhe ngritjen e fesë Islame në Majas dhe më gjerë. Është iniciatorë i ndërtimit të dy xhamive në Majas, ka merita të mëdha në edukimin, arsimimin dhe punësimin e shumë të rinjve të fshatit, ku gjithnjë ishte dashamir, përkrahës dhe solidar i brezit të ri dhe i gjithë popullatës”.

Personalisht me mulla Tefik ef. Gashin më lidhin kujtime të shumta të paharrueshme si nga shkollimi në medresenë e Prishtinës dhe të Sarajevës ashtu gjatë shërbimit tonë shumëvjeçarë në Bashkësinë Islame. Me të gjithnjë kemi pasur marrëdhënie të ngushta shoqërore dhe shpeshëherë i kemi shkuar njëri tjetrit.

Ndër problemet e mëdha më të cilat u përballëm gjatë shkollimit tonë në Sarajevë ka qenë edhe çështja e udhëtimit me tren që zgjaste më tepër se 24 orë. Sidomos gjatë stinës së dimrit për shkak të ftohtit dhe numrit të madh të udhëtarëve cilët udhëtonin me rastin e festave në relacion Sarajevë - Fushë Kosovë dhe anasjelltas, udhëtimi ishte i padurueshëm. Andaj shpeshherë ka ndodhur që gjatë tërë kohës kemi qenë të detyruar të qëndrojmë në këmbë nëpër korridoret e vagonëve të trenit. Për fat të keq shumica dërmuese e këtyre udhëtarëve ishin shqiptarë. Disa prej tyre ishin duke kryer shërbimin e detyruar ushtarak në Sarajevë, Mostar, Dubrovnik dhe qytete tjera kurse të tjerët për shkak të kushteve të vështira ekonomike në Kosovë në këto qytete ishin duke punuar si punëtorë fizik.

M.Tefiku ka qenë i gjymert edhe sa ishte nxënës. Një ditë vikendi në Sarajevë duke shëtitur nëpër qytet ai na fut në një ëmbëltore. Kur desha unë për t'i paguar edhe pse ma herët kishte huazuar disa të holla nga unë, ai kurrësi nuk më lejoi duke thënë se me qëllim të tillë kishte marrë të hollat hua nga unë.

Gjatë studimeve të tij në Bagadat, ai më ka bërë një shërbim të madh duke me abonuar në revistën e njohur mujore "Et-Terbijetul - Islamije". Kjo revistë më ka ardhur rregullisht gratis deri pas viteve të tetëdhjeta, nga e cila kam mësuar shumë gjëra të çmueshme ngase ka qenë më përmbajtje të pasur.

Mulla Tefik ef. Gashin e karakterizonte aftësia e mirëfilltë profesionale, devotshmëria, modestia, sinqeriteti, bujaria, drejtësia, guximi intelektual dhe patriotizmi fetar dhe atdhetar. Ai si me shokë, ashtu me nxënës dhe me njerëz në përgjithësi ka qenë i sjellshëm, i dashur, i shoqëruar, i afërt, i hapur dhe komunikativ. Andaj si i tillë kudo që ka punuar dhe vepruar ka lënë mbresa të pashlyera pozitive.

Pas një sëmundje kogja të gjatë të cilën e përballonte me durim në mënyrë Islame, më 25 dhjetor 2013, mulla Tefik ef. Gashi ndërroj jetë në moshën shtatëdhjetë vjeçare. Ai u varros me nderime të larta pas namazit të drekës në fshatin e tij në Majac. Në varrimin e tij mori pjesë një numër jashtëzakonisht i madh i farefisit, shokëve, miqve dhe dashamirëve, nga viset e ndryshme të Kosovës dhe nga Maqedonia e Mali i Zi. Për punën dhe kontributin e tij shumëvjeçarë, në emër të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës dhe medresesë Alaudin foli, mulla Reshat Mexhidi, ndërsa në emër të Këshillit të Bashkësisë Islame të Podujevës foli kryetari i tij mulla Bekim Jashari. Namazin e xhenazes ia fali dhëndëri i tij, mulla Idriz Bilalli imam në xhaminë kryesore të Podujevës.

Mulla Tefik ef. Gashi la pas vetës familjen e tij shumëanëtarëshe: bashkëshorten, katër djem, pesë vajza, dhe disa nipa e mbesa, të gjithë të edukuar në frymën Islame.

Dy djem të tij e kanë kryer medresenë Alaudin në Prishtinë, ndërsa dy të tjerët kanë kryer një kolegji Islamik dyvjeçar në Dubai. Një vajzë e tij gjithashtu e ka kryer medresenë ndërsa katër të tjerat kanë mësuar leximin e Kur'anit. Për veç një vajze të tjerat janë të martuara për hoxhallarë.

Përveç anëtarëve të familjes dhe farefisit të gjërë, mulla Tefiku la pas veti edhe një numër të madh të shokëve, miqve dhe shumë gjenerata nxënësish të cilët për herë do ta përkujtojnë me respekt të lartë duke iu lutur Allahut xh.sh. që ta mëshirojë.

Prandaj me pjesëmarrjen e tij në ndërtimin e hajrateve, me mësimin e më se 33 gjeneratave për ta lexuar Kur'anin, dhe me mësimin dhe edukimin e familjes së vet në frymën Islame, mulla Tefik ef. Gashi ka arritur të jetë në mesin e atyre tri kategorive të njerëzve për të cilët Muhamedi a.s. ka thënë se edhe pas vdekjes nuk do t'u ndërpritet regjistrimi i sevapeve të tyre, nga veprat e tilla të lëra pas vetes.

Personaliteti i Tefik efendi Gashit dhe veprimtaria e tij si edukator, mësimdhënës, shok, bashkëshort dhe si prind i suksesshëm duhet të jetë shembull dhe model jetësorë për të gjithë ata që punojnë dhe

veprojnë në kuadër të institucioneve të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe më gjerë.

Ndërrimi jetë i shokut të tillë, të dashur e të ngushtë dhe ndarja nga ai na ka pikëlluar jashtëzakonisht shumë, megjithatë na ngushëllon shpresa se do të takohemi me të në botën tjetër për të cilën Allahu ka thënë se ajo është me e mirë se kjo botë dhe e gjithmonshme.

Në fund e lusim Zotin e madhërishtëm që për këtë kontribut të tij shumëvjeçarë në interes të Islamit dhe myslimanëve, ta shpërblejë atë me xhenet-i Firdevs!

NË SHENJË PËRKUJTIMI

Faik Miftari

NDËRROI JETË PROFESOR, DR. MUHAMET PIRRAKU (1944-2014)

Lajmi për vdekjen e profesorit Muhamet Pirrakut nuk më befasoi shumë, pasi që herën e fundit kur e pash në media me rastin e promovimit të librit të tij të fundit, monografi kushtuar Hasan Prishtinës me titull: "Hasan Prishtina, vlerë sublimë e kombit" më 22 nëntor 2013, e pashë të zbehur, pasi që vuante nga sëmundja, dhe se i ishin afruar ditët e fundit të jetës në këtë botë kalimtare, ngase që të gjithë neve jemi të Zotit dhe tek Zoti do të kthehemi, kush më herët e kush më vonë.

Posa mora lajmin për vdekjen e tij, lexova një Fatihë për shpirt të tij dhe bëra dua (lutje) që Krijuesi Fuqiplotë ta mëshirojë me mëshirën e tij të gjithëmbarshtme shpirtin e tij të ndritur, ky ishte obligimi im moral në aspektin fetar ndaj profesorit të nderuar. Po për respektin që kisha ndaj tij, si profesor, historian, publicist, i cili me shkrime të shumta



*Dr. Muhamet Pirraku
(1944-2014)*

dhe me botimin e mbi 20 librave ka lënë gjurmë përherë të shënuar në historiografinë e re shqiptare, e ndjeva edhe një obligim njerëzor që ta përkujtoj me këtë shkrim post mortum (pas vdekjes), historianin drencak Muhamet Pirrakun.

Që nga libri i tij i parë i botuar me titull "Kultura kombëtar shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit" e gjer në librin e tij të fundit të botuar me titull "Hasan Prishtina, vlerë sublimë e kombit" historiani Muhamet Pirraku ka hulumtuar, studiuar, shkruar, për personalitete të shquara kombëtare e fetare, sikurse Myderriz Ymer Prizreni, Mulla Idriz Gjilani, për ngjarjet historike të popullit shqiptar, sikurse Lidhja e Prizrenit, Masakra e Tivarit etj, si dhe për shumë figura dhe personalitete të shquara shqiptare si dhe për shumë ngjarje historike nëpër të cilat ka kaluar populli i përvuajtur shqiptar.

Me profesorin për herë të parë jam takuar, qysh në fund të vitit 1989, kur e pata gjetur në shtëpinë e tij, i rrethuar me plot shkrime, gazeta, revista e libra të shumta në dhomën e tij. Po nuk erdha rastësisht, por me një detyrë dhe lutje për të kryer një punë sa profesionale por edhe nacionale për momentin gjatë së cilës kalonte populli shqiptar në ato çaste të vështira në Kosovë, e që do të vazhdojë plot një dekadë e tërë (1989-1999). Në atë kohë sapo pat fituar në Bosnjë ish kryetari Alija Izetbegoviçi dhe partia e tij SDA-ja, e në Kosovë pusheteti serb e kishte suprimuar autonominë dhe veç e përforconte kontrollin e tij të plot politik, ekonomik, të sigurisë, policor mbi Kosovën, Ismet Kasumagiçi njëri i afërt me Alia Izetbegoviçin, i cili së bashku me te ka qenë i dënuar dhe në burg në procesin e montuar të Sarajevës të vitit 1983, më kërkoi prej meje që të ja dërgoj një histori të shkurtër të popullit shqiptar prej ekzistimit e gjer në ditën e sotshme nëpër të cilin kalonte Kosova. Në atë kohë isha absolut, dhe pas bisedave me shokë, duke menduar se kush do të kishte kryer këtë detyrë me përpikëri dhe me plot vullnet, më sugjeruan që këtë do të bëjë më së miri profesori i nderuar Muhamet Pirraku. Kur ja shtrova kërkesën profesorit, me gjithë dëshirë dhe vullnet e pranoi, dhe për një kohë të shkurtër tha do të kesh gati, "pasi që neve jemi të lidhur me boshnjakët që nga koha e periudhës osmane, dhe kemi prejardhje të njëjtë nga

ilirët, të dytë jemi popull autokton në Ballkan, dhe të dytë na bashkon identiteti islam që e kemi, dhe se gjatë periudhave të ndryshme historike kemi përjetuar shumë luftëra, masakra, ndjekje, shpërngulje, e po kam frikë që prapë do të na përsëritet, por nuk e di a neve përpara populli shqiptar në Kosovë, apo popullit boshnjak në Bosnjë”. Pas kësaj materialin e përgatitur e përkthyer në gjuhën boshnjake dhe ja dërguam z. Ismet Kasumagiçit në Sarajevë, i cili më tutje e përktheu në disa gjuhë botërore dhe materialin e përgatitur nga profesor Muhamet Pirraku për një histori të shkurtër të shqiptarëve dhe Kosovës, në formë memorandumit i përcolli në shumë qendra të ndryshme botërore për sensibilizimin e çështjes shqiptare në ish Jugosllavi në përgjithësi e Kosovës në veçanti. Ishte koha kur detyrat i kryenim me përpikëri dhe pa lënë gjurmë, në veprimtarinë tonë për çështjen e Kosovës.

Profesori i nderuar Muhamet Pirraku do të mbetet në kujtim të thellë, pasi që ka qenë intelektual i rrallë, gjatë kohës së monizmit, por edhe pas saj i anatemuar, që në mënyrë shkencore dhe në bazë të të dhënave faktografike, ka shpjeguar dy fakte tejet të rëndësishme të historisë së popullit shqiptar, për rolin e fesë islame dhe Lidhjes e Prizrenit si bazament të krijimit, ruajtjes dhe mbijetesës së popullit shqiptar në përgjithësi e Kosovës në veçanti. Më poshtë do të cek disa thënie të tij për këto dy fenomene:

“Sa u përket shqiptarëve të Kosovës dhe trojeve tjera shqiptare, me anë të islamizmit u ndal procesi i tjetërsimit etnik, sepse me parqitjen e islamizmit u ndërpre procesi i nivelimit kulturor dhe etnik serb në viset e Kosovës dhe rajoneve tjera të banuara me shqiptarët”. “Islami për shqiptarët është fe e periudhës së humanizmit dhe renesancës”. “Civilizimi islam ka qenë faktori kryesor i qenies kombëtare shqiptare, faktori që e përcaktoi dhe e përkufizoi arealin e Shqipërisë etnike në shekujt XV-XVII, që i dha emrin kombëtar, popullit dhe atdheut, shqiptar e Shqipëri”.

“Për ta kuptuar më drejtë problemin e shtruar, duhet të vëmë në spikamë faktin historik se uniteti fe-kombësi në periudhën e Rilindjes Kombëtare dhe të formimit të shteteve nacionale kudo në Evropë ka qenë Një dhe e pandashme, sikurse edhe në të gjitha luftërat nacional-

çlirimtare. Ndaj, nga kjo nuk mund të ishte i privuar as populli shqiptar, veçanërisht kur dihej se në rrethana të robërisë nën secilin pushtues ballkanik ortodoks apo evropian katolik, pjesës absolute të kombit shqiptar i rrezikoheshin të dyja, feja dhe kombësia. Dhe, kur të kihet parasysh fakti se shqiptarët myslimanë arrinin mbi katër të pestat e numrit të përgjithshëm të shqiptarëve, del qartë se kombi shqiptar realisht ishte komb mysliman, ndaj është plotësisht logjike pse forcën mendore dhe ushtarake të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e përbënin shqiptarët myslimanë”

Në fund të këtij shkrimi për profesorin Muhamet Pirraku do e përfundoja me fjalët, jetove shkurt në këtë botë të përkohshme, por ke lënë materiale të shumta të shkruara dhe të botuara për historiografinë e popullit tonë shqiptar, të cilët do të jenë fanar ndriçues për gjeneratat e ardhshme të studentëve, historianëve dhe studiuesëve të rinj.

Pas një sëmundje të rëndë dhe të gjatë, në moshën 70 vjeçare, vdiq prof. dr. Muhamet Pirraku. në orën 11.00 në Institutin e Historisë, në Prishtinë u mbajt një mbledhje komemorativë më 1.02.2014 ku drejtori i Institutit Dr. Hysen Matoshi foli mbi jetën dhe veprën e Dr. Muhamet Pirrakut. Ndërsa në orën 15:00 para varrimit të tij u mbajt tubimi përkujtimor në shkollën e fshatit të lindjes së tij në Flamuras (ish Sanakovc) në të cilin folën: Dr. Ragip Gjoshi, zëvendësministër për arsim, shkencë dhe Kultur të Republikës së Kosovës, veprimtari i dalluar i çështjes kombëtare zotëri Adem Demaqi dhe Dr. Mehmet Rukiqi.

Namazin e xhenazes së Dr. Muhamet Pirrakut ia fali miku i ngusht i tij mulla Hajrullah Hoxha i cili pran arkivolit të tij tha: “Prof. Dr. Muhamet Pirraku ka qenë një intelektual i mirëfilltë, dalluar dhe i pakrahasueshëm. Si i tillë gjatë tërë jetës së tij, si me fjalë ashtu me vepra e ka mbrojtur të vërtetën e çështjes kombëtare dhe fetare. Andaj e lusim Zotin e Madhërisë që ta shpërblejë me xhenet për kontributin e tij të çmueshëm të dhënë në interes të kombit shqiptar dhe fesë islame”.

Dr. Muhamet Pirraku u varros në vendlindjen e tij në Flamuras, K.K. Drenasit, me nderime të larta në mënyrë madhështore. Përveç farfisit, shokëve dhe miqve, në varrim morën pjesë me mijëra njerëz të

ardhur jo vetëm nga viset e ndryshme të Kosovës, por edhe nga trojet tjera shqiptare.

Në vazhdim po shënojmë disa vlerësime të publicistit të njohur Ahmet Qeriqit, për personalitetin dhe veprimtarinë patriotike të Dr. Muhamet Pirrakut:

U nda nga jeta historiani që asnjëherë nuk u zmbraps nga e vërteta shkencore, pavarësisht pasojave.

Dr. Muhamet Pirraku ishte në mesin e historianëve e veprimtarëve të vendit, i cili në asnjë segment të punës së tij shkencore nuk bëhej zap, nuk ndalonte rrugëtimin, por gjithnjë bënte një hap tutje, gjithnjë shkonte më tej, në kërkim të dijes dhe në gjurmim të së vërtetës, të asaj të vërtete, që qëndron në ballë të universit dhe për zbardhjen e së cilës është dashur dhe gjithnjë duhet të derdhet shumë mund dhe shumë përballje me forcat e errësirës, të cilat nuk kanë pushuar as po pushojnë dot për ta megjulluar atë, për ta deformuar dhe për ta tjetërsuar.

I lindur dhe i rritur në Drenicën e heroizmit dhe kryengritjeve shqiptare nga shekulli në shekull, dr. Muhamet Pirraku, interesimin e tij për ta ndriçuar historinë shqiptare e kishte edhe frymëzim familjar, duke qenë pjesëtar i një familjeje të përndjekur nga regjimet okupatore.

Në hulumtimet dhe studimet e tij, ka arritur të lërë gjurmë të thella në ndriçimin e shumë segmenteve studimore nga e kaluara e sidomos nga periudha e Rilindjes Kombëtare dhe nga historia e vazhdueshme e Rezistencës kombëtare, deri te Ushtria Çlirimtare e Kosovës e më pastaj, gjithnjë në përpjekje të vazhdueshme për t'i ruajtur vlerat e mirëfillta kombëtare. Ishte thellë i vetëdijshëm se politikat e caktuara kanë deformuar dhe deformat historinë, andaj me tërë qenien iu përkushtua ndriçimit të së vërtetës dhe ruajtjes me çdo kusht të identitetit kombëtar të shqiptarëve, i cili jo vetëm njëherë ishte rrezikuar si nga Roma e Bizanti, ashtu edhe nga Perandoria Osmane dhe nga sllavët.

Në mesin e një duzine të librave të botuara, një përkushtim të madh historiani, Muhamet Pirraku i ka kushtuar veprimtarit të mirë-

njohur të çështjes kombëtare, Hasan Prishtina, jetën dhe veprën e të cilit e ka analizuar në të gjitha segmentet, me fakte relevante historike dhe me studime interdisiplinare. Duke qenë i lidhur ngushtë me këtë personalitet të historisë sonë, duke qenë njohësi më i mirë dhe më i thellë i biografisë së tij, ai edhe pse i rënduar nga shëndeti, në dy vitet e fundit të jetës u detyrua sërish ta “zhvesh shpatën”, ashtu si dikur “Gjergj Elez Alia” i kujtesës popullore shqiptare, për ta mbrojtur Hasan Prishtinën nga pseudoshkenca dhe nga manipuluesit e sotëm, të cilët pretendojnë që me para të blejnë madje edhe origjinat e personaliteteve të mëdha të kulturës dhe historisë sonë kombëtare.

Me aq forcë që i kishte mbetur në muajt e fundit të jetës, kishte arritur ta nxirrte në dritë monografinë e plotë shkencore për Hasan Prishtinën, duke i ndërtuar bazamentin e vërtetë dhe të përjetshëm.

Dr. Muhamet Pirraku i ka dhënë shumë shkencës së historisë, i ka dhënë shumë Kombit e Atdheut dhe nuk ka përvetësuar asgjë, përveç autoritetit dhe të mirave që i ka gëzuar falë aftësive, punës, mundit dhe djersës së vet.

Ai do të mbetet shembulli i historianit këmbëngulës, i historianit atdhetar, i cili eci hapave të rilindësve, hapave të Lëvizjes Kombëtare shqiptare, hapave të luftës për liri, duke qenë një kronist realist dhe gjithnjë besnik i së kaluarës, interpretues e hartues i teksteve të historisë, autor i rreth 50 veprave, qindra studimeve e mijëra shkrimeve të ndryshme autoriale.

Shembulli i jetës dhe punës së tij të palodhshme, korrektësia shkencore, dija historike dhe përgjithësisht dija shkencore, dr. Muhamet Pirrakun e radhisin në “Gardën e nderit” të historianëve shqiptarë.

Jeta dhe veprat e Dr. Muhamet Pirraku

Prof. dr. Muhamet Pirraku, ka lindur në fshatin Flamuras (ish-Sankoc) të Drenasit, më 12 tetor 1944.

Shkollën fillore tetëklasëshe e mbaroi në vendlindje dhe në Bushat (ish Komaran), Shkollën e Mesme Bujqësore në Prishtinë, ku e mbaroi edhe Fakultetin Filozofik - Degën e Historisë. Studimet pasunivers-

sitare i kreu në Universitetin e Zagrebit dhe magjistroi në tezën “Rinia përparimtare e Kosovës 1919-1941”, më 29 tetor 1976. Gjashtë muaj specializoi në fushë të historisë së kulturës në Institutin e Romanistikës-Gjermanistikës në Universitetin e Vjenës, më 1979/80, kurse pas shumë krajetave politike, doktoroi, më 29 dhjetor 1988, në Degën e Historisë së Universitetit të Prishtinës, në tezën: “Kultura shqiptare prej viteve 70 të shekullin XVIII deri në vitin 1878”. Interesim për krijimtari letrare shfaqti nga viti i dytë i shkollës së mesme, ndërkaq shkrimin e parë nga fusha e historisë së kulturës e botoi si absolvent në histori, më 7 prill 1968.

Për aktivitet politik shqiptar dhe antijugosllav u përcaktua më 10 shtator 1960, kur u betua para flamurit kombëtar dhe veprimtarit politik, Fazli Graiçevci - tashmë dëshmor i kombit: Me 10 tetor 1960 organizoi tri klasat e dyta të Shkollës Bujqësore, të bojkotonin mësimin në gjuhën serbo-kroate, u priu në Këshillin Ekzekutiv të Krahinës së Kosovës dhe mbrojti kërkesën e nxënësve: “Mësimet në Shkollë të zhvillohen në gjuhën shqipe...!” Nga tashti do të shquhet me aktivitet disident në lëmë të edukimit politik kombëtar shqiptar në mjediset ku jetoi e veptoi. Nga mesi i vitit 1964 i përkiste grupit të intelektualëve në formim e sipër, të njohur si “Çeta e Bajo e Çerqiz Topulli”, të cilët e koordinonin aktivitetin politik shqiptar të Ilegalës patriotike shqiptare me disidentizmin në veprimtarinë politike, kulturore, arsimore, publicistike e shkencore.

Dr. Muhamet Pirraku në vitet shtatëdhjeta disa kohë e ka dhënë lëndën e historisë në medresenë e Mesme “Alauddin” në Prishtinë. Pas daljes së revistës fetare “Dituria Islame”, ai në disa numra të saj, kohë pas kohe botoi disa punime të çmueshme.

Pirraku do të shquhet si përhapës i literaturës beletristike, filozofike e historiografike të botuar në Tiranë dhe nga Mërgata shqiptare në Evropë dhe SHBA dhe si gjurmues e studiues i frytshëm me ndikim të madh qysh nga viti 1968. Nga mesi i viteve të '70 dhe në vitet e '80-ta, për shkaqe politike antijugosllave, mbi 15 vjet pati ndalesa e pengesa për botim e veprimtari shkencore, prej të cilave dhjetë vjet me ndalesë të plotë. Prej 4 gushtit 1981 deri më 4 gusht 1982 u mbajt

në burgjet e qarkut të Prishtinës, të Mitrovicës dhe të Sarajevës, kurse jashtë Institutit Albanologjik deri më 13 dhjetor 1983. Me rastin e burgosjes iu konfiskuan rreth dhjetë mijë faqe në dorëshkrim: shënime të kujtesës historike, punime shkencore, ditarë, vargje poetike si dhe literaturë historiografike, politike e filozofike.

Nga kjo kohë deri në fillim të vitit 1990, për të ndikuar në rrjedhat politike e historiografike, në një anë, dhe për ta ushqyer shpirtin krijues, në anën tjetër, u detyrua t'i botojë, pa emrin e tij, disa trajtesa, studime dhe dy vepra, ndër më emblematiket për Isa Boletinin dhe për Hasan Prishtinën.

Edhe në rrethana të tilla, nga lëmi i publicistikës, i kulturës dhe i shkencës historiografike, deri tashti, M. Pirraku botoi mbi 477 zëra bibliografikë - artikuj, trajtesa, recensione, kritika, fejtone, studime në mbi 810 numra të shtypit ditor, javor e mujor dhe në revista shkencore. Dhjetëra nga këta zëra bibliografikë kanë madhësinë voluminoze të veprave monografike për probleme të veçanta të kulturës dhe të historisë shqiptare.

Prof. Dr. Muhamet Pirraku, duke iu përgjigjur Ftesës së ndërgjegjes së vetë, pati rol të rëndësishëm në Lëvizjen për Pajtimin Gjithëshqiptar (përmes faljes së gjaqeve dhe të hasmërive) - 2 shkurt 1990-17 maj 1992 dhe fuqimisht e mbështeti aktivitetin luftarak dhe politik çlirimtar të UÇK-së, në tri Shfaqjet e saj 1993-2001. I përcolli me kujdes trendët politike kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me statusin politik shtetëror të Kosovës nën administrimin e UNMIK-ut dhe me kohë bëri analiza historiografiko-politike në mbështetje të kauzës së shqiptarësisë dhe të shtetësisë së Kosovës.

Veprat e tjera, të botuara me emër dhe mbiemër të tij, janë:

- Historia për klasën VII (bashkautor S. Rizaj), Prishtinë, 1975, 178;
- Kultura Kombëtare Shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit, Prishtinë, 1989, 604;
- Salih Gjukë Dukagjini: Shkrolaria e shqypes (nga osmanishtja: dr. Feti Hehdiu, mr. Mehdi Polisi), Prishtinë, 1991, 188;
- Ripushtimi jugosllav i Kosovës 1945, Prishtinë, 1992, 196;

- Kalvari i shqiptarësisë së Kosovës, TIVARI 1945, Prishtinë, 1993, 74;
- Mulla Idris Gjilani dhe Mbrojtja Kombëtare e Kosovës Lindore 1941-1951, Prishtinë, 1995, 710;
- Albania e Konicës, Prishtinë, 1995, 135;
- Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët (bashkautor dhe Kryeredaktor), Prishtinë, 1995, 575;
- Lidhja Shqiptare “Besa-Besën” në burimet serbe 1892-1902, Prishtinë, 1996, 72;
- Lëvizja Gjithëpopullore Shqiptare për Faljen e Gjakeve 1990-1992. Kronikë, Prishtinë, 1998, 472;
- Për kauzën shqiptare 1997-1999, Prishtinë, 2000, 286;
- Dritë e re për kryetarin e parë të Shqipërisë Etnike (bashkautor dhe redaktor), Prishtinë, 2002, 207;
- Jo katedrale në emër të shqiptarisë së imagjinuar, Prishtinë, Prill 2003, 192. (Botim i Dytë, i zgjeruar, Qershor 2003, fq. 199).
- “Myderriz Ymer Prizreni - Ora, Zemra dhe Shpirti i Lidhjes Shqiptare 1877-1887, Prishtinë, 2003, 522;
- Arrestimet e Pjesëtarëve të TMK-së - Ç’është kjo?! (bashkautor dhe redaktor), Prishtinë, 2004, 96;
- Masakra në Burgun e Dubravës 19-24 maj 1999 (bashkautor dhe redaktor), Prishtinë 2005, 200;
- Për kauzën e UÇK-së, Prishtinë, 2006, 390.
- Muhamet Pirraku ka shkruar edhe shumë vepra të tjera, ndërsa disa muaj më parë për të dytën herë nxori në dritë monografinë: Hasan Prishtina, vlerë sublime e kombit”.

PËRMBAJTJA

Qemajl Morina	
Lufta në Siri dhe pjesëmarrja e shqiptarëve në të	5
Mr. Ejup Haziri	
Rëndësia e marrëveshjeve në islam.....	17
Dr. Fikret Karçiç	
Usuli-fikhu - metodologjia e të drejtës islame.....	41
Prof. dr. Jahja Jesribi	
Kritika dhe racionalizmi, sipas Islamit.....	55
Agim Aliu	
Studim historik dhe arkitektonik i namazgjahut të Opojës	67
Mr. Rexhep Suma	
Islami - viktimë e terrorizmit medial.....	93
Desarta Vathaj	
Pozita e femrës në Arabine Saudite	121
Mexhid Yvejsi	
Poet me ndikim në lindje dhe perëndim -	
Shejh Muhamed Ikbali (1877-1938).....	151
Mr. Qemajl Morina	
Feja si faktor për të ardhmen e Kosovës	161
Ismet ef. Limani	
Omer Ibnul-Hatabi r.a.....	175
Zachary Karabell	
Xhihadi i Salahudinit?	191
Nuridin Ahmeti	
Shqiptarët pas largimit të Perandorisë Osmane,	
sipas shtypit të kohës.....	219
Mr. Sc. Burim Bibaj	
Rëndësia e sinqeritetit në Islam dhe dobietë e tij	229
Intervista me Noel Malcolm (Birni – Jeta Xharra).....	241

Muharrem Blakçori, përkthyesi i parë i Kur'anit	
në gjuhën shqipe	257
Nuridin Ahmeti	
610 vjet historie në 100-vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë	263
Hajrullah Hoxha	
Mulla Tefik ef. Gashi (shkurt 1943 - dhjetor 2013).....	269
Faik Miftari	
Ndërroi jetë Profesor, Dr. Muhamet Pirraku (1944-2014)	279
Përmbajtja.....	289